FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.69 | 4 qershor | 2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.277, datë 10.3.2010	Për një shtesë në vendimin nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së shqipërisë", të ndryshuar……	2591

VENDIM
Nr.277, datë 10.3.2010

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.153, DATË 7.4.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, që i bashkëlidhet vendimit nr.153, datë 7.4.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, i shtohet manuali i sinjalizimit rrugor, si pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MANUALI
I
SINJALIZIMIT
RRUGOR

HYRJE

Zhvillimet bashkëkohore në rrjetin rrugor urban dhe interurban si dhe fenomenet e dukshme që janë konstatuar, e bëjnë të domosdoshëm realizimin e një manuali për aplikimin konkret të sinjalizimit rrugor në tërë gamën e tij.

Hartimi i manualit të sinjalizimit rrugor, është mbështetur në legjislacionin në fuqi :

1. Ligjin Nr. 8378, date 22.07.1998, "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë"
2. Vendimin Nr. 153, date 07.04.2000 të Këshillit të Ministrave, "Rregullore për Zbatimin e Kodit Rrugor"
3. Konventa "Mbi shenjat dhe sinjalet e rrugës" e datës 8 Nëntor 1968.

Manuali i Sinjalizimit Rrugor do të shërbejë :

1. Për të gjithë entet pronare të rrugëve si dhe subjektet projektuese e zbatuese të sinjalizimit rrugor.
2. Për studimin dhe hartimin e projekteve të sinjalizimit rrugor si dhe për mirëadministrimin e sinjaleve rrugore;
3. Për zbatimin në praktikë të kërkesave të sinjalizimit rrugor;

Duke ju referuar numrit të madh të aksidenteve të cilat kanë ardhur si rezultat i mos respektimit të rregullave të sinjalizimit rrugor të përkohshëm gjatë punimeve në rrugë apo dhe mos vendosja e këtij sinjalizimi në rastin e aksidenteve rrugore në rrugët urbane dhe interurbane edhe për shkakun e mosnjohjes së këtij sinjalizimi rrugor si dhe skemave shoqëruese për mirëmenaxhimin e trafikut rrugor gjatë punimeve në rrugë, u konsiderua e nevojshme përfshirja në këtë manual dhe i rregullave të sinjalizimit të përkohshëm rrugor, për të ndihmuar entet pronare të rrugëve të menaxhojnë integralisht trafikun rrugor duke shmangur aksidentet rrugore gjatë punimeve në rrugë si dhe efektivat e policisë rrugore në vendndodhjen e aksidentit .

SI PËRDORET MANUALI

NDARJA TEMATIKE Manuali ndahet në dy pjesë:

E PARA - Përshkruhen rregullat mbi sinjalet vertikale, horizontale bazuar në Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë, Rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor si dhe Konventën mbi shenjat dhe sinjalet e rrugës.

E DYTA – Trajtohen në mënyrë të hollësishme situatat e veçanta që hasen shpesh gjatë zbatimit, për të siguruar një qarkullim komod dhe të sigurt për përdoruesit e rrugës.*(aneksi A).*
Po ashtu trajtohen skemat "model" të vendosjes së sinjaleve të përkohshëm gjatë punimeve në rrugë si dhe në rastin e aksidenteve rrugore *(aneksi B)*

MBËSHTETËSIT Teksti është i pajisur me një seri

Skedash: Të cilat japin karakteristikat e tipeve të ndryshme të sinjaleve vertikale të trajtuara, lidhur me përmasat, ngjyrat, vendosjen dhe bashkëvendosjen, etj.
Të grupuara në renditje progresive jepen në fillim të aneksit A.

Skemash: Të cilat japin grafikisht zgjidhjen e problemeve të ndryshme, duke ndihmuar në kuptimin e rregullave të tekstit.
Të grupuara në renditje progresive jepen në aneksin A dhe në aneksin B.

Figurash: Të cilat bëjnë lidhjen grafike me argumentin e trajtuar. Janë emërtuar njëlloj si në Rregulloren në zbatim të Kodit Rrugor.
Kur nuk janë vendosur në tekst janë grupuar në renditje progresive në aneksin A.

Tabelash: Të cilat ndihmojnë për të shkruar në mënyrë të rregullt gërmat dhe numrat në rrugë dhe në sinjale. Gjithashtu shërbejnë për të zgjedhur largësitë e paralajmërimit.
Të grupuara në renditje progresive jepen në fund të aneksit A.

Pamjesh: Të cilat përmbajnë zgjedhjen e saktë të përmasave të sinjalit, karaktereve, distancave, pozicionimit, etj.
Janë të përfshira në tekst.

NENET Nenet e cituara i referohen Rregullores së Zbatimit të Kodit Rrugor, përveç rasteve kur theksohet ndryshe.

NGJYRAT Ngjyrat e figurave janë thjesht treguese. Karakteristikat e ngjyrave të përdorura në sinjalet, janë të përcaktuara në mënyrë specifike sipas neneve 76 dhe 77/9

PËRCAKTIME DHE KLASIFIKIME RRUGËSH

(neni 2 i Kodit Rrugor)

Në zbatim të normave të Kodit Rrugor, përcaktohet se "rrugë" quhet zona për përdorim publik e destinuar për qarkullimin (me qarkullim nënkuptohet lëvizja, ndalimet dhe qëndresat) e këmbësorëve, të mjeteve dhe kafshëve (neni 2/1, i Kodit Rrugor).

Rrugët përcaktohen sipas nenit 2, të Kodit Rrugor:

- *rrugë interurbane*: rrugë jashtë një qendre të banuar;
- *rrugë urbane*: rrugë brenda një qendre të banuar;
- *shtegkalim*: rrugë me bazament natyror e formuar për kalimin e këmbësorëve ose të kafshëve.
- *qëndër e banuar:* bashkësi ndërtesash, e kufizuar përgjatë rrugëve në hyrje dhe në dalje me sinjalet përkatëse të fillimit dhe të mbarimit. Me një bashkësi ndërtesash nënkuptohet një grupim i vazhdueshëm, me intervale rrugësh, sheshesh, kopshtesh ose jo të ngjashme me to, të ndërtuara nga jo më pak se njëzet e pesë ndërtesa dhe zona me përdorim publik me hyrje automjetesh ose këmbësorësh në rrugë.

Sipas karakteristikave të tyre konstruktive, teknike dhe funksionale, në zbatim të nenit 2/2, të Kodit Rrugor, rrugët klasifikohen si vijon:

- **A** - *autostradë*;
- **B** - *rrugë interurbane kryesore*;
- **C** - *rrugë interurbane dytësore*;
- **D** - *rrugë urbane kryesore*;
- **E** - *rrugë urbane dytësore*;
- **F** - *rrugë lokale.*

Rrugët e përcaktuara në këtë mënyrë, duhet të kenë karakteristikat minimale të dhëna në tabelën që vijon:

TABELA E KARAKTERISTIKAVE KONSTRUKTIVE, TEKNIKE DHE FUNKSIONALE E RUGEVE SIPAS KLASIFIKIMIT

Nr.	Klasifikimi / Përcaktime rrugore	A Autostradë	B Rrugë interurbane kryesore	C Rrugë interurbane dytësore	D Rrugë urbane kryesore	E Rrugë urbane dytësore	F Rrugë lokale
1	**Karrexhata**	të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm	të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm	të vetme me të paktën një korsi lëvizjeje për sens	të pavarura ose të ndara nga trafikndarës	të vetme	të vetme
2	**Korsi**	të paktën 2 për çdo drejtim lëvizjeje	të paktën 2 për çdo drejtim lëvizjeje	të paktën 1 për çdo drejtim lëvizjeje	të paktën 2 për çdo drejtim lëvizjeje	të paktën 1 për çdo drejtim lëvizjeje	të paktën 1 korsi lëvizjeje
3	**Korsi emergjence**	po	jo	jo	Po *	jo	jo
4	**Korsi përshpejtimi dhe ngadalësimi**	po	po	jo	eventual	jo	jo
5	**Korsi biçikletash**	jo	jo	jo	po	jo	jo
6	**Bankina**	të shtruar në të dy anët e karexhatës	të shtruar në të dy anët e karexhatës	të shtruar në të dy anët e karexhatës	të shtruar në të dy anët e karexhatës	të shtruar në të dy anët e karexhatës	eventuale
7	**Trotuar**	jo	jo	jo	Po e përshtatur për M.P.A.K.	Po e përshtatur për M.P.A.K	eventuale
8	**Kryqëzim në nivel**	jo	jo	po	po me semaforë	po	po
9	**Kryqëzim në disnivel**	po	po	jo	eventual	jo	jo
10	**Kryqëzim me rrethrotullim**	jo	po	eventual	eventual	eventual	eventual
11	**Hyrje private ose anësore**	jo	po të koordinuara	po	po	po	po
12	**Rrethim për mbrojtjen e rruges**	Po	Jo	Jo	Eventual (ne vende te vecanta)	Jo	Jo

13	**Sistem asistence përgjatë rrugës**	po të paktën çdo 12 – 15 km	jo	jo	jo	jo	jo
14	**Furnizim me karburant**	jo	Çdo 12 – 15 km	Çdo 12 – 15 km	Jo me pak se 5 km nga njeri tjetri.	Jo	Jo
15	**Destinacione të përdorimit**	Për disa kategori automjetesh	Për disa kategori të mjeteve me motorr (për kategori të veçanta mjetesh ato duhen përcaktuar)	për mjete dhe këmbësore	për mjete dhe këmbësore	për mjete dhe këmbësore	për mjete dhe këmbësore
16	**Sinjale rrugore**	po	po	po	po	po	po
17	**Semaforë**	jo	Eventual	jo	Po (me kamera të fshehta)	po	jo
18	**Vend kalimi këmbësorësh**	jo	po	po	po	po	po
19	**Vend pushimi ose Parkimi**	po	po	jo	po	po	jo
20	**Xhep ndalimi**	jo	jo	po	jo	po	po
21	**Shpëtues**	jo	po	jo	po	po	jo
22	**Monitorim elektronik i trafikut**	po (në gjithë gjatësinë)	po (vetëm në hyrje dalje qytetesh)	jo	Po (në kryqëzim mbi 1000 mjete në orë piku)	jo	jo
23	**Shpejtësia maksimale e lejuar**	110 km/h	90 km/h	80 km/h	40 km/h	40 km/h	40 km/h

* Korsi e rezervuar për mjetet e shërbimit publik si : autobuz urban, zjarfikës, ambulancë (M.P.A.K.) Mjete të personave me aftësi të kufiz

Gjithashtu është quajtuar *rrugë shërbimi* rruga që ndodhet anash rrugës kryesore (autostradë, rrugë interurbane kryesore, rrugë urbane kryesore) e cila ka funksionin e lejimit të qëndrimit, si dhe grupimin e hyrjeve nga pronat që ndodhen në krah të rrugës kryesore dhe e kundërta, si edhe për lëvizjet dhe manovrimet e mjeteve të cilat nuk lejohen në vetë rrugën kryesore (neni $2/_4$, i Kodit Rrugor).

Rrugët sipas përdorimit, funksionit dhe nevojave të karakterit administrativ, ndahen në rrugë: (neni $2/_6$, i Kodit Rrugor)

- *shtetërore;*
- *rrethi (qarku);*
- *komunale;*
- *të brendëshme;*
- *shërbimi;*
- *ushtarake;*

ku entet pronare janë përkatësisht :

- *Shteti;*
- *rrethi (qarku);*
- *bashkia, ose komuna;*
- *subjekt privat ose shtetëror;*
- *komanda e Repartit ushtarak;*

Klasifikimi i rrugëve, sipas nenit 2/2 apo sipas nenit 2/5 të Kodit Rrugor, është në kompetëncë të:

- Ministrisë që mbulon veprimtarinë e Transportit, përsa i përket rrugëve shtetërore (neni 2/7 i Kodit Rrugor);
- Rrethit (qarkut) përsa i përket rrugëve të tjera (neni 2/7 i Kodit Rrugor).

Rrugët e klasifikuara në këtë mënyrë janë të regjistruara në Arkivin Kombëtar të Rrugëve të parashikuar nga neni 220 i Kodit Rrugor.

PËRCAKTIME RRUGORE DHE TRAFIKU

(neni 3 i Kodit Rrugor)

Sipas normave të Kodit Rrugor, përcaktimet rrugore dhe të trafikut kanë kuptimin vijues: (neni $3/_{1 \div 56}$ i Kodit Rrugor) Këto skema ndodhen në aneksin A.

Bankina: pjesë e rrugës e përfshirë ndërmjet kufirit të karrexhatës dhe elementit gjatësor me të afërm: trotuarit, trafikndarësit, argjinaturës, buzës së brendëshme të kanalit, ose buzës së sipërme të skarpatës. (**Skemat 1** dhe **2**)

Brez i rezervuar: shirit toke, jashtë kufirit rrugor, në të cilën është e ndaluar për pronarin e tokës të kryejë ndërtime, rrethime, të mbjella, depozitime, etj. (**Skema 2**).

Brez për qëndrime anësore: pjesë e rrugës në anë të karrexhatës, e ndarë me një vijë kufitare të ndërprerë e që përfshin rreshtin e vendeve të qëndrimit dhe korsinë përkatëse të manovrës.
(shih kapitullin Ndalimi, Qëndrimi, dhe Pushimi në Situata të veçanta). (**Skema 2**).

Brez i përkatësisë: shirit toke i ndodhur ndërmjet karrexhatës dhe kufirit rrugor. Është pjesë e pronësisë rrugore dhe mund të përdoret vetëm për realizimin e pjesëve të tjera te rugës. (**Skema 2**)

Brigjet e rrugës: zonë e terrenit që vjen menjëherë pas buzës së poshtme ose të sipërme të skarpatës së trupit rrugor, përkatësisht kur rruga është e ngritur ose e thelluar në terren. (**Skema 2**)

Degë kryqëzimi: pjesë rruge që bën pjesë në një kryqëzim. (**Skema 3**)

Ishull shpëtues: pjesë e rrugës e ngritur ose e kufizuar dhe e mbrojtur në mënyrë të përshtatshme, e destinuar për mbrojtjen dhe qëndrimin e këmbësorëve, në vendkalimet e këmbësorëve ose në ndalesa të transportit kolektiv.
(shih kapitullin Pengesat në Situata të veçanta) (**Skema 4**)

Ishull trafiku: pjesë e rrugës, e kufizuar në mënyrë të përshtatshme dhe e pashkelshme, e destinuar për rregullimin e rrymave të trafikut. (**Skema 4**)

Ishull trafik ndarës: pjesë gjatësore e rrugës, e pakalueshme nga mjetet, e destinuar për ndarjen e rrymave të mjeteve. (**Skema 2**)

Ishull udhëzues: pjesë e rrugës, e kufizuar në mënyrë të përshtatshme dhe e pashkelshme, e destinuar për rregullimin e rrymave të trafikut. (**Skema 4**)

Kalim në disnivel: kryqëzim në nivele të ndryshme, në të cilin rrymet e trafikut nuk ndërpriten ndërmjet tyre. (**Skema 6**)

Kalim në nivel: kryqëzim në nivel i rregulluar dhe i sinjalizuar në mënyrë të përshtatshme, me qëllim sigurimin e qarkullimit ndërmjet një ose më shumë rrugësh dhe një linje hekurudhore që kalon nëpër sipërfaqen rrugore. (**Skema 3**)

Kanal: vepër arti e destinuar për rrjedhjen e ujrave të shiut, borës ose të drenazhimit, i ndërtuar përgjatë ose tërthor rrugës. (**Skema 2**)

Karrexhata: pjesë e rrugës e destinuar për lëvizjen e mjeteve; ajo është e përbërë nga një ose më shumë korsi lëvizjeje dhe përgjithësisht, është e shtruar dhe e kufizuar nga vija anësore (**Skemat 1**).

Korsi: pjesë gjatësore e rrugës me gjerësi të përshtatshme për lejimin e kalimit të një rreshti të vetëm mjetesh (**Skema 1**)

Korsi biçikletash: pjesë gjatësore e rrugës e kufizuar në mënyrë të përshtatshme, e rezervuar për qarkullimin e biçikletave.
(shih kapitullin Korsi biçikletash në Situata të veçanta)

Korsi emergjence: korsi e veçantë në anë të karrexhatës e destinuar për ndalesat e emergjencës, për kalimin e mjeteve të ndihmës së shpejtë dhe në raste të rralla, për lëvizjen e këmbësorëve, kur kjo është e lejuar (**Skema 1**)

Korsi lëvizjeje: korsi përbërëse e karrexhatës, normalisht e kufizuar nga shenja horizontale (**Skema1**).

Korsi ngadalësimi: korsi e veçantë për të lejuar daljen e mjeteve nga një karrexhatë në mënyrë që të mos shkaktojë ngadalësimin e mjeteve që nuk marrin pjesë në një manovër të tillë (**Skema 4**).

Korsi e rezervuar: korsi lëvizje e destinuar vetëm për qarkullim të një ose të vetëm disa kategori mjetesh (**Skema 5**).

Korsi e specializuar: korsi e destinuar për mjetet që kryejnë manovra të caktuara, si parakalim, ngadalësim, shpejtim, manovra për qëndrim etj.

Korsi shpejtimi: korsi e veçantë për të lejuar dhe lehtësuar hyrjen e mjeteve në karrexhatë (**Skema 4**).

Krahu i kryqëzimit: pjesë rruge që bën pjesë në një kryqëzim. (**Skema 3**)

Kryqëzim në disnivel: bashkësi e infrastrukturave (mbikalime, nënkalime dhe rampa) që lejon zhvendosjen e rrymave të mjeteve ndërmjet degëve të rrugëve të vendosura në nivele të ndryshme (**Skema 6**).

Kryqëzim në nivel: zonë e përbashkët për disa rrugë, e organizuar në mënyrë të tillë që të lejojë zhvendosjen e rrymave të trafikut nga njëra rrugë te tjetra (**Skema 3**).

Kthesë: rakordim gjatësor ndërmjet dy pjesëve të drejta të rrugës, që kanë akse të cilat ndërpriten. (**figura II, 420**)

Kufi rrugor: fundi pronësisë rrugore, i cili rezulton nga aktet e blerjes ose nga dokumentat e shpronësimit të projektit të miratuar. Në mungesë të tyre, kufiri formohet nga buza e jashtme e hendekut të sigurimit apo kanalit, kur ai ekziston, ose nga këmba e skarpatës, nëse rruga është në lartësi, ose nga buza e sipërme e skarpatës, nëse rruga është në thellësi (**Skema 2**).

Parkimi: zonë ose infrastrukturë e vendosur jashtë karrexhatës, e destinuar për qëndrimin e rregulluar ose jo të mjeteve.
(shih kapitullin Qëndrime, Ndalime dhe Parkime në Situata të veçanta) si dhe (**Skemat 118,119,120**)

Pjerrësi: pjerrësi e rrugës me pjerrëzim gjatësor të vazhdueshëm

Qarkullimi: është lëvizja, ndalimi dhe qëndrimi i këmbësorëve, mjeteve dhe kafshëve në rrugë.

Qendër e banuar: bashkësi ndërtesash, e kufizuar përgjatë rrugëve në hyrje dhe në dalje me sinjale të posaçme të fillimit dhe të fundit. Me bashkësi ndërtesash kuptojmë një grupim të vazhdueshëm dhe të ndërprerë nga rrugë, sheshe, lulishte ose të njëjtë me to, të përbërë nga të paktën 25 ndërtesa dhe nga zona të përdorimit publik me hyrje për mjetet dhe këmbësorët në rrugë.

Rakordim konkav: rakordim ndërmjet dy pjerrësish të ndryshme njëra pas tjetrës, me akse që ndërpriten nën sipërfaqen e rrugës. Pjesë e rrugës me karakteristikë gjatësore konkave.

Rakordim konveks: rakordim ndërmjet dy pjerrësish të ndryshme njëra pas tjetrës, me akse që ndërpriten mbi sipërfaqen e rrugës. Pjesë e rrugës me karakteristikë gjatësore konvekse.

Rampë kryqëzimi: rrugë e destinuar për lidhjen e dy degëve të një kryqëzimi **(Skema 6).**

Rugë interurbane: rrugë jashtë qëndrave të banuara.

Rrugëkalim këmbësorësh: pjesë e rrugës e ndarë nga karrexhata me një vijë të verdhë, ose një mbrojtëse të posaçme paralele me të, e destinuar për kalimin e këmbësorëve. Ajo kryen funksionin e një trotuari rrugor në mungesë të tij.

Rrugëkalim mjetesh: hyrje ose dalje të një zonë anësore, e përshtatshme për qëndrimin e një ose më shumë mjeteve.
(shih kapitullin Rrugë për kalim të mjeteve në Situata të veçanta)

Rrugë ndërkombëtare: rrugë ose pjesë të rrugës që bëjnë pjesë në itinerare të përcaktuara nga marrëveshjet ndërkombëtare.

Rrugë urbane: rrugë brënda një qëndre të banuar.

Rrymë trafiku: bashkësi mjetesh (rrymë mjetesh), ose këmbësorësh (rrymë këmbësorësh), që lëvizin në rrugë në të njëjtën sens lëvizjeje në një ose më shumë rreshta paralele, duke ndjekur një trajektore të caktuar.

Shesh qëndrimi: pjesë e rrugës me gjatwsi tw kufizuar nw krah dhe gjatw bankinws e destinuar pwr qwndrimin e mjeteve.
(Shih Kapitullin Qëndrimi, dhe Pushimi në Situata të veçanta).

Shpëtuese: shih (Ishull shpëtues). (**Skema 4**)

Shtegkalim: rrugë me bazament natyror e formuar për kalimin e këmbësorëve ose të kafshëve.

Trafikndarës: pjesë gjatësore e rrugës, e pakalueshme nga mjetet, e destinuar për ndarjen e rrymave të mjeteve (**Skema 1**)

Trotuar: pjesë e rrugës jashtë karrexhatës, e ngritur ose e kufizuar dhe e mbrojtur, e destinuar për këmbësorët (**Skema 5**).

Udhëzues: bashkësi treguesish të destinuar pëër perëzgjedhjen e rrymave të trafikut dhe për t'i udhëzuar ne drejtime të caktuara.

Vendkalim këmbësorësh: pjesë e rrugës e shënuar në mënyrë të përshtatshme dhe e organizuar, në të cilën këmbësorët, gjatë kalimit nga njëra anë e rrugës në tjetrën, kanë përparësi ndaj automjeteve.
(shih kapitullin Vendkalim këmbësorësh në Situata të veçanta) (**Skema 50** dhe **51**).

Xhep ndalimi: pjesë e rrugës jashtë karrexhatës, e destinuar për ndalimin e mjeteve publike të linjës, ngjitur me trotuarin ose me një hapësirë tjetër pritjeje për këmbësorët.
(shih kapitullin Autobuz (Bus) në Situata të veçanta).

Zonë kryqëzimi: pjesë e kryqëzimit në nivel, në të cilën ndërpriten dy ose më shumë rryma trafiku (**Skema 3**).

Zonë ndërrimi:	pjesë e rrugës me sens unik, gjatë së cilës rryma paralele trafiku, në lëvizje në të njëjtin sens, mund të ndryshojnë pozicionin e tyre reciprok pa pasur nevojë të ndalen .
Zonë me trafik të kufizuar:	zonë, në të cilën hyrja dhe qarkullimi i mjeteve janë të kufizuara në orë të caktuara, ose për kategori të caktuara mjetesh. (shih kapitullin Hapësirë qarkullimi e rregulluar në Situata të veçanta).
Zonë rigrupimi:	pjesë e karrexhatës para vijës së ndalimit, e destinuar për grumbullimin e mjeteve në pritje për rrugë të lirë, përgjithësisht e ndarë në korsi të specializuara e të kufizuara nga vija gjatësore të pandërprera.
Zonë rrugore:	sipërfaqja e përfshirë brënda kufijve rrugorë; përfshin karrexhatën dhe brezat e përkatësisë. (**Skema 2**)
Zonë përzgjedhjeje:	pjesë e rrugës, e sinjalizuar në mënyrë të përshtatëshme, ku lejohet ndryshimi i korsisë, me qëllim që mjetet të kalojnë në korsi të specializuara.
Zonë urbane këmbësore:	zonë e ndaluar për qarkullimin e automjeteve, përveç atyre të shërbimit të urgjencës dhe mjeteve në shërbim të personave me aftësi të kufizuar lëvizjeje, që kanë përmasa dhe shpejtësi të krahasueshme me biçikletat. (shih kapitullin Hapësira për qarkullim të rregullt në Situata të veçanta).
Zonë e veçantë:	zonë urbane, në të cilën janë në fuqi rregulla të posaçme qarkullimi në mbrojtje të këmbësorëve dhe të mjedisit, e kufizuar nga sinjale të posaçme fillimi dhe fundi.(shih kapitullin Hapësira për qarkullim të rregullt në Situata të veçanta. (shih kapitullin Hapësira për qarkullim të rregullt në Situata të veçanta).

SINJALIZIMI VERTIKAL

neni 39 i Kodit Rrugor

Sinjalet vertikale, si ato të rrezikut, urdhëruese ose treguese duhet të kenë në pjesën e përparme të dallueshme nga përdoruesit e rrugës, formën, përmasat, ngjyrën dhe karakteristikat, në përputje me normat e rregullores së zbatimit të Kodit Rrugor dhe sipas figurave e tabelave që janë pjesë plotësuese e saj. (neni 75/1).

Kompetencat

Rreziqet, urdhërat dhe informacionet për përdoruesit e rrugës, përcaktohen nga enti pronar i rrugës, sipas një projekti specifik referuar një zone të tërë ose një itinerari të veçantë (neni 75/2).

Vendimet merren bashkarisht me pronarët e rrugëve kufizuese të interesuara (neni 75/2).

Për të operuar me zgjidhjet nga informacioni, enti duhet të ketë parasysh tipologjinë e rrugës, intervalin e shpejtësisë së projektuar, tipologjinë e trafikut, etj., (neni 75/3).

Panelet me mesazhe të ndryshueshme

Janë parashikuar nga Kodi panele me mesazhe të ndryshueshme, pra panele në të cilat të dhënat mund të ndryshohen nëpërmjet komandës në distancë (neni 75/4).

Këto panele i japin përdoruesit të dhëna të nevojshme për drejtimin, rreziqet, ose urdhërat, në ato vende ku këto të dhëna mund të ndryshojnë në kohë (neni 168/2).

Sinjalet në këto panele duhet të jenë krejtësisht të njëjtë me ato të vendosura vertikalisht fikse, pra të kenë të njëjtat përmasa, formë, ngjyrë, figura dhe gërma (neni 75/4), pamvarësisht nëse janë realizuar me pika ose në mënyrë jo të vazhdueshme (neni 168/2).

Është e detyrueshme që ndryshimi midis dy mesazheve të njëpasnjëshëm, të jetë sa më i shkurtër i mundëshëm, në mënyrë që të mos shpërqëndrojë drejtuesin nga drejtimi i mjetit (neni 75/4).

Gjithashtu sinjalet me mesazh të ndryshueshëm duhet të jenë të dallueshëm në çdo konditë dukshmërie dhe nuk duhet të shkaktojnë fenomenin e verbimit (168/2).

Rregullimi

Ndalohet përdorimi i sinjaleve të ndryshëm nga ata që përcakton rregullorja, me përjashtim të rasteve të autorizuara nga Ministria që mbulon Transportin, Drejtoria e Qarkullimit dhe Sigurisë Rrugore. (neni 75/5).

Mund të mbeten në përdorim sinjale të vendosur që paraqesin vetëm shmangie të vogla nga ato të parashikuara, me kusht që të garantohet dukshmëria (si ditën e natën) dhe instalimi i përshtatshëm (neni 75/5).

Çdo zëvendësim duhet, sigurisht, të kryhet në sinjale krejt të rregullt (neni 75/5).
Në anën e mbrapme të sinjalit, me ngjyrë të mbyllur duhet, në mënyrë të qartë, të tregohet (neni 75/7) :
- Enti ose administrata pronare e rrugës;
- Marka e firmës që ka prodhuar sinjalin;
- Viti i prodhimit;
- Numri i autorizimit të Ministrisë që mbulon Transportin, për prodhuesin e sinjaleve rrugore.

Këto të dhëna nuk duhet të zënë më shumë se 200 cm^2.
Për sinjalet e përhershme duhet shënuar edhe ekstremet e renditjes gjatë vendosjes (neni 75/7).

Publiciteti

Ndalohet ndërthurja ose bashkëvendosja me çdo lloj publiciteti (neni 75/6).
Gjithsesi enti pronar i rrugës mund të lejojë publicitetin e shërbimeve kryesore, së bashku me sinjalet rrugore në rastet e parashikuara nga rregullorja (neni 75/6).

Dukshmëria e sinjaleve

Për një dukshmëri sa më të mirë të sinjaleve duhet të garantohet hapësirë pa pengesa midis drejtuesit dhe sinjalit.
Proçesi logjik që kalon drejtuesi, duhet të jetë (neni 77/1) :
- perceptimi i pranisë së një sinjali;
- lidhja logjike me sinjalitikën rrugore;
- njohja e formës dhe e ngjyrës;
- leximi;
- zbatimi i sjelljës së kërkuar ose të zgjedhur.

Në rastet kur nuk është e mundur të garantohet dukshmëria e kërkuar në kapitujt respektivë (sinjale rreziku, urdhëruese ose treguese), distancat mund të ndryshojnë, me kusht që sinjali të paraprihet nga një sinjal i ngjashëm, i plotësuar me panel plotësues **model II 1** (neni 77/4).

Dukshmëria e për pasojë pamja e sinjalit (forma, ngjyra dhe simbolet), duhet të jenë të njëjta, si ditën ashtu edhe natën (neni 77/5). Natën dukshmëria mund të sigurohet me ndriçim ose reflektim (neni 75/6).

Shënim: Në të njëjtën mbajtëse nuk mund të vendosen sinjale me karakteristika ndriçimi ose reflektimi të ndryshme midis tyre. (neni 77/13).

Shiritat reflektues

Reflektimi, arrihet duke përdorur shirita plastmasi të veçantë.
Karakteristikat kolorometrike, fotometrike, dhe të jetëgjatësisë së shiritave reflektues që përdoren për sinjalet rrugore, përcaktohen me udhëzim të Ministrisë që mbulon Transportin, të botuara në Fletoren Zyrtare (neni 77/9)
Egzistojnë dy lloje shiritash materiali reflektues (neni 77/10):
- Me reflektim normal (klasi 1);
- Me reflektim të rritur (klasi 2).

Këto të fundit janë të detyrueshme tek sinjalet (neni 77/12):
- jep përparësi;
- ndal dhe jep përparësi;
- jep përparësi nga e djathta;
- ndalim parakalimi;
- sinjale paralajmëruese dhe të drejtimit të instaluara për herë të parë.

Në rastet e tjera vendosja e tyre është fakultative.
Zgjedhja e tipit të plasmasit reflektues bëhet nga enti pronar i rrugës në funksion të rëndësisë së sinjalit si dhe ndikimit që ai ka lidhur me sigurinë, shpejtësinë e ecjes dhe ndriçimin e ambientit (neni 77/11).

Përmasat

Përmasat e sinjaleve mund të ndryshohen, me autorizim të Ministrisë që mbulon Transportin: (neni 78/4)
- për situata rrugore ose të trafikut të veçantë, të përhershme;
- në funksion të shpejtësisë së lëvizjes dhe gjërësisë së rrugës.

Përmasat e sinjaleve mund të ndryshohen pa autorizimin e Ministrisë që mbulon Transportin: (neni 78/6)
- për situata rrugore ose trafik të veçantë të përkohshëm.

Në rastet që nuk jepen në tabela, përmasat e sinjaleve përcaktohen nga madhësia e gërmave, lexueshmëria e kërkuar në funksion të shpejtësisë mesatare të lëvizjes, si dhe nga numri i automjeteve të regjistruara (neni 78/7).

Sinjalet e mëdha
(neni 78/2)

Duhet të përdoren në këto raste :

- në anën e djathtë të rrugëve interurbane me dy ose më shumë korsi për çdo sens;
- në anën e djathtë të rrugëve urbane me tre ose më shumë korsi për çdo sens;
- për vendosje sipër karrexhatës.

Në qoftë se përsëriten nga krahu i majtë, këta të fundit mund të jenë edhe me përmasa normale.

Sinjalet e vogla
(neni 78/3)

Mund të përdoren vetëm në rastet kur hapësira e disponueshme nuk lejon përdorimin e sinjaleve me përmasa normale.

Sinjalet e përbëra

Kështu quhet një panel në të cilin shfaqen dy ose më shumë sinjale njëkohësisht (neni 78/5).
Mund të përbëhet edhe nga sinjali dhe paneli plotësues përkatës, në rastet kur dukshmëria është një kërkesë themelore (neni 81/13).

Përmasat e sinjalit të përbërë

Duhet te jenë të tilla që të përmbajnë disqe me diametër jo më të vogël se 40 cm ose trekëndësh me brinjë jo më të vogël se 60 cm (neni 78/5) (**Skema 8** *aneksi A*).

I vetmi përjashtim janë sinjalet e përbërë që i referohen pushimit të mjeteve, në të cilët disku i ndalimpushimit ka diametrin 30 cm (neni 78/5), (**Skema 9** *aneksi A*).
Ngjyra e sfondit të paneleve të sinjaleve të përbëra duhet të jetë e bardhë për sinjalet e përhershëm. Përkundrazi do të jetë e verdhë për ato që përmbajnë sinjale përshkruese të përkohshme.

Vendosja

Sinjalet vertikale vendosen, si rregull në anën e djathtë të rrugës (neni 79/1) (shih **skemën II A**, faqe 28).
Gjithashtu mund të vendosen edhe (neni 79/1) :

- në ishujt trafikndarës;
- sipër karrexhatës;
- të përsëritura në anën e majtë të rrugës;

Për motive të sigurisë ose në rast se është parashikuar në mënyrë të veçantë nga rregullat për sinjalin.
Sinjalet, që vendosen në buzë të rrugës (sinjalet anësore) distancën midis buzës vertikale nga ana e rrugës dhe buzës së trotuarit ose anës së jashtme të bankinës, duhet t'a kenë (neni 79/2):

- minimumi 30 cm;
- maksimumi 100 cm.

Pranohen distanca më të vogla, kur kjo kushtëzohet nga hapsirat, me kusht që sinjali të mos dalë mbi karrexhatë (neni 79/2).
Mbajtëset e sinjaleve duhet të fiksohen në distancë jo më të vogël se 50 cm nga buza e trotuarit ose nga ana e jashtme e bankinës (neni 79/2).
Në prani të barrierave metalike, mbajtëset mund të vendosen tek ato, me kusht që sinjali të mos dalë më shumë se vetë barrierat (neni 79/2).
Lartësia nga toka, duke kuptuar lartësinë e fundit të sinjalit ose panelit plotësues më të ulët (neni 79/3) duhet të jetë, me përjashtim të sinjaleve të lëvizshëm (neni 79/5) :

- minimumi 60 cm;
- maksimumi 220 cm.

Në rrugët urbane, për kushte ambienti të veçanta, sinjalet mund të vendosen edhe në lartësi më të mëdha, sidoqoftë jo më shumë se 450 cm (neni 79/5)
Në rrugët urbane, **në trotuare ose rrugë të rezervuara për këmbësorë**, duhet të kenë një lartësi min.220cm, me përjashtim të paneleve semaforike (neni 79/5), (shih **Skemën 10** *aneksi A*).

Në pjesë uniforme të rrugës sinjalet duhet të vendosen, sa të jetë e mundur, në lartësi të njëjtë (neni 79/4).
Vendosja (neni 79/13), në variantin e lëvizshëm ose me karakter të përkohshëm, mund të lejohet në rast të :

- motiveve të vërtetuara të punimeve;
- situatave emergjente të ambientit;
- situatave të veçanta të trafikut;
- kantjereve rrugore;
- paisjeve të punimit, fikse ose të lëvizshme.

Vendosja sipër karrexhatës
(neni 79/6 /12)

Sinjalet e vendosura sipër karrexhatës duhet të kenë lartësi dhe pjerrësi ndaj planit perpendikular me sipërfaqen e rrugës, në funksion të altimetrisë (profilit gjatësor) të saj.
Këto sinjale duhet të kenë lartësinë minimale 510 cm, përveç rasteve kur vendosen në vepra me lartësi më të vogël (p.sh. tunel, mbikalim). Pjerrësia për sinjalet e vendosur 510 cm lart, është 3 gradë nga ana që vijnë mjetet.
(shih **skemën II B** faqe 28)

Mbajtëset dhe mbështetësit e sinjaleve vertikale

Mbajtëset dhe mbështetëset e sinjaleve vertikale duhet të jenë përgjithësisht metalike. Përdorimi i materialeve të tjera duhet të miratohet nga Ministri që mbulon Transportin (neni 80/1).
Mbështetëset me seksion rrethor duhet të kenë një pjesë kundër rrotullimit të sinjalit ndaj mbështetëses, si dhe të vetë mbështetëses ndaj tokës (neni 80/2).
Seksioni i mbështetëses duhet të garantojë qëndrueshmërinë e sinjalit edhe në kondita të vështira atmosferike (neni 80/3) .
Qëdrueshmëria e mbështetëseve të sinjaleve, si dhe e bazamenteve e fiksueseve të tyre, duhet të llogaritet ose verifikohet nga specialistët e entit pronar të rrugës (neni 124/10).
Efekti i korrozionit duhet të merret parasysh si për mbajtëset ashtu edhe për mbështetëset (neni 80/4). Për karakteristikat teknike të mbajtëseve dhe mbështetësve ka një rregullore të Ministrisë që mbulon Transportin.
Çdo mbështetëse duhet të ketë vetëm një sinjal (neni 80/5) . Lejohet bashkimi i maksimumi dy sinjaleve, në rastet kur është e nevojshme të vendosen më shumë sinjale rreziku ose sinjale urdhëruese, nët ë njëjtin vend (neni 80/5).

Panelet plotësues

Panelet plotësues janë me formë drejtkëndore dhe duhet të përmbajnë simbole ose shënime të qarta dhe konçize (neni 81/2).

Tek panelet plotësues është i ndaluar shkrimi, kur është parashikuar një simbol i veçantë. Po ashtu është e ndaluar të përdoret sinjali "RREZIQE TË TJERA" i shoqëruar me panel plotësues, kur është parashikuar një sinjal i veçantë (neni 81/12).

Panelet plotësues janë të modeleve të mëposhtme (neni 81/3):

modeli **II 1** për largësitë;

modeli **II 2** për shtrirjet (zgjatjet);

modeli **II 3** për të treguar periudhat kohore;

modeli **II 4** për të treguar përjashtime ose kufizime;

modeli **II 5** për të treguar fillimin, vazhdimin dhe fundin;

modeli **II 6** për shpjegime ose tregues;

modeli **II 7** për të treguar ecurinë e rrugës kryesore;

LARGËSIA



Modeli II 1/a, neni 81

Modeli II 1/b, neni 81

Tregon largësinë, të shprehur në metra ose kilometra (me afërsi deri në 10 metra), ndërmjet sinjalit dhe fillimit të pikës objekt-treguese, ku zbatohet kushti teknik (neni 81/4)

SHTRIRJA

Modeli II 2/a, neni 81

Modeli II 2/b, neni 81

Tregon shtrirjen, domethënë gjatësinë të shprehur në metra ose në kilometra (me afërsi deri në 10 metra), të pjesës së rrugës së rrezikshme ose ku zbatohet kushti teknik (neni 81/5).

VLEFSHMËRIA KOHORE

3/a

3/c

3/b

3/d

Modeli II 3, neni 81

Modeli II 3/a do të thotë "i përhershëm";

Modeli II 3/b tregon orët e vlefshmërisë në çdo ditë;

Modeli II 3/c tregon vlefshmërinë në ditët e festave;

Modeli II 3/d tregon vlefshmërinë në ditët e punës;

Tregon kohën e vlefshmërisë, d.m.th. ditën, orën ose minutat, me anë të shifrave ose të simboleve, gjatë të cilave është në fuqi kushti teknik.

KUFIZIMI



Modeli II 4/a, neni 81

Saktëson vlefshmërinë e sinjaleve urdhërues për një ose disa kategori përdoruesish. Simbolet jepen me ngjyrë të zezë në një sfond të bardhë (neni 81/7).

PËRJASHTIMI



Modeli II 4/b, neni 81

Autorizon një përjashtim nga sinjalet urdhërues për një ose disa kategori përdoruesish (neni 81/7).

Simbolet përkatëse me ngjyrë të zezë në një sfond të bardhë do të paraprihen nga fjala "PËRVEÇ" (neni 81/7).

FILLIMI



Modeli II 5, neni 81

Tregon fillimin e një sinjali urdhërues, të rrezikut ose tregues (neni 81/8).

Përdorimi i panelit "FILLIM"

Nga momenti që koncepti i fillimit shprehet në çdo sinjal, përdorimi i tij duhet të kufizohet vetëm në rastet kur është i nevojshëm evidentimi i rrethanave (neni 81/8).

VAZHDIMI



Modeli II 5, neni 81

Tregon vazhdimin e një sinjali urdhërues, të rrezikut ose tregues (neni 81/8).

FUNDI



Modeli II 5, neni 81

Tregon mbarimin e vlefshmërisë së një sinjali urdhërues, të rrezikut ose tregues (neni 81/8).

Saktësimi

Ky model, në raste të veçanta ose të përkohshme, shpjegon kuptimin e sinjalit kryesor ose shton një tregim për të specifikuar vetë sinjalin (neni 81/9).
Simbolet, që përdoren për panelet plotësuese model 6, përveç të tjerave, mund të autorizohen nga Ministria që mbulon Transportin janë (neni 81/10) :

Modeli	**Kuptimi**
II 6/a	sinjalizim horizontal në ripunim
II 6/b	aksident
II 6/c	kalim binarësh
II 6/d	borëpastruese në veprim
II 6/e	zonë që përmbytet
II 6/f	varg mjetesh
II 6/g	mjete punimi në veprim
II 6/h	rrugë e rrëshqitshme nga akulli
II 6/i	rrugë e rrëshqitshme nga shiu
II 6/l	kamionë në ngadalësim
II 6/m	zonë rimorkimi të detyruar
II 6/n	sinjal i korsisë
II 6/p1	kthesë
II 6/p2	numri i kthesës
II 6/q1	pastrim mekanik i rrugës
II 6/q2	pastrim mekanik i rrugës



Modeli II.6/a, neni 81

Modeli II.6/b, neni 81



Modeli II.6/c, neni 81

Modeli II.6/d, neni 81



Modeli II.6/e, neni 81



Modeli II.6/f, neni 81

Modeli II.6/g, neni 81



Modeli II.6/h, neni 81

Modeli II.6/i, neni 81



Modeli II.6/l, neni 81

Modeli II.6/m, neni 81



Modeli II.6/n, neni 81

Modeli II.6/p1, neni 81

Modeli II.6/p2, neni 81

Modeli II.6/q1, neni 86

Modeli II.6/q2, neni 81

VAZHDIMI I RRUGËS KRYESORE











Modeli II.7, nenet 81

Ky model tregon vazhdimin e rrugës që ka përparësi ndaj rrugëve të tjera. Simboli është me ngjyrë të zezë mbi fushë të bardhë. (neni 81/11)



Skema II A, neni 79

Vendosje anësore në vijë të drejtë



Skema II B, neni 79

Vendosje sipër karrexhatës

SINJALET E RREZIKUT

neni 39 i Kodit Rrugor

Të përgjithshme

Sinjalet e rrezikut duhet të vendosen kur egziston një situatë reale rreziku në rrugë, që nuk perceptohet shpejt nga një drejtues mjeti në kushte normale dhe që zbaton rregullat e qarkullimit (neni 82/2).

Forma

Këto sinjale kanë formë trekëndëshi barabrinjës me kulm të drejtuar lart (neni 82/1).

Përmasat

Përmasat jepen në **Skedën 17** (neni 78/1).

Ngjyrat

Për këto sinjale përdoren zakonisht ngjyrat e bardhë, e kuqe dhe e zezë (neni 76/1), me përjashtim të rasteve të veçanta të parashikuara.

Hapësirat minimale të shikueshmërisë

Përmasat minimale të hapësirës së shikueshmërisë së sinjaleve të rrezikut, në mënyrë indikative, jepen më poshtë :

Tipi i rrugës	Hapësira e shikueshmërisë
Autostradë dhe rrugë interurbane kryesore	150 m
Rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane kryesore (me shpejtësi më të madhe se 40 km/orë	100 m
Rrugë të tjera	50 m

Plotësime

Në rastet kur hapësira e shikueshmërisë është më e vogël se 20% ndaj minimumeve të dhëna më sipër, përmasat mund të zvogëlohen, mjafton që sinjali të paraprihet nga një tjetër, i njëjtë, i plotësuar me panelin përkatës **Modeli II 1**.

Sinjalet e rrezikut, si rregull, vendosen në një distancë rreth 150 m nga pika e fillimit të rrezikut të paralajmëruar (neni 79/7).

Në rrugët urbane me shpejtësi maksimale të lejuar më të vogël se 40 km/orë, distanca mund të zvogëlohet në përshtatje me kushtet vendore (neni 79/7).

Në rastet kur nuk është e mundur të respektohen distancat, sinjali i rrezikut duhet të plotësohet me panelin përkatës Model II 1 që jep distancën e saktë nga rreziku.

Për motive sigurie, ai gjithsesi mund të paraprihet nga një tjetër, i njëjtë, që po ashtu jep distancën e saktë nga rreziku (neni 82/3).

Vendosja

Sinjalet e rrezikut duhet të vendosen në anën e djathtë të rrugës. Në rrugët me dy ose më shumë korsi për çdo sens lëvizje, duhet të merren masa, në lidhje me kushtet vendore, me qëllim që sinjalet të dallohen edhe nga drejtuesit e mjeteve që kalojnë në korsitë e brendëshme. Kjo bëhet duke i përsëritur në anën e majtë ose sipër karrexhatës (neni 82/4).

Në këtë rast, në qoftëse tregimi i rrezikut vlen për të gjithë karrexhatën, sinjali vendoset me qendër në përputhje me aksin e saj. Nëqoftëse i referohet vetëm një korsie, duhet të vendoset mbi aksin e asaj korsie dhe të plotësohet nga një shigjetë të vendosur nën të (**modeli II 6**/n), me majën e drejtuar poshtë. (neni79/6).

Shtrirja-Vlefshmëria

Nëse sinjali përdoret për të treguar një rrezik që shtrihet (zgjat) për një pjesë rruge me gjatësi të caktuar, (për shembull, seri kthesash të rrezikshme, rrugë e prishur, punime në rrugë, etj.) kjo e fundit duhet të tregohet në panelin plotësues SHTRIRJE.

Nëse në këtë pjesë të rrugës ka kryqëzime, sinjali duhet përsëritur pas çdo kryqëzimi. Shtrirja maksimale, pas së cilës sinjali, sidoqoftë duhet përsëritur, nuk mund të jetë më shumë se 3 km (neni 82/5).

Kur shtrirja e një pjese rruge të sinjalizuar nuk përcaktohet lehtësisht, vazhdimi dhe fundi i rrezikut, mund të sinjalizohen përmes të njëjtit sinjal të plotësuar nga paneli VAZHDIM ose FUND (neni 82/6)

Nëse kushti i rrezikut kufizohet në kohë, sinjali duhet të plotësohet me panelin plotësues të VLEFSHMËRISË KOHORE (neni 81/6).

Kombinime

Në rast vendosje në të njëjtën mbajtëse të një sinjali rreziku dhe një sinjali urdhërues, sinjali i rrezikut duhet të jetë gjithmonë më lart atij urdhërues. (**Skema 12** *aneksi A*) (neni 82/7).

RRUGË E DEFORMUAR (VALËZUAR) (Neni 83)

Figura II 1, nenet 83

Paralajmeron nje pjese te rruges ne gjendje te keqe ose te shtruar ne menyre jo te rregullt.

Figura II 2, nenet 83,177
kurriz

Figura II.3, neni 83
gropë

Përdoret për të paralajmëruar një anomali altimetrike të mysët dhe të lugët (konkave) përgjatë rrugës (neni 83/3).

KTHESË

Figura II.4, neni 84
nga e djathta

Figura II.5, neni 84
nga e majta

Paralajmëron një kthesë të rrezikshme nga e djathta dhe nga e majta, për shkak të karakteristikave planimetrike të rrugës ose të pamjes së pamjaftueshme.

KTHESË E DYFISHTË

Figura II 6, neni 84
e para nga e djathta

Figura II 7, neni 84
e para nga e majta

Paralajmëron një varg kthesash të rrezikshme të pandërprera, nga të cilat **Figura II 6** e para nga e djathta dhe **Figura II 7** e para nga e majta.

KALIM NË NIVEL ME BARRIERA

Figura II 8, neni 85

Paralajmëron një vendkalim hekurudhor i përforcuar me pengesa ose gjysëmpengesa.

KALIM NË NIVEL, PA PENGESA

Figura II 9, neni 85

Paralajmëron një vendkalim hekurudhor, pa pengesa.

KRYQI I SHËN ANDREAS



Figura II 10/a, nenet 85,186

Lajmëron afrimin e menjëhershëm të një vendkalimi hekurudhor, me një binar pa pengesa, dhe tregon detyrimin për të ndalur, në përputhje edhe me shiritin e ndalimit.

KRYQ I DYFISHTE I SHËN ANDREAS



Figura II 10/b, nenet 85,186

Lajmëron afrimin e menjëhershëm te një vendkalimi hekurudhor pa pengesa, me dy ose më tepër binarë, dhe tregon detyrimin për të ndalur, në përputhje me shiritin e ndalimit.

KRYQI I SHËN ANDREAS I VENDOSUR VERTIKALISHT

Figura II 10/c, nenet 85,186

Ka të njëjtin kuptim me sinjalin e fig. II.10/a. Në këtë rast vendosen vertikalisht, për mungesë hapësire.

KRYQ I DYFISHTE SHËN ANDREAS I VENDOSUR VERTIKALISHT

Figura II 10/d, nenet 85,186

Ka të njëjtin kuptim me sinjalin e fig. II 10/b. Vendoset vertikalisht për mungesë hapësire.

PANEL I PARË, I DYTË, I TRETË LARGËSITREGUES

Figura II 11/a

Figura II 11/b

Figura II 11/c

Sinjali i parë plotësues, me tri vija të kuqe, të pjerrëta, vendosur poshtë sinjalit të figurës II 8 dhe II 9.
Sinjali i dytë plotësues, me dy vija të pjerrëta të kuqe, vendosur në 2/3 e largësisë ndërmjet linjës hekurudhore dhe panelit të parë largësitregues.
Paneli i tretë plotësues, me një vijë të kuqe të pjerrët, vendosur në 1/3 e largësisë ndërmjet linjës hekurudhore dhe panelit të parë largësitregues.

VENDKALIM TRAMVAJI

Figura II.12, neni 86

Parasinjalizon një linje tramvaji, brenda ose jashtë qendrave të banuara, të parregulluar me semaforë, që ndërpret ose kufizon pjesën e rrugës me automjete.

VENDKALIM KËMBËSORËSH

Figura II.13, neni 133

Paralajmëron një vendkalim këmbësoresh, i dalluar nga shenjat përkatëse mbi rruge, në rrugët jashtëqytetëse dhe ato qytetëse me kufizim të shpejtësisë më të madhe nga shpejtësia e përcaktuar në nenin 142/1 të Kodit Rrugor

VENDKALIM BIÇIKLETASH

Figura II.14, nenet 86,133

Paralajmëron një vendkalim biçikletash, qe dallon nga shenjat përkatëse mbi rruge, në rrugët jashtëqytetëse dhe ato qytetëse me kufizim të shpejtësisë më të madhe nga shpejtësia e përcaktuar në nenin 142/1 të Kodit Rrugor

Figura II. 15, neni 87
zbritje e rrezikshme

Figura II. 16, neni 87
ngjitje e tatëpjetë

(**Figura II 15**) Paralajmëron një zbritje të rrezikshme, si pasojë e faktorëve vendorë, veçanërisht të disfavorshëm. Pjerrësia është shprehur në përqindje.

(**Figura II 16**) Paralajmëron një ngjitje të rrëpirët të rrezikshme, si pasojë e faktorëve vendorë të disfavorshëm. Pjerësia është shprehur në përqindje.

NGUSHTIM SIMETRIK

Figura II 17, neni 88

Paralajmëron një ngushtim të rrezikshëm të rrugës në të dy anët.

NGUSHTIM ASIMETRIK

Figura II 18, neni 88
nga e majta

Figura II 19, neni 88
nga e djathta

Në këtë rast ngushtimi i përket vetëm njërës anë të karrexhatës. Këshillohet që me udhëzim të Ministrisë që mbulon veprimtarinë e Transportit të vendosen pajisje të veçanta për të rregulluar qarkullimin në prani të ngushtimeve. (neni 88/4).

Kombinime

Në fillim të ngushtimeve në të cilat shihet e nevojshme vendosja e një sensi të vetëm lëvizjeje të alternuar, për kufizime të përmasave të korsive dhe duke mbajtur parasysh ecurinë planimetrike të rrugës, si dhe tipin dhe përmasat e mjeteve të cilave u lejohet kalimi, duhet të përdoren sinjalet: E DREJTË PËRPARËSIE, NË DREJTIMET NJËKALIMSHE TË ALTERNUARA (**figurat II 41** dhe **45**) (nenet 108 dhe 112).



Figura II.41, nenet 37,108

Figura II.45, nenet 37,41,112

Në rrugët me dy ose më shumë korsi për sens lëvizjeje ngushtimet që sjellin reduktim të numrit të korsive tregohen me sinjalet: NDRYSHIME NË NUMRIN E KORSIVE NË DISPOZICION (**figura II 341** dhe **343**) (neni 133/20).

Figura II.341, neni 13



Figura II.343, neni 133

Në ngushtime me sens të vetëm të alternuar dhe në të cilat daljet nuk janë të dukshme njëra nga tjetra ose të dallueshme prej 50m, duhet të vihet në punë një impiant semaforik funksionues për të gjithë ditën. Nëse zgjatja e ngushtimit është e kufizuar në kohë, impianti semaforik mund të zëvendësohet nga sinjalizime manuale.

URË E LËVIZSHME

Figura II 20, neni 89

Tregon një urë të lëvizshme por sidoqoftë të manovrueshme. Sinjali mund të plotësohet me panelin e parë largësimatës të përdorur në kalimet në nivel (**figura II 1/a**) dhe me nje panel **model II 3** tregues i orareve të manovrës ose i funksionimit.

BANKINË ME RREZIK SHEMBJEJE

Figura II.21 neni 90

Sinjalizon një pjese rruge me bankinë që shembet ose jo të praktikueshme, ose rrezik për rënie në një gropë të thellë ose në një thellësi në rast parkimi (neni 90/1). Sinjali duhet të plotësohet nga një panel **model II** 2 që tregon shtrirjen e kësaj pjese rruge (neni 90/2).

RRUGË E RRËSHQITSHME

Figura II 22, neni 91

Paralajmëron një pjesë rruge që në kushte të veçanta mund të paraqesë një sipërfaqe në rrezikshmëri rrëshqitjeje.Kushtet e veçanta, kryesisht shiu, akulli ose shkaqe të tjera të lokalizuara,

FËMIJË

Figura II.23, neni 92

Paralajmëron vënde nga kalojnë fëmijë, të shkollave, kopshteve, parqeve publike, fushat e lojës e të tjera të ngjashme me këto.

KAFSHË TË LIRA

Figura II.24, neni 93
Kafshë shtëpiake,të lira,

Figura II.25, Neni 93
Kafshë shtëpiake,të egra

Tregojnë afrimin në një pjesë rruge, ku mund të shfaqen ose mund të kalojnë kafshë.

DREJTIM QARKULLIMI TË DYFISHTË

Figura II.26, neni 94

Paralajmëron një pjesë të së njëjtës rrugës, me drejtim qarkullimi të dyfishtë, kur pjesa pararendëse ishte me qarkullim me një kalim.

QARKULLIM RROTULLUES

Figura II.27, nenet 94,120

Paralajmëron një ndërprerje të rrugëve jashtë qytetëse, me qarkullim rrotullues

DALJE NË MOL OSE NË PENDË (PRITË)

Figura II 28, neni 95

Paralajmëron përdoruesin që rruga që po përshkohet të çon në një mol ose në një pendë lumi ose kanali, me rrezik rënie në ujë.

MATERIALE TË PAQËNDRUESHME NË RRUGË

Figura II 29, neni 96

Paralajmëron praninë mbi rrugë të zhavorit, çakullit, granilit ose të materialeve të tjera, të paqëndrueshme, që mund të zvogëlojnë në mënyrë të rrezikshme bashkëveprimin e mjetit me rrugën, ose të godasin në largësi.

RËNIE GURËSH

Figura II.30/a, neni 96
nga e majta

Figura II.30/b, neni 96
nga e djathta

Sinjalizon një pjesë të rrugës ku ekziston rrezik:
- për rënie gurësh e dherash;
- për prani të mundshme të tyre në karrexhatë.
Ekziston një version djathtas dhe një majtas i sinjalit për t'iu përshtatur më mirë situatës që jep.

SEMAFOR

Figura II 31/a, nenet 97,167

Figura II 31/b, nenet 97,167

Paralajmëron një impiant semaforik me vendosje vertikale (31/a) dhe horizontale (31/b) të fenerëve.(neni 97/1)

Simboli

Tre rrathët e ngjyrosur të semaforit duhet të jenë reflektues. Rrethi i verdhë mund të zëvendësohet nga një sinjal i verdhë, i ndritshëm, vezullues. (neni 97/2)

Tre rrathët mund të vendosen qoftë vertikalisht qoftë horizontalisht, sipas vendosjes efektive të fenerëve (neni 97/3). Përmasat e sinjalit duhet të jenë të formatit të madh (**Skeda 17**) kudo që kushtet e impiantit e lejojnë (neni 97/4).

MJET FLUTURUES

Figura II.32, neni 98

Paralajmëron mundësinë e zhurmave te forta, të paparashikuara ose verbimin nga drita e fortë, shkaktuar nga mjetet fluturuese të kuotave të ulëta.

ERË E FORTË, ANËSORE

Figura II 33, neni 99

Paralajmëron një pjesë të rrugës ku mund të verifikohen erëra të forta, si në zona të ekspozuara, dalje nga tuneli, fundi i pjesëve që gjënden në mes të zonave malore ose situata të ngjashme.

Kombinime

Sinjali mund të kombinohet me atë SHPEJTËSI E KËSHILLUESHME (**figura II 312**), ose shpejtësia që këshillohet të mos kalohet në kushte meteorologjike të erërave të forta anësore.

Figura II.312, neni 133

Figura II.313, neni 133

Sinjali mund të plotësohet me një panel plotësues **model II 2** dhe në fund të pjesës së sinjalizuar duhet të vendoset sinjali FUND I SHPEJTËSISE SE KËSHILLUAR (**figura II 313**).

RREZIK ZJARRI

Figura II 34, neni 100

Tërheq vëmendjen rreth rrezikut të ndezshmërisë së zonave pyjore, ose afrimin e vendeve, ngjitur me rrugën me rrezik të madh zjarri.

Sinjali duhet të plotësohet nga paneli plotësues **model II 2** me treguesin e shtrirjes së zonës me rrezik (neni 100/2).

RREZIQE TË TJERA

Figura II.35, nenet 81,85,101,189,333

Paralajmëron një rrezik të ndryshëm nga ato të treguar në sinjalizime të tjera rreziku.

Është i detyrueshëm një panel plotësues model II 6, një simbol ose një mbishkrim që saktëson natyrën e rrezikut. (neni 101/1).

Kombinime

Sinjali gjithmonë duhet të plotësohet nga paneli model II 6 (neni 101/2) ose nga një panel i cili, në rast se simboli përkatës nuk është parashikuar ose nuk ekziston, me shkrim të shkurtuar, tregon natyrën e rrezikut (neni 81/12).

Përjashtime

Në situata të emergjencës dhe në pritje të sinjalt të veçantë ose të panelit plotësues, sinjali mund të përdoret përkohësisht pa panel (neni 101/2).

SINJALET PËRSHKRUESE

Sinjalet që japin përshkrime të vendosura nga autoritetet kompetente të rrugës për përdoruesit e saj, ndahen në tre lloje: (neni 102/1):

- sinjale përparësie;
- sinjale ndalimi;
- sinjale detyruese;

Të përgjithshme

Sinjalet përshkruese duhet të vendosen në pikën ku fillon detyrimi ose sa më afër tij (neni 79/8).
Të pajisur me panelin plotësues **model II 1** mund të jepen më përpara me qëllim paralajmërimi (neni 79/8).
Gjatë pjesës së rrugës të sinjalizuar me sinjal përshkrues sinjalet duhet të përdoren pas çdo kryqëzimi (neni 102/2).
Përsëritja mund të bëhet duke përdorur sinjale me format të reduktuar, të plotësuar me panele plotësues **model II 5/a2** ose **II 5/b2** (neni 102/4).
Termi përshkrues tregohet duke përdorur të njëjtin sinjal të pajisur me panel **model II 5/a3** ose **II 5/b3** (neni 102/5), me përjashtim të rasteve kur është parashikuar një sinjal i veçantë i fundit të përshkrimit (detyrimit).
Sinjalet e FUNDIT (mbarimit) të detyrimit ose ndalimit, duhet të vendosen sa më afër të jetë e mundur, ose pikërisht në pikën ku përfundon ndalimi ose detyrimi. (neni 79/10)

Vendosja

Sinjalet përshkruese vendosen në anën e djathtë të rrugës (neni 102/3).
Në rrugët me dy ose më shumë korsi për çdo drejtim lëvizje, duhet të merren masa, në lidhje me kushtet vendore, me qëllim që sinjalet të dallohen edhe nga drejtuesit e mjeteve që kalojnë në korsitë e brendëshme. Kjo bëhet duke i përsëritur në anën e majtë ose sipër karrexhatës. Në këtë rast, në qoftëse urdhri vlen për të gjithë karrexhatën, sinjali vendoset në qendër në përputhje me aksin e saj; Nëqoftëse i referohet vetëm një korsie, duhet të vendoset mbi aksin e asaj korsie dhe të plotësohet nga një shigjetë të vendosur poshtë (**modeli II 6/**n), me majën të drejtuar poshtë (neni 79/6).

Plotësimi

Nëse përshkrimi kufizohet njëkohësisht për një ose disa kategori mjetesh, simbolet përkatëse vendosen në panelin plotësues **model II 4/a** (neni 102/6).
Nëse duhet të lejohet një përjashtim i njëkohshëm nga një ose më shumë kategori mjetesh përdoret paneli plotësues **model 44/b** me simbolin që paraprihet nga fjala "PËRVEÇ" (neni 102/6).

Hapësirat minimale të shikueshmërisë

Përmasat minimale të hapësirës së shikueshmërisë të sinjaleve të përshkrimit, në mënyrë indikative, jepen më poshtë:

Tipi i rrugës	Hapësira e shikueshmërisë
Autostradë dhe rrugë interurbane kryesore	250 m
Rrugë interurbane dytësore, rrugë urbane kryesore (me shpejtësi më të madhe se 40 km/orë	150 m
Rrugë të tjera	80 m

Në rastet kur hapësira e shikueshmërisë është më e vogël se 20% ndaj minimumeve të dhëna më sipër, përmasat mund të zvogëlohen, mjafton që sinjali të paraprihet nga një panel tjetër, i njëjtë, plotësues i panelit përkatës **modeli II 1**.

Kompetencat

Në anën e mbrapme të sinjalit përshkrues, me përjashtim të atyre që përdoren në kantieret rrugore, duhet të jepen të dhënat e bazës juridike për vendosjen e sinjalit.

SINJALET E NDALIMIT

Të përgjithshme

Sinjalet e ndalimit ju ndalojnë pëdoruesve të rrugës qarkullimin ose drejtime të veçanta të lëvizjes, një manovër të veçantë, ose vendosin kufizime.
Sinjalet e ndalimit ndahen në *të përgjithshëm* dhe *të veçantë*:

» quhen *të përgjithshëm* ato që u drejtohen të gjitha mjeteve;
» quhen *të veçantë* ato që u drejtohen vetëm një kategorie mjetesh ose kategorie të veçantë përdoruesish (neni 113/2).

Forma

Sinjalet e ndalimit kanë formë rrethore (neni 113/1).

Përmasat

Përmasat jepen në **Skedën 16** (neni 78/1).

Ngjyrat

Tek sinjalet përdoren kryesisht ngjyrat: e bardhë, blu, e kuqe, dhe e zezë (neni 76/1) përveç rasteve të parashikuara ndryshe.

Përmbajtja

Vlerat numerike të vendosura në sinjale, ju referohen gjithmonë përmasave dhe peshës efektive të mjetit në momentin e kalimit të tij.

Kombinimi

Nëse kushtet vendore të impiantit nuk e lejojnë përdorimin e sinjalit të vetëm të ndalimit ose të sinjaleve të ndalimit të plotësuar nga panele kufizuese **model II 4/a**, lejohet përdorimi në një sinjal të vetëm maksimumi me dy simbole që lidhen me kategorinë e mjeteve objekt i ndalimit (neni 115/2).

NDALIM QARKULLIMI
(neni 114/1a)

Figura II 46, neni 114

Tregon se është e ndaluar hyrja në një rrugë ku qarkullimi nuk lejohet në dy drejtimet e lëvizjes.

NDALIMKALIMI (DREJTIM I NDALUAR)
(nenet 114, 120/5)

Figura II 47, nenet 114, 120

Tregon se është e ndaluar hyrja në një rrugë e cila lejohet të kalohet në drejtimin e kundërt në cilësinë e lëvizjes me një drejtim.

NDALIM PARAKALIM
(nenet 30, 37, 114/1c)

Figura II 48, nenet 30, 37, 114

Tregon ndalimin e parakalimit për mjetet me motor, me përjashtim të ciklomotorëve dhe motoçikletave, edhe nëse manovra mund të kryhet brenda gjysëmkarrexhatës (me ose pa shirit te vazhdueshëm) (neni 114/1c).

Shiritat reflektues

Sinjali duhet të realizohet me shirita reflektuese me efikasitet të lartë (klasa 2).

LARGËSIA MINIMALE E DETYRUESHME
(neni 114/1ç)

Figura II 49, neni 114

Tregon ndalimin për të ndjekur mjetin që paraprin në një distancë më të vogël se ajo e dhënë në metra në sinjal (neni 114/1ç).

KUFIZIMI MAKSIMAL I SHPEJTËSISË
(neni 114/1d)

Figura II 50, nenet 30, 37, 114, 177

Tregon shpejtësinë maksimale në kilometra për orë, me të cilën mjeti mund të levizë në pjesën e rrugës së përcaktuar nga sinjali, duke mbetur të paprekura normat e sjelljes sipas nenit 140 të Kodit Rrugor ose kufizimet e mundshme minimale të vendosura për një kategori të caktuar mjetesh.

NDALIM SINJALIZIMI ZANOR
(neni 114/1dh)

Figura II 51, neni 114

Tregon që është i ndaluar, përveç në rast rreziku të menjëhershëm, përdorimi i lajmëruesve akustikë (neni 114/1dh).

NDALIM PARAKALIMI PËR MJETET E RËNDA ME NGARKESË TË PLOTË, MË TË MADHE SE 3,5 TON
(nenet 30, 115/1a)

Figura II 52, nenet 30, 115

Tregon ndalimin e parakalimit të automjeteve me motor për automjetet e rënda me ngarkesë të plotë më të madhe se 3.5 ton të treguar ne lejen e qarkullimit dhe të përshtatur për transportin e personave.

Përjashtime

Lejohet parakalimi i mjeteve pa motor vetëm nëse manovra mund të kryhet brenda gjysëmkarrexhatës (me ose pa shirit të pandërprerë).

Kompetencat

Pesha mund të përcaktohet në mënyra të ndryshme nga enti pronar i rrugës dhe, në këtë rast, sinjali duhet të pajiset me panelin plotësues që do të tregojë këtë vlerë.

Shiritat reflektues

Sinjali duhet të realizohet me shirita reflektuese me efikasitet të lartë (klasa 2).

NDALIMQARKULLIMI PËR MJETERET QË TËRHIQEN NGA KAFSHË
(neni 115/1b)

Figura II 53, neni 115

NDALIMQARKULLIMI PËR KËMBËSORË
(neni 115/1c)

Figura II 54, neni 115

NDALIMQARKULLIMI PËR BIÇIKLETA
(neni 115/1ç)

Figura II 55, neni 115

NDALIMQARKULLIMI PËR MOTOÇIKLETA
(neni 115/1d)

Figura II 56, neni 115

NDALIMQARKULLIMI PËR MJETET ME KRAHË
(neni 115/1dh)

Figura II 57, neni 115

NDALIMQARKULLIMI PËR TË GJITHA MJETET
(neni 115/1e)

Figura II 58, neni 115

Ndalohet lëvizja e të gjitha automjeteve, përfshirë motomjetet me tre dhe katër rrota.

NDALIMQARKULLIMI PËR AUTOBUZËT
(neni 115/1ë)

Figura II 59, neni 115

NDALIMQARKULLIMI PËR MJETET ME NGARKESË TË PLOTË,
MBI 3,5 TONË DHE
MBI.....TONË
(neni 115/1f)

Figura II 60/a, neni 115 Figura II 60/b, neni 115

Ndalimi i rezervohet mjeteve të papërshtatshme për transport njerëzish, pesha e të cilave tregohet në dokumentat e qarkullimit.

Mund të përcaktohet një vlerë e ndryshme nga pesha e lejuar për transport duke e dhënë këtë vlerë në ngjyrë të bardhë në brendësi të profilit të mjetit në skicuar në sinjal (**figura II 60/b**) ose nëpërmjet panelit plotësues.

NDALIMQARKULLIMI PËR MJETET
ME MOTOR QË TËRHEQIN NJË RIMORKIO
(neni 115/1g)

Figura II 61, neni 115

Nuk quhen rimorkio karrocat me jo më shumë se dy rrota për të cilat nuk vlen ndalimi.

Përjashtime

Përjashtime të mundshme për rimorkiot, të cilat nuk kalojnë një peshë të caktuar, mund të tregohen me anë të një paneli plotësues.

NDALIMQARKULLIMI PËR MAKINA BUJQËSORE
(neni 115/1gj)

Figura II 62, neni 115

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË TRANSPORTOJNË MALLRA TË RREZIKSHME
(neni 115/1h)

Figura II 63, neni 115

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË TRANSPORTOJNË LENDË PLASËSE OSE PRODUKTE LEHTËSISHTT TË NDEZSHME
(neni 115/1i)

Figura II 64/a, neni 115

Përjashtime të mundshme për transport të sasive të vogla mund të tregohen me panel plotësues i cili duhet të tregojë sasinë.

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË TRANSPORTOJNË PRODUKTE QË BASHKËVEPROJNË DHE E NDOTIN UJIN
(neni 115/1i)

Figura II 64/b, neni 115

Përjashtime të mundshme për sasi të vogla mund të tregohen me panel plotësues i cili duhet të tregojë sasinë.

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË KALOJNË GJERËSINË NË ..METRA
(neni 116/1a)

Figura II 65, neni 116

Duhet të vendoset vetëm nëse gjerësia e mjeteve që lejohet të qarkullojnë në rrugë është më e vogël se ajo e vendosur nga neni 61 i Kodit Rrugor.

Shih paragrafët Plotësime dhe Përmbajtje në faqet 41 dhe 42

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË KALOJNË LARTËSINË NË KOMPLEKS MË TË MADHE SE ... METRA
(neni 116/1b)

Figura II 66, neni 116

Duhet të vendoset vetëm nëse lartësia e mjeteve që lejohet të qarkullojnë në rrugë është më e vogël se ajo e përcaktuar nga neni 61 i Kodit Rrugor.

Shih paragrafët Plotësime dhe Përmbajtje në faqet 41 dhe 42

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE OSE I KOMPLEKS MJETEVE, QË KALOJNË GJATËSINË MË TË MADHE NË ... METRA
(neni 116/1c)

Figura II 67, neni 116

Duhet të vendoset vetëm nëse gjatësia e mjeteve ose e kompleksit të mjeteve që lejohet të qarkullojnë në rrugë është më e vogël se ajo e vendosur nga neni 61 i Kodit Rrugor.

Shih paragrafët Plotësime dhe Përmbajtje në faqet 41 dhe 42

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË KALOJNË NJË MASË MË TË MADHE SE ....TONË
(neni 116/1ç)

Figura II 68, neni 116

Duhet të vendoset vetëm nëse pesha e lejuar në rrugë është më e vogël se ajo e vendosur nga neni 62 i Kodit Rrugor, për mjetet që lejohet të qarkullojnë në këtë pjesë rruge.
Shih paragrafët Plotësime dhe Përmbajtje në faqet 41 dhe 42

Sinjali mund të plotësohet me panel plotësues **model II 6** i cili do të tregojë numrin maksimal të mjeteve që lejohet të qarkullojnë njëkohësisht.

NDALIMQARKULLIMI I MJETEVE QË KALOJNË MASËN PËR AKS MË TË MADHE SE .... TONË
(neni 116/1d)

Figura II 69, neni 116

Duhet të vendoset vetëm në rastin në të cilin pesha për aks me gjithë ngarkesë, e lejuar për qarkullim është më e vogël se ajo e vendosur nga neni 62 i Kodit Rrugor.

Shih paragrafët Plotësime dhe Përmbajtje në faqet 41 dhe 42

RRUGË E LIRË
(nenet 30, 117/1a)



Figura II 70, nenet 30, 117

Tregon pikën në të cilën urdhërimet e dhëna më parë pushojnë së qëni të vlefshme.

Sinjali është në sfond në ngjyrë të bardhë me shirit në ngjyrë të zezë.

FUND I KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË
(nenet 30, 117/1b)

Figura II 71, nenet 30, 117

Duhet të përdoret sa herë që rifillojnë kufijtë e përgjithësuara të shpejtësisë të cilat janë në fuqi në atë rrugë (neni 117/1b).
Në rastet kur dëshirohet të vihet një kufizim ndryshe, por gjithsesi më i madh se ai i përmendur, duhet të përdoret sinjali **KUFIRI MAKSIMAL I SHPEJTËSISË** (figura II 50) që do të tregoj kufizimin e ri, pa vendosur sinjalin **FUND I KUFIZIMIT TË SHPEJTËSISË MAKSIMALE (figura II 71)**.
Sinjali është me sfond në ngjyrë të bardhë me simbol në ngjyrë gri të errët dhe shirit në ngjyrë të zezë.

FUNDI I NDALIMPARAKALIMIT
(nenet 30, 117/1c)

Figura II 72, nenet 30, 117

Tregon fundin e ndalimit të parakalimit për të gjitha mjetet.

Sinjali është me sfond të bardhë me simbol në ngjyrë gri të errët dhe shiriti është detyrimisht në ngjyrë të zezë.

FUNDI I NDALIM PARAKALIMIT PËR MJETET E RËNDA ME NGARKESË TË PLOTË, ME MASË MË TË MADHE SE 3.5 TON
(nenet 30, 117/1ç)

Figura II 73, nenet 30, 117

Sinjali është me sfond në ngjyrë të bardhë me simbol në ngjyrë gri të errët dhe shirit në ngjyrë të zezë.

NDALIMPUSHIMI
(neni 118/1a)

Figura II 74, neni 118

Shih kapitullin Ndalimi, qëndrimi dhe pushimi në "Situata të Veçanta"

NDALIMQËNDRIMI
(neni 118/1a)

Figura II 75, neni 118

Shih kapitullin Ndalimi, qëndrimi dhe parkimi në "Situata të Veçanta"

PARKIM
(neni 118/1c)

Figura II 76, neni 118

Shih kapitullin ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe parkimi në "Situata të Veçanta"

PARALAJMËRIM PARKIMI
(neni 118/1ç)

Figura II 77, neni 118

Shih kapitullin Ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe parkimi në "Situata të Veçanta"

RRUGËKALIMI
(neni 118/1d)

Figura II 78, neni 118

Shih kapitullin Rrugëkalime në "Situata të Veçanta"

PUSHIM I LEJUAR PËR KATEGORI TË VEÇANTA AUTOMJETESH
(neni 118/2/3)

Figura II 79/a

Figura II 79/b

Figura II 79/c

Shih kapitullin Ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe parkimi në "Situata të Veçanta"

RREGULLIME TË NDRYSHUESHME TË VENDQËNDRIMIT NË QENDRËN E BANUAR
(neni 118/4)

Figura II 79/d, neni 118

Shih kapitullin Ndalimi, qëndrimi, pushimi dhe parkimi në "Situata të Veçanta"

SINJALET E DETYRIMIT

Të përgjithshme

Sinjalet e detyrimit vendosin për përdoruesit një sjellje të veçantë, ose një kusht të veçantë qarkullimi i cili duhet të respektohet (neni 119/1). Ndahen në *të përgjithshme* dhe *të veçanta*.

Forma

Sinjalet e detyrimit janë në formë rrethore (neni 119/1).

Përmasat

Përmasat janë ato të dhëna në **Skedën 15** (neni 78/1).

Ngjyrat

Sinjalet e detyrimit të përgjithshme përdorin ngjyrën e bardhë për simbolet dhe ngjurën blu për sfondin; ato të veçantat ngjyrën e zezë për simbolet, të bardhë për sfondin dhe të kuqe për kornizën (neni 119/2).

Plotësime

Sinjalet e detyrimit u drejtohen të gjithë përdoruesve, përveç përjashtimeve të dhëna në panelet plotësuese **model II 4**.

DETYRIME
TË PËRGJITHSHME

DREJTIME TË DETYRUESHME
(nenet 30, 120/1a)

Figura II 80/a



Figura II 80/b



Figura II 80/c



Figura II 80/d



Figura II 80/e

Vendosje gjatësore

I tregojnë drejtuesit të mjetit drejtimin e vetëm të lejuar (neni 120/2).

Plotësime

Sinjalet e figurës **II 80/a÷c** zakonisht vendosen në pikën në të cilën fillon detyrimi (neni 120/2).

Sinjalet e figurës **II 80/d÷e** zakonisht vendosen përpara pikës në të cilën fillon detyrimi (neni 120/2).

Sinjalet e figurës **II 80/d÷e** mund të plotësohen nga paneli plotësues **model II 1** (neni 120/2).

DREJTIME TË LEJUESHME
(nenet 30, 120/1b)

Figura II 81/a



Figura II 81/b

Figura II 81/c

I sinjalizojnë drejtuesit të mjetit drejtimet e vetme të lejuara (neni 120/3).

Vendosje gjatësore

Zakonisht sinjalet vendosen para pikës në të cilën fillon detyrimi (neni 120/3).

KALIM I DETYRUESHËM MAJTAS OSE DJATHTAS
(neni 30,120/4,173,175)

Figura II 82/a

Figura II 82/b

Vendosje gjatësore

Tregon detyrimin për të kaluar djathtas ose majtas në një pengesë, një ishull, një brez shpëtimi, një trafikndarës, ose sinjalizon devijimin në rast të punimeve në rrugë ose për shkaqe të tjera (neni 120/4).

Plotësime

Sinjalet duhet të vendosen në fillinin e ishullit të trafikut, të trafikndarësit, etj., në mënyrë që të perceptohet në kohë dhe të bëhet i qartë tregimi i kalimit të detyruar (neni 120/5).

Në rast se rruga e treguar ka një trafikndarës më të madh se 1,50m, sinjalet mund të plotësohen nga sinjali **DREJTIM I NDALUAR** (**figura II 47**) të vendosur në krahun e kundërt të fillimit të trafikndarësit.

KALIME TË LEJUESHME
(nenet 30,120/4,173,175)

Figura II 83, nenet 30, 120, 173, 175

Lejon kalimin nga të dyja anët e një pengese, ishulli etj .

Vendosje gjatësore

Sinjalet duhet të vendosen në fillimin e ishullit të trafikut, të trafikndarësit, etj, në mënyrë që të jenë të perceptueshme (shikueshme) në kohë dhe të bëhet i qartë tregimi i kalimit të detyruar. Shih kapitullin Pengesa në "Situata të Veçanta"

QARKULLIM RRETHOR
(neni 120/6)



Figura II 84, neni 120

Vendosje gjatësore

I tregon drejtuesve të mjeteve detyrimin e qarkullimit sipas drejtimit të dhënë nga shigjetat (neni 120/6).

Vendosja

Sinjali duhet të vendoset në pragun e zonës në të cilën kryhet qarkullimi rrethor (neni 120/6).

Në rrugët interurbane ky sinjal gjithmonë paraprihet nga sinjali **PARALAJMËRIM I QARKULLIMIT RRETHOR** (**figura II 27** faqe 37) (neni 120/6). Shih kapitullin Rrethore në "Situata të Veçanta"

KUFIZIMI MINIMAL I SHPEJTËSISË
(neni 120/1d)

Figura II 85, neni 120

I tregon drejtuesit të mjetit që qarkullon në rrugë, ose në një ose më shumë korsi objekt të sinjalit, kufirin minimal të shpejtësisë të cilën janë të detyruar të mbajnë (neni 120/7).

U ndalohet mjeteve të cilat nuk janë në gjendje të arrijnë këtë shpejtësi minimale, të zënë këtë rrugë ose korsi (neni 120/7).

FUNDI I KUFIZIMIT MINIMAL TË SHPEJTËSISË
(neni 120/1d)

Figura II 86, neni 120

Fundi i detyrimit duhet të tregohet me sinjalin përkatës, detyrimisht të shenjuar nga një shirit i kuq (neni 120/7).

ZINXHIRË TË DETYRUESHËM PËR DËBORË
(nenet 120, 133/18)



Figura II 87, nenet 120, 133

I tregojnë drejtuesit të mjetit detyrimin për të qarkulluar, duke u nisur nga pika ku është vendosur sinjali, me zinxhirë ose goma dëbore (neni 120/8).

Vendosje gjatësore

Sinjali zakonisht është i vendosur në pikën në të cilën fillon detyrimi (neni 120/8).

Kombinime

Sinjali mund të përfshihet në sinjalin **RRUGË E LIRË** (shih paragrafin Rrugë e Lirë në kapitullin Sinjale të lokalitetit dhe lokalizimeve) duke mbajtur vlerat e veta të përcaktuara.

RRUGË KALIMI PËR KËMBËSORË
(neni 120/9a)

Figura II 88, neni 120

Vendosje gjatësore

Tregon se rruga ose pjesë e saj është e rezervuar për këmbësorët

Sinjali vendoset në fillim të rrugës, të një itinerari ose rrugë të rezervuar vetëm për këmbësorët (zonë këmbësorësh).

FUNDI I RRUGËS SË KALIMIT PËR KËMBËSORË
(neni 120/10)

Figura II 89, neni 120

Tregon fundin e një rruge a zone të rezervuar për këmbësorët.

RRUGËKALIM PËR BIÇIKLETA
(neni 120/9b)

Figura II 90, neni 120

Tregon se rruga ose një pjesë e saj është e rezervuar për biçikleta (neni 120/9b). Shih kapitullin Zonë për biçikleta në "Situata të Veçanta"

Vendosje gjatësore

Sinjali duhet të vendoset në fillim ose gjatë vazhdimit të një zone, të një korsie ose të një itinerari të rezervuar për qarkullim biçikletash (neni 122/9b).

Sinjali duhet të përsëritet pas çdo ndërprerjeje ose pas çdo kryqëzimi (neni 120/9b).

FUNDI I RRUGËKALIMIT PËR BIÇIKLETA
(Neni 120/10)

Figura II 91 neni 120

Tregon fundin e zonës së rezervuar për biçikleta.

RRUGËKALIMI PËR BIÇIKLETA, NGJITUR ME TROTUARIN
(neni 120/9c)

Figura II 92/a, neni 120

Tregon fillimin e një korsie ose piste për biçikleta, ngjitur dhe paralel me një trotuar ose gjithsesi një kalim të rezervuar për këmbësorët (neni 120/9c).

Mund të realizohet në mënyrë të tillë që të respektojë vendosjen reale gjeometrike të pistës së biçikletave në lidhje me trotuarin.

FUNDI I RRUGËS SË KALIMIT PËR BIÇIKLETA, NGJITUR ME TROTUARIN
(neni 120/10)

Figura II 93/a, neni 120

Tregon fundin e një rrugëkalimi për biçikleta ngjitur me trotuarin.

RRUGËKALIM I REZERVUAR PËR KAFSHË BARRE OSE ME SHALË
(neni 120/9ç)

Figura II 94, neni 120

Tregon se rruga ose një pjesë e saj është e rezervuar për kafshë barre ose me shalë (neni 120/9d).

Vendosje gjatësore

Sinjali duhet të vendoset në fillim ose në vazhdim të një piste ose të një kalimi të veçantë (neni 120/9d).

FUNDI I RRUGËS SË KALIMIT TË REZERVUAR PËR KAFSHË BARRE OSE ME SHALË

Figura II 95, neni 120

Tregon fundin e zonës së rezervuar për kafshë barre ose me shalë.

DETYRIME TË VEÇANTA

NDAL - DOGANA
(neni 121/1a)

Figura II 96

Figura II 97/a

Figura II 97/ b

Tregon një vendkalim doganor ku është i detyrueshëm ndalimi (neni 121/2).

Në të njëjtin sinjal, poshtë shiritit horizontal, mund të vendoset fjala "doganë" në gjuhën e vendit kufitar.

Në kufijtë e vendeve anëtarë të Bashkimit Europian sinjali zëvendësohet nga ai i **figurave II 97/a** dhe **b**.

NDAL POLICIA
(neni 121/3)

Figura II 98, neni 121

Shenja e një postoblloku të policisë ku duhet detyrimisht të ndalohet (neni 121/3).

Shenja është e lëvizshme, duhet të vendoset në distancë të përshtatshme me postoblokun, në mënyrë që drejtuesi i mjetit të marë masat e duhura pas perceptimit të sinjalit. Sinjali, duhet të vendoset në mënyrë që të mos përbëjë rrezik për qarkullimin, duhet të përsëritet në pikën e ndalimit.

Në rast të një rruge që çon në një vendkalim kufiri, lejohet të përsëritet shenja në gjuhën e shtetit kufitar.

NDAL – STACION
(neni 121/4)

Figura II 99, neni 121

Paralajmëron një stacion ku është e detyrueshme të ndalohet për veprimet e hyrje – daljes, si në autostradë, ashtu edhe në hyrje të kontrolluara (neni 121/4)
Në rast të një rruge që çon në një vendkalim kufiri, lejohet të përsëritet shenja në gjuhën e shtetit kufitar.

SINJALET E PËRPARËSISË

Të përgjithshme

Përparësia duhet të bëhet e ditur me anë të sinjaleve përshkruese që duhet të vendosen, nga dhe me shpenzimet e pronarit të rrugës që ka përparësinë. Sinjalet që tregojnë përdoruesve që duhet të japin ose që kanë përparësi, ndahen në dy kategori :

- sinjalet që detyrojnë përdoruesit të japin përparësi;
- sinjalet që ju tregojnë përdoruesve që në kryqëzimet ose njëkalimet e alternuara, drejtuesit e mjeteve që vijnë nga rruga tjetër ose në drejtim të kundërt kanë detyrim t'ju japin përparësi.

Është e rëndësishme të theksohet se sinjalet e përparësisë duhet të pajisen me panelet plotësuese m**odel II 1** ose **model II 5/a2** dhe **b2** (neni 103/2).

JEP PËRPARËSI
(neni 104/1)



Figura II 36, neni 104

Sinjali duhet të përdoret për t'ju treguar drejtuesve detyrimin për të dhënë përparësi mjeteve që qarkullojnë në të dy drejtimet e rrugës në të cilën ata do të futen ose do të kalojnë (neni 104/1).

Plotësime

Sinjali mund të plotësohet me panelin plotësues **mod II 7** (neni 103/3).

Kombinimi

Sinjali mund të vendoset së bashku, në të njëjtën mbajtëse, me sinjalet e drejtimit të detyruar, që vendosen gjithmonë më poshtë. (neni 103/5)

Mënyra e vendosjes

Për mënyrën e vendosjes shih kapitullin Kryqëzime në "Situata të Veçanta"

Shirita reflektimi

Sinjali duhet të realizohet duke përdorur shirita reflektimi me efikasitet të lartë (klasi 2).

NDALO DHE JEP PËRPARËSI
(neni 105/1)

Figura II 37, neni 105

Sinjali duhet të vendoset nëpër kryqëzime ose në vende që nuk gëzojnë të drejtën e përparësisë, për t'ju treguar drejtuesve të mjeteve detyrimin për të ndaluar para vijës tërthore të ndalimit në kryqëzim dhe për të dhënë përparësi para se të futen në kryqëzim ose në fluksin e qarkullimit (neni 105/1).

Plotësime

Sinjali mund të plotësohet në panelin plotësues **model II 7** (neni 105/3).

Kombinime

Sinjali mund të vendoset, në të njëjtën mbajtëse së bashku me sinjalet e drejtimit të detyruar, që vendosen gjithmonë poshtë të parit (neni 103/5).

Mënyra e vendosjes

Për mënyrën e vendosjes shih Kapitullin Kryqëzimet në "Situata të veçanta".

Shiritat reflektues

Sinjali duhet të realizohet duke përdorur shirita plasmasi reflektues me efikasitet të lartë (klasa2)

PARALAJMËRIMI PËR TË DHËNË PËRPARËSI
(neni 106/1)

Figura II 38, neni 106

Duhet të vendoset në pjesën më të afërt të hyrjes në rrugën me të drejtë përparësie jashtë qendrave të banuara dhe, brenda qendrave të banuara, në pjesën më afërt të kryqëzimeve me rrugë të cilat kanë kufizim të shpejtësisë jo më të madhe se ajo e vendosur nga neni 140/1 i Kodit Rrugor, pra kur kushtet e trafikut kërkojnë vendosjen për motive sigurie ose disiplinimi të qarkullimit.

Në vendin ku vendosen këto sinjale, mund të vendosen edhe sinjale të paralajmërimit të kryqëzimit, të plotësuar me sinjalin e përparësisë, në të cilën jepet konfigurimi topografik i kryqëzimit (neni 106/2).

Plotësime

Sinjali mund të plotësohet me panelin plotësues **model II 7** (neni 103/3). Largësia midis sinjalit të paralajmërimit dhe shiritit tërthor të ndalimit shtohet në panelin plotësues **model II 1** të vendosur sipër vetë sinjalit (neni 106/3). Në rast se ekzistojnë kryqëzime të tjera midis sinjalit të paralajmërimit të përparësisë dhe kryqëzimit, sinjali duhet të përsëritet pas çdo kryqëzimi, i plotësuar me panelin **model II 1** që tregon distancën përkatëse (neni 106/4).

PARALAJMËRIMI PËR T'U NDALUAR DHE PËR TË DHËNË PËRPARËSI
(neni 104/1)

Figura II 39, neni 106

Duhet të vendoset në pjesën më të afërt të hyrjes në rrugën me të drejtë përparësie jashtë qendrave të banuara dhe, brenda qendrave të banuara, në pjesën më afër kryqëzimeve me rrugë të cilat kanë kufizim të shpejtësisë jo më të madhe se ajo e vendosur nga neni 140/1 i Kodit Rrugor, pra kur kushtet e trafikut kërkojnë vendosjen për motive sigurie ose disiplinimi të qarkullimit.

Në vendin ku vendosen këto sinjale, mund të vendosen edhe sinjale të paralajmërimit të kryqëzimit, të plotësuar me sinjalin e përparësisë, në të cilën jepet konfigurimi topografik i kryqëzimit (neni 106/2).

Plotësime

Sinjali mund të plotësohet me panelin plotësues **model II 7** (neni 103/3). Largësia midis sinjalit të paralajmërimit dhe shiritës tërthore të ndalimit, shtohet në panelin plotësues **model II 1** të vendosur sipër vetë sinjalit (neni 106/3). Në rrugët e përmendura më sipër kur ekzistojnë kryqëzime të tjera midis sinjalit të paralajmërimit të përparësisë dhe kryqëzimit, sinjali duhet të përsëritet pas çdo kryqëzimi, i plotësuar me panelin **model II 1** që tregon distancën përkatëse (neni 106/4).

KRYQËZIM ME PËRPARËSI NGA E DJATHTA
(neni 109/1)

Figura II 40, nenet 41, 104, 107

Sinjali duhet të vendoset në rrugët interurbane për të lajmëruar një kryqëzim midis dy ose më shumë rrugëve, në të cilat mbizotëron rregulli i përgjithshëm i përparësisë nga e djathta (neni 107/1).

Ky sinjal, në qendrat e banuara, mund të përdoret vetëm kur kushtet e trafikut këshillojnë vendosjen për motive të sigurisë (neni 107/1).

Mënyra e vendosjes

Për mënyrën e vendosjes shih kapitullin Kryqëzimet në "Situata të Veçanta"

Shiritat Reflektuese

Sinjali duhet të realizohet me shirita reflektuese me efikasitet të lartë (klasa 2).

JEP PËRPARËSI NË RRUGË NJËKALIMSHE TË ALTERNUARA
(neni 108/1)

Figura II 41, nenet 37, 108

Rekomandohet që pajisjet e veçanta për të rregulluar qarkullimin në prani të ngushtimeve mund të vendosen drejtëpërsëdrejti nga organet kompetente.

Mënyra e vendosjes

Sinjali duhet të përdoret në fillim të ngushtimeve të përhershme, në rastet në të cilat është e nevojshme të vendoset një drejtim unik ecjeje i alternuar, për përmasa të kufizuara të korsisë, duke mbajtur parasysh planimetrinë e rrugës si dhe tipet dhe përmasat e mjeteve të cilat lejohet të qarkullojnë. (neni 108/1)

Në ngushticë një kalimshe të alternuara, në të cilat hyrjet nuk duken nga njëra - tjetra ose janë më tepër se 50 m larg, duhet të vendoset impiant semaforik që funksionon gjatë gjithë ditës (neni 108/3)

Sinjali duhet të ketë në pjesën e mbrapme të vendosur nga prodhuesi, shkrimin që vërteton bazën juridike të vendosjes (neni 108/2).

E DREJTA E PËRPARËSISË
(neni 109/1)



Figura II 44, nenet 109, 111

Sinjali duhet të përdoret për të treguar një pjesë rruge që gëzon të drejtën e përparësisë (neni 111/1)

Plotësime

Sinjali mund të plotësohet me panelin plotësues **model II 7** (neni 103/3).

Përmasat

Sinjali mund të përsëritet në format më të vogël para dhe pas çdo kryqëzimi ose eventualisht, në ishuj trafikndarës të kryqëzimeve të kanalizuara, i plotësuar me panelin plotësues **model II 7** (neni 111/2).

Mënyra e vendosjes

Për mënyrën e vendosjes shih kapitullin Kryqëzimet në "Situata të Veçanta"

FUNDI I TË DREJTËS SË PËRPARËSISË
(neni 109/1)

Figura II 42, neni 109

Ju tregon përdoruesve të rrugës me të drejtë përparësie që rruga nuk e gëzon më atë të drejtë (neni 109/1).

Mënyra e vendosjes

Për mënyrën e vendosjes shih kapitullin Kryqëzimet në "Situata të Veçanta"

KRYQËZIMET ME TË DREJTË PËRPARËSIE
(neni 110/1)

Fig. II.43/a, neni 110

Fig. II.43/b, neni 110

Fig. II.43/c, neni 110

Fig. II.43/d, neni 110

Fig. II.43/e, neni 110

Sinjali duhet të vendoset në rrugët interurbane dhe, aty ku shikohet e arësyeshme, në rrugët urbane, për të paralajmëruar një kryqëzim në rrugë jo kryesore (neni 112/1).

Egzistojnë këto variante :

Figura	*Emërtimi*	*Aplikimi*
Fig II 43/a	Kryqëzim me të drejtë përparësie	Kryqëzim në 4 degë
Fig II 43/b	Kryqëzim në formë "T" me të drejtë përparësie nga e djathta	Hyrje vetëm nga e djathta
Fig II 43/c	Kryqëzim në formë "T" me të drejtë përparësie nga e majta	Hyrje vetëm nga e majta;
Fig II 43/ç	Hyrje nga e djathta	Korsi shpejtësie nga e djath
Fig II 43/e	Hyrje nga e majta	Korsi shpejtësie nga e majta

Plotësimi

Tre sinjalet e para mund të plotësohen me paneli plotësues **model II 7** (neni 103/3).

Mënyra e vendosjes

Për mënyrën e vendosjes shih kapitullin Kryqëzime në "Situata të Veçanta"

KRYQËZIME TË SEMAFORIZUARA

Sinjale përparësie të vendosura në kryqëzimet e rregulluara me semafor, nënkuptohen të vlefshëm vetëm kur semafori nuk punon ose është me të verdhë pulsuese. Në këto raste nuk duhet të përdoret asnjë panel plotësues me këtë specifikë.

SINJALET TREGUESE

Të përgjithshme
(neni 122/1)

U japin përdoruesve të rrugës informacionin e nevojshëm për:
- të qarkulluar me rregullsi dhe të sigurtë;
- të thjeshtuar dallimin e:
  - itinerareve;
  - qëndrave administrative;
  - shërbimet dhe impiantet rrugore të nevojshme.

Kompetencat
(neni 75/2)

Enti pronar i rrugës vendos për informacionet që duhet t'i jepen përdoruesve sipas një projekti të veçantë që i referohet një zone të tërë ose itinerareve të veçanta.

Klasifikimi dhe qëllimi

Sinjalet treguese, në varësi të informacioneve që ato përmbajnë, ato ndahen (neni 39/1C Kodit Rrugor):
- *paralajmëruese* në afërsi të kryqëzimeve, informojnë paraprakisht për drejtime të mundshme ose lejojnë zgjedhjen paraprake të pozicioneve në karrexhatë në raport me vendin të cilin duan të arrijnë (neni 125);
- *drejtimi*: në përgjigje të kryqëzimeve, tregojnë degëzimin e kryqëzimeve për t'u ndjekur për të arritur lokalitetet e dhëna në sinjalet e paralajmërimeve (neni 126);
- *pohuese:* në dalje të kryqëzimeve ose përgjatë një itinerari, konfirmojnë drejtimin, rrugën ose itinerarin të cilit i përket, për të evituar gabime në rrugë e sipër (neni 130);
- *tregim rruge dhe largësimatës progresiv;* (neni 127)
- *tregues itinerari;* (neni 128)
- *tregues i qendrave administrative;* (neni 129)
- *tregues emri rruge;* (neni 131)
- *tregues turistik dhe territorial;* (neni 132)
- *tregues të nevojshëm për drejtimin e mjetit* (neni 133)
- *tregues shërbimesh të nevojshme* (neni 134)

Cilësitë dhe kriteret për shfrytëzim
(neni 75/2, 125/2 dhe /6)

Projekti i sistemit të sinjaleve treguese, për të garantuar sigurinë dhe rrjedhshmërinë e qarkullimit të këmbësorëve dhe mjeteve, duhet të ketë cilësitë themelore të mëposhtëme:

- ***Përshtatshmëria:*** numri, lloji dhe vendosja e sinjaleve duhet t'i përshtaten gjendjes së rrugës, për të lejuar perceptimin e menjëhershëm dhe korrekt dhe për të mos hutuar përdoruesit.

Në shembullin e **Skemës 13** (aneksi A), janë përballur dy instalime sinjalesh drejtimi: e para, e gabuar, jep drejtime konfuze e shumë paperceptueshme, e dyta, e cila i bindet tipareve të përshtatshmërisë, lejon një perceptim të qartë dhe të menjëhershëm.

- ***Koherenca:*** në të njëjtin itinerar duhet të jepen të njëjtat informacione. Domethënë duhet të ndiqen kriteret e mëposhtëme:

- Informacionet që ndodhen në sinjalet e përzgjedhjes, paralajmërimit, drejtimit dhe konfirmimit, si dhe të gjitha sinjalet e vendosura përgjatë itinerarit, duhet të jenë koherente midis tyre, të plota dhe të koordinuara;
- Sinjalet e paralajmërimit duhet të tregojnë qendrat e arritshme nga secili degëzim, për të realizuar një përzgjedhje dhe drejtim të përshtatshëm të rrymave të mjeteve;
- Sinjalet e drejtimit duhet të tregojnë të njëjtat qendra administrative të dhëna nga sinjalet e paralajmërimit;
- Në të njëjtën kohë, sinjalet e konfirmimit duhet të sigurojnë përdoruesin mbi korrektësinë e drejtimit të zgjedhur, tregojnë emrin e qendrës së treguar nga sinjalet e mëparshme të drejtimit;
- Informacionet mbi drejtimet që duhen ndjekur përsëriten në të gjitha kryqëzimet, me përjashtim të atyre në të cilat struktura e rrugëve që degëzohen nuk lë të dyshohet për saktësinë e itinerarit;
- Një shembull i aplikimit të kriterit të koherencës jepet në **Skemat 14** dhe **14a** (aneksi A), të cilat ilustrojnë rastin e dy kryqëzimeve të njëpasnjëshme (e para interurbane, e dyta urbane) përgjatë një itinerari rrugor.

- ***homogjeniteti*** : në të njëjtin itinerar, nga fillimi në fund, sinjalitika e tregimit duhet të realizohet me të njëjtin grafik, simbologji, ngjyrë dhe largësi të leximit.

Nisur nga kompleksiteti i sinjaleve të tregimit, vlejnë gjithashtu kriteret e përgjithshme të mëposhtëme:

- informacionet që duhet t'u jepen përdoruesve duhet të jenë të plota dhe të sakta, kështu që duhet të zgjidhen me shumë kujdes dhe vëmëndje (neni 122/5);

- sinjalet e drejtimit duhet të respektojnë ambientin rrethues dhe të harmonizohet me të (neni 122/3);

- sinjalet e drejtimit duhet të realizohen dhe të lidhen në mënyrë që të jenë lehtësisht të shikueshme dhe të kuptueshme (neni 122/3).

Detyrueshmëria

Sinjalet e tregimit janë të detyrueshme dhe duhet të jetë konform (neni 122/7) cilësive dhe kritereve të dhëna më sipër, në rrugët e mëposhtme:

- autostradë (Tipi A)
- rrugë interurbane (Tipi B dhe C);
- rrugë urbane kryesore (Tipi D) me shpejtësi më të madhe se 40 km/orë (neni 140/1 Kodit Rrugor);
- itinerarët e hyrjes dhe daljes nga qëndrat e banueshme, me përjashtim të kryqëzimeve me rrugët lokale të paasfaltuara ose të pa rëndësishme.

Përmasat
(neni 78/1 dhe /7)

Si rregull kryesor, përmasat e sinjaleve treguese varen nga sasia e informacionit që përmbajnë, dhe përcaktohen duke patur parasysh elementët e mëposhtëm, të përshkruar në vijim nga ky kapitull (tabelat e dhëna përmbajnë shembujt lidhur me pika të ndryshme):

- shpejtësinë lokale mbizotëruese **Skemat 15** dhe **15a**;
- hapësirën e paralajmërimit **Skema 16**;
- largësinë e leximit **Skemat 17** dhe **17a**;
- numrin e mbishkrimeve **Skemat 15** dhe **15a**;
- lartësinë e shkronjave **Skemat 17** dhe **17a**; **15** dhe **15a**;
- hapësirën ndërmjet shkronjave **Tabelat II 22a ÷ n**;
- hapësirën ndërmjet rrjeshtave dhe anëve **Skema 18**;
- madhësinë e kornizave **Skema 18**;

Këto **Skema dhe tabela** ndodhen në aneksin A.

Vendosja e përmasave të sinjaleve është një operacion që kryhet me kujdes dhe vëmëndje, duke mbajtur parasysh hapësirën e paralajmërimit, ose pjesët e hëpësirës që, duke u përshkruar me një shpejtësi të caktuar, i lejojnë përdoruesit të rrugës të perceptojë mesazhin që përmban sinjali dhe të vendosë cilin veprim të bëjë për pasojë. Mekanika e perceptimit përbëhet nga fazat:

- ***dallimi i sinjalit***: konsiston në hasjen e ekzistencës së një sinjali përgjatë rrugës; në këtë fazë është i rëndësishëm roli i kornizave, ose e thënë më mirë shenja optike në sfondin e peisazhit;
- ***njohja***: gjatë kësaj faze përdoruesi identifikon llojin e sinjalit, domethënë klasën e mesazhit që mund të merret prej tij; dhe përgatitet për leximin e mbishkrimit ose njohjes së simboleve, duke dalluar paraprakisht elementët e veçantë (për shembull mund të përqëndrohet vëmëndja vetëm mbi shtojcat blu, nëse interesi tij kufizohet në një vendarritje interurbane).

- Elementët që thjeshtësojnë njohjen janë forma e sinjalit (që lejon dallimin e kategorisë: rrezik, detyrim, tregim, etj.), dhe ngjyra e tij (që lidhet për shembull me llojin e rrugës ose vendarritjen të cilës i referohet tregimi);

- *leximi i mbishkrimit ose dallimi i simbolit*: është faza në të cilën përdoruesi kupton mesazhin e sinjalit dhe vendos, për pasojë, lëvizjen që duhet bërë; për të thjeshtëzuar leximin e mbishkrimeve duhet të bëhet kujdes maksimal në realizimin e një kompozimi grafik të ekuilibruar mjaftueshëm, duke përmasuar me kujdes elementët e veçantë në panel, domethënë: lartësinë e karatereve dhe hapësirën ndërmjet tyre, anët ndërmjet mbishkrimit dhe buzëve, pozicionet reciproke të mbishkrimeve, etj.;

- *largësia e lexueshmërisë*: është pjesa e hapësirës, që ndodhet në hapësirën e dallimit që larg, e cila lejon leximin e mbishkrimit; në fuksion të tij përcaktohet lartësia e shkronjave, sipas formularëve të dhënë në paragrafin në vijim. Përgjatë të njëjtit itinerar, largësia e leximit të sinjaleve të ndryshme duhet të ruhet e njëjtë, sipas kriterit të homogjenitetit.

Vendosja e përmasave të sinjaleve kryhet sipas fazave në vijim:

- përkufizimi i shpejtësisë lokale që mbizotëron në rrugë;

- zgjedhja e tipit të alfabetit sipas përshkrimeve të dhëna në paragrafin më poshtë;

- përcaktimi i hapësirës së lajmërimit, vetëm për sinjalet e paralajmërimit, në fuksion të shpejtësisë që mbizotëron, duke përdorur diagramën e **Skemës 16**;

- vlerësimi i largësisë së leximit më të përshtatshme për situatën, duke mbajtur parasysh numrin e veprimeve që përdoruesi duhet të kryejë duke e përshkruar;

- përcaktimi i lartësisë minimale të shkronjave në funksion të largësisë së leximit, përmes **tabelave 1a+c,** faqe 72 (duke marrë parasysh vlerat e lartësisë minimale që i përgjigjen një shkrimi të vetëm) ose diagramat e **Skemave 17** dhe **17a**;

- përcaktimi i lartësisë minimale të shkronjave, vetëm për sinjalet që përmbajnë tre ose më shumë mbishkrime, në funksion të shpejtësisë lokale mbizotëruese dhe të numrit të mbishkrimeve, duke përdoruar **tabelat 1a+c** ose diagramat e **Skemave 15** dhe **15a**. Lartësia më e madhe e mbishkrimeve të pranishme në më shumë se dy rradhë lidhet me nevojën për të garantuar një largësi leximi më të madhe, e domosdoshme për leximin e plotë të shkrimit;

- vendosja e blloqeve të ndara të mbishkrimeve në brendësi të panelit dhe shënjimi i shigjetave të mundshme;

- Vendosja e përmasave përfundimtare të tabelës, me qëllim që të përmbajë informacionet e quajtura të domosdoshme, sipas një faqosjeje grafike të ekuilibruar dhe kritereve të përshtatshmërisë, koherencës dhe homogjenitetit.

Përshkrimet që i përkasin sinjaleve të vetme ose situatave të veçanta jepen në Skema të posaçme përshkruese.

Mbishkrimet
(neni123)

Karakteret alfabetike dhe numrat e përdorur janë: (tabelat ilustrojnë tipet e ndryshme) (neni 123/5):

Tabelat II 22 a+n

- *Alfabeti* NORMAL

  - shkronja pozitive të vogla; **tabela II 22a**
  - shkronja pozitive të mëdha; **tabela II 22b**
  - shkronja negative të vogla; **tabela II 22d**
  - shkronja negative të mëdha; **tabela II 22e**

-

- *Numra* NORMAL

  - karaktere pozitive; **tabela II 22c**
  - karaktere negative **tabela II 22f**

- *Alfabeti* NGJESHUR

  - shkronja pozitive të vogla; **tabela II 22g**
  - shkronja pozitive të mëdha; **tabela II 22h**
  - shkronja negative të vogla; **tabela II 22l**
  - shkronja negative të mëdha; **tabela II 22m**

- Numra të NGJESHUR

  - karaktere pozitive; **tabela II 22i**
  - karaktere negative **tabela II 22n**

- ***Vendosja e shkronjave të mëdha*** (neni 123/6):

  - emra të përveçëm gjeografikë: rrethe, qytete, qendrat e banuara, komunat, fshatrat.

- ***Vendosja e shkronjave të vogla*** (neni 123/6):

  - emra të përgjithshëm dhe të përveçëm që i përkasin pikave të interesit publik urban;
  - emra të rrugëve urbane dhe interurbane;
  - lagje, stacione, porte, aeroporte, zyra, ente, komanda, zyra administrative, spitale, qendra qytetesh, emra rrugësh, parqe;
  - mbishkrime të tjera të ndryshme të emrave gjeografikë.

- ***Vendosja e shkronjave të ngjeshura*** (neni 123/7)

  - në mungesë të hapësirës;
  - në prani të fjalëve ose grupeve të fjalëve të pashkurtueshme.

- ***Vendosja e shkronjave negative***:

  - në lidhje me kombinimin kromatik karakter- sfond, siç është dhënë në **Skemën 19**;
  - trashësia e karaktereve negative duhet të reduktohet në masën 15% në krahasim me ato pozitivet (neni 123/10).

- ***Pranohen shkrutime të emrave shumë të gjatë*** (neni 123/9).

- ***Hapësira ndërmjet karaktereve***:

  - është e njëjtë për një alfabet të dhënë;
  - përbëhet nga drejtëkëndësha përmbledhës të karaktereve të dhënë nga **tabelat II 22 a+n**;
  - është e pavarur nga gjatësia e fjalëve, ashtu siç shfaqet dukshëm në shembullin e **tabelës II 18**

- ***Lartësia e karaktereve***: përcaktohet në funksion të hapësirës së shikimit, të largësisë së leximit të kërkuar nga lloji i rrugës dhe nga shpejtësia që mbizotëron (neni 123/8):

- ***Largësia e lexueshmërisë***: lartësia e karaktereve duhet të përputhet me largësinë e lexueshmërisë sipas asaj që i korrespondon të shprehur nga diagramet e dhëna në **Skemat 17** dhe **17a**. Sipas llojit të rrugës, gjithsesi respektohen vlerat minimale të largësisë së lexueshme, të dhëna më poshtë, të cilave duhet t'i përgjigjet një lartësi e përshtatshme e karaktereve:

- autostrada (Tipi A): 150 m;
- rrugë interurbane kryesore (Tipi B): 150 m;
- rrugë interurbane dytësore (Tipi C): 100 m;
- rrugë urbane kryesore (Tipi D): 100 m;
- rrugë urbane dytësore (Tipi E): 60 m;
- rrugë lokale (Tipi F): 60 m;

Është e nevojshme, gjithsesi, që entet pronare të rrugës të përdorin largësi të lexueshme më të madhe se ajo minimale;

- ***Shpejtësia lokale mbizotëruese***: në sinjalet që paraqesin më shumë se dy mbishkrime, lartësia e karaktereve duhet të jetë më e madhe se minimalja, për të garantuar një largësi leximi më të madhe, dhe kjo llogaritet duke u nisur nga vlera e shpejtësisë mbizotëruese e shprehur në km/orë, sipas procedurës në vijim: përcaktohet largësia e lexueshmërisë në funksion të shpejtësisë lokale mbizotëruese me formulën empirike:

$$\mathbf{D = N \cdot V / 3{,}6}$$

në të cilën simbolet kanë këto kuptime:

D = largësia e lexueshmërisë e shprehur në metra;
N = numri i rreshtave të pranishëm në mbishkrim;
V = shpejtësia lokale mbizotëruese e shprehur në km/orë;

Nxirret gjatësia minimale e gërmave "**H**", e shprehur në centimetra, nga formulat:

H = D / 8 për alfabetet normale,
H = D / 6 për alfabetet e ngjeshura;

- **Tabelat 1a+c** faqe 72, paraqesin vlerat e gjatësisë minimale të gërmave, të llogaritura në funksion të vlerave të shpejtësisë lokale mbizotëruese, dhe të kufijve të largësisë minimale të lexueshme; enti pronar i rrugës ka të drejtë të përdorë gërma me lartësi më të madhe se sa minimalia e kërkuar;

- diagramet e **Skemave 15** dhe **15a** shprehin përpjestimin midis lartësisë së gërmave dhe shpejtësisë lokale mbizotëruese në rastin e sinjaleve me më shumë se dy mbishkrime.

Tabela 1a

Lartësia minimale e karaktereve – Autostradë (Tipi A) dhe rrugë interurbane kryesore (Tipi B)								
	1 ose 2 mbishkrime		3 mbishkrime		4 mbishkrime		5 mbishkrime	
Shpejtësia [km/orë]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]
Deri në **110**	**20**	**26**	**20**	**26**	**20**	**26**	**20**	**26**
120	20	26	20	26	20	26	22	28
130	**20**	**26**	**20**	**26**	**20**	**26**	**24**	**30**

Tabela 1b

Lartësia minimale e karaktereve – Rrugë interurbane (Tipi C) dhe rrugë urbane kryesore (Tipi D)								
	1 ose 2 mbishkrime		3 mbishkrime		4 mbishkrime		5 mbishkrime	
Shpejtësia [km/orë]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere Normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere Normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]
Deri në 70	14	18	14	18	14	18	14	18
80	14	18	14	18	14	18	14	20
90	**14**	**18**	**14**	**18**	**14**	**18**	**16**	**22**
100	14	18	14	18	14	20	18	24
110	14	18	14	18	16	20	20	26

Tabela 1c

Lartësia minimale e karaktereve – Rrugë interurbane dytësore (Tipi E) dhe rrugë lokale (Tipi F)								
	1 ose 2 mbishkrime		3 mbishkrime		4 mbishkrime		5 mbishkrime	
Shpejtësia [km/orë]	Karaktere Normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]	Karaktere normale [cm]	Karaktere të ngjeshura [cm]
Deri në 40	8	10	8	10	8	10	8	10
50	**8**	**10**	**8**	**10**	**8**	**10**	**10**	**12**
60	8	10	8	10	8	12	10	14
70	8	10	8	10	10	14	12	16
80	8	10	8	10	12	16	14	20
90	**8**	**10**	**10**	**14**	**14**	**18**	**16**	**22**
100	8	10	10	14	14	20	18	24
110	8	10	10	14	16	20	20	26

Simbolet

Përdoren në këto raste:
- në shtesë ose në zëvendësim të mbishkrimeve (neni 123/1);
- lexim i dobët i sinjaleve për teprim të mbishkrimeve (neni 123/3);
- kompozim i papërshtatshëm i sinjaleve për teprim të mbishkrimeve (neni 123/3).

Simbolet e parashikuara nga rregullorja janë ilustruar në **figurat II 100÷231** (neni 123/2).
Përdorimi i simboleve të paparashikuar është i mundur vetëm me autorizim të Ministrisë që mbulon veprimtarinë e Transportit (neni 123/4).

Kornizat

Kornizat e paneleve përbëjnë një element kryesor për perceptimin korrekt të sinjaleve, meqënëse kontribuojnë në përkufizimin e shenjës optike të sfondit.
Skema 18 paraqet parametrat dhe formulat që duhen përdorur për të përmasuar (formatuar) kornizat e sinjaleve të drejtimit katror, drejtëkëndësh dhe drejtëkëndësh të theksuar.

Shkurtimet

Lejohen për emra të përbërë ose shumë të gjatë (neni 123/1 - /9).

Pikat kryesore

Lejohen për të përmirësuar menjëhershmërinë e informacionit (neni 123/1).

Numërimi i rrugëve

Lejohen për të përmirësuar menjëhershmërinë e nformacionit (neni 123/1).

NGJYRAT

Ngjyrat e sfondit

Lidhen me llojin e rrugës së i cilës i referohet tregimi, sipas përkatësisë së mëposhtëme të vlefshme në përgjithësi dhe të ilustruar nga shembujt e mëposhtëm të **Skemës 19** (neni 76/2):

bardhë	: rrugë urbane;	(Tipi D, E, F)
jeshile	: autostradë;	(Tipi A)
blu	: rrugë interurbane;	(Tpi B,C, F)
kafe	: pika me interes historik; turistik, etj. – emërtime gjeografike;	
zezë	: zona industriale, etj.;	
portokall	: autobuz shkolle dhe taksi;	
kuqe	: SOS, aksidente;	
kuqe dhe e bardhë	: sinjale dhe vija;	
hiri	: sinjale horizontale;	
verdhë	: sinjale të përkohshme (Të gjitha tipet)	

Disa sinjale të karakterizuara nga një ngjyrë sfondi e përshtatshme me llojin e rrugës në të cilën gjenden, mund të përmbajnë zona ose shtesa të ngjyrave të ndryshme, që i përkasin llojit të rrugës ose të vendarritjes të cilit i referohet treguesi, siç jepet ne **Skemën 19** dhe në shembujt e tjerë të sinjaleve treguese (neni 122/8);

Nëse sinjalet përmbajnë një ose më shumë tregime të së njëjtës natyrë, ngjyra e sfondit është tamam ajo e / ose atyre drejtimeve të cilat ato tregojnë, pavarësisht nga lloji i rrugës në të cilën ato gjenden (neni 122/9).

Shkrimet në sfond

Lidhen me tipin e rrugës të cilës i referohet tregimi, sipas përkatësisë së mëposhtëme të vlefshme në përgjithësi (neni 76/3):

- sfond i bardhë	: shkrime të zeza;
- sfond i bardhë	: shkrime blu;
- fushe i bardhë	: shkrime gri;
- sfond jeshil	: shkrime të bardha;
- sfond blu	: shkrime të bardha;
- sfond kaf	: shkrime të bardha;
- sfond i zi	: shkrime të verdha;
- sfond portokall	: shkrime të zeza;
-sfond i kuq	: shkrime të bardha;
- sfond i verdhë	: shkrime të zeza.

Simbolet

Lidhen me llojin e rrugës të cilës i referohet tregimi, sipas përkatësisë së mëposhtëme, të vlefshme në përgjithësi (neni 76/4):

- sfond i bardhë	: simbole të zeza;
- sfond i bardhë	: simbole blu;
- sfond i bardhë	: simbole gri;
- sfond jeshil	: simbole të bardha;
- sfond blu	: simbole të bardha;
- sfond kaf	: simbole të bardha;
- sfond i zi	: simbole të verdha;
- sfond portokalli	: simbole të zeza;
- sfond kuq	: simbole të bardha;
- sfond i verdhë	: simbole të zeza.

Kornizat

Lidhen me ngjyrën e sfondit të tabelës sipas përkatësisë së mëposhtëme (neni 125/6):

- sfond i bardhë	: kornizë e zezë;
- sfond jeshil	: kornizë e bardhë;
- sfond blu	: kornizë e bardhë;
- sfond kaf	: kornizë e bardhë;
- sfond i kuq	: kornizë e bardhë;
- sfond portokalli	: kornizë e zezë;
- sfond i zi	: kornizë e verdhë;
- sfond i verdhë	: kornizë e zezë.

Korniza të shkëputura

Trashësia është sa gjysma e kornizës së sinjalit dhe ngjyrat që përdoren janë:

- e bardhë në afrimet midis: blu, jeshil, kafe;
- e zezë në afrimet midis: bardhë, e verdhë.

FAQOSJE GRAFIKE
(neni 78/7)

Duhen ndjekur kriteret e përgjithshme të mëposhtme:

- ndarje në blloqe e tregimeve që i përkasin drejtimeve të ndryshme dhe që drejtohen nga një shigjetë (shih **tabelën II 21 figurat majtas,**);
- ndarja ndërmjet blloqeve duhet të jetë e perceptueshme me qartësi dhe e menjëhershme;
- faqosja e blloqeve dhe vijëzimi i shigjetave pa i dhënë rëndësi të veçantë simetrisë së degëve me shigjetat;
- rradhitje e elementëve përbërës (shih **tabelën II 21 figura djathtas**);
  - djathtas, nëse vendoset në afërsi të anës së djathtë të sinjalit,
  - majtas, nëse vendoset në afërsi të anës së majtë të sinjalit,
  - qendër, nëse vendoset në qendër të sinjalit;
- respektimi i rregullave që lidhen me alfabetin (shih paragrafin e Përmbajtjes në këtë Kapitull);
- hapësirë e saktë midis rradhëve dhe anëve:
  - intervalet, anët dhe shkëputjet influencojnë kontrastin e saktë midis mbishkrimeve dhe sfondit së tabelës;
  - intervalet ndërmjet rrjeshtave dhe shkëputjet nga anët dhe nga kornizat nuk duhet të jenë më të vogla se lartësia e gërmave të mëdha ose të vogla të larta (shih **Skemën 18**);
- përmasim i saktë i kornizave perimetrike dhe të shkëputura.

VENDNDODHJA
(neni 124)

Vlejnë normat e përgjithshme të përshkruara në kapitullin Sinjalizimi Vertikal.
Normat e veçanta lidhur me sinjalet e paralajmërimit, të drejtimit, ose të situatave të tjera të veçanta, jepen në Rregulloren e zbatimit të Kodit Rrugor (nenet 125, 126 dhe 127 ÷ 134)

Instalime mbi rrugën e kalimit të mjeteve, të sinjaleve të korsisë (neni 79/6 dhe /12 neni 124)

Sinjalitika e paralajmërimit dhe e drejtimit mund të vendoset mbi karrexhatë, dhe në veçanti mund të marrë karakteristikat e sinjalitikës së korsisë, kur ekzistojnë një ose më shumë nga kushtet e mëposhtëme(neni 124/7 dhe 125/5):

- dy ose më shumë korsi për çdo sens të lëvizjes;
- kryqëzime të kanalizuara ose planimetrisht komplekse;
- vëllim i madh trafiku me përqindje të lartë të makinave me lartësi gabarite të madhe;
- mbizotërim i shpejtësisë së lartë;
- itinerare autostradale (Tipi A), unaza (Tipi A dhe B), drejtime kryesore të vendkalimeve ose itinerare të hyrjes ose daljes nga qendrat urbane;
- pamundësi e realizimit të një sinjalitike anësore efikase.

Për instalim të sinjaleve, vlejnë normat e përgjithshme të dhëna në kapitullin Sinjalitika Vertikale; mund të përdoren ura, mbikalime ose vendndodhje të tjera dhe pozicione të përshtatshme (neni 124/9).
Në lidhje me pikën e vendosjes që i përket kryqëzimit të cilit i referohet, sinjalet e korsisë marrin funksionet e mëposhtme:

- shumë më përpara	: paralajmëruse;
- më përpara	: përzgjedhje;
- prag kryqëzimi	: drejtim;
- fillim i korsive të ngadalësimit	: drejtim;
- korsi të kthesës	: drejtim;
- të përpjeta, etj.,	: drejtim;
- paskryqëzime	: konfirmim;
- pas hyrjeve	: konfirmim.

Forma dhe përmasat e sinjaleve të korsisë janë përshkruar në **Skemën 20**. Përmbajtja e secilit panel duhet t'i referohet korsisë përkatëse, mbi të cilën ajo është pozicionuar.

VERIFIKIME (neni 122/4)

Enti pronar i rrugës, ose enti përdorues në marrëveshje me të, duhet të kryejë periodikisht verifikimet e sinjalitikës treguese për të vlerësuar:

- përpuethshmërinë funksionale ndaj kërkesave të trafikut dhe nevojave të përdoruesve;
- përputhshmërinë ndaj kërkesave të përshtatshmërisë, koherencës dhe homogjenitetit, përballë ndryshimeve të pandërprera të ambientit në të cilin është vendosur;
- gjendjen e mirëmbajtjes për një eficencë perfekte.

SINJALET PARALAJMËRUESE

Të përgjithshme

Sinjalet e paralajmërimit përdoren për të informuar përdoruesit e rrugës për afërsinë e një kryqëzimi nga i cili degëzohen disa rrugë, me qëllim thjeshtimin e zgjedhjes së drejtimit të interesuar.

Për përdorimin e tyre duhen respektuar kriteret e përshtatshmërisë, koherencës dhe homogjenitetit (shih paragrafin Cilësitë dhe kriteret në kapitullin "Sinjalet Treguese").

Ndahen në dy lloje alternative (neni 125/8):

- paralajmërim të kryqëzimeve, për t'u përdorur kryesisht në rrugë me një korsi për çdo drejtim të lëvizjes;
- sinjal të përzgjedhjes, për t'u përdorur kur karrexhata është e ndarë në dy ose më shumë korsi për çdo drejtim të lëvizjes, duke patur vendarritje të ndryshme;

Vendndodhja

Vlejnë rregullat e përgjithshme të dhëna në kapitullin "Sinjalet Vertikale" (neni 79).

Për sinjalet e paralajmërimit të kryqëzimeve dhe të përzgjedhjes duhet të sigurohet një hapësirë lajmërimi në funksion të shpejtësisë lokale mbizotëruese, konform vlerave të dhëna në **tabelën 2**; të njëjtat vlera janë dhënë edhe në diagramën e **Skemës 16** (aneksi A) (neni 124/1).

Tabela 2 – Hapësira minimale e shikueshmërisë së sinjaleve të paralajmërimit

Shpejtësia lokale mbizotëruese [km/orë]	*Hapësira e përshquarjes* [m]
50	100
70	140
90	170
110	200
130	250

Dukshmëria
(neni 77/12)

Për sinjalet e paralajmërimit është i detyrueshëm përdorimi i sipërfaqeve Skemuese me eficencë të lartë (klasa 2).

Kompetencat
(neni 125/14)

Sinjalet e paralajmërimit të kryqëzimeve dhe të përzgjedhjes janë në ngarkim të entit pronar.

SINJALET E PARALAJMERIMIT TË KRYQEZIMEVE

Çdo sinjal paralajmërimi mund të përmbajë tregimin e një kryqëzimi të vetëm (neni 125/4).

Lejohet një shmangie nga ky rregull nëse (neni 124):

- largësia ndërmjet dy kryqëzimeve është më e vogël se 250 m;
- shpejtësia lokale mbizotëruese ose rrethana të tjera të veçanta nuk lejojnë respektimin e largësive të dhëna, **tabelën 2**.

Dy shembuj të sinjaleve të paralajmërimit, me tregimin e dy kryqëzimeve, janë ilustruar në **figurat II 236** dhe **237**

Përmbajtja
(neni 125/2 dhe /3)

Përmbajtja përfaqëson skemën e kryqëzimit dhe është e përbërë nga elementët e mëposhtëm:

Shigjetat

- mund të jenë të trashësive të ndryshme sipas gjeometrisë dhe rëndësisë së rrugës;
- duhet të jenë të përmasave të tilla që të mund të lejojnë një faqosje të saktë të mbishkrimeve.

Mbishkrimet

- tregojnë emrat e qendrave administrative të arritshme përmes degëve të ndryshme të kryqëzimit;
- në çdo drejtim të shënuar duhet, mundësisht, të vihet emri i një qendre të vetme;
- në rast të kundërt, numri i qendrave duhet të jetë i kufizuar për të përmbushur kriterin e përshtatshmërisë.

Simbolet

- është i mundur përdorimi i tyre;
- simboli është e mira të vendoset para mbishkrimit; në rastet në të cilat ky vend prish ekuilibrin e faqosjes grafike, simboli do të vendoset pas mbishkrimit;
- treguesit e rrugëve, autostradave, itinerareve ndërkombëtare, duhet të shoqërohen nga simboli përkatës i identifikimit (neni 125/13).

Sinjalet

- mbi shigjetat që përmbajnë sinjalet e paralajmërimit të kryqëzimeve mund të paraqiten sinjale rreziku ose urdhëruese, në format të vogël, në degëzimin e kryqëzimit ku qëndron rreziku ose kufizimi. (neni 125/7).
- Përsa i përket përdorimit të karaktereve dhe simboleve vlejnë rregullat e përgjithshme të dhëna në kapitullin "Sinjalet Treguese"
- Shembujt që i përkasin sinjaleve paralajmëruese janë dhënë në kapitullin Kryqëzime në "Situata të Veçanta"

Ngjyrat

Vlejnë rregullat e përgjithshme të dhëna në paragrafin Ngjyrat në kapitullin "Sinjale Treguese"

Vendndodhja

Vlejnë rregullat e përgjithshme të parashtruara në kapitullin "Sinjalet Vertikale" dhe në ato që lidhen me paralajmërimet e dhëna në pjesën e fillimit të këtij kapitulli (nenet 79 dhe 124/1).

Sinjalet e paralajmërimit të kryqëzimeve vendosen në një largësi nga pika në të cilën fillon manovra e kthimit, ose në fillim të korsisë së ngadalësimit, në funksion të shpejtësisë lokale mbizotëruese, në përputhje me vlerat e dhëna në **tabelën 3** dhe në diagramën e **Skemës 21** (aneksi A) (neni 124/2).

Largësia e vendndodhjes së sinjaleve të paralajmërimit të kryqëzimeve		
Shpejtësia lokale mbizotëruese [km/orë]	Largësia e vendndodhjes [m]	
	Kryqëzim me korsi shpejtimi	Kryqëzime pa korsi shpejtimi
50		60
70		80
90	30	100
110	40	130
130	50	

Tabela 3

Në prani të kushteve të tilla:

- autostradë (Tipi A);
- rrugë interurbane kryesore (Tipi B);
- situata të veçanta të trafikut ose sigurisë;

Sinjalet e vendosura në largësinë e treguar në pikën e mësipërme duhet të paraprihen nga një ose më shumë sinjale analoge të vendosura në largësi të përshtatshme (në përputhje me rregullat e përgjithshme); kjo largësi duhet të jepet në një panel të posaçëm plotësues **modeli II 1**.

Në veçanti, në autostrada (Tipi A) dhe në rrugë interurbane kryesore (Tipi B) të pajisura me korsi emergjence, vendoset të paktën një sinjal paralajmërimi 500 m nga pika në të cilën fillon manovra e kthimit, ose e fillimit të korsisë së ngadalësimit (neni 124/4) (neni 174/4 Kodit Rrugor).

Shembuj që i përkasin vendndodhjes së sinjaleve të paralajmërimit janë dhënë në kapitullin Kryqëzime në "Situata të Veçanta"

Sinjalizimi i korsisë

Vlejnë rregullat e përgjithshme të parashtruara në kapitullin "Sinjalet Treguese"

SINJALE TË PËRZGJEDHJES

Zëvendësojnë sinjalet e paralajmërimit të kryqëzimeve në rrugë me karrexhata të ndara në dy ose më shumë korsi për çdo drejtim lëvizjeje me drejtime të ndryshme.

Të përgjithshme
(neni 125/8)

Shërbejnë për të lejuar zgjedhjen paraprake të vendosjes në karrexhatë në raport me drejtimin që drejtuesit e mjeteve duan të ndjekin.

Përmbajtja
(neni 125/9/10/12)

Sinjali i përzgjedhjes paraqet korsitë korresponduese të vijëzuara në karrexhatën që i afrohet një kryqëzimi. Ai përbëhet nga elementët e mëposhtëm:

Shirita të shkëputur

- paraqesin korsitë e disponueshme;

Shigjetat

- tregojnë drejtimet e lejuara të lëvizjes për secilën korsi;
- duhet të bashkërendohen me shigjetat horizontale të përzgjedhjes të paraqitura në sipërfaqen e rrugës;
- në korespondencë të çdo korsie vendoset një shigjetë e vetme;
- shigjeta vendoset mundësisht në pjesën e poshtme të sinjalit;
- madhësia e shigjetave duhet të jetë në përpjestim me atë të sinjalit;
- lartësia e shigjetave ndryshon nga ⅓ në ¼ të asaj të sinjalit;
- shigjetat e përdorura janë dhënë në **Skemën 22** (aneksi A) dhe janë ndarë në llojet e mëposhtëme:
  - vertikale drejtuar lart;
  - e kthyer, drejtuar djathtas ose majtas;
  - drejtuar lart dhe djathtas ose majtas;
  - drejtuar djathtas ose majtas.

Mbishkrimet

- tregojnë vendarritjen.

Simbolet

- është i mundur përdorimi i tyre;
- treguesit e rrugës, autostradave, itinerareve ndërkombëtare, duhet të jenë të shoqëruara nga simboli përkatës i identifikimit (neni 125/13).

Shembuj të sinjaleve të përzgjedhjes dhe të përdorimit të tyre, janë ilustruar në **figurat II 244** dhe **245** dhe në kapitullin Kryqëzimet të "Situatave të Veçanta"

Ngjyrat

Vlejnë rregullat e përgjithshme të dhëna në paragrafin Ngjyrat të kapitullit "Sinjalet Treguese"

Vendndodhja

Vlejnë rregullat e përgjithshme lidhur me paralajmërimet e dhëna në pjesën e fillimit të këtij kapitulli.

Sinjali i përzgjedhjes duhet të vendoset në harmoni me fillimin e zonës së përzgjedhjes që i paraprin kryqëzimit.

Në prani të këtyre kushteve:

- autostrada (Tipi A);
- rruga interurbane kryesore (Tipi B);
- rrugë interurbane dytësore (Tipi C);

Nëse nuk është i mundur respektimi i hapësirës së lajmërimit të dhënë në funksion të shpejtësisë lokale mbizotëruese, sipas sa është parashtruar në rregullat e përgjithshme dhe në **tabelën 2**, sinjali i përzgjedhjes duhet të përsëritet më përpara me një sinjal të ngjashëm të vendosur në largësi të përshtatshme (në zbatim të rregullave të përgjithshme); kjo largësi duhet të jepet në një panel të posaçëm plotësues, **modeli II 1** (neni 124/5).

Sinjalizimi i korsisë

Vlejnë rregullat e përshkruara në kapitullin "Sinjalet Treguese"

SINJALE TË DREJTIMIT

neni 39/1 C i Kodit Rrugor

Të përgjithshme

Përdoren në harmoni me çdo kryqëzim dhe tregojnë degëzimin e kryqëzmit që duhet ndjekur për të arritur qendrat e ndryshme administrative.

Kriteret e përdorimit

Të gjithë emrat e qendrave që shfaqen në sinjalet e paralajmërimit ose të përzgjedhjes që i paraprijnë kryqëzimit, duhet të figurojnë në sinjalet përkatëse të drejtimit dhe, në dy llojet e sinjaleve, duhet të jenë të njëjtë (*kriteri i koherencës*).

Nëse shihet e nevojshme, mund të shtohen sinjale drejtimi që i përkasin vendarritjeve dytësore, derisa nuk prishet perceptimi i sinjaleve kryesore të drejtimit (*kriteri i përshtatshmërisë*).

Emri i një qendre i vënë në një sinjal drejtimi duhet të përsëritet në sinjalet e mëpasme, në drejtim të udhëtimit, deri tek vetë qendra (*kriteri i koherencës dhe i homogjenitetit*), (neni 126/6).

Një shembull i sistemit sinjalizimit të koordinuar është ilustruar në **Skemat 14 dhe 14a** (aneksi A).

Përmbajtja

Përsa i përket mbishkrimeve dhe simboleve vlejnë:

- normat e përgjithshme të përshkruara në kapitullin Sinjalet Treguese;

- normat e veçanta të dhëna në kapitullin Sinjalet e Paralajmërimit.

Përsa i përket përmasave të sinjaleve të cilat janë përbërëse të sinjaleve të drejtimit rekomandohen **Skedat 5** dhe **6**.

Në sinjalet e drejtimit urban, në rastin e lajmërimit për një qendër interurbane, dhe në çdo rast të sinjaleve të drejtimit interurban, përveç emrit të qendrës duhet te tregohet largësia në kilometra, e shprehur në shifra pa simbolin "km" (neni 126/5). Shifra që tregon largësinë e shprehur në kilomentra duhet të ndjekë gjithmonë emrin e qendrës administrative.

Mund të shtohet një simbol ndërmjet atyre të parashikuar nga rregullorja. Për vendin e tyre vlen sa më poshtë:

- sinjalet urbane:
  - simboli vendoset ndërmjet emrit dhe shigjetës;
- sinjalet interurbane:
  - simboli vendoset nga ana e kundërt e shigjetës.

Mund të vendoset simboli i identifikimit të rrugës (neni 126/5).

Sinjali i drejtimit mund të jetë i përbërë nga kombinacioni i një simboli, si ai i **figurave II 100÷231**, me një shigjetë horizontare, përshkruar në **skedën 10** (neni 130/7).
Sinjali i drejtimit mund të përbëhet nga kombinimi i një shigjete me një sinjal të identifikimit të rrugës, përshkruar në kapitullin sinjalet e identifikimit të rrugëve dhe largësimatësit progresiv dhe të ilustruar në **figurat II 269**, **270** dhe **271** (neni 127/5).

Ngjyrat
(neni 126/7)

- Vlejnë rregullat e përshkruara në paragrafin "Ngjyrat" në kapitullin Sinjalet Treguese.

Forma dhe Përmasat

Për formën e sinjaleve të drejtimit vlejnë normat e mëposhtëme:

- në brendësi të *qendrave të banuara*:
  - forma drejtëkëndëshe, me shigjetë në drejtim të qendrës administrative. (neni 126/1);
- në rrugët interurbane:
  - forma drejtëkëndëshe me shigjetën, që sipas rastit tregojnë drejtime nga e djathta ose nga e majta (neni 126/2);
  - forma drejtëkëndëshe, me shigjetë me drejtim lart, nëse tregojnë drejtimin drejt.

Normat e sapo dhëna vlejnë në funksion të lokalizimit të sinjaleve dhe jo nga përmbajtja e tyre; domethënë, në një qendër të banuar (për shembull) sinjalet që drejtojnë në qendrat interurbane gjithsesi janë të tipit drejtëkëndësh me shigjetë.
Sinjalet me shigjetë (të përdorura në rrugët interurbane të tipit A, B, C ose F) janë të orientuara në drejtim të qendrës së shënjuar (neni 126/2).

Përmasat e sinjaleve në tërësinë e tyre dhe të përbërësve të veçantë jepen respektivisht:

- në **Skedën 5** për sinjalet drejtëkëndore me shigjetë
- në **Skedën 6** për sinjalet drejtëkëndore me shigjetë ose drejtëkëndore me shigjetë drejt.

Forma dhe përmasat e sinjaleve të drejtimit të përbëra nga kombinacione të një simboli me një shigjetë horizontale, janë përshkruar në **Skedën 10**.
Sinjalet e drejtimit mund të jenë të përbëra edhe nga kombinacione të një shigjete horizontale me një sinjal identifikimi të rrugës, edhe në të njëjtin panel, siç përshkruhet në shembujt e figurave II 269, 270 dhe 271; në këtë rast përmasat janë ato të dhëna në **Skedën 1**, të kështillueshme në formate normale dhe të vogla; nëse tabela është realizuar me bashkimin e dy paneleve drejtëkëndore, secili prej tyre ka lartësinë sa gjysma e bazës.

Vendndodhja
(neni 124/6)

Sinjalet vertikale të drejtimit duhet të jenë të vendosura në një prej pikave më të mundshme ndërmjet:

- në prag të kryqëzimit;
- në ishujt trafikndarës të posaçëm;
- në kufijtë e daljes nga kryqëzimi

Pamja
(neni 77/12)

Sinjalet duhet të vendosen me orientim të tillë që të shihen shumë mirë nga rryma e trafikut që lëviz në atë drejtim.
Për sinjalet e drejtimit është i detyrueshëm përdorimi sipërfaqeve Skemuese me eficencë të lartë (celuloid) (klasa 2).

Sinjalet e korsisë
(neni 126/3)

Vlejnë rregullat e përshkruara në kapitullin Sinjalet Treguese.
Shigjetat që do të përdoren duhet të jenë të tipit të përshkruar në **Skemën 22** (aneksi A):
- duhet të vendosen me orientim nga poshtë, në pjesën e poshtme të secilit sinjal të korsisë;
- nëse tregojnë një korsi në dalje, në kthesë ose gjithsesi një korsi të ndryshme nga korsitë e drejta, duhet të futen në cepin e poshtëm djathtas ose majtas, sipas drejtimit të korsisë;
- nëse tregojnë një korsi të drejtë, duhet të vendosen në qendër të sinjalit përkatës të korsisë, me majë të shigjetës në përputhje me aksin e saj;
- nëse sinjali i drejtimit është së bashku me një ose më shumë sinjale të përzgjedhjes, shigjeta duhet të jetë e tipit analog me sinjalet e paralajmërimit, të dhëna në **Skemën 22**

Grupe sinjalizimi të përbashkët
(neni 126/8)

Sinjalet e drejtimit mund të grupohen në mënyrë të arsyeshme në një grup sinjalesh të përbashkëta.
Në çdo grup sinjalizimi të përbashkët duhet të respektohen kriteret në vijim:
- çdo grup nuk duhet të përmbajë më shumë se 6 sinjale. Për të vendosur më shumë sinjale, ato do të ndahen në disa grupe, duke respektuar megjithatë kriterin e përshtatshmërisë; në rast se nuk është e mundur vendosja e më shumë grupeve sinjalizimi të përbashkëta, numri i sinjaleve të pranishme në grupin e vendosur nuk mund të jetë gjithsesi më i madh se 6;
- grupet më të vogla, me shigjeta treguese të të njëjtit drejtim, duhet të vendosen në pikat më të përshtatshme të kryqëzimit, duke respektuar normat për vendndodhjen të dhëna më sipër;
- të gjitha sinjalet e vendosura në të njëjtin grup duhet të kenë të njëjtat përmasa, pavarësissht nga gjatësia e mbishkrimit që përmbajnë;
- ndërmjet dy sinjaleve ose grupi sinjalesh që tregojnë drejtime të ndryshme dhe vendosen në të njëjtën mbajtëse, është e nevojshme një ndarje vertikale prej 5 cm, siç tregohet në **Skemën 23** (aneksi A);

- përkatësisht me drejtimin e shigjetave, sinjalet vendosen duke respektuar rradhitjen e mëposhtme të vendosjes nga lart, poshtë:

- sinjalet me shigjetë treguese "drejt";
- sinjalet me shigjetë treguese "majtas";
- sinjalet me shigjetë treguese "djathtas"

- ndërmjet sinjaleve që tregojnë drejtimin e rrugës, duhet të respektohet dhe vendosja nga lart poshtë, sipas ngjyrës së fushës, shih shembullin e tabelës 13 e 23

- e bardha: qendrat e banuara
- e gjelbër: autostradat
- blu: rrugë interurbane
- kafe: drejtime turistike e territoriale
- e zezë: drejtime industriale e tregëtare

- në çdo grup, sinjalet e ndryshme për secilin drejtim duhet të zbatohen duke i vendosur afër atyre që kanë të njëjtën ngjyrë të sfondit;
- duke iu bindur tipareve të koherencës, rradha e vendosjes nga lart poshtë të qendrave duhet të jetë mundësisht e njëjtë me atë të sinjaleve të konfirmimit, të mëpasme; shihni për këtë shembullin e **Skemave 14** dhe **14a**;
- nëse grupi është vendosur majtas, shigjetat vertikale duhet të pozicionohen në krahun e djathtë të sinjalit, siç ilustrohet në **Skemën 24** (aneksi A);

Veç atyre të përmendura në **Skemat 13**, **14**, **14a**, dhe **23** (aneksi A), shembuj të ndryshëm të vendosjes së saktë të sinjaleve të drejtimit janë ilustruar në kapitullin Kryqëzime të Situatave të Veçanta .

Kompetencat

Detyrimet në ngarkim të entit pronar të rrugës, në të cilën janë vendosur sinjalet e drejtimit:

- vendosja e skeleteve të mbështetjes së sinjaleve të vetme ose të grupeve të përbashkëta;
- vendosja e sinjaleve të vetme që tregojnë vende urbane me interes publik;
- vendosja e sinjaleve të vetme që tregojnë qendra administrative të arritshme me kalueshmëri normale.

Detyrime në ngarkim të enteve të veçanta të interesuara, me autorizim të entit pronar të rrugës:

- vendosja dhe vënia në punë e sinjaleve me tregime të veçanta (sinjale industriale, hotelerie, etj.)

SINJALET POHUESE

Të përgjithshme

Sinjalet pohuese duhet të sigurojnë përdoruesin për korrektsinë e drejtimit të zgjedhur, duke treguar emrin e qendrës të dhënë tashmë në sinjalet e mëparshme të paralajmërimit dhe të drejtimit, ashtu siç ilustrohet në **Skemat 14** dhe **14a** (aneksi A). Në dalje nga kryqëzimet dhe përgjatë itinerareve, ato pohojnë drejtimin, rrugën dhe itinerarin të cilit i përkasin, për të shmangur gabimet gjatë përshkimit (neni 130/2).

Konkretizojnë tiparet e shprehura nga kriteret e përshtatshmërisë, koherencës dhe të homogjenitetit, të ilustruara në pjesën hyrëse të sinjaleve treguese (neni122/2).

Përmbajtja

Sinjali mund të përmbajë shumë emra lokalitetesh, të ndjekura nga largësitë përkatëse kilometrike, si për shembull **në figurën II 285 me sfond blu** (neni 130/4).

Rradha e mbishkrimeve duhet të përkojë me rradhën e qendrave përgjatë itinerarit.

Karakteret e mbishkrimit kanë madhësi të ndryshme sipas rëndësisë së qendrës që tregohet.

Përsa i përket mbishkrimeve dhe simboleve vlejnë rregullat e përgjithshme për sinjalet treguese.

Sinjali i pohimit mund të përkojë me sinjalin e identifikimit të rrugës, të trajtuar në paragrafin Sinjalet – emër rruge të kapitullit Sinjale të lokalitetit dhe lokalizimit të kombinuar me shigjeta vertikale; në këtë rast simbolet e identifikimit, në zbatim të kritereve të homogjenitetit dhe koherencës duhet të shfaqen edhe në sinjalet përkatëse të paralajmërimit të kryqëzimeve, përzgjedhjes dhe drejtimit (neni 130/6).

Sinjali i pohimit mund të përbëhet nga simbolet e **figurës II 100÷231** të kombinuara me shigjeta vertikale, siç ilustrohet në **Skedën 10** (neni 130/7).

Sinjalet e pohimit mund të përbëhen edhe nga kombinime të një shigjete vertikale me një sinjal identifikimi të rrugës, edhe mbi të njëjtin panel, siç paraqitet në shembujt e **figurës II 286**.

Në këtë rast përmasat janë ato që rezultojnë nga bashkimi i dy paneleve katror të tipit të paraqitur nga **Skeda 1**, këshillohet në formate normal dhe të vegjël.

Nëse tabela është realizuar nga bashkimi i një paneli katror me një panel drejtëkëndësh, ky i fundit ka lartësi të njëjtë me gjysmën e lartësisë së bazës. Paneli i vetëm i mundshëm që rezulton nga ky bashkim ka përmasat e sinjalit drejtëkëndësh së përshkruar në **Skedën 2**.

Në rrugët urbane, funksioni i pohimit mund të kryhet edhe nga një sinjal tërësisht i njëjtë me atë të drejtimit me shigjeta vertikale me drejtim lart; për të ilustruar këtë rast drejtojuni sinjaleve të drejtimit, trajtuar në paragrafin e mësipërm (neni 130/5).

Ngjyrat
(neni 126/7)

Vlejnë rregullat e përshkruara në paragrafin "Ngjyra" në kapitullin Sinjalet Treguese.

Vendndodhja

Sinjalet e pohimit vendosen normalisht pas degeve të daljes nga kryqëzimi dhe në dalje nga qendrat e banuara (neni 130/1).

Në autostrada dhe në rrugë interurbane (Tipi A dhe B), sinjali i pohimit duhet të vendoset rreth 500 m pas fundit të korsisë së përshpejtimit (neni 130/3).

SINJALET E IDENTIFIKIMIT TE RRUGËVE DHE LARGËSIVE METRIKE PROGRESIVE

Të përgjithshme

Përdoren për t'i dhënë përdoruesve informacionet në vijim:

- varësinë administrative të rrugës (rrugë shtetërore, rrugë rrethi, etj.);
- numrin e identifikimit të rrugës;
- vendndodhjen gjatë rrugës, të shprehur si largësi kilometrike progresive.

Përmbajtja dhe ngjyrat

Sinjalet e identifikimit të rrugës, të ilustruar në **figurat II 256÷260**, japin një simbol të përbërë nga kodi administrativ i rrugës i ndjekur nga numri i identifikimit dhe ka karakteristikat e mëposhtme (neni 127/1):

- itineraret ndërkombëtare:	E + numrin, në sfond te gjelbër;
- autostradë:	A + numrin, në sfond te gjelbër;
- tunele:	T + numrin, në sfond te gjelbër;
- rrugë shtetërore:	RSH + numrin, në sfond blu;
- rrugë rrethi:	RR + numrin, në sfond blu;
- rrugë komunale	K + numrin, në sfond të bardhë.

Lartësia e mbishkrimeve që përmbajnë simbole, të vendosura në sinjale drejtimi, nuk duhet të jetë më e vogël se 8 cm (neni 127/4).

Sinjalet e identifikimit të rrugës të kombinuara me shigjeta horizontale, ilustruar në **figurat II 269**, **270** dhe **271**, mund të përdoren si sinjale pohimi dhe janë përshkruar në kapitullin përkatës (neni 127/5).

Sinjalet e identifikimit të rrugës të kombinuara me shigjeta vertikale, ilustruar në **figurën II 286**, mund të përdoren si sinjale pohimi dhe janë përshkruar në kapitullin përkatës (neni 127/5).

Sinjalet largësive metrike progresive, ilustruar në **figurat II 261** dhe **262**, japin largësitë e shprehura në kilometra; mund t'i shtohet treguesi i hektometrave në shifra romake (neni 127/2).

Largësimatësit progresiv mund të kombinohen me simbolin e identifikimit të rrugës dhe me sinjalin e pohimit, siç përshkruhet në **figurën II 265**.

Në rrugët e hapura për trafik është e lejuar mbajtja në punë e sinjaleve të largësive metrike (gurëve kilometrikë) (neni 127/2).

Përmasat

Sinjalet e identifikimit të rrugës, nëse përdoren të vetëm kanë përmasat e dhëna në **Skedën 1**, këshillohet në format normal dhe të vogël.

Sinjalet drejtëkëndësh kanë lartësi të barabartë me gjysëm e lartësisë së bazës. Për sinjalet e identifikimit të rrugës të bashkuar me shigjeta horizontale ose vertikale, të cilat kryejnë funksionet e drejtimit ose të pohimit, drejtojuni kapitujve përkatës.

Sinjalet e largësive metrike progresiv kanë përmasat e treguara në **figurat II 261** dhe **262**.

Vendndodhja

Sinjalet e identifikimit të rrugës mund të jenë të vendosura: (neni 127/3)

- si sinjale më vete;
- tek sinjalet e paralajmërimit, përzgjedhjes, drejtimit dhe pohimit.

SINJALE TË ITINERARIT

Të përgjithshme

Përdoren para daljes nga autostradat (Tipi A) dhe nga rrugët interurbane kryesore (Tipi B) për të treguar qendrat dytësore ose të largëta dhe pika me interes publik, turistik ose gjeografik të arritshme përmes kalimit normal nga ajo dalje (neni 128/1/2)

Përmbajtja

Përbëhet nga kombinime të përbërësve të mëposhtëm (shih figurën II 272);

- një panel drejtëkëndësh i bardhë, që mban emrin e daljes në ngjyrë të zezë;

- një panel drejtëkëndësh me një ngjyrë të përshtatshme me rrugën në të cilën është vendosur, i mbyllur nga një kornizë e bardhë dhe që përmban jo më shumë se 5 rrjeshta me mbishkrim, që lidhen me qendrat e arritshme nga kjo dalje;

- një panel plotësues **model II 1** që tregon largësinë nga dalja, me përmasa që i përshtaten atyre të sinjalit.

Ngjyrat

Mbishkrimet që lidhen me qendrat urbane, turistike ose gjeografike duhet të jenë të përfshira në brendësi të tabelës me ngjyra sipas specifikimeve të dhëna në paragrafin »Ngjyrat« në Kapitullin Sinjalet Treguese.

SINJALET E QENDRAVE ADMINISTRATIVE DHE VENDNDODHJET

Të përgjithshme

Përdoren për të lokalizuar pikat e territorit për qëllime të qarkullimit rrugor.
Janë të klasifikuara kështu :

- sinjale të fillimit dhe mbarimit të qendrave të banuara ;
- sinjale të lokalizimit të pikave me interes publik;
- sinjale të emrit të rrugës dhe numrit të godinave;
- sinjale turistike dhe të territorit.

Kompetencat dhe plotësime të veçanta

Nuk lejohet t'i shtohet emrit të qendrave të banuara ndonjë mbishkrim tjetër, dhe as të vihet poshtë sinjalit ndonjë shkrim, qoftë edhe me panel shtesë.

Sinjalet jo të saktë duhet të bëhen të saktë nën kujdesin e atij që i ka vënë në punë.

Enti pronar i rrugës duhet të vendosë riparimin nga ai që i takon dhe, në rast të mospërmbushjes brenda gjashtëdhjetë ditëve, mund të marrë masa me ngarkimin e shpenzimeve përkatëse.

SINJALET E FILLIMIT DHE FUNDIT TË QENDRAVE TË BANUARA
(neni 129/4/6)

Të përgjithshme

Janë sinjale të qendrave të banuara të detyrueshme dhe përdoren për të treguar emrat e tyre.

Kanë vlerë edhe për të sinjalizuar kufirin e shpejtësisë dhe ndalimin e sinjaleve akustike (nenet 140/1 dhe 154/3 të Kodit Rrugor), pra nuk është i nevojshëm përdorimi i sinjaleve përkatëse përshkruese (neni 129/4).

Nuk duhet të përdoren për të treguar hyrjen në territorin komunal, për këtë qëllim mund të përdoren sinjalet territoriale me sfond ngjyrë kafe, të përshkruara në paragrafin Sinjalet turistike dhe territoriale të këtij kapitulli.

Një shembull i sinjalit të qendrës së banuar, së bashku me sinjale të territorit komunal dhe të fillimit dhe fundit të rrethit është dhënë në **Skemën 25** (aneksi A).

Përmbajtja dhe njyrat

Sinjali FILLIMI I QENDRËS SË BANUAR është i formës drejtëkëndëshe, me sfond të bardhë me kornizë dhe gërma të zeza.

Emri i qendrës së banuar duhet të shkruhet i plotë dhe pa shkurtime (neni 129/5).

Nëse qendra e banuar ka emër të përbërë, përshkrimi mund të bëhet në dy rrjeshta (neni 129/5).

Nëse qendra e banuar është një fraksion (pjesë e vogël e veçant afër qytetit ose komunës), emri i komunës mund të figurojë ndërmjet kllapave dhe në format të reduktuar (neni 129/5).

Nuk lejohet t'i shtohet asnjë mbishkrim tjetër emrit të qendrës së banuar.

Sinjali **FUNDI I QENDRËS SË BANUAR** është i përbërë nga (neni 129/6):

- një sinjal i qendrës së banuar me sfond të bardhë dhe gërma të zeza, me një diagonale me ngjyrë të kuqe, që fillon nga poshtë majtas dhe shkon djathtas lart (neni 129/6);
- një sinjal pohimi me sfond blu dhe mbishkrime në të bardhë, mbajtës i emrave të dy ose tre qendrave të banuara të mëpasme të plotësuar me largësitë përkatëse në kilometra:
    - rrjeshti i parë lart i sinjalit të pohimit tregon qendrën e banuar më të afërt;
    - rrjeshtat më poshtë tregojnë një ose më shumë qendra të banuara të rëndësishme që vijnë më pas, për shembul kryqendrën e rrethit.

Përmasat
(neni 129/3)

Sinjalet e fillimit dhe fundit të qendrës së banuar mund të vendosen:

- në anë të karrexhatës;
- mbi karrexhatë.

Përmasat përkatëse për të dy rastet jepen në **Skedën 8**.

Vendndodhja - Montimet

Sinjali i fillimit të qendrës së banuar duhet të vendoset në fillim të saj, përgjatë gjithë rrugëve që çojnë në qendrën e treguar, në përputhje me pikat në të cilat përdoruesit duhet të përshtasin lëvizjen e tyre në zbatim të kufizimeve të shpejtësisë, të ndalimit të sinjaleve akustike dhe të ndalimeve të tjera të vlefshme për qëndrën e banuar.

Gjithashtu nuk duhet të vendosen në kufijtë përkatës komunalë ose në pika të tjera, nëse këto janë larg nga qendra e banuar, sepse do të vendosnin kufizime të papërshtatshme për mjetet (neni 129/4).
Për të vendosur disiplinimin e qarkullimit rrugor, komunat duhet të marrin masa, me vendim të Këshillit, për saktësinë e kufijve të qendrës së banimit (neni 4 i Kodit Rrugor).

SINJALET E FILLIMIT DHE MBARIMIT TË PREFEKTURËS OSE FILLIM DHE MBARIM I RRETHIT (neni 129/7)

Të përgjithshme

Janë sinjale të qëndrave të banuara të mundshme. Nuk lejohet t'i shtohet asnjë tregues tjetër emrit të rrethit ose qendrës së banuar në rrugë interurbane.

Përmbajtja dhe njyrat

Sinjali përmban:
- në pjesën më të sipërme, emrin e prefekturës ose rrethit në të cilin hyhet;
- më poshtë, emrin e rrethit nga i cili dilet (neni 129/7).

Mbi emrin e rrethit nga i cili dilet vendoset një diagonale me ngjyrë të kuqe, që fillon poshtë majtas dhe lart djathtas (neni 129/7).

Sfondi i sinjalit është me ngjyrë jeshile ose blu sipas llojit të rrugës në të cilën është vendosur, mbështur në rregullat e përgjithshme të ngjyrave të sinjaleve treguese.

Mbishkrimet dhe kornizat duhet të jenë me ngjyrë të bardhë.

Një shembull i sinjaleve të rretheve dhe qendrave të banuara në rrugë interurbane, së bashku me sinjalet e qendrës së banuar dhe territorit komunal, jepet në **Skemën 25**.

Përmasat

Përmasat jepen në **Skedën 8**.
Këshillohen përmasat 90x200 cm. (neni 129/7)

SINJALE TË LOKALIZIMIT TË PIKAVE ME INTERES PUBLIK (neni 129/9)

Të përgjithshme

Përdoren për të treguar lokalizimin e vendeve ose zonave të interesit publik që nuk mund të gjenden ndryshe (neni 129/9).

Një shembull i sinjaleve jepet në **figurat II 277÷284**.

Përmbajtja dhe ngjyrat

Janë të përbëra nga simbolet përkatëse të vendit të cilin duan të tregojnë dhe nga një shigjetë horizontale e drejtuar në drejtim të hyrjes së tij (neni 129/10).
Përgjithësisht ngjyra e sfondit është e bardhë; korniza dhe shigjeta janë të zeza.
Në rast të tregimit të pikave me interes turistik, sinjali është i ngjyrës kafe me shigjeta dhe kornizë të bardhë.

Përmasat

Janë të njëjtat me sinjalet që tregojnë shërbime të impianteve të nevojshme, të përshkruara në **Skedën 3**.

Vendndodhja

Vendosen pingul me aksin e rrugës, në përputhje me pikën e shënuar (neni 129/10).

SINJALET EMER-RRUGE
(neni 131/1)

Të përgjithshme

Tregojnë emrin e rrugës, të sheshit, të shëtitores etj, dhe të çfarëdolloj tjetër vendi të ndryshëm (neni 131/1).

Përmbajtja dhe ngjyrat

Mbishkrimet janë me ngjyrë të zezë.
Kornizat janë me ngjyrë blu (neni 131/3).
Sinjali mund të përmbajë tregimin e godinave që i përkasin asaj pjese të rrugës.

Përmasat

Përmasat dhe karakteristikat e tjera janë ilustruar në **skedën 4** (neni 131/3).

Vendndodhja/Montimi

Duhet të vendosen në qendrat e banuara, në përputhje me kryqëzimet, në të dyja anët e të gjitha rrugëve (neni 131/1).
Vendosja mund të bëhet (neni 131/4):

- mbi *fenerët semaforik*;
  - pjesa e dalë, e gjitha mbi trotuar, drejtohet nga ana e jashtme e karrexhatës;
  - lartësia e bordit të poshtëm të sinjalit duhet të jenë ndërmjet 3,00 dhe 3,50 m nga shresa e rrugës;
- në sheshe, rrugë me pemë, etj.:
  - mbi mbajtës të vendosur në bordin e trotuarit. Çdo mbajtës mund të mbajë sinjalet e dy rrugëve në kënd, të vendosur në lartësi të ndryshme dhe sipas këndit të formuar nga dy rrugët;
- në shtylla ose mbajtës të ndriçimit publik ose të ndonjë tipi tjetër;
- me ngjitje në mur, nëse rrethanat e mundësojnë.

Përveç rasteve të pamundësisë materiale ose të ndonjë specifike tjetër lartësia nga sipërfaqja e rrugës është ndërmjet 2,50 dhe 3,00 m.

Një shembull i vendosjes është dhënë në **figurën II 291**.

Bashkëvendosja

Në rrugët me një drejtim, sinjali EMËR-RRUGË duhet të vendoset së bashku me sinjalin DREJTIM I VETËM PARALEL, mbi të njëjtin mbajtës e më sipër tij (neni 131/5).

Në këtë rast sinjali i drejtim të vetëm duhet të ketë të njëjtat përmasa me emrin e rrugës; një shembull është ilustruar në **figurën II 292** (neni 131/5).



Figura II 292 neni 131

Sinjali **EMËR-RRUGE** nuk duhet të vendoset sëbashku me tabelat publicitare (neni 131/8).

SINJALE TE NUMRAVE CIVIL TË BANESAVE

Është një sinjal i veçantë i përdorur për të treguar numrin e banesave civile, të vetme ose bllok banesash, sipas normave të rregullave vendore përkatëse (neni 131/7). (**figura II 293**).

Figura II 293 neni 131

Është i lejuar aplikimi, për çdo dhjetë numra afërsisht, i një numri godine pingul me aksin e rrugës, i fiksuar në shtyllën e ndriçimit publik ose në një mbështetës tjetër të disponueshëm, në mënyrë që të duket pingul me rrymat e trafikut.

SINJALE TURISTIKE DHE TERRITORIALE
(neni132/1)

Të përgjithshme

Sinjalet e këtij grupi janë të ndara në tipet e mëposhtëme (neni 132/1):

- sinjale turistike;
- sinjale industriale;
- sinjale hoteliere;
- sinjale territoriale;
- sinjale të vendeve me interes publik.

Përmasat

Forma dhe përmasat e sinjaleve varen nga angazhimi që ato kryejnë:

- si sinjale drejtimi:
  - vlejnë rregullat e përshkruara në **Skedën 5** dhe **6** dhe në kapitullin Sinjale drejtimi;
- si sinjale lokalizimi të pikave me interes publik:
  - vlejnë rregullat e përshkruara në **Skedën 3**;
- si sinjale treguese të hotelerive:
  - sugjerohen përmasat e dhëna në **Skedën 7**;
- si sinjale treguese territoriale:
  - vlejnë normat e dhëna në **Skedën 8** dhe **9**.

Përmbajtja dhe gjyrat

Simbolet e gjendura në sinjalet në fjalë janë përfshirë ndërmjet atyre të ilustruara në **figurat II 100÷231** (neni 132/1).

Treguesit turistik dhe territorial mund të përfshihen në sinjalet e mëposhtëme:

- udhëzuese
- turistike
- territoriale
- qendrat e banuara dhe territorit (neni 132/1).

Sfondi i sinjaleve është në ngjyrë kafe (neni 132/4).
Mbishkrimet dhe kornizat janë në ngjyrë të bardhë (neni 132/4).

Në rast të futjes së simboleve turistike dhe territoriale në sinjale të tjera, për ngjyrat vlejnë rregullat e përshkruara në paragrafin Ngjyrat të kapitullit Sinjalet treguese (neni 76/2).

Nëse përdoren si sinjale drejtimi mund të vendosen të vetme.

Nëse përdoren si sinjale lokalizimi mund të vendosen të vetme dhe në pozicione të pavarura, por nuk duhet të pengojnë dukshmërinë e sinjaleve të tjera.

Vendosja
(neni 132/2)

Montimi i tyre është i mundur vetëm në rrugët që çojnë drejtëpërsëdrejti në vendin e treguar.
Largësia ndërmjet sinjaleve dhe vendit të treguar, përveç rasteve të pamundësisë, nuk mund të jetë më e madhe se 10 m larg nga vendi

Kompetencat
(neni 132/3)

Detyrimi për furnizimin, montimin dhe mirëmbajtjen e sinjaleve në fjalë është në ngarkim të subjektit të përcaktuar nga organi përkatës.

Në rast se flitet për subjekte të ndryshëm nga enti pronar i rrugës, duhet të merret autorizim paraprak i këtij të fundit, i cili do të vendosë kriteret teknike për montimin.

SINJALE TURISTIKE DHE TË TERRITORIT
(neni 132)

figura II 294, neni 132



figura II 295, neni 132

Përdoren për të treguar vendndodhjen territoriale dhe informacione të tjera të dobishme.
Janë me ngjyrë kafe, me kornizë dhe shkrime në ngjyrë të bardhë.
Nëse tregojnë territore të komunave kanë formë dhe përmasa si në **skedën 8**. Në **Skemën 25** (aneksi A) jepet një shembull i zbatimit.
Për të dhënë informacione me interes turistik ose të territorit, për shembull, emrin e një lumi të kalueshëm, etj., përdoret paneli i dhënë në **skedën 9**; nëse përdoret formati drejtëkëndësh, paneli duhet të ketë lartësinë sa një e treta (⅓) e bazës. Një shembull i sinjalit turistik dhe territorial jepet në **figurën II 294** dhe **295**.

TREGUESIT INDUSTRIAL

Figura II 296, neni 132

Të përgjithshme

Sinjalet me tregues industrialë mund të montohen, sipas vlerësimit të entit pronar të rrugës, në rast se, për konfigurimin e vendeve dhe të rrjetit rrugor, e quan të nevojshme vendosjen e një sistemi sinjalizues, informativ, të fillimit të zonës industriale (neni 132/5).

Montimi i këtyre sinjaleve duhet të respektojë kushtet në vijim:
- nuk duhet të cënohet siguria e qarkullimit;
- nuk duhet të cënohet efikasiteti i pjesës tjetër të sinjalizimit
- montimi duhet të bëhet në pozicion të pavarur (neni 132/5).

Sinjali i drejtimit, me treguesin ZONË INDUSTRIALE dhe simbolin përkatës, mund të vendoset në kryqëzime dhe, aty ku është e nevojshme, i kombinuar me një grup sinjalizues të përbashkët që mund të ndodhet aty (neni 132/6).

Nuk pranohet futja e asnjë emri industrie në këto sinjale:
- paralajmërim kryqëzimi;
- përzgjedhje;
- pohimit (neni 132/6).

Në qendrat e banuara, ku zonat industriale janë të lokalizuara, duhet të përdoren sinjale që tregojnë kolektivisht zonën industriale (neni 132/7).

Industritë e vetme dhe qendra të veçanta do të tregohen më tutje në kryqëzimet lokale, përgjatë itinerareve kryesore të hyrjes në zona industriale (neni 132/7).

Fjalët dhe simbolet treguese dhe logove të ndërmarrjeve mund të jenë të riprodhuara, ne hapësirën e rezervuar për simbolin, me grafikën e vet, për ta bërë më lehtë të dukshme; në rast të kundërt hapësira e rezervuar për simbolin lihet e bardhë (neni 132/8). Shembuj të sinjaleve industrialë dhe të montimit të sinjalitikës industriale jepen përkatësisht në **figurën II 296** dhe në **Skemën 27** (aneksi A).

TREGUESIT E HOTELERISË
(neni 132/9)

Të përgjithshme

Sinjalet treguese të hotelerisë duhet të bëjnë pjesë në një sistem të përbashkët dhe autonom të sinjalizimit tregues nëse, enti pronar e gjykon se është i domosdoshëm shënimi për në hotelet e ndryshme. (neni 132/9).

Sinjalizimi i treguesve hoteliere përfshin (neni 132/10):

- një sinjal me funksione paralajmërimi të një pike informacioni turistiko-hotelerie ose të një sinjali të mëpasëm informacioni;
- një sinjal për informim të përgjithshëm rreth numrit, kategorisë (të treguar edhe me simbologjinë me yje), emërtimit të hoteleve;
- një seri sinjalesh paralajmërimi dhe drejtimi, të vendosura në pozicione të pavarura dhe që nuk pengojnë sinjalizimin tregues, për të drejtuar përdoruesit në intenerarin e zgjedhur;

Një shembull i vendosjes së sinjalizimit të hotelerisë jepet në **Skemën 28** (aneksi A).

Përmbajtja dhe ngjyrat

Sinjalet treguese të hotelerisë janë me fushë të bardhë, me korniza, simbole, shkrime dhe kompozime grafike siç specifikohet në **skedën 7** dhe të thjeshtuara në **figurat II 298÷301** (neni 132/11).

Përmasat

Përmasat e gërmave të sinjaleve të ndryshme të hotelerisë duhet të jenë të tilla që të njehsojnë largësinë e lexueshmërisë.

Kompetencat

Vendosja e sistemit sinjalizues të drejtimeve të hotelerisë bëhet me autorizim të entit pronar të rrugës, i cili përcakton mënyrën e vendosjes (neni 130/9).

SINJALE TË DOBISHME VENDTREGUESE
(neni 133/1)

Sinjalet e kësaj kategorie japin të dhëna lidhur me vendndodhjen ose paralajmërojnë situata të cilat drejtuesit e mjeteve duhet të kenë parasysh për të rritur sigurinë dhe rregullin e qarkullimit (neni 133/1).

Në varësi nga vendosja, këto sinjale kanë dy funksione të ndryshme (neni 133/1):

- *vendndodhjen*, nëse vendosen në lidhje me vendin e treguar;
- *lajmërimin*, nëse janë së bashku me një shigjetë që tregon drejtimin që duhet ndjekur ose me një panel plotësues **model II 1** që jep largësinë midis sinjalit dhe vendit të treguar.

Nëqoftëse nuk jepet ndryshe, përmasat janë si në **skedën 1** dhe **2** (neni 131/1).

Kur përdoren si shtojca, përmasat e tyre duhet të përshtaten me ato të sinjalit të cilit i janë shtuar dhe kompozimit të tij grafik (neni 133/1).

Spital
(neni 133/2)

figura II 302, neni 133

Përdoren për të treguar afërsinë e një spitali, shtëpie kurimi, klinike, etj.

Ky sinjal ka edhe qëllimin e lajmërimit të përdoruesve të rrugës për masat që duhen marrë në këtë situatë.
Emri i spitalit mund të jepet me panel plotësues **model II 6**.

Kur spitali ka edhe shërbimin e urgjencës, sinjali vendoset bashmë me sinjalin NDIHMË E SHPEJTË, të dhënë në paragrafin Sinjale të shërbimeve të nevojshme të këtij kapitulli.

Një shembull i vendosjes jepet në **Skemën 29** (aneksi A).

Vendkalim këmbësorësh
(neni 133/3)

figura II 303, neni 133

Tregon një vendkalim këmbësorësh, i cili:

- nuk është i rregulluar me impiant semaforik;
- nuk është pjesë e një kryqëzimi.

Është gjithmonë i dyanshëm, edhe në rrugët me një drejtim.
Mund të vendoset:

- në të dy anët e karrexhatës;
- në ishullin shpëtues trafikndarës;
- mbi karrexhatë.

Në rrugët interurbane (Tipi B, C, F) dhe në ato urbane kryesore (Tipi D), duhet të paraprihet nga sinjali i rrezikut me funksion paralajmërimi (**figura II 13**); një shembull i vendosjes jepet në **Skemën 30** (aneksi A).

Në rastin e sinjaleve me dritë të vetën, këshillohet kombinimi me burime drite për të ndriçuar vijat e bardha horizontale.

Urdhërat e tjera për vendkalimet e këmbësorëve jepen në kapitullin "Vendkalime për këmbësorët në Situata të Veçanta".

Autobus shkolle
(neni 133/4)

figura II 304, neni 133

Tregon një vendqëndrim të autobusëve që transportojnë nxënës shkollash ose është i vendosur në autobusë që tregon se autobusi është i përshtatshëm për transportin e fëmijëve për dhe nga shkolla.

Është gjithmonë me pamje dyfaqëshe dhe vendoset në anë të trotuarit pingul me aksin e rrugës.

SOS
(neni 133/5)

figura II 305, neni 133

Tregon një sistem të kërkimit të ndihmës së shpejtë, ose për asistencë. Vendoset në të dyja anët, pingul me aksin e rrugës.

Nuk vendoset nëse sistemi i kërkimit të ndihmës është vendosur në një xhep pushimi të dhënë me sinjalin përkatës, të dhënë në kapitullin Sinjale të shërbimeve të nevojshme dhe të ilustruar në **figurën II 329 me sfond blu**.

Nënkalim dhe mbikalim këmbësorësh
(neni 133/6)

figura II 306, neni 133

figura II 307, neni 133

Tregon një nënkalim ose mbikalim për të kapërcyer rrugën.

Sinjalet vendosen në të dyja anët e rrugës dhe, pingul me aksin e rrugës.

Vendosen në fillim të shtratit të rrugës.

Mund të montohet edhe me tre elementë me faqe të vendosura në 60^0 midis tyre.

Plan i pjerrët këmbësorësh
(neni 133/6)

figura II 308, neni 133

Vlejnë rregullat për sinjalet e nënkalimeve dhe të mbikalimeve

Rrugë pa dalje
(neni 133/7)

figura II 309, neni 133

I vendosur në fillim të një rruge, tregon që ajo është pa dalje për automjetet. Ka simbol të përcaktuar dhe topografi të pandryshuar.
Simboli i përbërë vetëm nga shiriti i kuq, mund të vendoset si plotësues në sinjale të paralajmërimit të kryqëzimeve ose të përzgjedhjes, për të treguar një rrugë pa dalje të atij kryqëzimi.
Shembuj të vendosjes jepen në kapitullin "Kryqëzime".

Paralajmërim i rrugës pa dalje (neni 133/7)

figura II 310, neni 133

figura II 311, neni 133

Paralajmëron kryqëzimin e një rruge me një rrugë tjetër pa dalje. Jep skemën grafike të vendosjes së rrugëve të kryqëzimit.
Shembuj të vendosjes jepen në kapitullin "Kryqëzime".

Shpejtësi e këshillueshme
(neni 133/8)

figura II 312, neni 133

figura II 313, neni 133

Jep shpejtësinë që këshillohet të mos tejkalohet në kushte optimale të trafikut dhe të motit.

Mund të vendoset në rrugët interurbane (tipi B dhe C) ose autostrada (tipi A) në përputhje me kthesa të rrezikshme ose me pjesë rruge ku fryjnë erëra të forta.

Mund të vendoset së bashku me një panel plotësues të shtrirjes, **model II 2**.

Në fund të pjesës së sinjalizuar, vendoset sinjali i fundit të shpejtësisë së këshilluar (fig. II. 313).

Rrugë e rezervuar për mjetet me motor
(neni 133/9)

figura II 314, neni 133

figura II 315, neni 133

Tregon fillimin e një rruge, e ndryshme nga autostrada, e rezervuar për qarkullimin e mjeteve me motor.

Përdoret për rrugët në të cilat duhen zbatuar të njëjtat rregulla që rregullojnë qarkullimin në autostrada.

Sinjali duhet të vendoset në të gjithë hyrjet e këtyre rrugëve dhe zëvendëson sinjalet e ndalimit për mjetet pa motor.

Mund të shtohet një panel plotësues model II 1 për të treguar largësinë ndërmjet tabelës dhe fillimit të rrugës, në lartësinë e kryqëzimit të fundit.

Ka përmasa minimale 90 x 90 cm.

Në çdo dalje duhet të vendoset sinjali i fundit të rrugës së rezervuar për mjetet me motor (fig. II 315)

Tunel
(neni 133/10)

figura II 316, neni 133

Tregon fillimin e një tuneli natyral ose artificial.

Vendoset para hyrjes së tunelit. Emri i tunelit mund të jepet me një panel plotësues **model II 6**.

Gjatësia mund të tregohet me një panel plotësues **model II 2**.9

Për një shembull vendosjeje shih kapitullin Tunel në "Situata të veçanta" si dhe **Skemën 60** (aneksi A)

Urë

(neni 133/11)

figura II 317, neni 133

Tregon fillimin e një ure, mbikalimi rrugor, rrugë – urë e të tjera të ngjashme me to.

Vendoset në fillim të urës.

Emri i urës ose i rrjedhës së ujit të kapërcyer, mund të jepet me anë të një paneli plotësues **model II 6**.

Gjatësia e shprehur në metra, mund të jepet me anë të një paneli plotësues **model II 2**.

Për një shembull vendosjeje, shih kapitullin Urë në "Situata të veçanta" si dhe **Skemën 111** (aneksi A)

Zonë banimi
(neni 133/12)

figura II 318, neni 133

figura II 319, neni 133

Shih kapitullin Zonë banimi në "Situata të veçanta".

Zonë këmbësore
(neni 133/13)

figura II 320, neni 133

figura II 321, neni 133

Shih kapitullin Zonë banimi në "Situata të veçanta".

Zonë e trafikut të kufizuar
(neni 133/14)

figura II 322, neni 133 figura II 323, neni 133

Shih kapitullin Zona banimi në "Situata të veçanta".

Vendkalkim biçikletash
(neni 133/15)

figura II 324, neni 133

Tregon një vendkalim të karrexhatës, nga ana e një rruge për biçiklistët, të shënuar edhe me sinjalizim horizontal.
Mund të vendoset me dy faqe, nga të dyja krahët e rrugës, ose sipër saj.

Në rrugët interurbane (Tipi B, C,F) dhe në ato urbane kryesore (Tipi D), duhet të paraprihet nga sinjali i rrezikut me funksion paralajmërimi (**figura II 14**). Në këtë rast vendosja është e njëjtë me atë të sinjalit të vendkalimit të këmbësorëve, të dhënë në **Skemën 30** (aneksi A).
Në rastin e sinjaleve me dritë të vetën, këshillohet kombinimi me burime drite për të ndriçuar tek sinjalet horizontale.

Kthesë gjysmëdrejt nga e majta
(neni 133/16)





figura II 325, neni 133 figura II 326, neni 133

Lajmëron detyrimin e manovrave alternative për t'u kthyer majtas, kur në kryqëzimin e ardhshëm, ndalohet kthimi majtas.

Ky sinjal përgatit përdoruesin për të kryer një kthesë në dy mënyra:

- kthesë e tipit gjysmëdrejtë, që jepet në **figurën II 325**;
- kthesë e tërthortë, që jepet në **figurën II 326**.

Simbolika e sinjaleve vendore është e pandryshueshme sido që të jetë.
Shiritat reflektues duhet të jenë të bardhë dhe gri.

Kthim prapa
(neni 133/16)

figura II 327, neni 133

Mund të konsiderohet një variant i veçantë i përdorimit të sinjalit kthesë nga e majta.

Tregon praninë e një vepre arti, nën ose mbikaluese, në një rrugë me karrexhata të pavarura të përshtatshme për t'u kthyer nga drejtimi i nisjes.

Sheshpushimi
(neni 133/17)

figura II 328, neni 133

figura II 329, neni 133

Tregon praninë e një sheshpushimi në anë të rrugës për të kryer një ndalesë. Vendoset rreth 10 m nga fillimi i sheshpushimit.

Tranzitimi
(Kalueshmëria)
(neni 133/18)

Përdoret kur është e nevojshme të bëhen të ditura, në kohën e duhur, kushte rrugore të vështira ose pakalueshmëria e rrugës.

figura II.330 neni 133/18

Paralajmëron tregimet ose detyrat që kanë të bëjnë me kalueshmërinë:

- gjendje të përkohshme të kalueshmërisë në rrugë malore;
- kufizime të mundshme të kalueshmërisë;
- rekomandimin ose detyrimin për vendosjen e zinxhirëve ose gomave të dëborës.

Vendosja

Sinjali vendoset:
- në fillim dhe gjatë pjesëve në ngjitje, në pjesët e kryqëzimeve rrugore;
- në dalje të zonave të banuara ndërmjetëse.

Sinjali përbëhet nga një panel drejtëkëndor që jep emrin e pjesës fundore të rrugës së cilës i referohet, në të cilin vendosen tre panele të lëvizshëm (**a**, **b** dhe **c**) që mund të shfaqen vetëm, ose të kombinuar, sipas asaj që duan të tregojnë.

Përmasat

Përmasat e këshillueshme janë:
- paneli kryesore: 200x135 cm;
- panelet e lëvizshme: 35x105 cm.

Shiritat reflektues përdoren me të gjitha ngjyrat.
Të tre panelet e lëvizshëm mund të japin këto të dhëna:
- ***paneli a*:**
  - sfond jeshil dhe fjala "e hapur" në ngjyrë të bardhë: rrugë e lirë;
  - sfond i kuq dhe fjala "e mbyllur", në ngjyrë të bardhë: rrugë e pakalueshme.
- ***paneli b:***
  - i gjithi i bardhë pa asnjë simbol;
  - sinjali i **figurës II 87**: zinxhirët të detyrueshëm;
  - simboli i **figurës II 181** dhe **182**: këshillim për vendosjen e zinxhirëve ose goma "dëbore".
- ***paneli c*:**
  - i gjithi i bardhë pa asnjë simbol;
  - emra qendrash të banuara ose kilometrazh progresiv: vendin deri ku rruga është e kalueshme..fig.II.331 -336

Janë të mundshme këto kombinime:
- **rrugë e hapur:**
  - *paneli a:* sfond jeshil dhe fjala "e hapur" e përsëritur në disa gjuhë;
  - *paneli b:* asnjë e dhënë; sinjal i **figurës II 87**; simbol i **figurave II 181** dhe **182**;
  - *paneli c:* asnjë e dhënë;
- **rrugë e mbyllur**
  - *paneli a:* sfond i kuq me fjalën "e mbyllur" e përsëritur në disa gjuhë;
  - *panel b:* sinjal i **figurës II 87**; simbol i **figurave II 181** dhe **182**;
  - *paneli c:* asnjë e dhënë; pika deri në të cilën rruga është e kalueshme.

Shembull të panelit kryesor dhe të paneleve të lëvizshme jepen në **figurat II 330÷336**.

Përdorim korsie
(neni 133/19)

figura II 337, neni 133



figura II 338, neni 133

Tregon mënyrën për përdorimin e korsive të veçanta të rrugës, ose dhe të korsive që janë në gjëndje pune në drejtimin e lëvizjes.

Mund të përdoren për të treguar korsinë e destinuar për mjete që lëvizin me shpejtësi që përbën pengesë për qarkullimin.

Përmasat dhe shembujt jepen në **figurat II 337÷340**.



figura II 339, neni 133



figura II340, neni 133

Ndryshim korsish në gjendje pune
(neni 133/20)

figura II 341, neni 133



figura II 343, neni 133



figura II 342, neni 133



figura II 344, neni 133

Sinjalizon një ndryshim të përhershëm në zvogëlim ose në zmadhim të numrit të korsive të përdorshme në drejtim të lëvizjes.

Përmasat dhe shëmbujt jepen në **figurat II 341÷344**.

Nëse korsia ka gjatësi më të madhe se 500 m, dhe në përputhje me kushtet dhe karakteristikat e rrugës, duhet të përdoret sinjali i paralajmërimit i përbërë nga i njëjti sinjal tërësor i panelit plotësues **model II 1.**

Autostradë dhe rrugë interurbane kryesore
(neni 133/21, 23)

figura II 345, neni 133



figura II 347, neni 133

Tregon fillimin e një autostrade (tipi A) ose të një rruge interurbane kryesore (tipi B).

Janë të mundshme këto vendosje:

- të vetme, në fillim të autostradës ose rrugës së cilës i referohet, me funksion lokalizimi;
- së bashku me një panel që jep kushtet e veçanta të qarkullimit të vlefshme për autostradën ose rrugën, në fillim të hyrjes së saj, me qëllim paralajmërimi.

Ngjyrat janë:

- jeshile për autostradat (tipi A);
- blu për rrugët interurbane kryesore (tipiB).

Ato kanë përmasat e mëposhtëme:

- sinjal i lokalizimit: 300x170 cm;
- sinjal i paralajmërimit: 300x120 cm pjesa e majta;
  300x180 cm pjesa e djathtë.

Sinjali në formë të reduktuar (**figura II 161**) mund të vendoset me sinjalet e paralajmërimit, përzgjedhjes, drejtimit, për të identifikuar drejtimin ose tek një rrugë interurbane kryesore.

Shembujt jepen në **figurat II 345** dhe **347**.

Fundi i autostradës dhe fundi i rrugës interurbane kryesore
(neni 133/22, 23)

Figura II 346, neni 133

Është i njëjtë me sinjalin e autostradës ose rrugës interurbane kryesore, por me një vijë diagonale me ngjyrë të kuqe, që fillon majtas poshtë dhe shkon djathtas lart.

Me funksion paralajmërimi vendoset së bashku me panelin plotësues **model II 1**.

Përmasat janë të njëjta me sinjalin e fillimit.

Rrugë njëkalimshe paralele
(neni 133/24)

Figura II 348, neni 133

Përdoret në kryqëzimet për të treguar se qarkullimi në rrugën që ndërpritet lëvizja është me një drejtim, sipas shigjetës. Në këtë rast rruga mund të shfrytëzohet në të gjithë gjerësinë e saj.

Vendoset paralel me aksin e rrugës.

Kur vendoset vetëm, ka përpasat normale 25x100 cm.

Është mirë që të vendoset së bashku me sinjalin EMER RRUGE dhe në këtë rast ka të njëjtat përmasa;

Si shembull vendosjeje shih Kapitullin Kryqëzime në "Situata të veçanta".

Nëse kryqëzimi është me semafor, të dy sinjalet mund të vendosen mbi panelin semaforik dhe për të vlejnë normat e vendosjes që jepen në paragrafin sinjale emër rruge të këtij kapitulli.

Rrugë njëkalimshe ballore (neni 133/25)

Figura II 349, neni 133

Vendoset përpendikular me aksin e rrugës dhe mund të jetë së bashku me sinjalin drejtim i vetëm paralel. Vendoset në të djathtë e në të majtë të fillimit të rrugës me një drejtim dhe mund të përsëritet në të majtë.

Është e rëndësishme, për të garantuar sigurinë e qarkullimit, që sinjalet e rrugës me një drejtim dhe drejtim njëkalimësh paralel, të vendosen pas sinjalit të ndalim kalimit të vendosur në krahun tjetër të hyrjes.

Paralajmërim i shmangësit të këshilluar (neni 133/26)

Figura II 350, neni 133



Figura II 351, neni 133

Duhet të përdoret për të paralajmëruar drejtimin e lëvizjes së këshilluar për mjetet me masë të përgjithshme më të madhe se 3,5 ton, për të evituar që këto mjete të kalojnë në një qendër të banuar ose pjesë të saj.
Formohet nga bashkimi i simbolit të një mjeti me një shigjetë të modelit që jepet në **Skemën 22** (aneksi A)**, rasti a** dhe që vendoset sipër simbolit të mjetit. Përmasat jepen në **skedën 2**.

Në pikën e ndryshimit të drejtimit duhet të vendoset sinjali i drejtimit të këshilluar për kamionët, i njëjtë me atë të paralajmërimit, por me shigjetën e drejtimit.

Kufijtë e shpejtësisë së përgjithshme (neni 133/27)



Figura II 352, neni 133

Sinjali duhet të vendoset në afërsi të kufijve tokësorë ose detar kombëtar dhe tregon kufizimet e përgjithshme të shpejtësisë që janë në fuqi në Shqipëri.

Në pjesën e sipërme të tabelës vendosen emri, simboli ndërkombëtar dhe flamuri i shtetit shqiptar.

Kufizimet e shpejtësisë vendosen sipas këtij rregulli, nga lart – poshtë:

- shpejtësia maksimale e lejuar për lëvizje brenda qendrave të banuara;
- shpejtësia maksimale e lejuar për lëvizje jashtë qendrave të banuara;
- shpejtësia maksimale e lejuar për lëvizje në rrugët interurbane kryesore (tipi B);
- shpejtësia maksimale e lejuar për lëvizje në autostrada (tipi A);

Simboli dhe pozicioni i tyre jepen në **figurën II 352**.
Përmasat janë 150x250 cm.
Tabelat janë me sfond të bardhë.
Simbolet e dy kuadrateve të para janë me ngjyrë të zezë.
Kuadrati i dytë është me diagonale të kuqe për të treguar fundin e qendrës së banimit

SINJALE TË SHËRBIMEVE TË NEVOJSHME

Të përgjithshme
(neni 134/1)

Japin të dhëna që, edhe pse nuk lidhen ngushtësisht me drejtimin e mjeteve dhe qarkullimin e tyre, mund të jenë të nevojshme për përdoruesit e rrugës.

Në varësi nga vendndodhja e tyre, kanë dy funksione të ndryshme (neni 134/1):

- *lokalizimin*, kur vendosen në vendin e treguar;
- *paralajmërimin*, kur janë së bashku me shigjetën që tregon drejtimin që duhet ndjekur ose me një panel plotësues **model II 1** që jep largësinë ndërmjet sinjalit dhe vendit të treguar.

Përbëhen nga një panel që ka simbolin përkatës të shërbimit të treguar.

Përmbajtja dhe ngjyrat
(neni 134/1)

Si rregull i përgjithshëm, ngjyrat e sfondit janë të njëjta me ato të rrjetit rrugor në të cilin është vendosur sinjali.
Sinjalet që tregojnë një shërbim të rëndësishëm për turistët kanë sfondin me ngjyrë gështenjë.
Emërtimi mund të vendoset në hapësirën poshtë simbolit.

Përmasat

Nëse nuk është specifikuar ndryshe, përmasat jepen në **skedën 3** (neni 134/1).
Simbolet e këtyre sinjaleve, kur përdoren si shtojca në sinjalet e paralajmërimit, përzgjedhjes, drejtimit ose tregimit, kanë përmasa në përshtatje me sinjalin të cilit i janë shtuar dhe kompozimit grafik përkatës (neni 134/1).

Kompetencat
(neni 35
i Kodit Rrugor)

Entet e mëposhtëme:
- pronarët e rrugëve, jashtë qendrave të banuara;
- komunat, në qendrat e banuara, edhe për rrugët private të hapura për përdorim publik dhe rrugët lokale;

autorizojnë vendosjen e sinjaleve që tregojnë vende të shërbimeve rrugore, përveç sinjaleve që lajmërojnë shërbimin e urgjencës mjekësore, që vendoset nga vetë entet.

Vendosja dhe mirëmbajtja e këtyre sinjaleve është në ngarkim të pronarëve.

Ndihmë e shpejtë
(neni 134/2)

Figura II 353, neni 134

Tregon një strukturë sanitare të organizuar për shërbime të urgjencës.

Itineraret që të çojnë për atje duhet të sinjalizohen me sinjalin "NDIHMA E SHPEJTË". Ky ka funksion paralajmërimi dhe vendoset në kryqëzimet më të rëndësishme të rrugës kryesore.

Kur shërbimi i urgjencës ndodhet në brendësi të një spitali, sinjali vendoset bashkë me sinjalin SPITAL të përshkruar në paragrafin "Sinjale" që japin informacione të nevojshme për drejtuesit; një shembull i bashkëvendosjes jepet në **Skemën 29** (aneksi A).

Ndihmë teknike
(neni 134/3)

Figura II 354, neni 134

Tregon një ofiçinë mekanike ose pika servisi përgjatë rrugës interurbane.

Telefon
(neni 134/4)

Figura II 355, neni 134

Tregon një kabinë telefonike përgjatë rrugës interurbane.

Furnizim
(neni 134/5)

Figura II 356, neni 134

Figura II 357, neni 134

Tregon një impiant furnizimi me karburant, përgjatë një rruge interurbane.
Nëse impianti shpërndan edhe benzinë pa plumb, një prej simboleve bëhet me ngjyrë jeshile

Ndalim autobuzi

(neni 134/6)

Figura II 358, neni 134

Tregon pikat e qëndrimit të mjeteve të transportit publik interurban. Hapësira blu mund të përdoret për të saktësuar shërbimet, linjat, oraret.
Nëse hapësira nuk është e mjaftueshme mund të plotësohet me panelin **model II 6** i cili ka përmasat e specifikuara në **skedën 9**
Sinjali mund të përdoret edhe përgjatë rrugëve urbane.

Ndalim Tramvaji
(neni 134/7)

Figura II 359, neni 134

Tregon pikat e ndalimit të një linje tramvaji. Përdoren të njëjtat rregulla të përshkruara për stacionet e autobuzëve.

Informacione
(neni 134/8)

Figura II 360, neni 134

Tregon një vend informacioni turistik ose të një natyre tjetër.

Hotel për të rinjtë (neni 134/9)

Figura II 361, neni 134

Tregon një hotel apo bujtinë për të rinjtë.

Zonë për piknik
(neni 134/10)

Figura II 362, neni 134

Tregon një hapësirë të pajisur me tavolina, stola dhe pajisje të tjera të ndryshme, ku përdoruesi i rrugës mund të qëndrojë dhe pushojë.

Kamp
(neni 134/11)

Figura II 363, neni 134

Tregon afrimin e një strukture pritjeje të kompletuar dhe të autorizuar për tenda, kampe dhe autokampe.
Përdoret në rrugët interurbane dhe në ato urbane periferike.

Radioinformacion rrugor
(neni 134/12)

Figura II 364, neni 134

U tregon përdoruesve frekuencën e valës në të cilën mund të marrin lajme të nevojshme për qarkullimin rrugor.

Në rrugët normale vendosen rreth 1 km pas përfundimit të qëndrave të banuara.
Dhënia e informacionit dhe vendosja në punë është në ngarkim të entit pronar.

Motel
(neni 134/13)

Figura II 365, neni 134

Tregon një motel afër në rrugën interurbane.
Mund të përdoret vetëm në rrugët interurbane

Bar dhe restorant
(neni 134/14)

Figura II 366 neni 134

Figura II 367 neni 134

Tregon afrimin e një bari ose restoranti në rrugët interurbane.
Janë të ndaluara në qendrat e banuara.

Parkim ndërrim mjeti
(neni 134/15)



Figura II 368 neni 134



Figura II 369 neni 134

Figura II 370 neni 134

Figura II 371 neni 134

Tregon ose lajmëron një parkim të vendosur posaçërisht në një stacion ose në fund të një linje shërbimi të transportit publik ose në një itinerar këmbësorësh.

Sinjali lidhur me mjetet publike është i përbërë nga një panel i bardhë i tipit të **figurës II 286** që jep:

- në pjesën e sipërme simbolin e parkimit (**figura II 170**), së bashku me simbolin "+" në ngjyrë të zezë;
- në pjesën e poshtëme simbolin e shërbimit publik (tramvaj, metro, autobuz, etj.), (**figura II 141÷144**), së bashku me të dhënat kryesore lidhur me vendarritjet ose numrat e ndryshme të linjave.

Sinjali lidhur me itineraret e këmbësorëve përbëhet nga një panel në ngjyrë kafe i tipit (**figura II 286**) që jep:

- në pjesën e sipërme simbolin e parkimit (**figura II 170**), së bashku me simbolin "+" në ngjyrë të bardhë;
- në pjesën e poshtëme simbolin e ekskursionistëve (**figura II 207**), së bashku me shënimin e vijave të bardha të këmbësorëve.

Mund të shtohet një panel plotësues **model II 3** me emrin e vendqëndrimit.
Një shembull i sinjaleve të parkimit të këmbimit jepet në **figurat II 368÷371**.

Mjete mbi tren dhe mjete në vazhdim
(neni 134/16)



Figura II 372 neni 134

Figura II 373 neni 134

Vendoset në afërsi të një stacioni hekurudhor për të lajmëruar drejtuesit e mjeteve për shërbimin e transportit të autoveturave në vazhdim të udhëtuesve.
Vendoset nën kujdesin dhe me shpenzimet e entit hekurudhor, me marrëveshje paraprake me entin pronar të rrugës.

Mjete në anije
(neni 134/17)

Figura II 374 neni 134

Tregon një port apo molet dhe pikat e imbarkimit të mjeteve në traget.Vendoset në afërsi të një porti ose në hyrje të një qendre të banuar, përgjatë rrugës për në port.

Nëse ekzistojnë kalata të ndryshme, sinjalet e vendosura në brendësi të zonës portuale duhet të përmbajnë tregimin e vendarritjeve të anijeve.

Tregimi i qendrave të vendarritjes duhet të shprehet në gjuhën shqip dhe në gjuhën e vendit të mbërritjes së anijeve.

Lejohet përdorimi i siglës automobilistike të kombit të mbërritjes, në gërma të zeza brenda një trajte vezake të bardhë.

Nëse nevojiten informacione të tjera të nevojshme, mund të shtohet një panel plotësues **model II 6**.

Taksi
(neni 134/18)

Figura II 375 neni 134

Tregon vendndodhjen e një zonë parkimi të rezervuar për mjete të shërbimit publik.

Përmasat janë:

- normale: 40x60 cm;
- të mëdha: 60x90 cm.

Zona është e kufizuar nga vija të verdha, të plotësuara me shkrim horizontal "TAXI", me të njëjtën ngjyrë të vedhë.

Zonat e shërbimit
(neni 134/19)

Figura II 376 neni 134

Në rrugët interurbane përdoret një sinjal i përbërë ku jepen simbolet e shërbimeve të ofruara.Duhet të përdoren simbolet përkatëse, ilustruar në **figurat II 100÷231**.

Në brendësi të zonës mund të përdoren sinjale me vetëm një simbol të shërbimit për të treguar vendin e saktë dhe rrugën që duhet ndjekur për ta arritur.

Zonë e pajisur me mjete shkarkimi
(neni 134/20)

Figura II 377 neni 134

Tregon një zonë të rezervuar për ndalimin dhe parkimin e autokarvanëve, e pajisur me impiante të mbledhjes së mbeturinave organike dhe ujrat e papastra dhe të zeza, që janë depozituar në depozitën e autokarvanit, apo të mjeteve të tjera.

Policia
(neni 134/21)

Figura II 378 neni 134

Figura II 379 neni 134

Figura II 380 neni 134

Figura II 381 neni 134

Tregon selinë më të afërt të një poste ose zyre të një organi policie.

Në sinjal duhet të jepet rrethi, adresa dhe numri i telefonit.

Vendoset përgjatë rrugëve interurbane në afërsi të hyrjeve të zonave të banuara.

Sinjali është me sfond të bardhë me shkrime në ngjyrë të zezë.

Përmasat janë 90x60 cm.

SINJALIZIMI HORIZONTAL

neni 40 i Kodit Rrugor

Të përgjithshme

Sinjalet horizontale, të shënuara në rrugë, shërbejnë për të rregulluar qarkullimin, për të drejtuar përdoruesit dhe për të dhënë udhëzime dhe tregues të dobishëm për sjellje të veçanta për t'u mbajtur. (neni 40/1 i Kodit Rrugor).

Sinjalet horizontale ndahen në (neni 40/2 i Kodit Rrugor) :

- shirita gjatësore;
- shirita tërthore;
- vendkalime këmbësorësh ose biçikletash;
- shigjeta drejtuese;
- shkrime dhe simbole;
- shirita kufizuese të vendeve të qëndrimit ose për vendqëndrimet e rezervuara;
- ishuj trafiku ose sinjalizimi paraprak për pengesa brenda karexhatës;
- shirita kufizuese të stacioneve të qëndrimit të mjeteve të transportit publik të linjës;
- sinjale retroreflektuese integrative të sinjalitikës horizontale;
- sinjale të tjera të parashikuara nga aktet në zbatim;
- sinjale horizontale të ndaluar.

Nuk lejohet (neni 40/10 Kodit Rrugor):

- Ndalimi në rrugët , anët e të cilës dallohen nga një shirit e vazhduar ;
- qarkullimi mbi shiritat gjatësore, përveçse kur ndërrohet korsi;
- qarkullimi i mjeteve të paautorizuara në korsitë e rezervuara.
- Në vendkalimet e këmbësorëve drejtuesit e mjeteve duhet tu japin përparësi këmbësorëve që kanë filluar kalimin. Vendkalimet e këmbësorëve duhet të jenë gjithmonë të kalueshme dhe për karrocat me rrota të invalidëve .

Materialet

Të gjitha sinjalet horizontale duhet të realizohen me materiale të tilla që të jenë të dukshme si ditën edhe natën , si kur bie shi edhe kur shtrati i rrugës është i lagur (neni 135/1).

Sinjalet horizontale duhet të jenë të realizuara me materiale të pa thërmueshme dhe nuk duhet të dalin me shumë se 3 mm mbi sipërfaqen e shtruar të rrugës (neni 135/3).

Ngjyrat
(neni 135/5)

Ngjyrat e sinjaleve horizontale janë si më poshtë

- e bardhë;
- e verdhë;
- e kaltër;
- e verdhë , e kombinuar me të zezë.

Përdorimi i tyre është përcaktuar për çdo kategori sinjalesh në nene të veçanta në Rregulloren e Zbatimit të Kodit Rrugor. Mund të përshtaten ngjyrat e sistemit të sinjalizimit vertikal kur sinjalet ose simbolet përkatëse të përfaqësuara në të përsëriten në, sipërfaqen e rrugës.

Efektiviteti

Sinjalet horizontale duhet të mbahen gjithmonë në gjëndje pune në rast të rishtrimit të sipërfaqes të rrugës, ato duhet të zëvendësohen në kohën teknikisht të nevojshme. Mungesa e sinjaleve horizontale në rastin e rihapjes së trafikut, duhet të bëhet e ditur me përdorimin e sinjaleve të **figurës II 35** së bashku me panelin **model II 6/a** (neni 135/7).

Sinjalet horizontale, kur nuk u përgjigjen më qëllimeve për të cilat janë venë, duhen të hiqen apo të prishen, në një mënyrë të tillë të përshtatshme që të mos shkaktojnë më pas ngatërresa në sinjalet e reja që do të vihen (neni 135/8).

SHIRITAT GJATËSORË
(neni 136)

Shiritat gjatësore shërbejnë për të ndarë drejtimet e lëvizjes apo korsitë, për të kufizuar rrugën ose për të orientuar mjetet drejt drejtimit të duhur.

Shiritat gjatësore ndahen në:
- shirita ndarës në drejtim të lëvizjes ;
- shirita korsish;
- shiritat anësorë të rrugës ;
- shirita orientimi;
- shirita drejtues, në kryqëzime.

Gjerësia minimale e të gjitha shiritave gjatësore përveç atyre të anëve është (neni 138/1):

- 15 cm për autostradat dhe rrugët interurbane kryesore;
- 12 cm për të gjitha llojet e tjera të rrugëve;

Të tilla shirita mund të jenë të pandërprera ose të ndërprera; gjatësia e pjesëve dhe intervaleve të shiritave të ndërprera në vijë të drejtë është dhënë në **tabelën** e mëposhtëme (neni 136/3) ndërsa në **Skemën 31** (aneksi A) janë dhënë të gjitha tipet e shiritave.

Tabela e shiritave gjatësore të ndërprera

lloji shiritit	*pjesa [m]*	*intervali [m]*	*qëllimi aplikimit*
a	4,5	7,5	ndarje e drejtimit të lëvizjes dhe korsive të lëvizjes në pjesë me shpejtësi të parashikuar më të madhe se 110 km/orë
b	3,0	4,5	ndarje e drejtimit të lëvizjes dhe korsive të lëvizjes në pjesë me shpejtësi të parashikuar ndërmjet 50 km/orë dhe 110 km/orë
c	3,0	3,0	ndarje e drejtimit të lëvizjes dhe korsive të lëvizjes në pjesë me shpejtësi të parashikuar jo më të madhe se 50 km/orë ose në tunele
ç	4,5	1,5	shirita të paralajmërimit të afrimit të një shiriti të vazhdueshëm
d	3,0	3,0	për të përkufizuar korsitë e shpejtësisë dhe të ngadalësisë
dh	1,0	1,0	për shirita të anëve dhe për të ndërprerë shiritat e pandërprera që i korrespondojnë hyrjeve anësore ose itinerareve të biçikletave, triçikleve, etj.
e	1,0	1,5	për shirita të drejtimit në kryqëzime
ë	4,5	3,0	për shirita të ndarjeve të korsive të kthyeshme

Në kthesa, intervalet e shiritave tipi "a" dhe "b" mund të jenë të zvogëluara në mënyrë të arsyeshme. Shiritat e tipit "ç' nuk janë të detyrueshme (neni 137/11).

Shirita të ndarjes së drejtimeve të lëvizjes (neni 137)

Ndarja e drejtimeve të lëvizjes mund të bëhet me anë të katër tipeve të shiritave:

- shirita të pandërprera;
- shirita të dyfishta ku njëra është e ndërprerë;
- shirita të dyfishta të pandërprera;
- shirita të ndërprera.

Shiritat duhet të jenë të pandërprera (neni 137/2):

- në rrugë me dy korsi lëvizjeje, për sa kohë që nuk mund të lejohet zënia, qoftë edhe e çastit, e korsive plotësuese për parakalim;
- më afërsi të kryqëzimeve në nivel;
- në zonat ballore;
- në afërsi të vendkalimeve të këmbësorëve dhe biçikletave;
- në afërsi të pjesëve të rrugës në të cilat pamshmëria është e dobët, si për shembull në kthesa dhe në pjesë të ngritura;
- në afërsi të kalimeve hekurudhore në nivel;
- në afërsi të ngushtimeve të rrugëve.

Shtrirja e një shiriti të vazhdueshëm nuk duhet të jetë më i vogël se 30 m përveç rastit në të cilin dy kryqëzime janë aq pranë , sa që nuk lejojnë një gjatësi të tillë (neni 136/5).

Përgjatë kthesave, në pjesët e ngritura dhe në ngushtime, të cilat nuk kanë drejtim njëkalimësh të alternuar, shiriti i vazhdueshëm i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes duhet të ketë gjatësi të tillë, që të mos lejojë zënien e korsisë plotësuese për të gjithë pjesën e rrugës në të cilën pamja nuk është e mjaftueshme (neni 137/3).

Dy shirita përbri njëri-tjetrit, ku njëri është i vazhdueshëm dhe tjetri i ndërprerë, duhet të përdoren kur njëri prej dy drejtimeve të lëvizjes ka një largësi pamjeje të kufizuar (neni 137/4). Kjo mund të ndodhë në kthesa (shih kapitullin Kthesa në Situata të veçanta), në kurrize rrugore (shih kapitullin Kurrize rrugore në Situata të veçanta) dhe për të lejuar parakalimin e mjeteve në dalje nga zona të kryqëzimit (shih kapitullin Kryqëzime në Situata të veçanta).

Gjatësia e këtyre shiritave përbri njëri-tjetrit nuk duhet të jetë më e vogël se 30 m.

Vetëm mjetet që lëvizin në të djathtë të shiritit të ndërprerë kanë mundësinë t'i tejkalojnë të dyja (neni 40/4 Kodit Rrugor).

Dy shirita të pandërprerë përbri njëri-tjetrit duhet të përdoren në këto raste:

- në rrugë me një karrexhatë me dy ose me shumë korsi për drejtim të lëvizjes;
- kur dy ose më shumë korsi në të njëjtin drejtim të lëvizjes janë kufizuar nga shirita të pandërprera;
- kur ndarja e drejtimeve të lëvizjes nuk përputhet me aksin e rrugës;
- kur vendoset një trafikndarës, edhe jo i parafabrikuar, për t'i dhënë një siguri më të madhe qarkullimit, duke ndarë dy drejtime të lëvizjes; në këtë rast, nëse hapësira ndërmjet dy shiritave është më e madhe se 50 cm, ajo duhet të evidentohet me shirita të bardha paralele pingul me aksin e rrugës.

Largësia ndërmjet dy shiritave përbri njëri-tjetrit duhet të jetë jo më e vogël se gjerësia e një prej dy shiritave (neni 137/1).

Shiritat e pandërprera mund të jenë të ndërprera në përputhje me rrugën ose hyrjet anësore, vetëm nëse garantohet një pamje e mjaftueshme për kalimin dhe kthimin (neni 137/9).

Në të gjitha rastet e tjera të ndarjes së drejtimeve të lëvizjes zbatohen shiritat e ndërprera.

Shiritat e korsisë
(neni 138)

Përcaktimi i madhësisë së korsisë, e marrë si largësia ndërmjet akseve të shiritave që kufizojnë korsinë (neni 40 i Kodit Rrugor) është në varësi të funksionit të tipit të rrugës të tipit të automjetit në kalim dhe e rregullimit të saj. Madhësia e korsisë zgjidhet në këto përmasa : 2,75 m – 3 m – 3,25 m – 3,5 m – 3,75 m; ndërsa për korsitë e emergjencës madhësia zgjidhet në intervalin ndërmjet 2 dhe 3,5 m (neni 138/1).

Në hyrjen e kryqëzimeve të qyteteve, madhësia e korsisë mund të reduktohet në 2,5 m, përsa kohë që këto korsi nuk përdoren për mjete të rënda apo për transport publik (neni 138/2).

Gjerësia e korsisë së lëvizjes përgjatë shtratit të rrugës duhet të mbahet e njëjtë sa më shumë të jetë e mundur, përveç rasteve kur afrohen krzqëzimet apo vendet e sigurimit në stacionet e qëndrimit të tramvajeve. Në kthesa duhet të realizohet një zgjerim i përshtatshëm në funksion të tipit të mjeteve në kalim dhe të rrezes së kthesës (neni 138/3).

Shiritat e korsisë mund të jetë të pandërprera ose të ndërprera dhe të me ngjyrë të bardhë ose të verdhë.

Në zonat ballore, në afërsi të kryqëzimeve shiritat e ndarjes së korsive duhet të jenë të pandërprerë, në pjesën më të afërt me vijën e ndalimit, për të paktën 30 m (neni 138/4).

Shiritat e korsisë së rrugës me të drejtë përparësie mund të jenë të zgjatura në brendësi të zonës së kryqëzimeve, por duhet të jenë të ndara. Shiritat e korsive nuk mund të jenë të zgjatura në brëndësi të zonave të kryqëzimeve për sa kohë që ekzistojnë shiritat e drejtimit (neni 138/5).

Korsitë e rezervuara, nëse nuk janë të mbrojtura nga elementë të ngritur, janë të ndara nga korsitë e tjera të lëvizjes përmes dy shiritave të pandërprera përbri njëra-tjetrës, një i bardhë 12 cm dhe një e verdhë 30 cm, të larguara nga njëra-tjetra me 12 cm.

Shiriti i verdhë duhet të jetë i vendosur në bazë të korsisë së rezervuar (neni 138/6). Shih **Skemën 32** (aneksi A).

Shkrimet janë të tipit të paraqitur në **Skemën 32**.

Pistat e biçikletave, nëse nuk janë të mbrojtura nga elementë të ngritur nga sipërfaqja, janë të ndara nga korsitë përmes dy shiritave të pandërprera përbri njëri-tjetrit, një i bardhë prej 12 cm dhe një i verdhë prej 30 cm, në një largësi prej 12 cm nga njëri-tjetri . Shiriti i verdhë duhet të jetë i vendosur në bazë të korsisë së rezervuar (neni 138/7).

Shih **Skemën 33** (aneksi A) edhe për simbolin.

Shiritat anësorë të rrugës
(neni 139)

Anët e rrugës tregohen me shirita me ngjyrë të bardhë (neni139/1).

Shiritat anësorë janë të pandërprerë kur i përkasin korsisë së emergjencës dhe bankinave dhe mund të vendosen në pjesët e rrugës ku nuk lejohet ndalimi (neni 139/2).

Shiritat anësorë janë të ndërprera kur i përkasin një rruge me detyrimin dhënie përparësie, me degëzime, me korsi të shpejtimit dhe të ngadalësimit, me sheshe ose zona ndalimi dhe me rregullim në trotuar të mjeteve (neni 139/3).
Shih **Skemën 42** (aneksi A).

Gjerësia minimale e shiritave të anëve është (neni 139/4):
- 25 cm për autostradat dhe rrugët interurbane kryesore;
- 15 cm për interurbanet dytësore, urbanet kryesore dhe urbanet dytësore;
- 12 cm për rrugët lokale.

Shiritat anësorë të autostradave dhe të rrugëve interurbane kryesore, në zonat me mjegull ose në zonat në të cilat shpesh verifikohen kushte të ndryshme të motit, mund të pajisen me elementë të ngritur të cilët prodhojnë një efekt zanor ose një vibracion të mjeteve për të lajmëruar drejtuesin e mjetit rreth vendndodhjes së tij në lidhje me anët e rrugës. Kjo vendosje mund të bëhet në të gjitha ato raste kur shihet e nevojshme (neni 139/4).

Shiritat e pandërprera të anëve mund të shkelen vetëm nga mjetet që janë në shërbim të interesit publik dhe nga mjetet që duhet të kryejnë një qëndrim për emergjencë (neni 40/9 i Kodit Rrugor).

Shiritat ndërlidhës

Shiritat ndërlidhës janë shirita të pandërprera, të pjerrëta, në ngjyrë të bardhë (neni 140) dhe përdoren në varësi të ndryshueshmërisë së gjerësisë së rrugës së përdorur nga trafiku, ose të korsive (neni 140/1).

Pjerrësia e shiritave të ndërlidhjes ndaj aksit të rrugës nuk duhet të kalojë 5% për rrugët urbane, të lagjeve dhe të rrugëve lokale dhe 2% në rrugët e tjera , përveç rasteve kur kjoështë e pamundur për shkak të pranisë të kryqëzimeve të ngritura .Shih **Skemën 43** (aneksi A) (neni 140/2).
Nëse shiritat ndërlidhës përkufizojnë zonat e ndaluara për trafik, në këto rase këto zona mund të vijëzohen me vija të pjerrta në formë zebre (neni 140/3).

Shiritat ndërlidhës për të shmangur trafikun nga pengesa ose ishuj trafiku brenda rrugës, duhet të vijëzohen me vija të pjerrta në formë zebre (neni 140/4), si në **Skemën 43**.

Shiritat drejtues në kryqëzime
(neni 141)

Shiritat e drejtimit në kryqëzime janë të tipit "d" sipas tabelës së nenit 136/2 Këto shirita janë të kthyera, të ndërprera, me ngjyrë të bardhë dhe mund të jenë të vijëzuara në kryqëzime për të drejtuar mjetet sipas trajektores së saktë. Shih **Skemën 78** dhe **Skemën 81** (aneksi A) (neni 141/2).

Shiritat e drejtimit në kryqëzime mund të shënjohen edhe për të treguar kufijtë e zënies së kthesave nga gjerësia e tramvajeve (neni 141/2).

Shiritat e tërthortë
(neni 142)

Një shirit i tërthortë i vazhdueshëm tregon kufirin përpara të cilit drejtuesi i mjetit ka detyrimin të ndalojë makinën për të respektuar urdhërat semaforike, sinjalin NDALO DHE JEP PERPARESI, (**figura II 37**), sinjalin KALIM NE NIVEL (**figurat II 8** dhe **9**) apo dhe nje sinjal manual të dhënë nga personeli që kryen shërbimin e policisë rrugore (neni 40/5 i Kodit Rrugor).

Një shirit i tërthortë i ndërprerë tregon kufirin përpara të cilit drejtuesi i mjetit ka detyrim të ndalojë mjetin, nëse është e nevojshme, për të respektuar sinjalin JEP PERPARESI (**figura II 36**) (neni 40/6 i Kodit Rrugor).

Shiritat e tërthorta, ose shiritat e ndalimit, janë të pandërprera ose të ndërprera dhe me ngjyrë të bardhë.

Ato të pandërprerat kanë gjerësi minimale prej 50 cm dhe përdoren në kryqëzimet me semafor, në kalimet në nivel, në vendkalimet e kërmbësorëve me semafor dhe në prani të sinjalit NDALO DHE JEP PERPARESI (**figura II 37**) (shih **Skemën 44** aneksi A) (neni 142/1).

Shirita e ndalimit duhet (neni 142/2 dhe /3):

- të jetë paralele me rrugën kryesore;
- të jetë në prag të kryqëzimeve dhe, gjithsesi, e vendosur në mënyrë që të ndihmojnë manovrat e kthimit;
- të jetë e shënuar në mënyrë që drejtuesi i mjetit të mund të ndalojë në kohën e duhur para shiritit dhe të ketë pamjen më të madhe të mundshme;
- të jetë jashtë korsisë së shpejtimit;
- të lidhë anën e rrugës me shiritn gjatësore të ndarjes së drejtimeve të lëvizjes ose, në rrugët me një drejtim, me anën tjetër të rrugës;
- për rrugët pa ishuj shpëtimi ose ishuj trafikndarës, shirita duhet të lidhet me një shirit të vazhdueshëm gjatësor, të gjatë të paktën 10 m në qendrat e banuara dhe 25 m jashtë nga qendrat e banuara.

Shiriti tërthor i ndalimit, në prani të sinjalit **JEP PËRPARËSI** (**figura II 36**), është i përbërë nga një seri trekendëshash të bardhë të vijëzuar me kulme nga drejtuesi i mjetit për t'a detyruar të japë përparësi; këto trekëndësha kanë një bazë të përfshirë ndërmjet 40 dhe 60 cm dhe një lartësi të përfshirë ndërmjet 60 dhe 70 cm. Këshillohet të lihet një hapësirë ndërmjet dy trekëndëshave të afërt gati sa ½ e bazës dhe gjithashtu të mos shënjohen trekëndësha të paplotë. Shih **Skemën 34** (aneksi A) (neni 142/4).

Në kryqëzimet që rregullohen me semafor, shiriti i ndalimit shënjohet para vendkalimit të këmbësorve dhe 1 m larg tij. Shih **Skemën 35** (aneksi A) (neni 142/4).

Kalimet që këmbësorët ose biçikletat
(neni 143, 144)

Sinjalet horizontale të **VENDKALIMEVE PER KËMBËSORËT** janë dhënë në kapitullin Vendkalime këmbësorësh në "Situata të veçanta", ndërsa sinjalet horizontale të vendkalimeve të biçikletave janë dhënë në kapitullin Zona të biçikletave në "Situata të veçanta".

Shigjetat drejtuese
(neni 40)(neni 145)

Shigjetat drejtuese janë (neni 145/2):

- shigjeta djathtas për korsitë e caktuara për kthime djathtas;
- shigjeta drejt për korsitë e caktuara për kalimin drejt të kryqëzimeve dhe për të miratuar drejtimin e lëvizjes në rrugët njëkalimshe ;
- shigjetat majtas për korsitë e caktuara për kthimin majtas;
- shigjetat djathtas e shoqëruar me shigjetat drejt për korsitë e caktuara për kthimin djathtas dhe për vazhdimin drejt të kryqëzimit;
- shigjetat majtas të bashkuara me shigjetat drejt të caktuara për kthimin majtas dhe për vazhdimin drejt të kryqëzimit;
- shigjeta për rihyrje.

Përmasat e shigjetave janë të vendosura sipas **Skemave 36÷41**.

Ngjyra e shigjetave drejtuese është e bardhë (neni 145/1).
Shigjetat drejtuese mund të vendosen edhe për të treguar drejtime të lejuara dhe të ndaluara. Shih **Skemën 40** aneksi A **(fig II 439)** (neni 145/4).

Pozicioni i shigjetave në brendësi të korsisë është vendosur në **Skemën 48** aneksi A (Fig II.440) (neni 145/5).
Maja e shigjetave të vendosura në afërsi të vijës së ndalimit duhet të jetë larg saj të paktën 5 m (neni 145/6).

Intervali gjatësor mes më shumë shigjetave të barabarta të përsëritura gjatë të njëjtës korsi nuk duhet të jetë më pak se 10 m .Numri i shigjetave që përsëriten duhet të jetë i matur me gjatësinë e zonës së paraseleksionimit dhe të hyrjes(neni 145/7).

Shkrimet dhe simbolet
(neni 40) (neni 146)

Shkrimet dhe simbolet duhet të kenë karakteristikat e mëposhtme:

- karakteret që do të përdoren janë ato të **tabelave II 26/a ,b,c,ç** (neni 146/1);
- shkrimet duhet t'i referohen vetëm emrit të rrugëve dhe qëndrave administrative dhe të jenë me fjalë lehtësisht të kuptueshme edhe nga të huaj (neni 146/2);
- shkrimet duhet të kufizohen në një numër minimal fjalësh (neni 146/3) gjithsesi në mënyrë të tillë që të shmangen keqkuptimet mbi kuptimin e tyre;
- shkrimet duhet të jenë në ngjyrë të bardhë përveç fjalëve BUS, TRAM dhe TAXI që janë në ngjyrë të verdhë (neni 146/4);
- shkrimet kanë përmasa të ndryshme në funksion të tipit të rrugës dhe bëhen sipas **tabelave II 26/a÷d**;
- gërmat dhe fjalët që bëjnë pjesë në një shkrim rrjeshtohen në anën e poshtme pingul me aksin e rrugës (neni 146/6);
- nëse shkrimi përmban shumë rrjeshta, këto duhet të jenë të larguar ndërmjet tyre sa dyfishi i madhësisë së gërmave më të mëdha (neni 146/7).

Në prani të sinjalit vertikal **NDALO DHE JEP PËRPARËSI** (**figura II 37**) shirita e ndalimit duhet të plotësohet nga shkrimi STOP në sipërfaqe i cili duhet të jetë larg nga shirita e ndalimit nga 1 në 3 m. Shiko **Skemat 44** dhe **45 (fig.II432/a)** (neni 146/8).

Në prani të sinjalit vertikal **JEP PERPARESI** (**figura II 36**), shirita e ndalimit mund të plotësohet nga simboli i **Skemës 34**. Ky simbol nuk mund të jetë më pak se 2 m larg nga kulmet e trekëndëshave që përbëjnë vijën e ndalimit (neni 146/9).

Në afërsi të kalimeve hekurudhore duhet të vendoset, në përberje të sinjaleve vertikale, në çdo korsi në afërsi të kalimit, një Kryq i Shën Andresë me shkronjat PL brënda tij.
Ngjyra e sinjaleve të tij është e bardhë dhe përmasat përcaktohen nga fig II.443.
Shiko **Skemën 49** (aneksi A) (neni 146/10).

Simbolet mund të jenë përsëritës të sinjaleve vertikale ose të simboleve me të cilat ato shprehen. E rëndësishme është që të jenë të formuar në funksion të llojit të rrugës për të lejuar një perceptim të saktë.

Shembuj të kësaj norme janë simbolet **RRUGËKALIM BIÇIKLETASH** e shkrimet e shpejtësisë së këshilluar të dhëna në **Skemën 46** (aneksi A) (neni 146/11).

Shiritat e kufizimit të vendqëndrimeve ose të vendqëndrimeve të rezervuara (neni 147)	Shiritat e kufizimit të vëndqëndrimeve ose të vëndqëndrimeve të rezervuara janë dhënë në kapitullin Pushimi, Qëndrimi dhe Parkimi në "Situtata të veçanta".
Parasinjalizimi i ishujve të trafikut ose të pengesave brenda rrugës (neni 148)	Sinjalizimi horizontal i ishujve te trafikut, korsisë së paralajmërimit, emergjencës dhe trafikndarësve por edhe sinjalet e pengesave brenda rrugës janë dhënë në kapitullin Pengesa të "Situatave të veçanta".
Shiritat e kufizimit të ndalimeve të mjeteve të shërbimit publik, kolektiv të linjës. (neni 149)	Shiritat e përkufizimit të ndalimit të mjeteve që shërbejnë për transport publik të linjës janë dhënë në kapitullin Autobus të "Situatave të veçanta"
Sistemet prapareflektuese, përbërëse të sinjaleve horizontale (neni 151)	- sistemet prapareflektuese përdoren për të përforcuar sinjalet horizontale (neni 151/1); - ato duhet të kenë trupin dhe pjesët përthyese në të njëjtën ngjyrë me sinjalin horizontal që përforcojnë (neni 151/2); - sipërfaqja reflektuese minimale, për çdo faqe të përdorshme, duhet të jetë prej 20 cm^2 (neni 151/3); - lartësia maksimale nga sipërfaqja duhet të jetë 2,5 cm (neni 153/4); - duhet të fiksohen me sisteme të përshtatshme për të evituar shkëputjen; - frekuenca e vendosjes së pajisjeve duhet të jetë 10 m në vijë të drejtë dhe 3 m në kthesa (neni 151/4).
Sisteme të tjera për sinjalizimin horizontal (neni 152)	Sisteme të tilla si perçina, pllakëza apo tipe të tilla të ngjashme me to duhet të vendosen në rafshin e rrugës ose paksa të nxjerrë (neni 152/1). Seria e gozhdëve ose kunjave mund të realizohet me çdo lloj materiali, mjafton që të jetë i përshtatshëm për t'u parë dhe i fortë për t'u bërë shenjë në karrexhatë. Mund të përdoren, me kuptimin e shiritit së vazhdueshëm, kudo që ajo gjen aplikim (neni 152/2). Largësia ndërmjet anëve të dy elementëve të njëpasnjëshëm të këtyre pajisjeve nuk duhet të jetë më e madhe se 1 m
Sinjalet horizontale të ndaluara (neni 153)	Për rrugët e caktuara për trafik publik nuk lejohet asnjë shënjë e paheqëshme, përveç atyre të parashikuara nga këto norma, përjashto dhe treguesit që lidhen me garat në rrugë apo me veprimtari sportive. Për treguesit lidhur me sportet në rrugë ose garat sportive, sinjalet duhet të realizohen me materiale të lëvizshme dhe të heqshme përpara rivendosjes së qarkullimit normal.

SINJALET E NDRIÇUESHËM

neni 39 i Kodit Rrugor

Sinjalet vertikale të ndriçueshme, si ato të rrezikut dhe ato përshkruese, duhet të kenë pjesën e përparme të dallueshme nga përdoruesit e rrugës. Janë me ndriçim transparent, ngjyra, formë, përmasa dhe karakteristika, të sinjaleve normale vertikale, për të siguruar një ndriçim të njëtrajtshëm dhe të mos shkaktojnë verbim (neni 154/1)

Kompetencat

Sinjalet e ndriçueshëm vlerësohen nga enti pronar i rrugës, sipas një projekti (studimi) specifik, referuar një zone ose një itinerari të veçantë trafiku (neni 75/2,3)

Të përgjithshme

Sinjalet e ndriçueshme treguese me rëndësi për zona, mund të jenë të ndritshme në mënyrë transparente, me kusht që ngjyrat, forma dhe përmasat të jenë ato të përcaktuara për sinjalet vertikale normale (neni 155/1).

Funksioni

Fenerët semaforik, përjashto fenerët semaforik të verdhë të shkëlqyeshëm, shërbejnë për rregullimin në kohë, përparimin e rrymës së trafikut në një kryqëzim apo në një karrexhatë me disa korsi (nei 156).

Ngjyrat dhe rradha e ndezjes së dritave

Fenerët semaforik normal për automjete janë me tre ngjyra, në formë të rrumbullakët të vendosur vertikalisht: e kuqja sipër, e verdha në mes dhe e gjelbra poshtë.
(neni 157/1) (Figura II, 449)



Figura II 449, neni 157

Rradha e ndezjes së dritave është:

- e para, drita e gjelbër
- e dyta, drita e verdhë
- e treta, drita e kuqe

Kur feneri semaforik normal është vendosur në një trup me sinjalizimin tregues, të vendosur sipas karexhatës, pozicioni i dritave mund të jetë horizontal, me dritën e kuqe majtas, të verdhën në mes dhe të gjelbrën djathtas. (neni 157/2) (figura II 232).



Figura II.232, nenet 124,157

FENERËT SEMAFORIK TË KORSIVE
(neni 158)

Në rrugët njëkalimshe, të alternuara, feneri semaforik normal mund të jetë i dubluar me një fener të kuq të vendosur sipër tij, për të siguruar sinjalin e kuq në rast të një djegie të llambës në sinjalin e parë të kuq. (neni 157/5)

Janë semaforë me tre ngjyra në formën e shigjetave të ndriçuara, të vendosura vertikalisht me sfond të zi të rrumbullakët : shigjeta e kuqe sipër, shigjeta e verdhë në qendër dhe shigjeta e gjelbër në fund. (neni 158), (figura II 450). Rradha e ndezjes është si më sipër.



a	b	c	d	e
Për korsi që kthehet majtas	Për korsi që vazhdon drejt	Për korsi që kthehet djathtas	Për korsi të përzier majtas – drejt	Për korsi të përzier djathtas - drejt

Figura II 450, neni 158

Këta semaforë përdoren vetëm kur në rrugë ka korsi të specializuara për manovra, në drejtimet e treguara nga shigjetat dhe vetëm nëse kërkohet ndarja e rrjedhjes së trafikut në zonat e semaforizuara.

Shigjetat mund të kenë pjerrësi çfarëdo mjaft që ti përgjigjen drejtimit të kryqëzimit ku do të drejtohet mjeti. (158/4).

Në kryqëzimet kënddrejta me një korsi të përzier me dy manovra, shigjetat përkatëse të ngjyrosura mund të shkrihen në një të vetme (neni 158/5) (figura II 450/d,e).

Përmasat dhe vendosja është si në (neni 158) (figura II 451).



Figura II 451, neni 158

Përmasat jepen në mm	A	B	C	D	E	F	G	H	L	M	N	O	P	Q	R	T	U
Diametri deri në 200 mm	25	190	110	25	120	25	24	63	75	29	20	25	37	47	57	18	77
Diametri deri në 300 mm	38	265	150	38	165	38	34	95	112	43	30	38	57	70	85	26	115

FENERËT SEMAFORIK PËR MJETET E TRANSPORTIT PUBLIK

(neni 159)

Janë të përcaktuara posaçërisht për këto lloj mjetesh shërbimi dhe mund të jenë me tre apo më shumë ngjyra (figura II 452, 453) sipas simbolit:

a. sfondi i zi, vija e bardhë horizontale

b. sfondi i zi, trekëndësh i verdhë me majë të drejtuar lart

c. sfondi i zi, vija e bardhë vertikale

d. sfondi i zi, vija e bardhë e pjerrët djathtas

e. sfondi i zi, vija e bardhë e pjerrët majtas

Vendosja

Vendosja është vertikale. Vija e bardhë horizontale lart, trekëndëshi i verdhë në qendër dhe vija e bardhë vertikale në fund. (figura II 452).



Figura II.452, neni 159

Kur është e nevojshme vija e bardhë e pjerrët, duhet të vendoset në fund për të zëvendësuar dritën me vijë të bardhë vertikale qoftë dhe në lartësinë e saj, përkatësisht në të djathtë për dritën që flitet në shkronjën "d" dhe në të majtë për dritën që flitet në shkronjën "e" (figura II 453) (neni 159/1)



Figura II. 453, neni 159

Përmasat

Përmasat jepen në (mm)	A	B	C
Diametri d – 200	**35**	**190**	**110**

Radha e ndezjes së dritave:

- e para, vija e bardhë vertikale ose e pjerrët djathtas ose e pjerrët majtas
- e dyta, trekëndëshi i verdhë
- e treta, vija e bardhë horizontale (neni 159/3)

Fenerët semaforik për mjetet e transportit publik, vihen vetëm kur fenerët semaforik normal të automjeteve apo të korsive mund të shkaktojnë konfuzion, në afrimin e korrenteve të ndryshme të trafikut të mjeteve. (neni 159/4)

FENERË SEMAFORI PËR KËMBËSORËT
(neni 160)

Janë përcaktuar për të rregulluar kalimin e rrugës me semafor.

Ngjyrat dhe vendosja

Dritat e fenerëve semaforikë për këmbësorë janë në formën e këmbësorit të ngjyrosur, në një sfond të zi.

Vendosja e dritave është vertikale : këmbësori i kuq lart, i verdhi në qendër dhe i gjelbri poshtë. (figura II 454)

Figura II.454, neni 160

Simbolet përfaqësojnë:

a. këmbësori i kuq në sfond të zi të rrumbullakët, simboli i këmbësorit në pozicion pritje.
b. këmbësori i verdhë në sfond të zi të rrumbullakët, simboli i këmbësorit në pozicion pritje.
c. këmbësori i gjelbër në sfond të zi të rrumbullakët, simboli i këmbësorit në pozicion lëvizje.

Radha e ndezjes së dritave:

- e para këmbësori i gjelbër
- e dyta këmbësori i verdhë
- e treta këmbësori i kuq

Në rastet e përcaktimit të kalimeve këmbësore me semaforë për të verbër të parashikuar sipas Kodi Rrugor (neni 41 pika 5), ato kanë tre faza suplementare me tingull.

a. Lëshimi i tingullit të ndërprerë me frekuencë 60 impulse nga minuta e parë, tregon rrugë të lirë në sinkronizim me dritën e gjelbër.

b. Lëshimi i një tingulli me 120 impulse në minutin e parë, që tregon ndalimin ose boshatisjen e kalimit të këmbësorëve, nëse ai është i zënë, në sinkronizim me dritën e verdhë.

c. Mungesa e tingullit, tregon ndalim në sinkronizim me dritën e kuqe.

Sinjalizimet zanore mund të jenë me funksion të vazhdueshëm ose me komandim (buton).

Tingujt duhet të përshtaten në përputhje me impjantin semaforik, pa shkaktur shqetësime (neni 160/5,6,7)

Përmasat dhe forma

Janë si më poshtë: (figura II 455):



Figura II. 455, neni 160

Përmasat jepen në (mm)	A	B	C	D
Diametri d – 200	**160**	**72**	**160**	**96**

FENERËT SEMAFORIKË PËR BIÇIKLETA

(neni 161)

Vendosen vetëm në ato raste kur është e nevojshme të rregullohet kalimi i biçiklistëve dhe janë me tre drita dhe me figurat si më poshtë.

a. biçikletë e kuqe, në sfond të zi rrethor
b. biçikletë e verdhë, në sfond të zi rrethor
c. biçikletë e gjelbër, në sfond të zi rrethor

Pozicioni i dritave është vertikal, biçikleta e kuqe lart, biçikleta e verdhë në qendër, biçikleta e gjelbër poshtë. (neni 161/1,2) (figura II 456)

Figura II. 456, neni 161

Rradha e ndezjes së dritave është ajo e semaforëve të mësipërm.

Përmasat e simbolit të fenerëve semaforikë për biçikleta është si më poshtë: (figura II 457)



Figura II.457, neni 161

FENERË SEMAFORIK PËR AUTOMJETET ME KORSI TË KTHYESHME. (neni 162)

Përdoren për rregullimin e trafikut të mjeteve në rrugët me korsi të kthyeshme në karrexhatë me jo më pak se tre korsi, në vendkalimet e stacionëve të autostradave si dhe barrierat e kontrollit dhe pagimit të taksave.

Përgjithësisht këto fenerë vendosen horizontalisht mbi korsinë së cilës ai i referohet dhe tregon drejtimin :

a. dritë e kuqe në formë "X" me sfond të zi, vendosur majtas (vendoset mbi korsitë e pakthyeshme)

b. dritë e gjelbër në formë shigjete vertikale në sfond të zi me majë të drejtuar poshtë, vendosur djathtas.

Kur korsitë janë mbi tre, dhe kur ato qëndroret janë të kthyeshme, dy dritat që flitet më sipër duhet të jenë të integruara në një dritë në formën e shigjetës së verdhë me sfond të zi, vezulluse, e shmangur drejt fundit djathtas ose majtas.

Shigjeta tregon drejtimin që duhet të ndjekë drejtuesi i mjetit duke braktisur korsinë në të cilën ndodhet dhe të spostohet drejt korsisë përbri të përcaktuar nga drejtimi i shigjetës të fenerit me vezullim të verdhë. (neni 162/1,2,3) (figura II 458)



Figura II.458, neni 162

Përmasat e simboleve të fenerëve semaforikë për korsi të kthyeshme



Figura II.459, neni 162

Përmasat jepen në (mm)	A	B	C	D	E	F
Diametri d – 600	**180**	**480**	**76**	**500**	**260**	**330**

FENERËT SEMAFORIKË TË VERDHË VEZULLUES (PULSANT) (neni 163)

Përdoren kryesisht në kryqëzim apo në pika rreziku, ku kërkohet të tërhiqet vëmendja e drejtuesve të mjeteve, për t'i ftuar ata të ulin shpejtësinë dhe të tregojnë kujdes dhe vetë kontroll të situatës së trafikut.

Këta semaforë me ngjyrë të verdhë vezulluese (pulsant) janë tre tipe: (neni 163/1) (figura II 460)

Figura II.460, neni 163

a. Një dritë e verdhë vezulluese, rrethore
b. Një dritë e verdhë vezulluese, rrethore me simbolin e këmbësorit në pozicionin për të lëvizur, në sfond të zi.
c. Një dritë e verdhë vezulluese rrethore ose me simbolin e biçikletës në sfond të zi.

Drita e tipit "a" mund të jetë e vendosur edhe brenda një sinjali rreziku "SEMAFOR" me diametër të barabartë me atë të diskut të verdhë të përfshirë brenda tij. (neni 163/2)

Dritat e pikave "b" dhe "c" duhet të vendosen në impiantin semaforik në rastet kur ka përplasje të këmbësorëve ose biçiklistëve. Në të gjitha këto raste ka përparësi këmbësori dhe biçiklisti. (neni 163/3,4)

FENERËT SEMAFORIKË TË VEÇANTË (neni 164)

Përdoren për kalimet në nivel me ose pa barierë, në hyrje të urave të lëvizëshme, në urat e imbarkimit të trageteve ose në rrugët mbi të cilat janë të nevojshme ndalesat e trafikut për afrim të mjeteve me faza, për zbritje ose hipje nga toka etj. (neni 164) (figura II 461/a,b,c)



Figura II.461, neni 164

Fenerët semaforikë të veçantë janë të përbërë nga:

a. një dritë e kuqe vezulluese rrethore;
b. dy drita të kuqe, vezulluese, të vendosura vertikalisht ose horizontalisht, të alternuara
c. fener semaforik "vala e gjelbër"

Fenerët e tipit "c" janë me një ose disa drita të rrumbullakta njëri mbi tjetrin. Në ta shënohet me numra të bardhë në sfond të zi treguesit që lidhen me shpejtësinë që duhet të respektojë drejtuesi i mjetit në koordinim me impjantin semaforik të itinerarit. (neni 164/4,5,6)

Përmasat dhe ndriçimi i dritave semaforike (neni 165)

Si rregull, diametri i dritave semaforike është 200mm. Në rastet e rrugëve me shumë trafik, mund të përdoret edhe drita me diametër 300 mm, vetëm për dritën e kuqe. Për dritat e semaforëve të mjeteve për korsi të kthyeshme, mund të përdoret diametri maksimal 600 mm. (neni 165/1)

Ndriçimi i dritave semaforike duhet të jetë lehtësisht i dallueshëm dhe pa vibrime, nga një largësi minimalisht jo më e pakët se 75m, për dritat me diametër 300mm. (neni 165/1,2)



Vlera minimale e intensitetit të dritave në kushte normale mbi aksin optik të sistemit të jetë jo më pak se 100 qirinj, për dritat me diametër 200 mm, dhe 200 qirinj, për dritat me diametër 300 mm.

Fenerët semaforikë vendosen mbi shtylla standarte në anën e djathtë të rrugës, mbi trotuar ose mbi bankinat përballë. Fenerët semaforikë mund të përsëriten edhe në anën e majtë të rrugës.

Vendosja e fenerëve semaforikë (neni 166)

Në rrugë me tre e më shumë korsi, semaforët duhet të vendosen vertikalisht, perpendikular mbi aksin e secilës korsi, në lartësi 5.1m deri në 6m, nga pjesa e poshtme e fenerit, për të siguruar një pamshmëri sa më të mirë nga drejtuesit e mjeteve. (neni 166/1,2,3,4,5,10) (figura II 462)

Semafori duhet të jetë me kontrast me sfond të zi.



Figura II 462, neni 166

Përmasat janë si më poshtë:

Përmasat jepen në mm	A	B	C	D	E
Diametri d = 200 mm	**600**	**900**	**12**	**0,6**	**45**
Diametri d = 300 mm	**900**	**1350**	**16**	**0,8**	**70**
Diametri d = 300 dhe 200 mm	**900**	**1350**	**16**	**0,8**	**70**

Semaforët për këmbësorë të vendosur mbi shtylla në trotuar, duhen orientuar përpendikular me aksin e rrugës, në mënyrë që të mos krijojë konfuzion në lëvizjen e këmbësorëve.

Semafori duhet të vendoset gjithnjë në të djathtë të lëvizjes së trafikut. Vendosja e tyre duhet të jetë konform skemës, në të kundërt bëhet pengesë për çrregullimin e trafikut. Në kryqëzim fenerët semaforik vendosen si (në skemat 30/a,b dhe 35/a,b), (neni 166/8-10)

Orari i funksionimit të impianteve semaforikë (neni 167)

Si rregull, impiantet funksionojnë me kohë të fiksuar, është e ndaluar të funksionojnë nga ora 23:00 deri në ora 7:00. Tejkalimi i këtij orari lejohet vetëm për ato raste që kanë komandim nga këmbësorët.

Në kushte të një trafiku të shtuar apo rrugë me korsi me lëvizje të alternuar apo punime në rrugë, lejohet funksionimi i tyre edhe në harkun kohor 23:00 deri 7: 00.

Impiantet semaforikë gjithmonë duhet të parasinjalizohen me sinjallin e rrezikut "SEMAFOR". (neni 167/2,3) (figura II 31/a-b)

SINJALET E NDRITSHME TË VEÇANTA. (neni 168)

Përdoren për t'i dhënë përdoruesve të rrugës mesazhe të ndryshme dhe janë:

a. sinjale me mesazhe të ndryshueshme
b. kolonza të ndriçueshme dhe sinjalet e futura brenda në rrugë apo në anë të trotuareve, të bankinave, të orientimit, të shpërndarjes dhe të sigurimit të trafikut.

Ato duhet të jenë të dallueshme në çdo situatë të ditës e mjedisit dhe nuk duhet të provokojnë verbim.

Përmasat, ngjyrat dhe forma e tyre, duhet të jetë e njëjtë me ato që përkojnë me sistemet vertikale të sinjalizimit, pavarësisht nga mënyra e aplikimit.

Kolonat duhet të kenë një lartësi jo më pak se 1m (neni 168/1,5)

Frekuenca e dritave sinjalizuese (neni 169)

Frekuenca e dritave sinjalizuese nuk duhet të jetë më pak se 50 herë në minut dhe jo më shumë se 80 herë në minut. Cikli i ndezjes dhe shuarjes duhet të këtë kohëzgjatje të barabartë.

SITUATA TË VEÇANTA

ZONAT ME QARKULLIM TE RREGULLUAR

Janë zonat të cilat kërkojnë një sinjalizim të veçantë:

- zonë këmbësore;
- zona e trafikut të kufizuar;
- zona banimi

ZONË KËMBËSORE

Tregon fillimin e zonës së ndaluar për qarkullimin e mjeteve, përveç atyre në shërbim të emergjencës dhe mund të përmbajë përveç devijimit për biçiklistët, për mjetet në shërbim të personave me aftësi të kufizuar ose atyre me karrocë, si edhe të atyre me emetim zero, të cilat kanë një shpejtësi të tillë sa të krahasohen me biçikletat (neni 3/55 i Kodit Rrugor).

SINJALI I ZONËS SË KËMBËSORËVE
(neni 133/13)

Figura II 320, neni 133

Figura II 321, neni 133

Tregon fillimin e zonës së ndaluar për qarkullimin e mjeteve.
Mund të jetë sëbashku me një panel plotësues me sfond të bardhë i cili përmban përjashtime të mundshe, kufizime ose shmangie.

Në dalje duhet të vendoset sinjali i fundit të zonës së këmbësorëve.

Paneli katror mund të këtë brinjë me përmasa 60 ose 90 cm.
Paneli drejtëkëndësh mund të ketë brinjën e shkurtër 60 ose 90 cm.

Disku i vizatuar në sinjal duhet të ketë përmasat:

- diametri 30 cm në brendësi të panelit me brinjë 60 cm;
- diametri 50 cm në brendësi të panelit me brinjë 90 cm.

ZONË E TRAFIKUT TË KUFIZUAR

Tregon fillimin e zonës, ku hyrja dhe qarkullimi i mjeteve është i kufizuar në kohë ose për disa kategori mjetesh (neni 3/51 Kodit Rrugor.

SINJALI ZONË ME TRAFIK TË KUFIZUAR (neni 133/15)

Figura II 323, neni 133

Figura II 322, neni 133

Tregon fillimin e zonës në të cilën hyrja dhe qarkullimi janë të kufizuara në kohë ose për një kategori të caktuar mjetesh.

Mund të jetë së bashku me një panel plotësues me sfond të bardhë i cili përmban përjashtime, kufizime ose shmangie të mundshme.

Në dalje duhet të vendoset sinjali fund i zonës së trafikut të kufizuar.

Paneli katror mund të këtë brinjë me përmasa 60 ose 90 cm.

Paneli drejtëkëndësh mund të ketë brinjën e shkurtër 60 ose 90 cm.

Disku i vizatuar në sinjal duhet të ketë përmasat:

- diametri 30 cm në brendësi të panelit me brinjë 60 cm;
- diametri 50 cm në brendësi të panelit me brinjë 90 cm.

ZONË BANIMI

Zonë banimi është një zonë urbane me rregulla të veçanta qarkullimi për mbrojtjen e këmbësorëve dhe të ambientit, e kufizuar përgjatë rrugëve të hyrjes nga sinjale të posaçme të fillimit dhe të fundit (neni 3/31 i Kodit Rrugor).

SINJALI ZONË E BANUAR
(neni 133/12)

Figura II 318, neni 133

Figura II 319, neni 133

Tregon fillimin e një rruge ose zone me karakter banimi apo rezidenciale, në të cilën ekzistojnë rregulla të veçanta kujdesi dhe sjelljeje.

Mund të vendoset në fillim të kësaj rruge ose zone.

Duhet të vendoset së bashku me një panel plotësues, me sfond të bardhë që përmbledh përkujdesjet e veçanta të sjelljes të cilat duhen ndjekur në brendësi të rrugës ose zonës.

VENDKALIME KËMBËSORE

Përkufizime

Pjesa e karrexhatës, e shënuar dhe e organizuar në mënyrë të përshtatshme, mbi të cilën këmbësorët, gjatë kalimit nga njëra anë e rrugës në tjetrën, kanë përparësi ndaj automjeteve.

Në vendkalimet e këmbësorëve drejtuesit e mjeteve duhet t'u japin përparësi këmbësorëve që kanë filluar kalimin.

Vendkalimet për këmbësorët duhet të jenë gjithmonë të kalueshme edhe për personat e paaftë në karrike me rrota, në kujdesje për të verbërit, mund të vendosen sinjale në sipërfaqen e rrugës ose sinjale të tjera rreziku në afërsi të vetë vendkalimeve (neni 40/11 i Kodit Rrugor).

Sinjalet vertikale

Sinjali VENDKALIM KËMBËSOR **figura II 13** (neni 86/2) duhet të përdoret për të parasinjalizuar një kalim për këmbësorët të evidentuar nga sinjalet e posaçme mbi karrexhatë:

- në rrugët interubane;
- në rrugët urbane me shpejtësi maksimale deri 50 km/orë;
- në rrugët e tjera urbane, kur kushtet e trafikut kështillojnë përdorimin për motive sigurie (neni 86/4).

Montohet duke ndjekur rregullat e vlefshme për sinjalet e rrezikut. Një shembull i aplikimit të këtij sinjali është dhënë në **Skemën 30** (aneksi A).

Sinjali VENDKALIM KËMBËSOR **figura II 303** (neni 133/3) lokalizon një vendkalim për këmbësorët:
- të parregulluar nga impianti semaforik;
- që nuk ndodhet në kryqëzime.

Në rastin e sinjalit me ndriçim, është i kështillueshëm kombinimi me rreze të posaçme drite, për të ndriçuar sinjalet horizontale të shiritave të bardha tip zebër të këmbësorëve.
Është gjithmonë me pamje të dyfishtë, edhe në rrugët me një drejtim, dhe vendoset në të dy anët e karrexhatës, në ishullin e mundshëm trafikndarës ose edhe përmbi karrexhatë.

Sinjalet NËNKALIM KËMBËSOR (**figura II 306**) dhe MBIKALIM KËMBËSOR (**figura II 307**) lokalizojnë një nënkalim ose një mbikalim këmbësorësh për kalimet rrugore. Vendosen me pamje të dyfishtë në fillim të tyre.
Atje ku është e nevojshme, mund të vendosen edhe me tre elemente me pamje në kënd prej 60 gradë midis tyre. Të njëjtin përdorim ka dhe sinjali PLAN I PJERRËT KËMBËSORËSH (**figura II 308**).

Sinjalet horizontale

Vendkalimet për këmbësorët janë evidentuar në karrexhatë përmes shiritave të bardha paralele, tip zebre, me drejtimin e lëvizjes së mjeteve (neni 143/1). Shih **Skemën 50** (aneksi A).

Gjatësia e shiritave është:

- ≥ 2,50 m në rrugët lokale dhe urbane dytësore;
- ≥ 4,0 në rrugët e tjera.

Gjerësia është:

- 50 cm për shiritat;
- 50 cm për intervalet. (hapësira midis shiritave te bardha)

Gjerësia e vendkalimit duhet të jetë gjithsesi në përpjesim të drejtë me fluksin e trafikut të këmbësorëve.

Shiriti i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes duhet të jetë i pandërprerë deri në afërsi të vendkalimit të këmbësorëve për një gjatësi jo më pak se 30 m (neni 137/2ç).

Shiriti tërthor i ndalimit në përgjigje të një vendkalimi këmbësorësh me semafor duhet të jetë i pandërprerë (neni 142/1).

Në kryqëzimet me semaforë shiriti i ndalimit duhet të jetë përpara vendkalimit të këmbësorëve në një largësi prej 1 m nga kufiri i tij (neni 142/5). Shih **Skemën 35** (aneksi A).

Në prani të sinjalit **NDAL DHE JEP PËRPARËSI** vendkalimi këmbësorëve, nëse ekziston, duhet të vijëzohet të paktën 5 m nga ana e sipërme e shiritit tërthor të ndalimit; në këtë rast këmbësorët duhet të drejtohen drejt vendkalimit të këmbësorëve përmes sistemeve mbrojtëse (penguese) të përshtatshëm të sigurisë (neni 143/3). Shih **Skemën 51** (aneksi A).

Në rrugët ku është i lejuar ndalimi, për të përmirësuar shikueshmërinë nga ana e drejtuesve të mjeteve në përballje me këmbësorët që janë gati për të kaluar karrexhatën, vendkalimet e këmbësorëve mund të jenë të paraprirë, në drejtimin e lëvizjes së mjeteve, nga një shirit i verdhë zig-zag me gjatësi në përpjestim të drejtë me largësinë e shikueshmërisë (**Skema 52** aneksi A).

Mbi këtë shirit nuk lejohet ndalimi (neni 143/4).

AUTOBUS

Vendosja dhe mirëmbajtja e sinjaleve është nën kujdesin e enteve pronare të rrugëve. (neni 37/1 i Kodit Rrugor).

Sinjalet vertikale

Sinjali NDALIM AUTOBUSI (neni 134/6), i dhënë në **figurën II 358**, tregon vendin e ndalimit të mjeteve të transportit publik interurban.

Hapësira blu nën kuadratin e bardhë me simbol të zi mund të përdoret për të treguar shërbimet e transportit, vendarritjen e tyre dhe oraret e mundshme.

Nëse kjo hapësirë nuk është e mjaftueshme, sinjali plotësohet nga paneli **model II 6**, i cili ka përmasat e **Skedës 9**. Sinjali mund të përdoret edhe në zonat urbane.

Sinjali AUTOBUS SHKOLLE (neni 133/4), paraqitur në **figurën II 304**, vendoset në anën e trotuarit dhe tregon vend ndalimin e autobusit të shkollës.

Duhet të vendoset:
- me pamje të dyfishtë, në mënyrë që të jetë i dukshëm nga të dyja anët;
- pingul me sipërfaqen e rrugës.

Nëse vendoset mbi autobus me dukshmëri nga të katër anët tregon se ai është i përshtatur për transportin e fëmijëve nga shkolla dhe për në shkollë.

Ngjyra e sfondit është portokalli (neni 76/2e) dhe simbolet me të zeza (neni 76/3b).

Sinjali PARKIM KËMBIMI ME LINJAT E AUTOBUSËVE, TRAMVAJIN, OSE SHËRBIME TË TJERA TË TRANSPORTIT (**figura II 368÷370**) tregon ose një vend parkimi afër një ndalese ose një stacion të fundit të linjës së shërbimit për transportin publik urban.

Përmasat e kësaj tabele janë dhënë në **Skedën 2**.

Plotësohet me (neni 134/15):

- të dhëna të rëndësishme lidhur me vendarritjet (poshtë në të djathtë të tabelës);
- të dhëna lidhur me numrin e veçantë të linjave të transportit publik të disponueshme (poshtë në të djathtë të tabelës);
- emrin e mundshëm të ndalesës përmes panelit plotësues **modeli II 6** (jo i detyrueshëm) (neni 134/15).

Sinjalet horizontale

Vendqëndrimet duhet të lokalizohen duke mbajtur parasysh normat e mëposhtme (neni 134/6):

- në zonat interurbane në rrugë me një karrexhatë dhe me dy drejtime lëvizjeje vendqëndrimet duhet të jenë të larguara të paktën 50 m, në vendosje njëra përpara tjetrës, drejtimit përkatës të lëvizjes;
- në qendrat e banuara dhe në rrugët interurbane vendqëndrimet, të vendosura në përgjigje të zonave të kryqëzimeve, vendosen maksimalisht, të paktën 20 m pas kryqëzimit. Në rast se kjo përbën një cënim të qarkullimit, vendosen të paktën 10 m përpara kryqëzimit.

Shiritat e kufizimit të vendqëndrimeve në zonat urbane kanë karakteristikat e mëposhtëme (shih **Skemën 53** aneksi A):

- janë të përbëra nga një shirit gjatësor i verdhë i ndërprerë, i vendosur në një largësi minimale prej 2,70 m nga trotuari ose nga shiriti i anës (neni 149/1);
- vendosen gjithashtu dy shirita të tërthortë të verdha, të pandërprera që bashkohen pingul me të mëparshmet (neni 149/1);
- në rastin e xhepave ose zonave të pushimit, shiritat e tërthortë mund të mos jenë të vijëzuara (neni 149/1);
- gjerësia e shiritave, qoftë të ndërprera qoftë të pandërprera, është 12 cm (neni 149/1).

Zona e vend qëndrimit është e skematizuar në **Skemën 53** dhe është e ndarë në tre pjesë (nenet 149/2 dhe 149/3):

- e para, dhe e fundit me gjatësi 12 m, është e nevojshme për të kryer manovrën e parkimit pranë trotuarit dhe mund të evidentohet me vijëzimin e një shiriti të verdhë zig-zag;
- zona qendrore duhet të jetë e gjatë të paktën sa ç'mund të jetë mjeti më i gjatë që kryen qëndrimin, e shtuar me 2 m;
- e treta, me gjatësi 12 m, është e nevojshme për të kryer manovrën e rihyrjes në fluksin e trafikut nga ana e mjetit dhe mund të evidentohet me vijëzimin e një shiriti të verdhë zig-zag.

Në brendësi të vendit të qëndrimit, duhet të shkruhet BUS (neni 149/4) dhe shkrimi duhet të jetë i verdhë (neni 146/4) dhe i vendosur në përgjithësi në ⅓ e zonës së qëndrimit. Përdoren karakteret e **tabelave II 26/a÷d** (neni 146/1).

Vendqëndrimet përgjatë rrugëve interurbane duhen parashikuar, maksimalisht, në sheshe të posaçme qëndrimi jashtë karrexhatës të quajtura XHEPA OSE ZONA TË NDALIMIT (neni 3/41, 48 i Kodit Rrugor).

Në rastet ku vendqëndrimi i autobusëve vendoset pranë një kryqëzimi rrugor, ai duhet të vendoset pas kryqëzimit jo më pak se 60m larg tij. Në rastet kur vendqëndrimi i autobusëve duhet vendosur para kryqëzimit ai duhet të jetë jo më afër se 60 m para kryqëzimit.

Xhep ndalimi

Me XHEP NDALIMI kuptohet pjesa e rrugës, jashtë karrexhatës, e destinuar për ndalimin e mjeteve të shërbimit publik të linjës, të cilat ndodhen pranë trotuarit ose një hapësire tjetër të pritjes së këmbësorëve.

Sheshet duhet të kenë këto karakteristika (shih **Skemën 54** aneksi A):

- gjerësia minimale 3 m në përputhje me qëndrimin;
- gjatësia minimale e ndalimit 12 m;
- vendkalimi i hyrjes 30 m;
- vendkalimi daljes 30 m;
- duhet të jetë një trotuar ose një ishull i posaçëm i gritur;
- vendoset tabela NDALIM AUTOBUSI (**figura II 358**).

Në rast se korsia për autobusin është e rezervuar (neni 138/6), ajo mbrohet nga elementë të ngritur nga sipërfaqja ose ndahet nga korsitë e ecjes përmes dy shiritave të pandërprera përkrah njëra-tjetrës, një e bardhë 12 cm e gjerë dhe një e verdhë 30 cm, të larguara ndërmjet tyre 12 cm; shiriti i verdhë duhet të jetë i vendosur në krahun e korsisë së rezervuar. Shih **Skemën 32** (aneksi A).

KAZANET PËR MBETURINAT

Kazanët për mbledhjen e mbeturinave urbane qoftë dhe me diferencim të tyre, vendosen në përgjithësi jashtë karrexhatës ose, gjithsesi, në mënyrë të tillë që të mos përbëjnë pengesë për qarkullimin (neni 67/1).

Kazanët duhet të jenë të shënjuar, duke vendosur mbi secilën anë vertikale, shirita të hollë me sipërfaqe reflektuese të bardha dhe të kuqe me karakteristikat e mëposhtme (neni 67/2) **figura II 479/a.**

- sipërfaqja minimale e përafërt e shiritave duhet të jetë 3200 cm^2 gjithsesi e ndërprerë siç evidentohet në **Skemën 55** (aneksi A);
- sipërfaqet reflektuese duhet të kenë të njëjtat kritere ngjyrimi e fotometri të vendosura për sinjalet rrugore;
- në zonët urbane ku bashkëjetojnë volume të mëdha trafiku dhe burime shqetësimi të ndriçuara, ose ambiente të ndriçuara shumë mirë, sipërfaqet reflektuese duhet të jenë si rregull të klasës 2 (neni 67/2).

Nëse nuk mund të aplikohet sinjali i cituar më sipër, për shkak të ndërtimit të kazanëve dhe të vendosjes së strukturës ndihmëse, ajo mund të zëvendësohet nga katër panele më të vogla, secila me sipërfaqe 20x20 cm, për një sipërfaqe të përafërt jo më të vogël se 1600 cm^2 siç jepet në **Skemën 55** (neni 67/3) **figura II 479/b.**

Në këtë rast kazanët duhet të vendosen në zona të përcaktuara për parkime jashtë ose brenda vetë karrexhatës.

Nëse kazanët nuk janë të pajisur me asnjë sinjalitikë, vendosen në vende të përshtatshme, jashtë karrexhatës (neni 67/4).

Nëse kazani vendoset në anët e karrexhatës (neni 67/5), zona e vendosjes së tij duhet të kufizohet nga një shirit i verdhë i pandërprerë me gjerësi 12 cm, siç Skemohet në **Skemën 56** (aneksi A) (neni 150/2).

Në përputhje me pjesën e kufizuar paralele me anët e karrexhatës është i ndaluar pushimi i mjeteve (neni 150/2).

KTHESË

Me kthesë kuptohet një rakordim gjatësor ndërmjet dy pjesëve te drejta të rrugës, të cilat kanë akse që ndrëpriten dhe që sjellin kushte të kufizimit të pamjes.

Ky kapitull përfshin paragrafet:

- vendosja e sinjaleve vertikale në kthesë;
- shirita gjatësore;
- sinjalet vertikale të rrezikut.

Përsa i përket përshirituesve (shmangësve) normal dhe atyre të veçantë anësor, konsultohuni me kapitullin Përshirituesit.

Vendosja e sinjaleve vertikale në kthesë

Vendosja e sinjaleve vertikale në kthesë duhet të ndjekë të dhënat e **skemës II C** dhe **skemës II D** në faqen 151

Shiritat gjatësore
(neni 136/3; 137/4)

Shiritat gjatësor të ndërprera në kthesa janë ato të **tabelës 31**, **rasti *b*, *c*** dhe **d**, të cilat gjenden edhe në tabelën e mëposhtëme me qëllimin përkatës të zbatimit. Me zvogëlimin e rrezes së kthesës intervalet e shiritave të rastit ***b*** mund të reduktohen.

Tabela shiritave gjatësore të ndërprera tipi *b*, *c*, *d* (neni 138/3)

Lloji i shiritës	*Gjurma e rrugës*	*Intervali*	*Qëllimi i zbatimit*
b	3,0 m	4,5 m	Ndarje e drejtimeve të lëvizjes dhe korsive në pjesët ku lejohet shpejtësia e projektuar nga 50 deri 100 km/orë
c	3,0 m	3,0 m	Ndarje e drejtimeve të lëvizjes dhe korsive në pjesë me shpejtësi jo më të madhe se 50 km/orë dhe në tunele
d	4,5 m	1,5 m	Shirita të paralajmërimit të afërsisë së një shiriti të pandërprerë

Ndarja e drejtimeve të lëvizjes, në rrugët me një karrexhatë, duhet të bëhet përmes shiritave të pandërprerë, në rast se nevojitet evitimi i zënies, nga ana e mjeteve, e korsisë në drejtimin e kundërt, për gjatë gjithë pjesës në të cilën pamja nuk është e mjaftueshme (neni 137/3).

Gjatësia minimale e një shirite të pandërprerë nuk duhet të jetë më pak se 30 m.

Në rast të një pamjeje të reduktuar përdoren dy shirita përkrah njëri-tjetrit, ku njëri është i pandërprerë dhe tjetri i ndërprerë, për një pjesë jo më të vogël se 30 m (neni 137/4).
Modalitetet e përdorimit të këtyre shiritave shpjegohen në figurat:

- **figura II 420**;
- **figura II 421**;
- **figura II 422**;
- **figura II 423**;
- **figura II 424**.

Sinjalet vertikale që lidhen me kthesat e rrezikshme
(neni 84)

Kthesat e rrezikshme dhe sheshet e kthimit duhet të parasinjalizohen duke përdorur sinjalet e rrezikut:

a) në rastin e kthesës nga e djathta përdoret sinjali i **figurës II 4**;

b) në rastin e kthesës nga e majta përdoret sinjali i **figurës II 5**;

c) në rastin e kthesës së dyfishtë me të parën djathtas përdoret sinjali i **figurës II 6**;

d) në rastin e kthesës së dyfishtë me të parën majtas përdoret sinjali i **figurës II 7**.

Në rastin e një numri kthesash të rrezikshme të njëpasnjëshme përdoren sinjalet *c)* ose *d)* sipas drejtimit të kthesës së parë duke shtuar panelin përfshirës **model II 2** i cili tregon gjatësinë e saj. Nëse zgjatja kalon 3 km, sinjali përsëritet.

Në rast të një numri sheshesh kthimi të njëpasnjëshëm përdoren sinjalet *c)* ose *d)* sipas drejtimit të kthesës së parë, duke shtuar panelin **model II 6/p1** që përmban shkrimin "kthesë e fortë" si dhe numri i tyre.

Secili shesh kthimi mund të tregohet me një numër në një panel të posaçëm **model II 6/p2** që ngjitet në anën e kufirit të jashtëm të rrugës dhe në qëndër të kthesës.
Nëse në një kthesë vihen dy panele, njëri për çdo drejtim lëvizjeje, është e preferueshme që të dy panelet të montohen në të njëjtin mbajtëse. Shih **Skemën 57** (aneksi A).



Skema II C, neni 79

VENDOSJA ANESORE NE KTHESE, MAJTAS



Skema II D, neni 79

VENDOSJA ANESORE NE KTHESE, DJATHTAS

Në mungesë të pengesave, që kufizojnë pamjen

KUFIZUES KORSISH

Korsitë e rezervuara në të cilat është lejuar vetëm lëvizja e kategorive të caktuara mjetesh, mund të kufizohen fizikisht qoftë nga shiritat e verdha, siç është shpjeguar në kapitujt e sinjaleve horizontale, qoftë nga elementë në reliev, të ngritur, të tillë që të realizojnë një ndarje gjatësore (neni 176/2).

Karakteristikat

Elementë të dukshëm në reliev, të ngritur, të përdorur kryesisht në zonat urbane, janë të përbërë nga produkte në materiale plastike ose gomë në ngjyrë të verdhë.

Duhet të jenë të pajisur me një sistem të qëndrueshëm, të fiksimit në rrugë, në mënyrë që të pengojë spostimet ose shkëputjet si efekt i rrymave të trafikut, dhe duhet të vendosen në mënyrë të tillë që të lejojnë rrjedhjen e ujrave të shiut (neni 176/3).

Përmasat

Elementët duhet të kenë një gjerësi nga 15 deri në 30 cm, lartësi 3 deri në 10 cm, me një qëndrueshmëri dhe një profil të tillë që të lejojë kapërcimin e tyre në rast nevoje.
Mund të pajisjen me pllakëza me sipërfaqe reflektuese ose sisteme te tjera prizmatike që të përthyejnë dritën për t'i bërë ato sa më shumë të dukshme (neni 176/4).

Miratimi

Kufizuesit e korsisë duhet të jenë të miratuara nga Ministria që mbulon veprimtarinë e Transportit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
Vendosja në rrugë bëhet me aprovimin paraprak të entit pronar të rrugës (neni 176/5).

SHMANGËSIT (PËRVIJUESIT)

SHMANGËSIT NORMALË ANËSORË (neni 171)

Shmangësit normalë, anësorë duhet të vendosen përgjatë atyre segmenteve rrugore, jashtë qëndrave të banuara, ku është e nevojshme shikueshmëria në largësi të ecurisë së aksit të rrugës, për arsye të shpejtësisë vendore zotëruese, drejtimit planoaltimetrik apo kushteve klimaterike të zonës. (neni 171/1).

Duhet të shmangen vendosjet rastësore, dhe për pjesë homogjene të rrugës, vendosja duhet të jetë në vazhdimësi dhe me të njëjtin lloj shmangësi.

Hapësira ndërmjet shmangësve normalë, anësorë

Shmangësit anësorë (**Skema 58** aneksi A), në vijë të drejtë, duhet të vendosen njëri pas tjetrit me një një hapësirë maksimumi 50 m. Në kthesa, vendosja e tyre bëhet në fuksnion të rrezes së kthesës, sipas tabelës së mëposhtëme:

Tabela e hapësirave ndërmjet shmangësve anësorë
(kjo tabelë ka vlerë treguese)

Rrezja e kthesës m	Hapsira ndërmjet dy shmangësve m
deri në 30	6
nga 30 ÷ 50	8
nga 50 ÷ 100	12
nga 100 ÷ 200	20
nga 200 ÷ 400	30
mbi 400	Interval i pranuar në vijë të drejtë dhe, gjithsesi, jo më shumë se 50

Hapësirat e vendosjes gjithësesi duhet të jenë sa më shumë që të jetë e mundur, të njëjta në të njëjtën pjesë të rrugës, në mënyrë që të përbëjnë një orientim optik, homogjen (neni 171/3).

Hapësirat zvogëlohen në mënyrë të përshtatshme edhe në vijë të drejtë në zona me mjegull (neni 171/4).

Karakteristikat e shmangësve normalë, anësorë

Shmangësit duhet të vendosen në kufijtë e jashtëm të bankinës dhe jo më pak se 50 cm nga ana e jashtme e rrugës (neni 171/5).

Lartësia përmbi tokë e shmangësve duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 70 dhe 110 cm dhe seksioni, parapëlqehet në formë trapezi me qoshe të rrumbullakosura. Duhet të brendashkruhen në një drejtëkëndësh me përmasa 10x12 cm brinja e vogël e të cilit duhet të jetë paralel me aksin e rrugës (neni 171/6).

Ngjyrat

Ngjyra e shmangësve duhet të jetë e bardhë dhe fasha të zeza, të lartë 25 cm të vendosur në pjesën e sipërme në të cilën vendoset elementi reflektues, i drejtuar drejt rrymës së trafikut, me mënyrat si vijon (neni 171/7):

- *në rrugët e zakonshme ose në rrugët njëkalimshe* (me një drejtim lëvizje)

Në shmangësin e djathtë duhet të shfaqet vetëm një element reflektues me ngjyrë të verdhë me sipërfaqë minimale 60 cm^2; në shmangësin e majtë duhet të shfaqen dy elementë reflektues të verdhë të vendosur vertikalisht dhe mundësisht larg njëri – tjetrit, sejcili me sipërfaqe aktive minimale 30 cm^2;

- *në rrugët me dy drejtime lëvizjeje*:

Në krahun e djathtë duhet të shfaqet një element reflektues i kuq, ndërsa në krahun e majtë duhet të shfaqet një element reflektues i bardhë; të dy elementët reflektues duhet të kenë një sipërfaqe minimale 60 cm^2.

Materiali dhe karakteristikat e shmangësit duhet të jenë të tilla që të mos përbëjnë rrezik në rast përplasjeje nga mjetet (neni 171/8); duhet të përdoren vetëm shmangës që plotësojnë karakteristikat e vendosura me rregullore teknike të posaçme, të miratuar nga Ministria që mbulon Transportin.

Zëvendësimet e shmangësve normalë anësorë në rastet e pengesave

Në prani të barrierave të sigurisë, mure, parapete ose pengesa të tjera, shmangësit mund të zëvendësohen nga elementë reflektues, të fiksuar në ta, që kanë përmasat dhe karakteristikat e dhëna në paragrafin e mëparshëm, të vendosur në pjesën e ngritur të barrierës ose përmbi të. Është e nevojshme që lartësia nga toka e elementëve reflektues të jetë sa ajo në shmangësit normalë (neni 171/10).

SHMANGËSIT E VEÇANTË ANËSOR
(neni 172)

Shmangësit e veçantë përdoren si sisteme të përhershme. Ata janë të tipeve dhe kanë norma përdorimi si më poshtë:

Shmangës për tunele
(neni 172/3a)
figura II 464

Shmangësit për tunelet janë dhënë në paragrafin Tunelet të kapitullit Situata të veçanta.

Shmangësit për rrugë malore(neni 172/3b)
figura II 465

Është e detyrueshme të përdoren në rrugët me prani të rreshjeve të mëdha të dëborës; vendosja e tyre duhet të zgjidhet në mënyrë, që edhe në këto kushte gjurma e rrugës të jetë e dukshme (**Skema 58**).

Mund të realizohen me materiale ose pjesë të ndryshme që, gjithsesi, duhet të jenë në gjendje t'i rezistojnë kushteve të ambientit malor dhe atyre që vijnë nga puna për pastrimin e dëborës.

Shmangësi, lartësia e të cilit duhet të zgjidhet e tillë që të mos mbulohet nga shtresa maksimale e dëborës e parashikuar, duhet të ketë shirita të alternuar, secili me lartësi 50 cm, me ngjyrë të verdhë dhe të zezë.

Të paktën njëri prej shiritave të sipërm duhet të jetë i realizuar me sipërfaqe reflektuese me ngjyrë të verdhë.

Shmangësi i kthesës së ngushtë ose i shesheve të kthimit (neni 172/3c) figura II 466

Tregon ecurinë e përshkueshmërisë së një kthese të ngushtë të përhershme ose të një sheshi kthimi.
Në rrugët interurbane **janë të detyrueshme** në të gjitha kthesat me rreze më të vogël se 30 m dhe me zhvillim në mënyrë të tillë që të përcaktojnë mungesën e pamjes (**Skema 59** aneksi A).

Sinjali është i përbërë nga një panel drejtëkëndësh, i vendosur horizontalisht, ku në një sfond të zi është vizatuar një shigjetë me majë të bardhë, të kthyer në drejtim të lëvizjes së mjeteve të cilëve u drejtohet.

Një panel i tillë montohet në anën e jashtme të kthesës në pozicion të mesëm dhe në kënd të drejtë me shikimin e drejtuesve të mjeteve të cilëve ju referohet.

Në rrugët me dy drejtime të lëvizjes sinjalet në fjalë duhet të jenë të orientuara në mënyrë të tillë që të jenë të shikueshme vetëm nga drejtuesit të cilëve ju referohen.

Lartësia nga toka vendoset sipas rastit, me qëllim që të arrihet pamja më e mirë e panelit.

Përmasat e paneleve janë:

- normale: 60x240 cm;
- të mëdha: 90x360 cm.

Shmangës për kryqëzime në formë "T" figura II 467

Janë të detyrueshme duke qenë të vetmet pajisje të sinjalizimit të kësaj situate anormale të rrezikut (neni 172/3ç) (**Skema 59**).

Ky panel duhet të vendoset:

- përballë degës së kryqëzimit që nuk vazhdon;
- poshtë sinjaleve drejtuese, nëse janë prezent;
- në pozicion paralel me rrugën që vazhdon.

Është i përbërë nga një panel drejtëkëndësh vendosur me brinjën e madhe horizontalisht, mbajtës i një vizatimi shigjete me kulm të bardhë në sfond të zezë, e orientuar në dy drejtimet e jashtme.

Përmasat e paneleve janë:

- normale: 60x240 cm
- të mëdha: 90x360 cm.

Shmangës modularë të kthesës (neni 172/3d) figura II 468

Quhen të tillë ata shmangës që ndjekin për një pjesë rruge formën e kthesave të ngushta.

Zbatohen në seri, me shumë elementë dhe shërbejnë për të theksuar krahun e jashtën të kthesës me reze më të madhe se 30 m dhe kthesave autostradale ose në rrugët jashtë qytetëse, në rastet kur është e nevojshme për të përmirësuar shikimin e ecurisë së rrugës në largësi.

Janë të përbëra nga një panel katror me sfond të zi mbi të cilin është vizatuar një shigjetë e bardhë me majë dhe kanë përmasat e mëposhtëme:

- 60x60 cm për rrugë të zakonshme;
- 90x90 cm për autostradat dhe rrugët interurbane kryesore.

Hapësira gjatësore ndërmjet elementëve është maksimalja e atyre të parashikuar nga tabela në vijim; gjithsesi mbahet parasysh se drejtuesi i mjetit duhet të mund të shohë të pakten tre shmangës njëkohësisht.

Tabela e ndarjes përsëgjati të shmangësve modular të kthesës (neni 172)

Rrezja e kthesës (metra)	***Hapësira ndërmjet përvijuesve (metra)***
30 ÷ 50	8
50 ÷ 100	12
100 ÷ 200	20
200 ÷ 400	30
> 400 (kur është e nevojshme)	30 ÷ 50

Shmangës i hyrjeve
(neni 172/3dh)
figura II 469

Këta lloj shmangësish, të dhënë në **Skemën 58**, përdoren për të kufizuar të dyja krahët e hyrjeve dytësore të rrugës që mund të mos jenë të parasinjalizuara, dhe ato që, për shkak të pozicionit të tyre të veçantë, janë të vështira për t'u parë.

Janë realizuar me:

- sipërfaqe anësore me vija të bardha dhe të kuqe me lartësi 20 cm;
- seksione rrethore, katrore, drejtëkëndëshe ose trekëndëshe;
- lartësi minimale 1 m nga toka;
- sipërfaqe plotësisht reflektuese.

Sistemet e shmangies së ndriçuar
(neni 172/3e)

Kthesa, pika kritike dhe anomalitë e tjera rrugore mund të jenë të theksohen me sisteme të shmangies së ndriçuar, vetëm nëse ngjyrat, format dhe mënyrat e përdorimit sigurojnë njëtrajtshmërinë e ndriçimit dhe shmangien e verbimit.

Këto sisteme miratohen nga Ministria që mbulon Transportin dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila autorizon përdorimin e tyre në situata të veçanta.

Shmangës të veçantë të pengesave për ishujt

Për shmangësit e veçantë të pengesave për ishujt drejtojuni paragrafit Ishujt të kapitullit Pengesat. fig.II. 472

KURRIZ RRUGE

Përkufizim :

Rakordim ndërmjet dy planeve të njëpasnjëshëm me pjerrësi të ndryshme që ndërpriten mbi sipërfaqen rrugore. Pjesë rruge me lakim gjatësor konveks (të kurrizët) (Tabela 7).

Sinjalet Vertikale

Figura II 2 nenet 83,177

Sinjali kurriz rruge (**Figura II 2**) duhet te përdoret për të paralajmëruar një anomali altimetrike gjatësore të rrugës, që kufizon shikueshmërinë (neni 83/2).

Për pozicionimin e tij dhe për të gjitha specifikat e instalimit shiko kapitullin "Sinjalet vertikale".

Sinjalet horizontale

Shiriti i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes duhet të jetë i vazhdueshëm në pjesët e rrugës ku shikueshmëria është e reduktuar (neni 137/2) dhe të ketë gjatësi të tille që të pengoje zënien e korsisë fqinje për gjithë pjesën e rrugës ku shikueshmëria është e pamjaftueshme.

Dy shirita paralele (krah njëra tjetrës), nga të cilat njëra e vazhduar dhe tjetra e ndërprerë, duhet të përdoren në rastin kur njeri nga dy kahjet e lëvizjes ka një shikueshmëri të reduktuar.

Gjatësia e shiritave të tilla paralele nuk duhet të jete me e vogël se 30 m (neni 137/4).

TUNEL

Figura.II.316, neni 133

Tregon fillimin e një tuneli artificial ose natyral.

Sinjali tregon normat e sjelljes që duhen respektuar në tunele, që janë:

- ndiz dritat jo verbuese
- ndalim qëndrimi ose pushimi
- ndalim të ndryshimit të kahut të lëvizjes
- shuaj motorin në raste ndalimi për arsye trafiku.

Bashkëshoqërimi

Mund të bashkëshoqërohet me:

- panel **mod. II 6**, që tregon emrin e tunelit
- panel **mod. II 2**, që tregon gjatësinë e tunelit të shprehur në metra. (**tabela 60** aneksi A)

Vendvendosja

Sinjali vendoset përpara hyrjes se tunelit.

Shmangësit e veçantë
(neni 172/3a)

Janë të detyrueshëm në tunelet pa ndriçim dhe jo drejtvizorë, dhe rekomandohen në të gjithë tunelet në 100 metrat e para nga hyrja. Kane karakteristikat dhe mënyrat e përdorimit si vijon:

- Janë panele reflektuese me ngjyre të verdhe në tunelet me një kahje lëvizjeje (sens unik), 20 cm në baze dhe 80 cm në lartësi.
- Në rast se tuneli është me dy kahje lëvizjeje, duhet të jenë me faqe dyfishe, me ngjyre të kuqe djathtas dhe të bardhe majtas.
- Duhet të montohen në mënyrë të tille që pozicioni i tyre të mos ndryshoje me kalimin e kohës.
- Nuk duhet të dalin drejt karrexhatës, në prani të barrierave të sigurisë.
- Distanca maksimale ndërmjet paneleve është 20m.
- Distanca duhet të zvogëlohet progresivisht (deri në një minimum prej 8 m) në rast se tuneli është në kthesë, si dhe për 10 elementët e pare nga hyrja.

KRYQËZIMET

KRYQËZIM I RREGULLUAR ME SINJALE "KRYQËZIM ME PËRPARËSI NGA E DJATHTA"

Sinjalet vertikale (**Skema 80** aneksi A):

- Sinjali "KRYQËZIM ME PËRPARËSI DJATHTAS" (**figura II 40**) është i vendosur në rrugë për të paralajmëruar një kryqëzim ndërmjet dy ose më shumë rrugëve për të cilat vlen rregulli i përgjithshëm i përparësisë në të djathtë;

- sinjali është i detyrueshëm në rrugët interurbane dhe mund të përdoret në qëndrat e banuara vetëm nëse kushtet e trafikut e këshillojnë përdorimin për motive sigurie (neni 107/1);

- sinjali duhet të vendoset, si rregull, në një largësi 150 m nga kryqëzimi. Në rrugët urbane me shpejtësi maksimale jo më të madhe se ajo e vendosur nga neni 140/1 i Kodit Rrugor (domethënë 40 km/orë në qendrat e banuara) largësia mund të reduktohet në lidhje me situatat dhe vendet (neni 79/7). Në rastet kur nuk është e mundur të respektohet largësia e pozicionimit, sinjali duhet të jetë i bashkëlidhur ma panelin model II.1 që tregon, largësinë efektive nga kryqëzimi (neni 82/3);

- për motive sigurie ose vëllimi të trafikut, sinjali KRYQËZIM "ME PËRPARËSI DJATHTAS" (**figura II 40**) mund të zëvendësohet nga sinjali JEP PËRPARËSI ose nga sinjali "NDALO DHE JEP PËRPARËSI" (**figura II 37**) (neni 105/1) (shih paragrafin Kryqëzime me sinjal dhënie përparësie dhe Kryqëzime me sinjal ndalo dhe jep përparësi në këtë kapitull).

Sinjalet horizontale (**Skema 80**):

- shiriti e ndarjes së drejtimeve të lëvizjes është i pandërprerë në afërsi të kryqëzimeve në nivel (neni 137/2b). Për të lejuar paralakimin e makinave në dalje të zonës së kryqëzimit, shiritit të pandërprerë i vihet në krah një i ndërprerë për një gjatësi jo më të vogël se 30 m (neni 137/4);

- në zonat e kryqëzimeve, me qëllim drejtimin e makinave në manovrimin sipas një trajektoreje të saktë, mund të vijëzohen shirita drejtimi.

Shiritat e drejtimit janë të kthyera, të ndërprera, me ngjyrë të bardhë, të tipit "e" (shih **Skemën 31** aneksi A) sipas nenit 136/3 (domethënë me shiritë 1m dhe me interval 1,5 m) (neni 141/1).

KRYQËZIM URBAN I RREGULLUAR ME SINJAL"JEP PËRPARËSI"

Në kryqëzime të veçanta, në vend të sinjalit "KRYQËZIM ME PËRPARËSI DJATHTAS" (**figura II 40**), që sinjalizon një kryqëzim ndërmjet dy ose më shumë rrugëve për të cilat vlen rregulli i përgjithshëm i përparësisë djathtas, mund të përdoret, për nevoja të sigurisë ose të vëllimit të trafikut, sinjali "JEP PËRPARËSI" (**figura II 36**), në shmangie të hierarkisë së rrugëve, me miratim të enteve pronare. Për këtë qëllim, për të garantuar pamje të kryqëzimit, duke ruajtur rregullat për largësitë e shikueshmërisë së sinjaleve, entet pronare mund:

- të ndalojnë vendosjen e kioskave, stacioneve të furnizimit, tabelave publicitare dhe pengesave të tjera të pamjes;

- të ndërhyjnë përmes zgjerimeve të mundshme, kositjes së barërave, prerjeve të shkurreve ose pemëve, ose, aty ku është e mundur, me eleminimin e mureve ose pengesave të tjera (neni 104/3).

Sinjalizimi në rrugë i cili nuk gëzon përparësi.

Sinjali vertikal (**Skemat 73** dhe **74** aneksi A):

- sinjali "JEP PËRPARËSI" (**figura II 36**) vendoset në hyrje të kryqëzimit dhe, gjithsesi, në distancë jo më të madhe se 25 m dhe 10 m, respektivisht brenda dhe jashtë qendrave të banuara nga fundi i karrexhatës së rrugës që ka përparësinë (neni 104/2). Atje ku sipërfaqja e rrugës e lejon, sinjali duhet të plotësohet me sinjalizimin horizontal (shih më poshtë) (neni 104/4).

- sinjali "PARALAJMËRIM PËR DHËNIE PËRPARËSIE" (**figura II 38**) duhet të vendoset në pjesën afër hyrjes në një rrugë me përparësi e cila ka kufij shpejtësie më të madhe se ajo e vendosura në nenin 140/1 të Kodit Rrugor (domethënë 40 Km/h në qëndrat e banuara) ose kur kushtet e trafikut e këshillojnë përdorimin për motive sigurie ose disiplinimi të qarkullimit (neni 106/1). Largësia ndërmjet sinjalit të paralajmërimit dhe shiritit të ndalimit vendoset në panelin plotësues të vendosur sipër vetë sinjalit (neni 106/3); në vend të këtij sinjali mund të përdoret sinjali PARALAJMËRIM KRYQËZIMI (neni 106/2) i plotësuar me sinjale të përparësisë, në të cilët paraqitet konfiguracioni topografik i kryqëzimit.

Sinjalet horizontale (**Skemat 73** dhe **74**):

- për rrugët pa ishuj shpëtimi ose ishuj trafikndarës, shiritat e ndalimit duhet të jetë bashkuar me shiritën gjatësore të vazhduar për një gjatësi jo më të vogël se 25 m dhe 10 m përkatësisht brenda dhe jashtë qendrave të banuara. (neni 142/3);

- shiriti i ndalimit është e përbërë nga një numër trekëndëshash të bardhë me kulm drejtuar nga drejtuesi i mjetit. Këta trekëndësha kanë një bazë të përfshirë ndërmjet 40 dhe 60 cm dhe lartësi të përfshirë ndërmjet 60 dhe 70 cm (neni 142/4). figura II 433. Sugjerohet të ndahen trekëndëshat ndërmjet tyre me një largësi të barabartë me gjysmës e bazës, gjithsesi duke vepruar në mënyrë të tillë që të merret një numër i plotë trekëndëshash;

- shiriti i ndalimit mund të plotësohet me simbolin e një trekëndëshi në sipërfaqe; kufiri i sipërm i trekëndëshit duhet të jetë të paktën 2 m larg nga kulmet e trekëndëshave që përbëjnë shiritën e ndalimit (neni 146/9). Nëse shiritëzohet, ky simbol duhet të përsëritet për çdo korsi të sensit të lëvizjes të cilit i referohet sinjali JEP PËRPARËSI (**figura II 36**).

Sinjalizimi në rrugë që gëzon të drejtën e përparësisë

Sinjali vertikal:

- sinjali "KRYQËZIM ME TË DREJTË PËRPARËSIE" (**figura II 43/a÷e**) mund të përdoret ku shihet i nevojshëm (neni 110/1). Duhet të vendoset 150 m nga kryqëzimi ose, sipas situatës së vendeve, në një largësi më të vogël (neni 81/7), duke treguar, në këtë rast, në panelin modeel II.1 bashkëlidhur, largësinë efektive nga kryqëzimi (neni 82/3).

Sinjali horizontal:

- shiriti i ndarjes së senseve të lëvizjes është i pandërprerë në afërsi të kryqëzimeve në nivel (neni 137/2b) për një gjatësi jo më të vogël se 30 m.(neni 136/5) Për të lejuar parakalimin e makinave në dalje të zonës së kryqëzimit, shiritës së pandërprerë i shtohet përkrah një e ndërprerë (neni 137/4).

Sinjali horizontal në zonën e kryqëzimit

- Në zonat e kryqëzimeve, me qëllim drejtimin e makinave në manovra sipas një trajektoreje të caktuar, mund të vijëzohen me shirita të drejtimit; shiritat e drejtimit janë të kthyera, të ndërprera, me ngjyrë të bardhë, të tipit "g" (shih **Skemën 31**) sipas nenit 136/3 (domethënë me pjesë 1 m dhe interval 1,5 m) neni 141/1.

KRYQËZIM INTERURBAN I RREGULLUAR ME SINJAL "JEP PËRPARËSI"

Në kryqëzime të veçanta, në zëvendësim të sinjalit "KRYQËZIM ME PËRPARËSI NGA E DJATHTA" (**figura II 40**), që sinjalizon një kryqëzim ndërmjet dy ose më shumë rrugëve në të cilat vlen rregulli i përgjithshëm i përparësisë djathtas, mund të përdoret, për nevoja sigurie ose vëllimi trafiku, sinjali "JEP PËRPARËSI" (**figura II 36**), në shmangie të hierarkisë rrugore, me marrëveshje ndërmjet enteve pronare. Për këtë qëllim, për të garantuar shikueshmërinë e kryqëzimit, pa iu shmangur rregullave për largësitë e paralajmërimit të sinjaleve, entet pronare munden:

- të ndalojnë vendosjen e kioskave, stacioneve të furnizimit, tabelave publicitare, dhe pengesa të tjera për pamjen;

- të ndërhyjnë përmes zgjerimeve të mundshme, kositjes së barërave, prerje shkurresh ose pemësh dhe, ku është e mundur, prishjen e mureve ose pengesave të tjera (neni 104/3).

Sinjalizimi në rrugë që nuk gëzon përparësi

Sinjale vertikale (**Skema 75** aneksi A):

- sinjali "JEP PËRPARËSI" (**figura II 36**) vendoset në buzë të një kryqëzimi, në një largësi nga kufiri i rrugës së automjeteve që gëzojnë të drejtën e përparësisë, jo më të madhe se 25 m dhe 10m, respektivisht brenda qendrave të banuara (neni 104/2). Sinjali duhet të shoqërohet, aty ku sipërfaqja e rrugës e lejon, me një sinjal horizontal të parashikuar (neni 104/4);

- sinjali "PARALAJMËRIM PËR TË DHËNË PËRPARËSI" (**figura II 38**) duhet të vendoset në pjesën në afërsi të hyrjes në rrugën me përparësi (neni 106/1);

largësia ndërmjet sinjalit dhe shiritit të ndalimit jepet në panelin plotësues të vendosur mbi vetë sinjalin (neni 106/3); në vend të këtij sinjali mund të përdoret sinjali PARALAJMËRIM PËR KRYQËZIM (neni 106/2) plotësuar me sinjalet e përparësisë.

Sinjali horizontal (**Skema 75**):

- për rrugët pa ishuj shpëtimi ose ishuj trafikndarës, vija e ndalimit duhet të bashkohet me shiritin gjatësor të pandërprerë për një gjatësi jo më të vogël se 25 m dhe 10m përkatësisht brenda dhe jashtë qendrave të banuara (neni 142/3);

- shiriti i ndalimit është e përbërë nga një numër trekëndëshash të bardhë me majë të drejtuar nga drejtuesi i mjetit. Këta trekëndësha kanë një bazë të përfshirë ndërmjet 40 dhe 60 cm dhe lartësi të përfshirë ndërmjet 60 dhe 70 cm (neni142/4). Sugjerohet të ndahen trekendëshat ndërmjet tyre me një largësi të barabartë me gjysmën e madhësisë së bazës, gjithsesi duke vepruar në mënyrë të tillë që të ruhet një numër i plotë trekëndëshash;

- shiriti i ndalimit mund të plotësohet me simbolin e një trekëndëshi të vijëzuar në sipërfaqe; kufiri i sipërm i trekëndëshit duhet të jetë larg nga kulmet e trekëndëshave përbërës të vijës së ndalimit të paktën 2 m (neni 146/9). Nëse vijëzohet, ky simbol duhet të përsëritet për çdo korsi të sensit të lëvizjes të cilës i referohet sinjali JEP PËRPARËSI (**figura II 36**).

Sinjalizimi në rrugë i cili gëzon të drejtën e përparësisë

Sinjali vertikal:

- Sinjali KRYQËZIM ME TË DREJTË PËRPARËSIE (**figurat II 43/a÷e**) duhet të përdoret në rrugët interurbane dhe aty ku vlerësohet e nevojshme, në ato urbane (neni 110/1) dhe duhet të vendoset 150 m para kryqëzimit (neni 79/7). Në rastin në të cilin nuk është i mundur respektimi i kësaj largësie, sinjali duhet të plotësohet me një panel model II.1 tregues të largësisë efektive nga kryqëzimi. Për motive sigurie, sinjali mund të paraprihet nga një tjetër i njëjtë, por që duhet të tregojë gjithmonë largësinë nga kryqëzimi (neni 82/3).

Sinjali horizontal:

- shiriti i ndarjes së senseve të lëvizjes është i pandërprerë në afërsi të kryqëzimeve në nivel (neni 137/2b) për një gjatësi jo më të vogël se 30 m. Për të lejuar parakalimin e mjeteve në dalje të zonës së kryqëzimit, shiritit të pandërprerë i vihet përkrah një i ndërprerë (neni 137/4).

Sinjali horizontal në zonën e kryqëzimit

Në zonën e kryqëzimit, me qëllim drejtimin e mjeteve në manovra sipas një trajektoreje të saktë, mund të vijëzohen shiritat e drejtimit; shiritat e drejtimit janë të kthyera, të ndërprera, me ngjyrë të bardhë, të tipit "e" (shih **Skemën 31**) sipas nenit136/3 (domethënë me gjurmë 1m dhe interval 1,5 m) (neni 141/1).

KRYQËZIMI URBAN I RREGULLUAR ME SINJAL "NDALO DHE JEP PËRPARËSI"

Në kryqëzime të veçanta, aty ku nuk është i mundur garantimi i kushteve të shikueshmërisë sipas nenit 104/3, ose gjithsesi në situata të veçanta të rrezikshme, duhet të përdoret sinjali NDALO DHE JEP PËRPARËSI (**figura II 37**) në vend të sinjalit JEP PËRPARËSI (figura **II 36**) (neni 105/2).

Sinjalizimi në rrugë që nuk gëzon përparësi

Sinjalet vertikale (**Skemat 61** dhe **62** aneksi A):

- sinjali "NDALO DHE JEP PËRPARËSI" (**figura II 37**) vendoset në buzën e një kryqëzimi ose sa më afër tij (neni 105/4); gjithsesi në një largësi jo më të madhe se 10 m (neni 79/9); sinjali duhet të bashkohet me sinjalitikën horizontale të parashikuar (neni 105/3);

- sinjali "PARALAJMËRIM PËR NDALIM DHE DHËNIE PËRPARËSIE" (**figura II 39**) duhet të vendoset në pjesën e fillimit të hyrjes mbi një rrugë me përparësi e cila ka kufirin e shpejtësisë më të madhe se ajo e vendosur në nenin 140/1 të Kodit Rrugor (domethënë 40 Km/orë në qëndrat e banuara), ose kur kushtet e trafikut e këshillojnë përdorimin për motive sigurie ose disiplinimi të qarkullimit (neni 106/1). Largësia ndërmjet sinjalit të paralajmërimit dhe shiritës së ndalimit është përfshirë në panelin plotësues të vendosur sipër vetë sinjalit (neni 106/3) model II 1; në vend të këtij sinjali mund të përdoret sinjali i paralajmërimit të kryqëzimit (neni 106/2) i plotësuar me sinjalet e përparësisë.

Sinjalet horizontale (**Skemat 61** dhe **62**):

- për rrugët pa ishull shpëtimi ose ishujt trafikndarës, shiriti i ndalimit duhet të bashkohet me shiritin gjatësor të pandërprerë për një gjatësi jo më të vogël se 25m e 10 m (neni 142/3); përkatësisht jashtë dhe brenda qendrave të banuara.

- shiriti i ndalimit është një shirit i bardhë i pandërprerë me gjerësi minimale 50 cm (neni 142/1);

- shiriti i ndalimit duhet të plotësohet me mbishkrimin STOP në sipërfaqe; largësia minimale ndërmjet kufirit të sipërm të mbishkrimit dhe bordit të linjës së ndalimit duhet të përfshihet ndërmjet 1 dhe 3 m (neni 146/8) figura II 432. Mbishkrimi duhet të përsëritet për çdo korsi të sensit të lëvizjes së cilës i referohet sinjali NDALO DHE JEP PËRPARËSI (**figura II 37**).

Sinjalizimi në rrugë që gëzon të drejtën e përparësisë

Sinjali vertikal:

- sinjali "KRYQËZIM ME TË DREJTË PËRPARËSIE" (**figurat II 43/a÷e**) duhet të përdoret në rrugët interurbane dhe aty ku shihet i nevojshëm, në ato urbane, për të parasinjalizuar një kryqëzim me rrugë jo kryesore (neni 110/1); duhet të jetë i vendosur 150 m nga kryqëzimi ose, sipas situatës së vendeve, në një largësi më të vogël (neni 79/7), duke treguar në këtë rast me një panel të posaçëm model II 1, largësinë efektive nga kryqëzimi (neni 82/3).

Sinjali horizontal:

- shiriti i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes është i pandërprerë në afërsi të kryqëzimeve në nivel (neni 137/2b) për një gjatësi jo më të vogël se 30 m (neni 136/5). Për të lejuar parakalimin e makinave në dalje të zonës së kryqëzimit, shiritit të pandërprerë i vendoset përkrah një i ndërprerë (neni 137/4).

Sinjali horizontal në zonën e kryqëzimit

Në zonën e kryqëzimit, me qëllim drejtimin e mjeteve në manovra sipas drejtimit të saktë, mund të vijëzohen shirita drejtimi; shiritat e drejtimit janë me kthesa, të ndërprera, me ngjyrë të bardhë, të tipit "e" (shih **Skemën 31**) sipas nenit 136/3 (domethënë me gjurmë 1 m dhe interval 1,5 m) (neni 141/1).

KRYQËZIMI INTERURBAN I RREGULLUAR ME SINJALIN "NDALO DHE JEP PËRPARËSI"

Në kryqëzime të veçanta, ku nuk është i mundur garantimi i kushteve të shikueshmërisë sipas nenit 104/3, ose gjithsesi në situata të veçanta të rrezikut, duhet të përdoret sinjali "NDALO DHE JEP PËRPARËSI" (**figura II 37**) në vend të sinjalit "JEP PERPARËSI" (**figura II 36**) (neni 104/2) (**Skema 66**).

Sinjalizimi në rrugë që nuk gëzon përparësi

Sinjalet vertikale (**Skema 66** aneksi A):

- Sinjali "NDALO E JEP PËRPARËSI" (**figura II 37**) vendoset në buzën e kryqëzimit ose sa më afër tij (neni 105/4); gjithsesi në një largësi jo më të madhe se 25 m (neni 79/9). Sinjali duhet të jetë i bashkuar me sinjalitikën e parashikuar horizontale (shih më tutje) (neni 105/4);

- Sinjali "PARALAJMËRIM PËR TË NDALUAR DHE DHËNË PËRPARËSI" (**figura II 39**) duhet të vendoset në pjesën më të afërt të hyrjes së rugës me përparësi (neni 106/1);

- largësia ndërmjet sinjalit dhe shiritit të ndalimit është përfshirë në panelin plotësues të vendosur sipër vetë sinjalit (neni 106/3);

Në vend të këtij sinjali mund të përdoret sinjali PARALAJMËRIM KRYQËZIMI (neni 106/2) i plotësuar me sinjalin e përparësisë. Sinjalet horizontale (**Skema 66**):

- për rrugët pa ishull shpëtimi ose ishuj trafikndarës, shirita e ndalimit duhet të bashkohet me shiritin gjatësor të pandërprerë për një gjatësi jo më të vogël se 25 m dhe 10m jashtë dhe brenda qendrave të banuara (neni 142/3);

- shiriti i ndalimit është një shirit i bardhë e pandërprerë me gjerësi minimale 50 cm (neni 142/1);

- shiriti i ndalimit duhet të plotësohet me mbishkrimin STOP në sipërfaqe; largësia minimale ndërmjet kufirit të sipërm të mbishkrimit dhe bordit të linjës së ndalimit duhet të përfshihet ndërmjet 1 dhe 3 m (neni 146/8). Mbishkrimi duhet të përsëritet për çdo korsi të drejtimit të lëvizjes së cilës i referohet sinjali NDALO DHE JEP PËRPARËSI (**figura II 37**).

Sinjalizimi në rrugë që gëzon të drejtën e përparësisë

Sinjali vertikal:

- sinjali KRYQËZIM ME TË DREJTË PËRPARËSIE (**figurat II 43/a÷e**) duhet të përdoret gjithmonë (neni 110/1) dhe duhet të vendoset 150 m përpara kryqëzimit (neni 79/7).
Në rast se nuk është i mundur respektimi i kësaj largësie, sinjali duhet të plotësohet nga një panel i posaçëm tregues i largësisë efektive të kryqëzimit. Për motive sigurie, sinjali mund të paraprihet nga një tjetër i njëjtë që duhet të tregojë largësinë efektive nga kryqëzimi (neni 82/3).

Sinjali horizontal:

- shiriti i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes është i pandërprerë në afërsi të kryqëzimeve në nivel (neni 137/2b) për një gjatësi jo më të vogël se 30 m (neni 136/5).
Për të lejuar parakalimin e makinave në dalje të zonës së kryqëzimit, shiritit të pandërprerë i vendosen përkrah një i ndërprerë për një gjatësi jo më të vogël se 30 m (neni 137/4).

Sinjali horizontal në zonën e kryqëzimit

Në zonën e kryqëzimit, me qëllim drejtimin e mjeteve në manovra sipas drejtimit të saktë, mund të vijëzohen shirita drejtimi; shiritat e drejtimit janë me kthesa, të ndërprera, me ngjyrë të bardhë, të tipit "e" (shih **Skemën 31**) sipas nenit 136/3 (domethënë me gjurmë 1 m dhe interval 1,5 m) (neni 141/1).

KRYQËZIMI URBAN I RREGULLUAR ME SEMAFOR

Sinjali vertikal (**Skema 76** aneksi A):

Sinjali SEMAFOR (**figura II 31**) duhet të përdoret për të paralajmëruar një impiant semaforik (neni 97/1) nëse ekziston një situatë reale e rrezikshme, e paperceptueshme në kohën e duhur nga një drejtues mjeti që ndjek rregullat normale të kujdesit (neni 82/2).

Sinjali normalisht vendoset 150 m nga impianti semaforik; në rrugët urbane me shpejtësi maksimale jo më të madhe se ajo e vendosur në nenin 140/1 të Kodit Rrugor (domethënë 40 km/orë), largësia mund të reduktohet sipas situatës dhe vendeve (neni 79/7), duke treguar, në këtë rast, me një panel të posaçëm, largësinë efektive nga impianti (neni 82/3).

Vendosja

Pozicionimi i semaforit dhe qëllimi i tij jepet në **Skemat 35, 35/A dhe 30/A,30/B** (aneksi A). Për çdo rast nuk duhen ndryshuar përmasat e vendosjes pasi krijojnë çrregullime në pozicionimin e mjeteve dhe këmbësorëve.

Sinjalet horizontale (**Skemat** 77 dhe **78** aneksi A):

- vija e ndalimit është e përbërë nga një shirit i bardhë i pandërprerë me gjerësi minimale 50 cm (neni 142/1);

- në zonat e rigrupimit në afërsi të kryqëzimit, shiritat e ndarjes së korsive të lëvizjes duhet të jenë të pandërprera për një gjatësi minimale 30 m (neni 138/4);

- në prani të një rruge me një karrexhate me dy ose më shumë korsi për çdo drejtim lëvizje, me qëllim ndarjen e tyre, duhet të jenë të vijëzuara dy shirita të pandërprerë, përkrah njëri-tjetrit (neni 137/6a);

- vija e ndalimit duhet të jetë e vijëzuar me largësi 1 m nga vendkalimi i mundshëm i këmbësorëve (neni 142/5);

- vendkalimet e këmbësorëve janë realizuar në karrexhatë përmes shiritave të bardha pingul me aksin me gjatësi jo më të vogël se 2,5 m në rrugët urbane dytësore dhe atyre lokale (tipi E, F) dhe 4 m në rrugët e tjera; gjerësia e shiritave dhe e intervaleve është 50 cm (neni 143/1);
- në zonat e kryqëzimeve, me qëllim drejtimin e mjeteve në manovra sipas një trajektoreje të saktë, mund të shiritëzohen shirita drejtimi. Ato janë më të harkuara; të ndërprera, me ngjyrë të bardhë, të tipit "e" (shih **Skemën 31**) sipas nenit 137/3 (domethënë një gjurmë 1 m dhe interval 1,5 m) (neni 141/1).

KRYQËZIM I RREGULLUAR ME SHIRITA DREJTIMI

Sinjalet horizontale (**Skema 81** aneksi A):

- shiritat e drejtimit mund të jenë të vijëzuara në zonat e kryqëzimit për të drejtuar makinat në manovra sipas një trajektoreje të saktë;
- shiritat e drejtimit janë të harkuara, të ndërprera, të tipit "e" (shih **Skemën 31**) sipas tabelës së nenit 136/3 (domethënë me gjurmë 1 m dhe interval 1,5 m) (neni 141/1);
- gjerësia minimale e shiritave është 15 cm, për autostradat dhe në rrugët interurbane kryesore dhe 12 cm për gjithë rrugët e tjera (neni 136/1);
- vija e ndalimit, në rrugën që nuk gëzon të drejtën e përparësisë, duhet të jetë e shiritëzuar paralel me aksin e rrugës kryesore (neni 142/2).

KRYQËZIM I RREGULLUAR ME SINJAL PARALAJMËRIMI

Sinjalet vertikale (**Skema 88** aneksi A):

- në afërsi të një kryqëzimi të një rruge me një tjetër pa dalje përdoret sinjali "PARALAJMËRIM TË RRUGËS PA DALJE" (**figurat II 310** dhe **311**) dhe vendoset në afërsi të vendit të treguar (neni 133/1) (**Skema 87**);

- sinjali "RRUGË PA DALJE" (**figura II 309**) tregon që po kjo rrugë është pa dalje për mjetet (neni 133/7);

- simboli i rrugës pa dalje (i përbërë nga shiriti vetëm i kuq) mund të aplikohet edhe në sinjalet PARALAJMËRIM KRYQËZIMI ose PËRZGJEDHJE, interurbane (me fushë blu) dhe urbane (me fushë të bardhë), për të paralajmëruar një degëzim pa dalje në kryqëzim (neni 133/7).

KRYQËZIM URBAN I RREGULLUAR ME SINJAL "KTHESË MAJTAS"

Sinjali vertikal:

- sinjali "KTHESË GHYSËM DREJT NGA E MAJTA" ose "KTHESË E TËRTHORTË NGA E MAJTA" (**figura II 325** ose **326**) paralajmëron detyrimin e manovrave alternative për t'u kthyer majtas, kur në kryqëzimin e mëpasëm, mbizotëron ndalimi i kthimit majtas, duke bërë gati drejtuesin e mjetit për një kthesë të tipit gjysëmdrejt (**figura II 325**) (**Skema 63**) ose për një kthesë të tipit jodrejtëpërdrejtë (**figura II 326**) (**Skema 64**) (neni 133/16).

Sinjali duhet të vendoset në afërsi të zonës ku duhet të fillojë manovra (neni 133/1).

KRYQËZIM NË RRUGË I RREGULLUAR ME TË DREJTË PËRPARËSIE

Sinjalet vertikale:

- sinjali "E DREJTË PËRPARËSIE" (**figura II 44**) duhet të përdoret për të treguar se një pjesë rruge gëzon të drejtën e përparësisë (neni 111/1) dhe duhet të përsëritet pas çdo kryqëzimi (neni 102/2);

- sinjali mund të përsëritet në format më të vogël para dhe pas çdo kryqëzimi i bashkuar me panel plotësues **model II 7** (neni 111/2);

Modeli II 7 tregon, nëpërmjet një shiriti më të gjerë, ecurinë e rrugës, që gëzon përparësi në krahasim me të tjerat (neni 81/11) (**Skema 86** aneksi A);

- sinjali "KRYQËZIM ME TË DREJTË PËRPARËSIE" (**figura II 43/a**) duhet të përdoret në rrugët interurbane dhe, ku shihet e nevojshme, në ato urbane, me qëllim paralajmërimin e një kryqëzimi me një rrugë pa të drejtë përparësie (neni 110/1) (**Skema 84** aneksi A);

- sinjali parashikon dy variante nëse rruga pa të drejtë përparësie ndodhet vetëm djathtas (**figura II 43/b**) ose majtas (**figura II 43/c**) e mbiquajtur KRYQËZIM NE FORMË "T" (**Skemat 82** dhe **83** aneksi A) dhe dy variante të tjera të mbiquajtur KRYQËZIM nëse rruga pa të drejtë përparësie futet me korsi të shpejtësisë djathtas (**figura II 43/d**) ose majtas (**figura II 43/c**) (**Skema 85**) (neni 110/2);

- sinjali "KRYQËZIM ME TË DREJTË PËRPARËSIE" (**figurat 43/a÷c**) duhet të vendoset, si rregull, në distancë rreth 150 m nga kryqëzimi. Në rrugët urbane, me shpejtësi lëvizjeje jo më të madhe se 40 km/orë, distanca mund të zvogëlohet sipas situatës vendore (nenet 103/4 dhe 79/7).

- sinjali "FUND I TË DREJTËS SË PËRPARËSISE" (**figura II 42**) duhet të përdoret për të treguar se rruga nuk gëzon më të drejtën e përparësisë dhe mund të vendoset vetëm kur në rrugë është vendosur sinjali "E DREJTË PËRPARËSIE" (**figura II 44**) (neni 109/1);

- sinjali mund të përsëritet disa herë para pikës në të cilën mbaron përparësia kur kushtet e trafikut e këshillojnë përdorimin për motive sigurie (neni 109/2). Në këtë rast sinjali duhet të bashkohet me një panel të posaçëm (**model II 1**) tregues i largësisë nga pika ku mbaron përparësia (neni 109/4);

- në rrugët interurbane ose në ato urbane me kufi shpejtësie më të madhe se 40 km/orë, sinjali duhet të përsëritet të paktën një herë (neni 109/3).

Sinjalet në rrugë që nuk gëzojnë të drejtën e përparësisë

- Në rrugët jo kryesore duhet të vendosen sinjale që tregojnë detyrimin për të dhënë përparësi (neni 110/3)

KRYQËZIM I RREGULLUAR ME SHIGJETAT DREJTUESE

Me qëllim lejimin e përzgjedhjes dhe rigrupimin e mjeteve në afërsi të kryqëzimit (**Skema 72** aneksi A), korsitë e rezervuara për manovra të caktuara janë kundërshënuar me shigjeta drejtuese (neni 145/1). Vendosja e shigjetave në brendësi të korsive të lejuara dhe ato të ndaluara është dhënë në **Skemën 48** (aneksi A).

Shigjetat drejtuese mund të përdoren edhe për të sinjalizuar drejtimet e lejuara dhe ato të ndaluara (neni 145/4).

Sinjale treguese

Në kryqëzimin e **Skemës 79** (aneksi A) kriteret e informacionit për drejtuesit e mjeteve, të përdorura për sinjalet treguese ishin:

- lajmërimi para hyrjes në kryqëzim për vendet e arritshme përmes secilit degëzim;

- konfirmimi në kryqëzim për drejtimet që duhen zgjedhur për të arritur lokalitetin dhe vendin e treguar;

- konfirmimi pas kryqëzimit për vendet e arritshme (neni 122/6).

KRYQËZIM URBAN I RREGULLUAR ME SINJAL "PARALAJMËRIM KRYQËZIMI"

Sinjali i paralajmërimit të kryqëzimit:

- sinjali i paralajmërimit të kryqëzimit duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1);

- duhet të vendoset në një largësi nga kryqëzimi sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjale të paralajmërimit (neni 124/2);

- në sinjal përfshihen edhe simbole (neni 125/13).

Sinjali i drejtimit:

- sinjali vendoset në buzë të kryqëzimit (neni 126/4);

- emrat e qendrave që jepen në sinjalet e drejtimit janë të njëjtë me ato që jepen në sinjalet e paralajmërimit (neni 126/4);

- sinjalet e drejtimit mund të rigrupohen në një "grup të vetëm sinjalizues" në të cilin respektohen kriteret e mëposhtme (neni 126/8):

a) të gjithë sinjalet e vendosura në të njëjtin grup duhet të kenë të njëjtat përmasa, pavarësisht nga gjatësia e emrave të shkruara në to.

b) shigjetat që tregojnë "drejt" duhet të vendosen sipër të tjerave. Nëse grupi është i vendosur në të majtë, shigjeta vertikale duhet të vendoset në anën e djathtë të sinjalit.

c) ndërmjet dy grupeve të sinjaleve që tregojnë drejtime të ndryshme, të vendosura në të njëjtën mbështetëse duhet të ketë një shkëputje prej 5 cm.

ç) në çdo grup sinjalizimi, sinjalet duhet të grupohen sipas ngjyrës së fushës.

d) shigjetat që tregojnë "majtas" duhet të vendosen poshtë shigjetave që tregojnë "drejt" dhe në fund poshtë vendosen shigjetat që tregojnë "djathtas"

dh) radha e vendosjes së sinjaleve, që tregojnë të njëjtin drejtim, nga lart poshtë, bëhet në bazë të ngjyrave të fushës: e bardhë – e gjelbërt – blu – kafe – e zezë.

e) çdo grup nuk duhet të përmbajë më shumë se gjashtë sinjale.

ë) grupet më të vogla, me shigjeta të vendosura drejt të njëjtit drejtim, duhet të vendosen në vëndet më të përshtatshme të kryqëzimit.

f) sinjalet e grupeve sinjalizuese në rrugët interurbane, duhet të jenë në formë shigjete, ndërsa në rrugët urbane duhet të jenë në formë drejtkëndëshe, me shigjetë të vendosur në të.

Sinjali i pohimit:

- sinjali i pohimit përdoret në dalje nga kryqëzimet komplekse, në dalje nga qëndrat administrative kryesore (neni 130/1);

- sinjali vendoset përgjatë itinerarit në vendet më të përshtatshme për të shmangur gabimet në rast mosvëmëndjeje ose shikueshmëri të ulët (neni 130/2);

- sinjali i pohimit realizohet duke bashkuar simbolet e **figurave II 100** dhe **115** me shigjetën vertikale (**figura II 287**) (neni 130/7);

- në zonat urbane funksioni i konfirmimit mund të zgjidhet edhe nga sinjali i drejtimit me shigjeta të orientuara lart (neni 130/5).

Sinjali i përparësisë

Për sinjalin e përparësisë horizontale dhe vertikale shih paragrafin kryqëzime urbane me sinjalin NDALO DHE JEP PËRPARËSI në këtë kapitull.

KRYQËZIMI INTERURBAN I RREGULLUR ME SINJALIN "PARALAJMËRIM KRYQËZIMI"

Sinjale treguese

Në kryqëzimin e **Skemës 65** (aneksi A) kriteret e informacionit për drejtuesit e mjeteve, të përdorura për sinjalitikën treguese ishin:

- të lajmëronte përpara kryqëzimit për vendet e arritshme përmes secilit degëzim;

- konfirmimin në kryqëzim për drejtimet që duhen zgjedhur për të arritur qendrat dhe vendet e treguara;

- konfirmimi pas kryqëzimit për vendmbërritjen në të cilat të çojnë rrugët përkatëse(neni 122/6).

Sinjali i paralajmërimit të kryqëzimit:

- sinjali i paralajmërimit të kryqëzimit duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1);

- sinjali duhet të vendoset në një largësi nga kryqëzimi sipas vlerave të shprehura në **tabelën 3** të kapitullit Sinjale të paralajmërimit (neni 124/2);

- në sinjal është përfshirë një simbol (neni 125/13).

Sinjali i paralajmërimit mund të plotësohet me sinjalin "PARALAJMERIM DHE DHENIE PERPARESIE" (neni 106/2).

Sinjali i drejtimit:

- sinjali është vendosur në buzë të kryqëzimit (neni 124/6);

- emrat e qendrave që jepen në sinjalet e drejtimit janë të njëjtë me ato që jepen në sinjalet e paralajmërimit (neni 124/4);

- sinjalet e drejtimit rigrupohen në një "grup sinjalesh të përbashkët" në të cilin respektohen në veçanti kriteret:

a) të gjithë sinjalet e vendosura në të njëjtin grup duhet të kenë të njëjtat përmasa, pavarësisht nga gjatësia e emrave të shkruara në to.

b) shigjetat që tregojnë "drejt" duhet të vendosen sipër të tjerave. Nëse grupi është i vendosur në të majtë, shigjeta vertikale duhet të vendoset në anën e djathtë të sinjalit. (neni 128/ a / b)

Sinjali i pohimit:

- sinjali i pohimi është vendosur në dalje nga kryqëzimi (neni 130/1);

Sinjali i përparësisë

Për sinjalet e përparësisë horizontale dhe vertikale rekomandohet paragrafi kryqëzim urban me sinjalin JEP PËRPARËSI në këtë kapitull.

KRYQËZIMI URBAN I RREGULLUAR ME SINJALIN E PËRZGJEDHJES

Sinjali tregues

Në kryqëzimin e **Skemës 67** (aneksi A) kriteret e informacionit për drejtuesit e mjeteve, të përdorura për sinjale tregues janë:

- të lajmërojë përpara kryqëzimit për vendet e arritshme përmes secilit degëzim;

- konfirmimin në kryqëzim për drejtimet që duhen zgjedhur për të arritur qendrat dhe vendet e treguara;

- konfirmimin pas kryqëzimit për vendet e arritshme (neni 122/6).

Sinjali i përzgjedhjes:

- sinjali i përzgjedhjes duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1);

Kur rruga është e ndarë në dy ose më shumë korsi për të njëjtin drejtim të lëvizjes, por me vendmbërritje të ndryshme, për të lejuar zgjedhjen paraprake të pozicionit në rrugën e automjeteve

në raport me drejtimet që drejtuesit e mjeteve duan të marrin në kryqëzim, në vend të sinjalit të paralajmërimit të kryqëzimit duhet të përdoret sinjali i përzgjedhjes (neni 125/8);

Sinjali i drejtimit:

- sinjali është vendosur në pjesën ballore të hyrjes në kryqëzim (neni 124/6);

- emrat e qendrave që jepen në sinjalet e drejtimit janë të njëjtë me ato që jepen në sinjalet e përzgjedhjes (neni 126/4);

- sinjalet e drejtimit rigrupohen në një "grup sinjalesh të përbashkët" në të cilin respektohen në veçanti kriteret:

- të gjithë sinjalet kanë të njëjtat përmasa (neni 126/8a);
- shigjetat "majtas" janë vendosur sipër shigjetave "djathtas" (neni 126/8d);
- sinjalet me sfond të bardhë janë vendosur sipër atyre me sfond blu (neni 126/8dh).

Sinjali i pohimit:

- sinjali i pohimit mund të përdoret në dalje nga qendrat e banuara kryesore ose pas kryqëzimeve komplekse (neni 130/1);

- ky sinjal vendoset përgjatë itinerarit në vendet më të përshtatshme për të shmangur gabimet në rast mosvëmëndjeje ose shikueshmëri të ulët (neni 130/2);

- në degëzimin majtas të kryqëzimit sinjali i konfirmimit realizohet duke bashkuar simbolet e **figurave II 100** dhe **112** me shigjetën vertikale (**figura II 288**) (neni 130/7);

- në degëzimin majtas të kryqëzimit funksioni i sinjalit të konfirmimit mund të zgjidhet nga sinjali i drejtimit me shigjetë të drejtuar lart (neni 130/5).

Sinjali horizontal

Në rrugët që kanë një numër të mjaftueshëm korsish për të lejuar përzgjedhjen, në aferisi të kryqëzimeve, korsitë që rezervohen për manovrime të përcaktuara duhet të jetë shenjuar me shigjeta drejtuese me ngjyrë të bardhë (neni 145/1);
Pozicioni i shigjetave në brendësi të korsisë jepet në **Skemën 48**.

Sinjali i përparësisë

Për sinjaliet e përparësisë horizontale dhe vertikale rekomandohet paragrafi kryqëzime urbane me sinjalin NDALO DHE JEP PËRPARËSI në këtë kapitull.

KRYQËZIM INTERURBAN I RREGULLUAR ME SINJALIN E PËRZGJEDHJES

Sinjali tregues

Në kryqëzimin e **Skemës 68** (aneksi A) kriteret e informacionit për drejtuesit e mjeteve të përdorura për sinjalet drejtuese janë:

- të lajmërojë përpara kryqëzimit për vendet e arritshme përmes secilit degëzim;

- konfirmimin në kryqëzim për drejtimet që duhen zgjedhur për të arritur qendrat e banuara dhe vendet e treguara;

- konfirmimin pas kryqëzimit për vendet e arritshme (neni 122/6).

Sinjali i përzgjedhjes:

- sinjali i përzgjedhjes duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1);

- kur rruga është e ndarë në dy ose më shumë korsi për të njëjtin drejtim të lëvizjes, por me vendmbërritje të ndryshme, për të lejuar zgjedhjen e parashikuar nga vendi në karrexhatë në raport me drejtimet që drejtuesit e mjeteve duan të marrin, në vend të sinjalit të paralajmërimit të kryqëzimit duhet të përdoret sinjali i përzgjedhjes (neni 125/8);

- sinjali duhet të vendoset në përputhje me fillimin e zonës së përzgjedhjes që i paraprin kryqëzimit (neni 124/5);

- nëse nuk është e mundur respektimi i hapësirës së paralajmërimit sinjali duhet të përsëritet më përpara dhe largësia të jepet në panelin plotësues (neni 124/5).

Sinjali i drejtimit:

- sinjali vendoset në kufirin e daljes nga kryqëzimi (neni 124/6);

- emrat e qendrave të banuara që jepen në sinjalet e drejtimit, janë të njëjtë me ato që jepen në sinjalet e paralajmërimit (neni 126/4);

- sinjalet e drejtimit rigrupohen në një "grup sinjalitik të përbashkët" në të cilin respektohen në veçanti kriteret:

  - të gjithë sinjalet kanë të njëjtat përmasa; (neni 126/8a).
  - shigjetat "majtas" janë vendosur sipër shigjetave "djathtas" (neni 126/8d).

Sinjali i pohimit:

Sinjali i konfirmimit mund të përdoret në dalje nga qendrat e banuara kryesore ose pas kryqëzimeve komplekse (neni 130/1);
Ky sinjal vendoset përgjatë itinerarit në vendet më të përshtatshme për të shmangur gabimet në rast mosvëmëndjeje ose shikueshmëri të ulët (neni 130/2);

Në sinjalet e konfirmimit shkruhen disa emra qendrash, së bashku me largësitë përkatëse në kilometra, në radhën në të cilën ato arrihen përgjatë itinerarit (neni 132/4).

Sinjalet horizontale

Në rrugët që kanë një numër të mjaftueshëm korsish për të lejuar përzgjedhjen, në afërsi të kryqëzimeve, korsitë që rezervohen për manovrime të përcaktuara duhet të jetë të shenjuara me shigjeta drejtuese me ngjyrë të bardhë (neni 145/1);
Pozicioni i shigjetave në brendësi të korsisë jepet në **Skemën 48**.

KRYQËZIM URBAN I RREGULLUAR ME SINJAL KORSIE ME FUNKSION PËRZGJEDHJE

Sinjali tregues

Në kryqëzimin e **Skemës 69** (aneksi A) kriteret e informacionit për drejtuesin e mjeteve, të përdorura për sinjalet drejtuese janë:

- lajmërimi përpara kryqëzimit për vendet dhe qendrat e arritshme përmes secilit degëzim dhe të realizojë një drejtim të përshtatshëm të rrymës së mjeteve;

- konfirmimin në kryqëzim për drejtimet që duhen zgjedhur për të arritur qendrat dhe vendet e treguara;

- konfirmimin pas kryqëzimit për vendet e arritshme (neni 122/6).

Sinjali i përzgjedhjes:

- sinjali i përzgjedhjes duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1);

- kur rruga është e ndarë në dy ose më shumë korsi për të njëjtin drejtim të lëvizjes, por me vendmbërritje të ndryshme, për të lejuar zgjedhjen e parashikuar nga vendi në karrexhatë në raport me drejtimet që drejtuesit e mjeteve duan të marrin, në vend të sinjalit të paralajmërimit të kryqëzimit duhet të përdoret sinjali i përzgjedhjes (neni 125/8);

KRYQËZIMI INTERURBAN I RREGULLUAR ME SINJAL KORSIE ME FUNKSION PËRZGJEDHJE DHE DREJTIMI

Sinjalet horizontale

Në rrugët që kanë një numër të mjaftueshëm korsish për të lejuar përzgjedhjen, në aferisi të kryqëzimeve, korsitë që rezervohen për manovrime të përcaktuara duhet të jenë të shenjuara me shigjeta drejtuese me ngjyrë të bardhë (neni 145/1); Pozicioni i shigjetave në brendësi të korsisë jepet me **Skemën 48**.

Sinjali tregues

Në kryqëzimin e **Skemës 70** (aneksi A), kriteret e informacionit për drejtuesit e mjeteve, të përdorura për sinjalet drejtuese janë:

- të lajmërojë përpara kryqëzimit për vendet dhe qendrat e arritshme përmes secilës korsi;
- të konfirmojë në fund të korsisë së ngadalësimit drejtimet për t'u marrë për të arritur qendrat dhe vendet e treguara;
- konfirmimi pas kryqëzimit për vendet e arritshëm (neni 122/6).
- Sinjalet e përzgjedhjes dhe drejtimit janë vendosur sipër karrexhatës; marrin kështu funksionin e sinjalit të korsisë dhe duhet të jenë konform skemave të vendosjes të dhëna në **tabelën 20** (neni 125/5 dhe 126/3).
- Sinjali i korsisë me funksion përzgjedhjeje dhe drejtimi me vendosje tip "portali":
- grupi sinjaleve përbëhet nga dy sinjale të korsisë me funksion përzgjedhje dhe një me funksion drejtimi të montuara në një suport të vetëm;
- grupi sinjaleve duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1);
- sinjali duhet të vendoset në përputhje me fillimin e zonës së përzgjedhjes (neni 124/5);
- shigjeta që përdoret në sinjalin e korsisë me funksion drejtimi është, në këtë rast, sipas modelit të dhënë në **Skemën 22**.
- Sinjali i korsisë me funksion drejtimi me vendosje tip "flamur":
- drejtimi i daljes përsëritet në kufirin e korsisë së ngadalësimit me një sinjal korsie me montim tip "flamur":

- shigjeta që përdoret është ajo e modelit të **Skemës 22, rasti b**.
- Sinjali i pohimit:
- sinjali i pohimit mund të përdoret në dalje nga qendrat kryesore ose pas kryqëzimeve komplekse (neni 130/1);
- ky sinjal vendoset përgjatë itinerarit në vendet më të përshtatshme për të shmangur gabimet në rast mosvëmëndjeje ose shikueshmëri të ulët (neni 130/2);
- sinjali i konfirmimit për "qendër" është realizuar duke bashkuar simbolin e **figurës II 100** me shigjetën vertikale (**figura II 287**) (neni 130/7);

KRYQËZIMI URBAN I RREGULLUAR ME SINJALE KORSIE ME FUNKSION PËRZGJEDHJE DHE DREJTIMI

Sinjali tregues

Në kryqëzimin e **Skemës 71** (aneksi A) kriteret e informacionit, për drejtuesit e mjeteve, të përdorura për sinjalet drejtuese janë:

- të lajmërojë përpara kryqëzimit për vendet dhe qendrat e arritshme përmes secilit degëzim e realizuar një përzgjedhjes të përshtatshëm të rrymës së mjeteve;

- konfirmimi në kryqëzim për drejtimet që duhen zgjedhur për të arritur qendrat dhe vendet e treguara, përmes secilës korsi;

- konfirmimi pas kryqëzimit, për vendet e arritshme (neni 122/6).

Sinjalet e përzgjedhjes dhe drejtimit janë vendosur sipër karrexhatës; marrin kështu funksionin e sinjalit të korsisë dhe duhet të jenë konform skemave të vendosjes të dhëna në **tabelën 20** (neni 125/5 dhe 126/3).

Sinjali i korsisë me funksion përzgjedhje dhe drejtimi me vendosje tip "portal":

- impianti sinjaleve duhet të sigurojë një hapësirë pamjeje sipas vlerave të shprehura në **tabelën 2** të kapitullit Sinjalet e paralajmërimit (neni 124/1) dhe duhet të vendoset në përputhje me fillimin e zonës së përzgjedhur (neni 124/5);

- shigjeta që përdoret në sinjalin e korsisë me funksion drejtimi është, në këtë rast, sipas modelit të dhënë në **Skemën 22, rasti a**.

Sinjali i korsisë me funksion drejtimi me vendosje tip "portal"

- kompleksi sinjaleve është vendosur në buzën e kryqëzimit (neni 124/6).

Sinjali pohues:

- sinjali i pohimit mund të përdoret në dalje nga qendrat kryesore ose pas kryqëzimeve komplekse (neni 130/1);

- ky sinjal vendoset përgjatë itinerarit në vendet më të përshtatshme për të shmangur gabimet gjatë rrugës në rast hutimi ose shikueshmërie të ulët (neni 130/2);

- sinjali i pohimit për "qendër" është realizuar duke bashkuar simbolin e **figurës II 100** me shigjetën vertikale (**figura II 287**) (neni 130/7);

- sinjali i pohimit për "autostradë" përputhet me sinjalin e identifikimit të rrugës, të kombinuar me shigjetën vertikale me drejtim lart (**figura II 286**) (neni 130/6);

- funksioni i pohimit për rrjetin qytetës mund të kryhet nga sinjalet e drejtimit me shigjeta të drejtuara lart (neni 130/5).

Sinjalet horizontale

- në rrugët që kanë një numër të mjaftueshëm korsish për të lejuar përzgjedhjen, në afërsi të kryqëzimeve, korsitë që rezervohen për manovrime të përcaktuara duhet të jenë të kundërshenjuara me shigjeta drejtuese me ngjyrë të bardhë (neni 145/1);

- vendosja e shigjetave në brendësi të korsisë jepet në **Skemën 48**.

Ishujt trafikndarës, shpëtues dhe të trafikut

- ISHULL SHPËTUES: pjesë e rrugës, e ngritur, ose e kufizuar dhe e mbrojtur, e destinuar për mbrojtjen dhe qëndrimin e këmbësorëve në vendkalimet e tyre ose në ndalesa të transportit publik të linjës.

- ISHULL TRAFIKU: pjesë e rrugës, e kufizuar në mënyrë të përshtatshme dhe e pakshkelshme, e destinuar për ndarjen dhe drejtimin e trafikut.

- ISHULL TRAFIKNDARËS: pjesë gjatësore e rrugës, e pakalueshme për mjetet, që shërben për ndarjen e rrymave të mjeteve

- ISHULLI UDHËZUES: shih ISHULL TRAFIKU.

Mënyra e realizimit të ishujve të trafikut

Në çdo rast u shërbejnë edhe vendkalimeve të këmbësorëve (neni 174).

Ishujt e trafikut (**Skema 47** aneksi A) mund të realizohen në mënyrat e mëposhtme (neni 174/1):

- *ishuj të rrafshtë*: realizohen me bojë të bardhë ose me gozhdë me kokë të gjerë ose me hemisfera. Këto të fundit duhet të kenë një profil të shtypur me diametër të ndryshueshëm ndërmjet 30 dhe 50 cm dhe duhet të jenë me ngjyrë të bardhë;

- *ishuj të kufizuar nga elementë vertikalë*: janë realizuar me toptha, sfera, birila, kone ose pajisje të njëjta, të vendosura përgjatë perimetrit të bankinës. Largësia ndërmjet një elementi dhe një tjetri duhet të jetë e tillë që të nxjerrë në dukje mirë konturet e ishullit;

- *ishuj të përhershëm*: mund të realizohen nëpërmjet derdhjeve prej betoni ose përmes një rrethimi betoni, gurësh të prerë, apo materiale të tjera, dhe me sistemim të brendshëm me gjelbërim.

Kur në ishull është edhe një vendkalim këmbësorësh dhe përbën zonë strehimi, ai duhet të ndërpritet për një gjerësi të njëjtë me atë të kalimit të këmbësorëve, për t'u lejuar atyre kalimin e kryqëzimit në nivel.

Zona e kufizuar nga perimetri i ishullit është e ndaluar për qarkullimin e të gjitha mjeteve, por mund të jetë e hapur për këmbësorët si shpëtues për kalimin e rrugës, për sa kohë ai është i hapur për ta (neni 176/2).

Sistemi kalimit në nivel duhet të praktikohet gjatë kohës së eksperimentimit të ishullit të trafikut (neni 174/3).

Elementë të parafabrikuar për shpëtuese këmbësorësh
(neni 176)

Janë realizuar përgjithësisht me beton dhe të prodhuar nga seksione të montueshëme nëpërmjet inkastrimeve të posaçme.
Duhet të zbatohen vetëm në zonat urbane për krijimin e ishujve për strehimin e këmbësorëve ose për platforma ngarkimi (neni 176/1).

Parasinjalizimi i ishujve të trafikut
(neni 148)

Ishujt e trafikut rrafsh me rrugën dhe trekëndëshat e ngritur të parasinjalizimit të ishujve të trafikut, duhet të jenë të evidentuar përmes shiritave të bardha të pjerrëta (tip zebre) të vendosura brenda shiritave të rakordimit, për kanalizimin e mjeteve ose ndërmjet këtyre dhe anës së karrexhatës, siç tregohet në **tabelat 47** dhe **89** (neni 148/1).

Shiritat e lidhjes realizohen siç shpjegohet në kapitullin përkatës të sinjaleve horizontale.

Shiritat tip zebre duhet të jenë: (neni 148/2) (**Skemat 47** ; **89** aneksi A)

- të bardha,
- të pjerrëta, të paktën 45 gradë në krahasim me korsinë, me pjerrësi në drejtim të lëvizjes;
- me gjerësi jo më të vogël se 30 cm;
- të ndërprera nga hapësira me gjerësi të paktën sa dyfishi i asaj të shiritave.

Në zonat me shirita të bardha të pjerrëta, mund të përdoren një numër elementësh paralel me profil lehtësisht të ngritur nga sipërfaqja e rrugës dhe të vendosura sipas drejtimit të shiritave (neni 175/2). Karakteristikat e këtyre elementëve janë dhënë në paragrafin e mëposhtëm.
Shiritat e lidhjes janë të bardha (neni 148/3).
Në zonat e sinjalizuara është i ndaluar pushimi (neni 148/3).

Sinjalizimi i ishujve të trafikut dhe shpëtues
(neni 175)

Afrimi i një ishulli të trafikut duhet të jetë i sinjalizuar me një shirit të bardhë të vazhdueshme me një gjatësi të mjaftueshme dhe nga një zonë me shirita të bardha të pjerrëta tip zebre e realizuar siç shpjegohet në paragrafin e mësipërm (neni 175/1).

Në zonat me shirita tip zebre mund të zbatohen një seri elementësh paralel me profil lehtësisht të ngritur nga plani i rrugës dhe të vendosur sipas pjerrësisë së zonës zebër (neni 175/2).

Elementët, me kënde mundësisht të rrumbullakosur, nuk duhet të ngrihen më shumë se 5 cm dhe duhet të jenë me ngjyrë të bardhë.

Largësia ndërmjet dy elementëve të njëpasnjëshëm duhet të jetë maksimalisht 2 m (neni 175/3).

Buzët e ishujve të trafikut dhe të sigurimit mund të bëhen më të dukshme duke i shiritëzuar vertikalisht me shirita të verdhë reflektues dhe të zinj, siç jepet në **Skemën 90** (neni 175/4).

Pjesa e ballore e ishujve të trafikut duhet të sinjalizohet nëpërmjet një sistemi me drita reflektuese me ngjyrë të verdhë ose me një varg dritash të verdha, karakteristikat e të cilave janë dhënë në paragrafin që i përket sinjaleve me ndriçim (neni 175/5).

Sistemi me drita reflektuese (shih **Skemën 91**), të quajtura shmangës të veçantë të pengesave, kanë karakteristikat e mëposhtëme (neni 175/6):

- kanë seksione gjysëmrrethore;
- kanë një shtrirje minimale 40 cm për çdo 50 cm lartësi;
- duhet të jenë plotësisht reflektues;
- nëse përdoren në vend të kolonëzave ndriçuese ose në kombinim me to, janë me ngjyrë të verdhë.

Për sinjalet vertikale shihni paragrafin e këtij kapitulli dedikuar sinjalizimit vertikal.

Sinjalet e ndritshme

Kolonëzat ndriçuese (neni 168/5) me drita të verdha duhet të kenë një lartësi jo më të vogël se 1 m dhe duhet të përdoren vetëm për të treguar praninë e:

- ishujt e shpëtimit;
- ishujt trafikndarës;
- ishujt e trafikut.

Ato mund të plotësohen me:

- dritat semaforike të verdha pulsuese;
- aplikime me reflektuese.

Perimetri i balleve të ishujve shpëtues, të bankinave të orientimit, ishujve të trafikut dhe tjerë të njëjta me to, mund të sinjalizohet edhe me: (neni 168/9)

- sisteme me dritën e tyre të verdhë;
- sisteme me dritë të verdhë reflektuese.

Të dyja aplikohen në pjesën vertikale të bordurës rrethore.

Në dritat pulsuese, frekuenca e ciklit duhet të jetë jo më e vogël se 50 herë në minutë dhe jo më e madhe se 80.

Frekuenca e NDEZJES dhe të SHUARJES duhet të kenë kohëzgjatje të barabartë. (neni 169).

Sinjalet vertikale

Kur sinjalizohet pjesa e sipërme e ishullit të trafikut, shmangësi i veçantë i pengesës, për të cilin flitet në paragrafin përkatës të këtij kapitulli, duhet të jetë i shoqëruar me sinjalet treguese të kalimit të detyrueshëm ose të lejueshëm të cilët janë dhënë në **figurat II 82/a, b** dhe **83** (neni 175/7).

Sinjalet KALIM I DETYRUAR (**figura II 82/a** dhe **b**) tregojnë detyrimin e kalimit djathtas ose majtas ishullit (neni 120/4).

Sinjali KALIM I LEJUAR (**figura II 83**) lejon kalimin e pengesës qoftë djathtas, qoftë majtas (neni 120/4).

Sinjalet e **figurës II 82/a,b** dhe **83** vendosen në pjesën e sipërme (kokës) të ishullit në mënyrë që të jenë të dukshme dhe të bëjnë të qartë treguesin e kalimit të detyruar ose të lejuar (neni 120/5).

Në rastet në të cilat trafikndarësi ka gjerësinë më të madhe se 1,5 m, sinjalet mund të plotësohen nga sinjali NDALIM KALIMI i **figurës II 47** i vendosur në anën e kundërt të pjesës së sipërme të vetë trafikndarësit (neni 120/5).

Trafikndarësi

Bëhen dy shirita të bardha të vazhdueshme përkrah njëra-tjetrës, në rastin e trafikndarësit të realizuar pa elementë të parafabrikuar, në mënyrë që të ndajnë, për siguri, dy drejtimet e lëvizjes.

Në rastet kur hapsira ndërmjet dy shiritave i kalon 50 cm, kjo hapsire duhet të evidentohet me shirita të bardha tip zebre (neni 137/6ç).

Nëse realizohet me elementë të përgatitur, qoftë për mënyrën e realizimit, qoftë për sinjalizimin horizontal dhe vertikal, referojuni paragrafeve të mësipërme mbi ishujt.

Sinjalet e pengesave

Pengesat, anomalitë dhe pikat kritike rrugore, atje ku nuk janë të eliminueshme, duhet të jenë të sinjalizuara në të gjitha rastet në të cilat shihet e nevojshme rritja e shikueshmërisë, veçanërisht në orët e mbrëmjes (neni 173/1).

Pengesat, që gjenden brenda ose afër rrugës, të cilat sjellin ngushtim të hapësirës ose rrezik për qarkullimin, duhet të jenë të sinjalizuara përmes shiritave të alternuara të shiritëzuara mbi pengesë, të bardha reflektuese dhe të zeza (shih **Skemat 102** dhe **110** aneksi A).
Duhet të jenë të pjerrëta me 45 gradë me drejtim poshtë në bazë drejt krahut në të cilin mjetet lëvizin. Mund të realizohen edhe mbi një sipërfaqe më vete e larg nga zona e rrezikut (neni 173/2).

Kur pengesa është e lokalizuar në brendësi të rrugës (neni 148) shiritëzohet trekëndëshi i sinjalizimit, i evidentuar me shirita të bardha të pjerrëta si në rastin e ishullit të trafikut (shih **Skemat 47** dhe **89** aneksi A, të paragrafit që i përket ishujve).

Nëse është e paqartë se nga cili krah duhet kaluar atëherë vendosen sinjalet urdhëruese të kalimit të detyruar ose të lejuar të **figurës II 82** ose **83** (neni 175/3).

Buzët e trotuarit (neni 173/5) mund të bëhen më të dukshme përmes aplikimit të shiritave alternativë me ngjyra të kundërta (e bardhë dhe e zezë ose, nëse është i ndaluar pushimi, me shirita të alternuara me ngyrë të verdhë dhe të zezë siç jepet në **Skemën 114**).

KALIMI NË NIVEL

Vendalimet hekurudhore nga pika e vështrimit të sinjaleve, ndahen në katër kategori:

1. Kalim në nivel me barriera;
2. Kalim në nivel me gjysëmbarriera;
3. Kalim në nivel pa barriera;
4. Linja hekurudhore lidhëse.

Të përgjithshme

Detyrime të përbashkëta për të gjitha tipet e kalimeve në nivel:

- Shiriti i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes në afërsi të një vendkalimi të çfardoshëm hekurudhor në nivel, me barriera ose pa barriera, duhet të jetë i pandërprerë dhe jo më pak se 30 m (neni 137/2dh dhe 136/5).
- Në afërsi të një kalimi të çfarëdoshëm në nivel, sipërfaqja rrugore duhet të jetë e shiritëzuar dhe në përbërje të sinjaleve vertikale, në çdo korsi në afërsi të kalimit, duhet të vendoset një KRYQ I SHËN ANDREAS me shkronjat PL brënda tij. Ngjyra që duhet përdorur është e bardhë dhe përmasat janë dhënë në **Skemën 92** (aneksi A) (neni 146/10).

Karakteret që duhen përdorur për shkrimet janë ato të dhëna në **tabelat II 26 a÷d** (neni 146/1).

Kalimet në nivel me gjysëmbarriera mund të vendosen vetëm në rast se karrexhata është e ndarë në dy drejtime lëvizjeje nga trafikndarësi i pakapërcyeshëm, me gjatësi të përshtatshme (neni 44/2 i Kodit Rrugor).

Kalimet në nivel në rrugë me një sens të pajisura me barriera që pengojnë gjithë karrexhatën vetëm në hyrje, janë quajtur kalime në nivel me gjysëmbarriera (neni 44/2 i Kodit Rrugor).

Në afërsi të një degëzimi rrugor (neni 85/7), në të cilin ekziston një kalim në nivel me ose pa barriera, në një largësi më të vogël se 150 m, të detyruar për impiantin e sinjalit të parë të rrezikut, duhet përdorur një prej sinjaleve të veçanta të rrezikut, i formatit të vogël, të vendosur në sinjalet paralajmëruese të kryqëzimit.

Ky sinjal duhet vendosur në rrugë që nuk i përket vendkalimit hekurudhor në largësi nga kryqëzimi jo më të vogël se vlerat e vendosura nga neni 124/2 dhe dhëna në **Skemën 93** (aneksi A). Tabela është dhënë në **figurën II 240**.

Detyrimi për një tabelë të tillë është në ngarkim të entit pronar të rrugës të painteresuar nga vendkalimi hekurudhor.

Sinjalet KRYQI I SHËN ANDREAS (**figurat II 10/a÷d**), NDAL DHE JEP PERPARËSI (**figura II 37**), pajisjet ndriçuese dhe akustike, si dhe pengesat vendosen nën kujdesin dhe me shpenzimet e përdoruesit të hekurudhës (neni 182/3/8).

Sistemet, ndriçuese dhe akustike, janë të detyrueshme kur bëhet fjalë për barriera të manovrueshme në largësi ose nuk janë të dukshme drejtëpërsëdrejti nga vendi i manovrës (neni 44/1 i Kodit Rrugor).

Në rastin në të cilin trarët e mbikalimeve hekurudhore dhe linjat e kontaktit të hekurudhës janë në një lartësi më të vogël se 5 m, është i nevojshëm aplikimi i pajisjeve të sigurisë kundër-formë për mbrojtje sipas normave të dhëna në udhëzimet përkatëse të Ministrisë që mbulon veprimtarinë e Transportit.

KALIMI NË NIVEL ME BARRIERË (**Skema 94**) (aneksi A)

Karakteristikat e barrierave

Barrierat duhet të jenë në sipërfaqen e jashtme me shirita reflektuese të bardha dhe të kuqe me pjerrësi 45 gradë kundrejt planit horizontal. Gjerësia e secilit shirit duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 15 dhe 20 cm.

Shirita të tilla duhet të jenë reflektuese dhe të realizuara me sipërfaqe reflektuese të efiçencës së lartë (klasa 2).
Për të përmirësuar shikueshmërinë e barrierave mund të vendosen në to, nëse është e nevojshme, drita të kuqe.
Sipërfaqet e barrierave duhet të jenë të paktën 0,2 m^2, për çdo metër gjatësi të barrierës, e vlerësuar në planin vertikal, paralel me barrierën.
Nëse barrierat kanë disa drita kjo sipërfaqje mund të reduktohet në gjysmë; ky reduktim mund të bëhet edhe në rastin e rrugëve përgjithësisht jo të përshtatshme, si rregull, për kalimin e mjeteve.
Lartësia e anës së sipërme të barrierës duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 0,9 dhe 1,3 m e matur kundrejt pikës më të lartë të karrexhatës (neni 182/2 dhe 183/1/2/3/4/5).
Janë të përfshira në barriera binarët, kangjellat dhe pajisje të tjera ekuivalente me to.

Sistemi i sinjalizimit optik dhe akustik i barrierave

Sistemi i sinjalizimit optik me drita të kuqe, atje ku parashikohet, përgjithësisht vendoset në anën e djathtë të karrexhatës në hapësirën më të afërt me kalimin në nivel dhe montohet në mënyrë të tillë që të jetë i dukshëm nga largësia më e madhe e mundshme.

Lartësia nga toka e *sistemit të sinjalizimit akustik* duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 2 dhe 2,5 m.
Karakteristikat gjeometrike janë dhënë në **Skemën 94**. Drita, ditën dhe pa mjegull, duhet të jetë e dukshme jo më pak se 100 metra largësi.

Sistemi i sinjalizimit akustik, atje ku parashikohet, duhet të jetë i dëgjueshëm për jo më pak se 100 m largësi, përveç rastit në të cilin drita e *sistemit optik* është e dukshme nga prapa. Në këto kushte dëgjimi i sinjalit akustik mund të realizohet në jo më pak se 100 m. Funksionimi i *sistemit të sinjalizimit akustik* duhet të fillojë të paktën 5 sekonda para fillimit të uljes së barrierave dhe të përfundojë jo më parë se fundi i uljes së tyre (neni 184/1/2/3/4).

Sinjali i kalimit në nivel

Çdo vendkalim hekurudhor me barriera duhet të jetë i paisur me sinjalin KALIM NË NIVEL ME BARRIERA (**figura II 8**). Kjo tabelë vendoset 150 m përpara vendkalimit. Në rast se është i pamundur respektimi i kësaj norme tabela plotësohet me panelin **model II 1** e cila tregon largësinë e saktë nga rreziku.

Gjithashtu shtohen tabela largësitreguese, nga të cilët i pari sipas **figurës II 11/a**, vendoset poshtë sinjalit KALIM NË NIVEL ME BARRIERA (**figura II 8**); ndërsa dy të tjerët, të paraqitur në **figurat II 11/b/c**, duhet të vendosen respektivisht në 2/3 dhe 1/3 e largësisë ndërmjet sinjalit dhe vendkalimit hekurudhor.

Tabelat largësitreguese duhet të kenë respektivisht 3, 2, 1 shirita të pjerrët, të kuqe, në sfond të bardhë, me pjerrësi 45 gradë kundrejt aksit të rrugës (neni 85/1/4/5).

Defektet

Në rast të defektit të mekanizmit të mbylljes së kalimit në nivel, barrierat zëvendësohen nga të paktën një këmbalec për çdo anë,. që duhet të jenë me shirita reflektuese të bardha dhe të kuqe në sipërfaqen e jashtme.

Këta këmbalecë duhet të kenë lartësi të përfshirë ndërmjet 1 dhe 1,4 m, gjatësi të paktën 1,5 m dhe të përmbajnë në pjesën e sipërme një tabelë me lartësi 0,25 m, dhe gjatësi sa ajo e këmbalecit.

Sipërfaqja duhet të jetë nga krahu i rrugës, me shirita të bardha dhe të kuqe të pjerrëta 45 gradë, secila me gjatësi të përfshirë ndërmjet 0,15 dhe 0,20 m.

Mund të përdoret vetëm një këmbalec për çdo anë, në këtë rast këmbaleci mban në pjesën e sipërme një disk me diametër 25 cm me ngjyrë të kuqe me bord të bardhë.

Në mungesë të këtij disku vendosen disa këmbalecë, në numër të përshtatshëm me gjerësinë e karrexhatës.

Shiritat e këmbalecit dhe disku duhet të jenë reflektues dhe të realizuar me sipërfaqe reflektuese me efiçencë të lartë (klasa 2).

Barrierat mund edhe të zëvendësohen me një flamur të kuq reflektues dhe me një fener me dritë të kuqe natën dhe në rastet e tjera të shikueshmërisë së dobët. Këto ndryshohen nga punonjësit e caktuar për përkujdesjen në kalimin në nivel (neni 182/1 dhe 187/1/2/3).

KALIMI NË NIVEL ME GJYSËMBARRIERA
(**Skema 95** aneksi A)

Karakteristikat e gjysëmbarrierave

Gjysëmbarrierat duhet të jenë me shirita reflektues të bardha dhe të kuqe, në sipërfaqen e jashtme, të pjerrëta 45 gradë me planin horizontal. Gjerësia e secilit shirit duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 15 dhe 20 cm.

Këto shirita duhet të jenë reflektuese dhe të realizuara me celuloid me efiçencë të lartë (klasa 2).

Mbi çdo gjysëmbarrierë vendosen dy drita të kuqe nga ku njëra në skajin e lirë.

Sipërfaqet e barrierave të drejtuara nga rruga duhet të jenë të paktën 0,2 m^2 për çdo metër të gjerësisë.

Sipërfaqja horizontale e sipërme e gjysëmbarrierës duhet të jetë e një lartësie, të llogaritur në krahasim me pikën më të lartë të karrexhatës, e përfshirë ndërmjet 0,9 dhe 1,3 m (neni 182/1 dhe 183/1/2/3/4/5).

Sistemet e sinjalizimit akustik dhe optik të gjysëmbarrierave

Në kalimet në nivel të pajisura me gjysëmbarriera, sistemet e sinjalizimit të ndriçuar me dy drita të kuqe që ndizen dhe fiken në mënyrë alternative, duhet të kenë përmasat e dhëna në **Skemën 94**, të montohen në anën e djathtë të karrexhatës, në hapësirën më të afërt me kalimin në nivel dhe të vendosura në mënyrë të tillë që të jenë të dukshme nga rruga në largësinë më të madhe të mundshme.

Lartësa nga toka e qëndrës së sistemit duhet të jetë jo më e vogël se 2 m dhe jo më e madhe se 2,5 m.

Frekuenca e dritave duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 50 dhe 70 ndezje në minutë.

Karakteristikat teknike të sistemeve me dritë të kuqe duhet të jenë të tilla që intensiteti i dritës së lëshuar të jetë i dukshëm, në mungesë mjegulle, edhe ditën të paktën në 100 m brenda një koni 30 gradë në hapje.

Sistemi i sinjalizimit me dritë të kuqe me një ose dy drita që ndizen e fiken, eventualisht të përsëritura në krahun e majtë të rrugës, mund të mos jenë në hapësirën më të afërt me kalimin në nivel por nuk duhet të jenë më larg se 30 m nga ai. Duhet të kenë karakteristikat e njëjta me ato të sistemeve të vendosura në anën e djathtë të rrugës.

Sinjalizimi akustik ka të njëjtat karakteristika të përshkrura për kalimet në nivel me barriera, përveç intesitetit, i cili mund të jetë më i ulët.

Funksionimi i këtyre sistemeve akustike dhe ndriçuese duhet të fillojë 30 sekonda përpara arritjes në kalimin në nivel të trenit më të shpejtë dhe ulja e barrierës duhet të fillojë jo më parë se 5 sekonda pas hyrjes në punë të sistemit së sinjalizimit akustik dhe ndriçues.

Funksionimi vazhdon deri në përfundim të kalimit të trenit (neni 185/1/2/3/4/5).

Sinjalet e kalimit në nivel

Sinjali KALIM NË NIVEL ME BARRIERA (**figura II 8**) duhet të përdoret për të sinjalizuar çdo vendkalim të pajisur me gjysëmbarriera.

Ky sinjal vendoset 150 m përpara kalimit në nivel. Në rast se është i pamundur respektimi i kësaj norme, tabela plotësohet me një panel **model II 1/a** që tregon largësinë e saktë të vendkalimit hekurudhor.

Gjithashtu vendosen tabela largësitreguese nga të cilat e para (**figura II 11/a**) vendoset sëbashku me atë të **figurës II 8** ndërsa të tjerat (**figurat II 11/b** dhe **c**) vendosen përkatësisht në 2/3 dhe 1/3 e largësisë ndërmjet sinjalit dhe vendkalimit hekurudhor.Këto tabela largësitreguese duhet të kenë përkatësisht 3, 2 dhe 1 shirita të pjerrët, të kuqe, në sfond të bardhë me pjerrësi 45 gradë ndaj karrexhatës (neni 85/1/4/5).

Defektet

Në rast të defektit të sistemit të mbylljes së kalimit në nivel, gjysëmbarrierat zëvendësohen nga të paktën një këmbalec për çdo anë që duhet të jetë me shirita reflektuese të bardha dhe të kuqe, në sipërfaqen e jashtme.

Këta këmbalecë duhet të kenë lartësi të përfshirë ndërmjet 1 dhe 1,4 m, gjatësi të paktën 1,5 m dhe të përmbajnë në pjesën e sipërme një tabelë me lartësi 0,25 m, dhe gjatësi atë të këmbalecit. Sipërfaqja duhet të jetë nga krahu i rrugës me shirita të bardha dhe të kuqe të pjerrëta 45 gradë, secila me gjerësi të përfshirë ndërmjet 0,15 dhe 0,20 m. Mund të përdoret vetëm një këmbalec për çdo anë, në këtë rast këmbaleci mban në pjesën e sipërme një disk me diametër 25 cm me ngjyrë të kuqe me bord të bardhë.

Në mungesë të këtij disku, vendosen disa këmbalecë, në numër të përshtatshëm me gjerësinë e karrexhatës.
Shiritat e këmbalecit dhe disku duhet të jenë reflektues dhe të realizuar me celuloid me efiçencë të lartë (klasa 2).

Gjysëmbarrierat mund edhe të zëvendësohen me një flamur të kuq reflektues dhe me një fener me dritë të kuqe natën dhe në rastet e tjera të shikueshmërisë së dobët; këto ndryshohen nga punonjësit e caktuar për përkujdesjen ndaj kalimit në nivel (neni 182/1 dhe 187/1/2/3).

KALIMI NË NIVEL PA BARRIERA

Sinjalet e kalimit në nivel
(neni 85/2/3/4/5/6 dhe 186/1/2/3)

Kalimi në nivel pa barriera duhet të sinjalizohet nga sinjali i KALIMIT NË NIVEL PA BARRIERA (**figura II 9**) i vendosur 150m përpara. Në rastet në të cilat nuk është i mundur respektimi i kësaj largësie sinjali duhet të plotësohet me një panel **model II 1** tregues i largësisë efektive të rrezikut.

Vendosen PANELE LARGËSITREGUES nga të cilët i pari (**figura II 11/a**) vendoset poshtë tabelës së **figurës II 9** dhe ato të **figurave II 11/b** dhe **c** përkatësisht në 2/3 dhe 1/3 e largësisë ndërmjet sinjalit dhe vendkalimit hekurudhor.

Këto tabela duhet të kenë përkatësisht 3, 2 dhe 1 shirita të pjerrët në 45 gradë, me ngjyrë të kuqe, në sfond të bardhë, të drejtuara ndaj karrexhatës.

Vendosen gjithashtu sinjalet e mëposhtëme:

a) KRYQI I SHËN ANDREAS (**figura II 10**) nëse shikueshmëria drejt hekurudhës është e mjaftueshme përgjatë gjithë rrugës së afrimit në të. Shih **Skemën 97** (aneksi A).

b) KRYQI I SHËN ANDREAS (**figura 10**) dhe sisteme NDALO DHE JEP PËRPARËSI (**figura II 37**) të vendosura në të njëjtin mbajtës nëse shikueshmëria është e mjaftueshme vetëm nga një largësi e afërt nga binarët. Shih **Skemën 97**.

c) KRYQI I SHËN ANDREAS (**figura 10**) dhe pajisja ndriçuese me dy drita të kuqe që ndizen e fiken në mënyrë alternative por edhe sistemi i sinjalizimit akustik nëse shikueshmëria nuk është e mjaftueshme. Këto sisteme mund të plotësohen edhe nga sinjalet e dhëna në gërmat a) dhe b).

Është e arsyeshme që sistemi ndriçues të vendoset në të njëjtën mbajtëse të sinjaleve.

Për të siguruar shikueshmërinë në çdo rast, sistemet e sinjalizimit ndriçues mund të përsëriten në krahun e majtë ose në ishullin e posaçëm në qëndër të rrugës ose mund të përsëritetn ose vendosen përmbi karrexhatë. Gjithashtu ato mund të bëhen të dukshme nga ana e pasme. Shih **Skemën 98**.

KRYQI I SHËN ANDREAS (**figura II 10**) vendoset në anën e djathtë të rrugës në pjesën më të afërt të binarit dhe gjithsesi jo më larg se 10 m nga traseja më e afërt. Është i njëfishtë nëse hekurudha është me një binar (**figura II 10/a**); është i dyfishtë nëse hekurudha është me dy ose më shumë binarë (**figura II 10/b**).
Këto sinjale vendosen me aksin më të madh horizontalisht nëse ka hapësirë të majftueshme, përndryshe vendosen vertikalisht (**figurat II 10/c** dhe **d**).

Në rast se qarkullimi i trenave është shumë i ngadaltë dhe i rregulluar nga një agjent ose nga një semafor i posaçëm, KRYQI I SHËN ANDREAS zëvendësohet nga një sinjal KALIM NË NIVEL PA BARRIERA i vendosur në të njëjtën largësi dhe i pajisur me një tabelë plotësuese që tregon largësinë në metra nga binarët (**modeli II 1/a**). Shih **Skemën 99**.

Sistemet e sinjalizimit optik dhe akustik të kalimeve në nivel pa barriera

Janë të detyrueshme në rast të shikueshmërisë së pamjaftueshme.
Sistemet e sinjalizimit të ndriçuar me dy drita të kuqe që ndizen e fiken në mënyrë alternative, atje ku parashikohet, duhet të kenë karakteristikat e **Skemës 94**. Ato montohen në krahun e djathtë të rrugës dhe, është e preferueshme, poshtë sinjalit KRYQI I SHËN ANDREAS (**figura II 10**).
Duhet të jenë të dukshme mirë dhe lartësia nga toka e qendrës së sistemit duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 2 dhe 2,5 m.
Frekuenca e dritave duhet të jetë e përfshirë ndërmjet 50 dhe 70 ndjezje në minutë.

Karakteristikat teknike të sistemit me drita të kuqe duhet të jenë të tilla që intensiteti i dritës t'i bëjë të dukshme, në mungesë të mjegullës, edhe ditën në largësi të paktën 100 m brënda një koni 30 gradë në hapje.

Sistemi akustik duhet të jetë i dëgjueshëm nga të paktën 100 m largësi.

Funksionimi dhe karakteristikat e pajisjeve ndriçuese dhe akustike janë të njëjta me ato të kalimeve në nivel me gjysëmbarriera (185/1/2/3/4 dhe neni 186/2/3).

KALIM LINJASH HEKURUDHORE LIDHËSE
(Skema 100)
(aneksi A)

Kur rruga ndërpritet nga një binar lidhës hekurudhor dhe drejtimi i kalimit është rregulluar me sinjale manuale me dorë nga personeli i angazhuar me manovrimet, vendkalimi duhet të sinjalizohet me anë të sinjalit RREZIQE TE TJERA (**figura II 35**) me panelin plotësues **model II 6/c** dhe më pas me KRYQIN E SHËN ANDREAS (**figura II 10**) në afërsi të vetë binarit.
Ky sinjal nuk është i detyrueshëm në qëndrat e banuara.

Sinjali i rreziqeve të tjera vendoset në largësi të përcaktuar nga vendkalimi dhe përsëritet në afërsi të tij në çdo situatë që e bën të nevojshëm. Vendosja e sinjaleve të rrezikut të montuara në afërsi të vendkalimit, kryhet nën kujdesin e pronarit të linjës hekurudhore ose të entit përdorues të hekurudhës. Vendosja e sinjaleve të tjera bëhet nën kujdesin dhe me shpenzimet e entit pronar të rrugës (neni 189/1/2/3).

RRUGËKALIMI

Përkufizimi

Hyrja në një zonë anësore të njëjtë me atë të qëndrimit të një ose më shumë mjeteve (neni 2/1 i Kodit Rrugor) (shih **Skemën 101** aneksi A).

Sinjali vertikal
(neni 118/1d)

Sinjali RRUGËKALIM (**figura II 78**) tregon zonën për hyrjen e mjeteve në prona anësore, në të cilat mbizotëron ndalimi i pushimit sipas nenit 155 të Kodit Rrugor.

Përmasat

Sinjali ka përmasa normale 40x60 cm dhe përmasa të mëdha 60x90 cm. Mund të autorizohet edhe një format i reduktuar.

Kompetencat

Në pjesën e sipërme të sinjalit duhet të tregohet enti pronar i rrugës që lëshon autorizimin.

Në pjesën e poshtme duhet të tregohet numri dhe viti i kësaj lejeje.

Mostregimi i entit dhe i të dhënave të autorizimit sjell paefektshmërinë e ndalimit.

Për rrugët private, por të hapura për kalim publik, autorizimi jepet nga Komuna.

Sinjali horizontal

- *Shiriti i ndarjes së drejtimeve të lëvizjes* (neni 137/9)
Mundësohet ndërprerja e shiritave të pandërprera në përputhje me hyrjet anësore, gjithmonë nëse garantohet një shikueshmëri e mjaftueshme për manovrimet e kalimit dhe të kthimit.

- *Shirit i anëve të karrexhatës* (neni 139/3)
Shiritat e anëve janë të ndërprera në përputhje me itineraret.

- Për përmasat e ndërprerjeve të s*hiritave* rekomandohet kapitulli i përgjithshëm i sinjaleve horizontale.

RRUGËKALIM BIÇIKLETASH

Në përputhje me vendkalimet e biçikletave drejtuesit e mjeteve duhet të japin përparësi për biçiklistët që kanë filluar kalimin. (neni 40 i Kodit Rrugor).

Kalimet e biçikletave duhet të jenë të parashikuara vetëm për të garantuar vazhdimësinë e pistave të biçikletave në zonat e kryqëzimeve (neni 144/1).

Rregullat e zbatueshme për pista të biçikletave jepen në udhëzime të veçanta.

Sinjalet vertikale

Janë parashikuar sinjalet e mëposhtëme:

- RRUGËKALIM PËR BIÇIKLETA (**figura II 90**);
- RRUGËKALIM PËR BIÇIKLETA NGJITUR ME TROTUARIN
- (**figura II 92/a**);
- RRUGËKALIM PËR KËMBËSORË DHE BIÇIKLETA (**figura II 92/b**);
- VENDKALIM BIÇIKLETASH (**figura II 14**)(sinjale rreziku);
- VENDKALIM BIÇIKLETASH(**figura II324**)(sinjale të dobishme për drejtuesin e mjetit).

Pista për biçikleta
(neni 120/9b)

Sinjali RRUGËKALIM PËR BIÇIKLETA (**figura II 90**) duhet të vendoset në fillim të një rruge, të një korsie ose të një itinerari të rezervuar për qarkullimin e biçikletave. Duhet të përsëritet pas çdo ndërprerejeje ose pas kryqëzimeve.
Fundi i detyrimit sinjalizohet me një sinjal të njëjtë, me diagonale të kuqe (SLASH) (**figura II 91**).

Pista për biçikleta ngjitur me trotuarin
(neni 120/9c)

Sinjali RRUGËKALIM BIÇIKLETASH NGJITUR ME TROTUARIN (**figura II 92/a**) duhet të vendoset në fillim të një itinerari të rezervuar për këmbësorët dhe për qarkullimin e biçikletave dhe duhet të përsëritet pas çdo ndërprerjeje dhe kryqëzimi. Fundi i detyrimit të sinjalit bëhet me një sinjal të njëjtë, me diagonale të kuqe (**figura II 93/a**). Simbolet mbi sinjal tregojnë vendosjen reale të trotuarit dhe të pistës për biçikleta.

Rrugë për këmbësorë dhe biçikleta
(neni 120/9c)

Sinjali RRUGË PËR KËMBËSORË DHE BIÇIKLETA (**figura II 92/b**) duhet të vendoset në fillim të një rrugë të rezervuar për biçikleta dhe për qarkullimin e këmbësorëve dhe përsëritet pas çdo ndërprerjeje dhe pas kryqëzimeve.

Fundi detyrimit sinjalizohet me një sinjal të ngjashëm, me diagonale të kuqe (SLASH) (**figura II 93/b**).

Vendkalim për biçikleta
(neni 86/3,neni 133/15)

Sinjali VENDKALIM BIÇIKLETASH (**figura II 14**) është një *sinjal rreziku* dhe duhet të përdoret për të parasinjalizuar një kalim biçikletash, që dallon nga shenjat përkatëse mbi karrexhatë, në rrugët interurbane dhe në ato urbane të projektuara për shpejtësi më të madhe se 40 Km/orë. Mund të përdoret në rrugët e tjera urbane vetëm nëse kushtet e trafikut e këshillojnë përdorimin për motive sigurie.

Sinjali VENDKALIM PËR BIÇIKLETA (**figura II 324**) është një *sinjal tregues* dhe lokalizon një vendkalim të karrexhatës nga ana e një piste për biçikleta, i shenjuar nga sinjalet e posaçme horizontale.

Në rrugët interurbane dhe në ato urbane kryesore, duhet të paraprihet nga sinjali trekëndor i rrezikut i **figurës II 14**.

Sinjali mund të përdoret në variantin me ndriçim të vetin dhe në këtë rast këshillohet kombinimi me burimet e posaçme të dritës, për ndriçimin e përqëndruar në sinjalet horizontale. Mund të montohet me pamje të dyfishtë, në të dy krahët e karrexhatës ose përmbi të.

Vendoset gjithmonë në përputhje me vendkalimin.

Sinjalet horizontale

Pistat për biçikleta, kur nuk janë të mbrojtura nga elementë të ngritur mbi rrugë, janë të ndara nga korsitë nëpërmjet dy shiritave të pandërprera përkrah njëra-tjetrës, një i bardhë me gjërësi 12 cm dhe tjetri i verdhë me gjërësi 30 cm, të largurara ndërmjet tyre 12 cm. Shiriti i verdhë vendoset nga ana e pistës për biçikleta siç jepet në **Skemën 33** aneksi A, të paraqitur në kapitullin që i përket sinjaleve horizontale (neni 138/7).

Tek *pistat* dhe tek *vendkalimet për biçikleta* mund të shënohen mbi rrugë sinjali ose simboli i sinjalit RRUGËKALIM PËR BIÇIKLETA (**figura II 90**) (**Skema 33**). Në çdo rast ato duhet të jenë në mënyrë të arsyeshme të deformuara në funksion të tipit të rrugës (neni 146/11).

Vendkalimet për biçikleta (neni 144/2) janë evidentuar në karrexhatë përmes dy shiritave të bardha të ndërprera, me gjerësi 50 cm, me segmente dhe intervale të gjata 50 cm. Largësia minimale ndërmjet anëve të brendshme të dy shiritave të tërthorta është 1 m për vendkalimet në rrugët me një sens dhe 2 m për vendkalimet në rrugët me dy drejtime, siç tregohet në **Skemën 103** (aneksi A).

Në rrugët ku është i lejuar pushimi, për të përmirësuar shikueshmërinë nga ana e drejtuesve të mjeteve në përballje me biçiklistët që duan të kalojnë karrexhatën, vendkalimet për biçikleta mund të paraprihen, në drejtimin e lëvizjes së mjeteve, nga një shirit i verdhë zig-zag.

Gjatësia e tij duhet të jetë në përpjestim me largësinë e dukshmërisë, dhe në të është i ndaluar pushimi. Shiriti i verdhë zig-zag është i të njëjtit tip të **Skemës 52** (aneksi A) të kapitullit Vendkalimet e këmbësorëve (neni 144/3).

U R Ë

Figura II 317, neni 133/11

Sinjali URË (**figura II 317**) tregon fillimin e një ure, viadukti, një kanali, një mbikalimi, sipërkalimi ose të njëjtë me to.

Plotësime

Mund të plotësohen nga:

- paneli **model II 6** i cili tregon emrin e urës ose të kanalit që do të kalohet;
- panel **model II 2** i cili tregon gjatësinë e veprës të shprehur në metra. (**Skema 111** aneksi A)

Vendosja

Vendoset në fillim të urës.

Kombinime

Nëse zona është subjekt i erërave të forta të anëve, mund të vendoset sinjali ERËRA TË FORTA ANËSORE (**figura II 33**).

NGADALSUESIT E SHPEJTËSISË

Sisteme me efekt optik
(neni 177/2)

Ngadalësuesit e shpejtësisë të parafabrikuar janë të përbërë nga rripa të tërthortë të vendosur përgjatë gjithë gjerësisë së karrexhatës.

Sipërfaqja e ngadalësuesve duhet të jetë e parrëshqitshme.

Sisteme me efekt akustik
(neni 177/3)

Janë të realizuara përmes aplikimeve në seri të të paktën 4 shiritave të bardha reflektuese me gjerësi në rritje në drejtimin e lëvizjes dhe me ngushtim në zbritje.
Shiriti i parë duhet të jetë i gjerë 20 cm, ndërsa ato pas tij duhet të jenë në rritje të paktën 10 cm në krahasim me të mëparshmen.
Shih **Skemën 104** (aneksi A) (figura II 473).

Kurrize artificiale
(neni 177/4/5/6)

Këto sisteme ngadalësimi janë realizuar përmes ashpërsimit të sipërfaqes së karrexhatës. Mund të realizohen me gërvishjtjen ose skalitjen e sipërfaqes së saj ose me aplikimin e shtresave të buta të integruara me sistemet reflektuese.

Këto sisteme mund të shkaktojnë edhe efekte vibrimi me intensitet të kufizuar.

Në rrugët ku mbizotëron një kufi shpejtësie më i vogël se 50 km/orë mund të vendosen kurrize artificiale të evidentuara në dukje nëpërmjet shiritave të pjerrëta të verdha dhe të zeza tip zebre paralel me drejtimin e lëvizjes, me gjerësi të njëjtë qoftë për shenjat, qoftë për intervalet (shih **Skemën 105** aneksi A) dhe të dukshme si ditën, ashtu edhe natën (neni 177/4), (figura II 474)

Kurrizet mund të realizohen në rrugë të zonave të banuara, në parqe publike dhe private, në rezidenca, etj.

Mund të vendosen në seri dhe duhet të jenë të sinjalizuara.
Në rastet e vendosjes në seri largësia ndërmjet ngadalsuesve duhet të jetë nga 20 deri në 100 m (neni 177/6).

Nuk lejohet të përdoren në itinerare të caktuara për mjetet e ndërhyrjes së shpejtë apo të emergjencës (neni 177/5).

Përmasat e kurrizeve (neni 177/6):

tipi	shpejtësia km/orë	gjerësia cm	lartësia cm
a	v ≤ 50	≥ 60	≤ 3
b	v ≤ 40	≥ 90	≤ 5
c	v ≤ 30	≥ 120	≤ 7

Përmasat janë dhënë në **Skemën 106** (aneksi A).

Materialet për realizimin e kurrizeve (neni 177/6):

- tipi a gomë ose material plastik;
- tipi b gomë ose material plastik;
- tipi c gomë, material plastik ose konglomerat valëzime të sipërfaqes rrugore me profil të mysët.

Ngadalësuesit e shpejtësisë të parafabrikuar duhet të jenë të mbërthyer fort në rrugë dhe të hiqen lehtë, n.q.s është e nevojshme, nga punëtorët e mirëmbajtjes.

Në zonën ku përdoren kurrizet, duhet të merren masa të përshtatshme për largimin e ujrave (neni 177/6).

Parasinjalizimi i kurrizeve është i përbërë nga sinjali i **figurës II 50** me një vlerë të përfshirë ndërmjet 20 dhe 50 km sëbashku me sinjalin e **figurës II 2,** të formatit të reduktuar, të vendosur të paktën 20 m përpara.

Një seri ngadalsuesish tregohet përmes sinjaleve të njëjta dhe një tabelë plotësuese, të vendosur poshtë sinjalit të **figurës II 2**, me fjalën " seri " ose "1, 2, ... ngadalsues" (neni 177/7).

RRETHRROTULLIMET

Rrethrrotullimi në rrugë urbane
(Skema 107)
(aneksi A)

Sinjali vertikal:

- sinjali QARKULLIM RRETHOR (**figura II 84**) duhet të vendoset në buzë të zonës ku kryhet qarkullimi në rrethrrotullim (neni 120/6), i cili u tregon drejtuesve të mjeteve detyrimin për të qarkulluar sipas drejtimit të dhënë nga shigjetat;

- sinjali QARKULLIM RRETHOR (**figura II 84**) mund të paraprihet nga sinjali QARKULLIM RROTULLUES (**figura II 27**) në rast se kushtet e trafikut e këshillojnë përdorimin për motive sigurie (neni 120/6). Sinjali duhet të montohet 150 m nga rrethrrotullimi ose, në lidhje me situatën dhe vendet, në largësi më të vogël (neni 79/7), duke treguar, në këtë rast, në një panel model II.1, largësinë efektive nga rrethrrotullimi (neni 82/3).

Rrethrrotullimi në rrugë interurbane

Sinjali vertikal:

- sinjali QARKULLIM RRETHOR (**figura II 84**) duhet të vendoset në buzë të zonës ku kryhet qarkullimi në rrethrrotullim (neni 120/6).

- Sinjali QARKULLIM RRETHOR (**figura II 84**) duhet të paraprihet nga sinjali QARKULLIM RROTULLUES (**figura II 27**) (neni 94/6 dhe 120/6). Sinjali duhet të montohet 150m përpara rrethrrotullimit (neni 79/7). Në rast se nuk është i mundur respektimi i kësaj largësie, sinjali duhet të plotësohet me një panel model II.1, duke treguar largësinë efektive nga rrethrrotullimi. Për motive sigurie, sinjali mund të paraprihet nga një tjetër, i njëjtë me të, gjithnjë me panelin plotësues, largësitregues që tregon largësinë efektive nga rrethrrotullimi (neni 82/3).

Rrethrrotullimi me përparësi atij që kalon

Në prani të një rrethrrotullimi, qarkullimi si rregull me përparësi nga e djathta, mund të zëvendësohet me një rregjim qarkullimi që i jep përparësi mjeteve në qarkullim rrethrrotullim. Në këtë rast pra, për mjetet që hyjnë në rrethrrotullim, vihet detyrimi i dhënies përparësi ose i qëndrimit dhe dhënies përparësi.

Sinjali vertikal:

- sinjali QARKULLIM RRETHOR (**figura II 84**) dhe sinjali JEP PËRPARËSI (**figura II 36**) ose NDAL DHE JEP PËRPARËSI (**figura II 37**) duhet të vendosen në pragun e zonës ku kryhet qarkullimi rrethrrotullues (neni 110/1 dhe 104/2).

Sinjali horizontal:

- sinjalet JEP PËRPARËSI (**figura II 36**) dhe NDAL DHE JEP PËRPARËSI (**figura II 37**) duhet të shoqërohen nga sinjalet horizontale të parashikuar (nenet 104/4 dhe 105/3), domethënë nga vijat e ndalimit (neni 142), të integruara me shkrimin STOP mbi rrugë, ose nga simboli eventual i trekëndëshit (neni 146/8/9) (**Skemat 61,73 dhe 75** aneksi A).

LEVIZJA NË RRUGË ME NJË DREJTIM

Në një rrugë me një drejtim qarkullimi duhet të vendosen:

- sinjali NDALIM KALIMI (**figura II 47**) nga krahu i ndaluar i hyrjes (neni 133/25);
- sinjali DREJTIM I VETËM PARALEL (**figura II 348**), që duhet të përdoret në kryqëzime për të treguar se në rrugën e nisur, qarkullimi është i rregulluar me një drejtim, duke saktësuar në të njëjtën kohë drejtimin.

Ky sinjal është i montuar paralelisht me aksin e rrugës dhe është e mira që të jetë i kombinuar me sinjalin EMËR RRUGE (shih **figurën II 292**), me të njëjtat përmasa.

Nëse kryqëzimi është me semaforë, të dy sinjalet mund të vendosen në pllakën sipër fenerit semaforik (**Skema 113** aneksi A) (neni 133/24).

Me qëllim plotësimin e tregimit të sinjalit DREJTIM I VETËM PARALEL (**figura II 348**) mund të vendoset sinjali DREJTIM I VETËM PËRBALLE (**figura II 349**), që është montuar normalisht në aksin e karrexhatës; ky sinjal montohet në të djathtë dhe në të majtë të fillimit të sensit të vetëm, me përsëritje të mundshme nga e majta (neni 133/25).

Në skema të veçanta qarkullimi, vendosen:

- sinjali DREJTIM I DETYRUESHËM (**figurat II 80/a÷c**) si rregull vendoset në pikat në të cilat fillon drejtimi i detyrimit të vetëm (neni 120/2);

- sinjali PARALAJMËRIM PËR DREJTIM TË DETYRUESHËM (**figurat II 80/d** dhe **e**), si rregull vendoset përpara pikës në të cilën fillon drejtimi i detyrimit të vetëm dhe mund të plotësohen me panelin **model II 1** tregues i largësisë nga ajo pikë (neni 120/2).

- sinjali DREJTIM I LEJUAR (**figurat II 81/a÷c**), si rregull vendoset përpara pikës në të cilën fillon detyrimi (neni 120/3).

NDALIMI, QËNDRIMI DHE PARKIMI

Rregulli parashikon:

- sinjalet për të ndaluar qëndrimin (NDALIMET);
- sinjalet për të dalluar zonat e rezervuara për qëndrim dhe parkim.

NDALIM

Sinjalet horizontale

Pjesët e rrugës në të cilat ndalimi është i ndaluar mund të tregohen me shenja horizontale, të përbëra nga segmente të alternuar me ngjyrë të verdhë dhe të zezë, të vendosura në faqen vertikale të buzës së trotuarit (neni 150/3) (**skema 114** aneksi A) ose me vija të anëve të pandërprera me ngjyrë të bardhë (neni 139/2).

NDALIMPUSHIMI

Sinjalet vertikale

Sinjali NDALIM PUSHIMI (**figura II 74**) duhet të përdoret në vendet ku është vendosur ndalimi i pushimit për mjetet (neni 118/a). **Nuk duhet të përdoret** në vendet në të cilat si rregull i përgjithshëm mbizotëron ndalimi (neni 118/1a).

Rrugët Interurbane

Vënia e sinjalit tregon, në mungesë të treguesit plotësues, që ndalimi është i përhershëm dhe ka vlerë edhe në orët e natës (neni 118/1a).

Rrugët Urbane

Vënia e sinjalit tregon, në mungesë të treguesit plotësues, që **ndalimi mbizotëron nga ora 08.00 deri në orën 20.00** (neni 118/1a).

Plotësime

Sinjali mund të plotësohet nga panele plotësuese me treguesit e mëposhtëm (neni 118/1a):

- ditët e javës, të muajit ose të orëve të ditës përgjatë të cilave vlen ndalimi (**modeli II 3/b**);

- në rast të ndalimit të pushimit për **gjithë ditën** duhet të vendoset treguesi "0-24" (**modeli II 3/a**);

- në rastin në të cilin ndalimi vlen vetëm në **ditët e pushimit** duhet të vendoset treguesi (**model II 3/d**);

- në rastin në të cilin ndalimi vlen vetëm në **ditët e festave** duhet të vendoset treguesi (**model II 3/c**);

- për të sinjalizuar përdoruesin, për heqjen e detyruar të mjetit nga pjesa e sinjalizuar e cila përbën pengesë ose rrezik për qarkullimin, përdoret paneli plotësues **model II 6/m**; ZONË RIMORKIMI TË DETYRUAR, me të njëjtën vlefshmëri orari si ai i sinalit të ndalimit.
- përjashtimet për disa kategori përdoruesish (**modeli II 4/b**). Të tilla përjashtime nga NDALIM PUSHIMI (**figura II 74**) janë treguar me sinjalin e përbërë VENDQËNDRIM I PRANUAR NGA KATEGORI TË VEÇANTA (**figura II 79**) (**skema 115** aneksi A).

Ato i përkasin:

- mjeteve të invalidëve (neni 118/2) **figura II 79/a**

  Në rastet në të cilat kërkohen kushte të veçanta të invaliditetit të personit që e kërkon, me proçedurën përkatëse, caktohet falas një hapësirë e përshtatshme pushimi me sinjalin e posaçëm i cili tregon targën e mjetit të autorizuar për ta shfrytëzuar. Në këtë rast, entet pronare të rrugës duhet të përgatitin dhe të mirëmbajnë në funksion dhe efiçencë të gjitha strukturat për të lejuar dhe thjeshtësuar lëvizjen e pesonave invalidë. Këto vende parkimi, të përcaktuara nga shirita të verdha dhe të shenjuara në sipërfaqen e rrugës nga simbolet e posaçme, duhet të shoqërohen nga një hapësirë e lirë e nevojshme për të lejuar hapjen e sportelit të mjetit, hyrjen dhe daljen nga mjeti dhe hyrjen në trotuar (**skemat 116** dhe **117** aneksi A) (neni 147/5).
- autoambulancat (neni 118/2) **figura II 79/b**
- mjetet që u përkasin forcave të armatosura, atyre të policisë, zjarrfiksëve, policisë bashkiake dhe shërbimeve të tjera të interesit publik dhe të ndihmës së shpejtë, enti pronar i rrugës, e kufizuar për zonat kufitare në shtratin përkatës të rrugës dhe për sipërfaqen tepër të domosdoshme (neni 118/3) **figura II 79/c.**
- periudhat që i përkasin ditëve dhe orëve në të cilat mbizotëron ndalimi për të lejuar veprime pastrimi të rrugës përmes mjeteve pastruese ose me mjete të tjera (**modeli II 6/q2** ose, në version sinjal i përbërë, **model II 8/a**)

Për zgjatjen, fillimin, vazhdimin dhe fundin mund të përdoren modelet normale të parashikuara për sinjalet vertikale (**modeli II 2** dhe **modeli II 5**) (neni 118/2).

NDALIMQËNDRIMI

Sinjali NDALIMQËNDRIMI (**figura II 75**) duhet të përdoret për të treguar vendet ku, **në mungesë të panelit plotësues**, janë ndaluar **përkohësisht** pushimi dhe qëndrimi dhe, gjithsesi, në çfarëdolloj momenti ndalimi i vullnetshëm i mjetit (neni 118/1b).
Nuk janë të nevojshëm as panelet plotësuese me tregues "0-24", as paneli ZONE RIMORKIMI TË DETYRUAR.

Parkimi

Zona ose infrastruktura e vendosur jashtë karrexhatës, e destinuar për pushimin e rregulluar ose jo të mjeteve (neni 3/28 Kodit Rrugor).

Sinjali horizontal

Kufizimi i vendeve të parkimit është kryer përmes vijëzimit në sipërfaqe të shiritave me gjerësi 12 cm që formojnë një drejtëkëndësh, brenda të cilit duhet të parkohet mjeti (neni 147/1).

Kompetencat

Kufizimi i vendeve të parkimit është i detyrueshëm kudo ku ndodhen vendet e parkimit, me vendosje të shpeshtë ose të rrallë (**skemat 118** dhe **119** aneksi A); është i detyrueshëm kur vendet e parkimit janë të disponueshme në një hapësirë përsëgjati (**skema 120** aneksi A) (neni 147/2).

Ngjyrat

Ngjyrat e shiritave të kufizimit të vendeve të parkimit janë (neni 147/3):
- e bardhë për vendet e pushimit pa pagesë;
- e kaltër për vendet e pushimit me pagesë;
- e verdhë për vendet e pushimit të rezervuar.

PARKIMI

Sinjalet vertikale

Sinjali PARKIM (**figura II 76**) mund të përdoret për të treguar një zonë të organizuar ose të pajisur për pushim për një kohë të papërcaktuar, përveç rasteve kur jepet ndryshe (neni 118/1c).

Plotësime

Sinjali mund të pajiset nga panele plotësuese për të treguar me vlerë urdhëruese (neni 118/1c):

- kufizimet e kohës. Në rast se pushimi është i lejuar vetëm për një kohë të përcaktuar duhet të vendoset treguesi i kësaj kohe i pajisur me simbolin e figurës II 172 (disku orar) (skema 121).

- tarifat për parkimin me pagesë. Në rastin e pushimit, qoftë edhe të lejuar vetëm me pagesë, duhet të vendoset treguesi i tarifës orare të pajisur me simbolin e figurës II 171 (parkimmatës) (skema 122).

- skemën e vendosjes së mjeteve.

- kategoritë e mjeteve të pranuara ose të përjashtuara.Në skemën 115 është paraqitur një shembull i sinjaleve në të cilin vlera urdhëruese është e barabartë. Duhet dalluar gjithsesi se i pari (parkim i rezervuar) presupozon ekzistencën e një infrastrukture të veçantë të destinuar për pushim, ndërsa në të dytën (ndalim pushimi me përjashtime), është i vendosur, si rregull, në anë të rrugës në të cilën ka kufizime të pushimit.

- sinjali mund të pajiset me panelin plotësues model II 1 ose model II 4/a për të treguar respektivisht largësinë dhe kategorinë e mjeteve për të cilat rezervohet parkimi (neni 118/4).

Kombinime

Sinjali mund të përfshihet në ato të paralajmërimit dhe të drejtimit (neni 118/1c).

Gjithashtu sinjali PARKIM (**figura II 76**) mund të përdoret në format të reduktuar edhe në kombinim me sinjalin NDALIM PUSHIMI (**figura II 74**) dhe NDALIMQËNDRIMI (**figura II 75**) për të treguar shmangiet nga ndalimet për ato kategori të listuara më përpara (neni 118/4).

PARALAJMËRIM PARKIMI

Sinjali PARALAJMËRIM PËR PARKIM (**figura II 77**) tregon drejtimin që duhet ndjekur për arritur në parkimin më të afërt (neni 118/1ç).

Plotësime

Sinjali mund të pajiset me **panelin plotësues model II 1** ose **model II 4/a** për të treguar respektivisht largësinë dhe kategorinë e mjeteve për të cilat rezervohet parkimi (neni 118/4).

PARKIM KËMBIMI

Sinjali PARKIM KËMBIMI PËR LINJAT E AUTOBUSIT (**figurat II 368÷371**) tregon ose të drejton drejt një parkimi këmbimi të vendosura ose të caktuara afër një stacioni ose fundi të një linje të mjeteve të transportit (përkatësisht autobuz, tram ose metro) ose në vendin më të afërt të itinerareve të këmbësorëve.
Informacione të mëtejshme rreth tipeve të sinjaleve janë të disponueshme në paragrafin kushtuar tyre në kapitullin Sinjalet treguese.

ZONA ANËSORE E QËNDRIMIT

Pjesa e rrugës ngjitur me karrexhatën, e ndarë nga ajo përmes një shirit anësor të ndërprerë dhe që përfshin rrjeshtin e vendeve të pushimit dhe korsinë përkatëse të manovrimit (**skema 123** aneksi A) (neni 3/3 i Kodit Rrugor).

XHEP NDALIMI (SHESHPUSHIM)

Pjesë e rrugës me gjatësi të kufizuar, afër me anën e jashtme të bankinës, e destinuar për pushimin e mjeteve (**figurat II 328** dhe **329**).

Sinjali vertikal

Tregon ekzistencën e një sheshpushimi në krah të rrugës për të kryer një ndalesë. Vendoset rreth 10 m para fillimit të sheshit të pushimit(neni 133/17).

Sinjali horizontal

Shiritat anësore të rrugës janë të ndërprera në përputhje me sheshin e pushimit (neni 139/3). Hapësira tregohet në tabelat e posaçme të kapitullit përkatës.

PENGUESIT E QËNDRIMIT

Penguesit e qëndrimit janë sisteme rrugore të vendosura për të penguar qëndrimin e mjeteve në hapësira ose zona të caktuara. Ato mund të përdoren për të vendosur një ndalim konkret për qëndrimet abuzive (neni 178/1).

Këto sisteme mund të harmonizohen me sistemet rrugore dhe të kryejnë edhe funksione ndihmëse si ato të kufizimit të zonës së këmbësorëve, hapësirës së rezervuar të parkimit, zonave jeshile, etj. (neni 178/2).

Në funksion të sistemeve rrugore, penguesit e qëndrimit janë të tipeve të ndryshme. Midis tyre, enti pronar mund të zgjedhë ato më të përshtatshmet për nevoja të veçanta specifike, traditat lokale dhe për ambientin urban (neni 178/3).

Penguesit e qëndrimit marrin formën e shtyllave, paleteve, kolonave me blloqe, shiritave, vazove të mëdha me lule.

Penguesit e qëndrimit duhet të ushtrojnë një veprim real të menjëhershëm ndaj kalimit qoftë me lartësinë në planin pamor, qoftë me hapësirën ndërmjet një elementi dhe një tjetri, në rastin në të cilin flitet për elementë të veçantë të vendosur përgjatë një perimetri (neni 178/4).

Penguesit e qëndrimit mund të jenë me çfarëdolloj materiali: beton, hekur, gizë, alumin, dru ose plastikë, e padjegshme.

Nuk duhet, qoftë nga forma apo nga karakteristikat, të përbëjnë rrezik për këmbësorët dhe në veçanti për fëmijët (neni 178/5). Penguesit e qëndrimit duhet të jenë të autorizuar nga Ministria që mbulon veprimtarinë e Transportit dhe të vendosen me urdhër të entit pronar të rrugës (neni 178/6).

T A X I

Figura II 375, neni 134

Sinjale vertikale

- sinjali TAXI (**figura II 375**) tregon vendndodhjen e një vendqëndrimi të rezervuar për autovetura në shërbim publik (neni 134/18);
- përmasat normale janë 40x60 dhe ato të mëdha janë 60x90;
- ngjyra e sfondit të tabelës është portokall (neni76/2e), shkrimet janë në ngjyrë të zezë (neni 76/3b).

Sinjale horizontale

- hapësira është e kufizuar nga shirita të verdha dhe e plotësuar nga shkrime horizontate TAXI (neni 134/18);
- shkrimi horizontal TAXI duhet të jetë në ngjyrë të verdhë (neni 146/4).

Për shkrimet horizontale përdoren karaktere sipas **tabelave II 26/a÷d** (neni 146/1).

TRAMVAJ

Sinjale vertikale

Sinjali NDALIM TRAMVAJI (**figura II 359**), tregon pikat e ndalimit të një linje tramvaji.

Hapësira blu që qëndron poshtë kuadratit të bardhë me simbol të zi mund të përdoret për të treguar shërbimet e tranzitit, vendarritjet e tyre dhe oraret e mundshme.

Nëse kjo hapësirë nuk është e mjaftueshme, sinjali plotësohet me një panel **model II 6** me përmasat e **skedës 9** (neni 134/7).

- Sinjali VENDKALIM TRAMVAJI (**figura II 12**) duhet të përdoret për të paralajmëruar, brenda dhe jashtë qendrave të banuara, një linjë tramvaji, të parregulluar me semafor, që takon, kryqëzon ose redukton karrexhatën e destinuar për mjetet (neni 86/1).

- Sinjali PARKIM KËMBIMI ME TRAMVAJIN (**figura II 369**) tregon ose jep një parkim të vendosur afër një stacioni ose një fundi linje (neni 134/15). Përmasat e një tabele të tillë jepen në **skedën 2**.

Ajo duhet të plotësohet me (neni 134/15):

- të dhëna të rëndësishme që i përkasin destinacioneve (në fund të tabelës djathtas);
- të dhëna lidhur me numrin e ndryshëm të linjave të transportit publik të disponueshme (në fund të tabelës djathtas);
- emrin e mundshëm të stacionit përmes **modelit II 3** (jo e domosdoshme) (neni 134/15).

Sinjale horizontale

Për të ndihmuar përdoruesit e rrugës mund të vijëzohen shirita drejtimi mbi kryqëzimet të cilat do të tregojnë kufijtë e pengesave në kthesat e tramvajeve (neni 141/2).

Mbishkrimet TRAMVAJI duhet të jenë në ngjyrë të verdhë dhe gërmat që duhet të përdoren duhet të jenë ato të **tabelave II 26/a÷d** (neni 146/1/4).

SINJALET E PËRKOHSHME

Neni 21 i Kodit Rrugor

Përdoren për të sinjalizuar punime, grumbullime, ngritje kantieri, aksidente rrugore etj, në rrugë në shfrytëzim nga autoritetet kompetente (neni 29/1).

Të përgjithshme

Sinjalet e përkohshme vendosen në pika të përcaktuara saktë në rrugë, me qëllim sigurimin e qarkullimit të mjeteve dhe përdoruesve të tjerë të rrugës, për realizimin pa probleme të punimeve në rrugë.

Çdo sinjal i përkohshëm duhet të jetë në përputhje me situatën në të cilën përdoret dhe për në të njëjtën situatë duhet të korrespondojnë të njëjtët sinjale dhe të njëjtat kritere paraqitje. Në asnjë rast nuk duhet të përdoren sinjalizimi i përkohshëm dhe sinjalizimi i përhershëm, në kundërshtim me njëri – tjetrin. Në këto raste sinjalet e përhershme hiqen.

Me përfundimin e punimeve në rrugë, sinjalet e përkoshme hiqen dhe nëse është e nevojshme, rivendosen sinjalet e përhershme, duke rivendosur situatën për qarkullimin në rrugë si më parë. (neni 29/4,5)

Vendosja

Sinjalet e përkohshme vendosen në krahun e djathtë të rrugës dhe kur e kërkon nevoja edhe në krahun e majtë duke orientuar trafikun.

Çdo punim në rrugë ose ngritje kantieri apo grumbullim materialesh, kur ai zgjat më shumë se shtatë ditë pune, ai duhet të sinjalizohet me vendosjen e një paneli. (figura II 382) (neni 29/6) me këto të dhëna:

a. Enti pronar apo koncensionari i rrugës
b. Të gjitha pikat e dispozitës te pikës 1 deri në 7
c. Emri i subjektit që kryen punimet
d. Kutia postare dhe numri i telefonit të përgjegjësit të kantierit



Figura II.382, nenet 28,29

Në situata emergjence dhe kur kërkohen punime me urgjencë të veçantë, masa e sigurimit për disiplinimin e qarkullimit merren nga enti pronar i rrugës. (neni 29/6,7)

Në rastin e intervaleve të paprogramueshme, domethënë në të gjitha ato raste që nuk hyjnë në aktivitetin e përditshëm të mirëmbajtjes, si dhe në rastet e aksidenteve rrugore, ose fatkeqësive natyrale, organi menaxhues i rrugës ose subjektet e caktuara nga ai, duhet të parapërgatitin skemat dhe udhëzuesit e sinjalizimit të përkohshëm.

Plotësime

Në të gjitha rastet, punimet, kantierët dhe grumbullimet në rrugë parasinjalizohen për të siguruar rrjedhjen e trafikut, me një sistem sinjalesh të përshtatshme për orientimin e trafikut në funksion të tipit të rrugës, shpejtësisë së lejuar të lëvizjes etj. me sinjalin e përkohshëm "PUNIME" (figura II 383) (neni 30/1,2). i montuar në një panel ku janë treguar përmasat e kantierit.

Kur gjatësia e rrugës është më e madhe se 100m, në asnjë rast ky sinjal nuk zëvendëson elementë të tjerë sinjalizues.

Figura II.383, nenet 30,37

Në përputhje me skemën sinjalizuese që hartohet për çdo rast ndërhyrje në rrugë është e domosdoshme të parashikohen sinjalet e mëposhtme : (neni 30/2,3)

a. Sinjale ndalimi:

1. NDALIM PARAKALIMI (figura II 48)
2. KUFIRI MAKSIMAL (figura II 50)
3. NDALOHET PARAKALIMI PËR MJETET ME NGARKESË TË PLOTË, MË TË MADHE SE 3.5 TONË (figura II 52)

b. Sinjale detyruese:

1. DREJTIM I DETYRUESHËM (figura II 80/a,b,c,d,e)
2. PARALAJMËRIM I DREJTIMIT TË DETYRUAR (figura II 80/d,e)
3. DREJTIMET E LEJUESHME (figura II 81/a,b,c)
4. KALIMET E DETYRUESHME (figura II 82/a,b)
5. KALIME TË LEJUESHME (figura II 83)

c. Sinjale të përkohshme:

1.SINJALE NGUSHTIM RRUGE (figura II 384, II 385, II 386, II 387)

2. DOPIO DREJTIM QARKULLIMI (figura II 387)

3. MBYLLJE E NJË OSE DISA KORSISH (figura II 411/a,b,c,d)

4. RRUGË E MBYLLUR (figura II 412/a, II 413/a,b)

5. RIHYRJE NË RRUGË (figura II 412, II 413/c)

6. SINJALE FUNDORE (figura II 70, II 71, II 72, II73)

7. BARRIERA (PENGESA) (figura II 392, II 393/a, II 402)

8. KUFIZUES SPECIAL

9. KONE DHE SHMANGËS FLEKSIBËL (figura II 386)

10.SINJALE HORIZONTALE TË PËRKOHSHME DHE PRAPAREFLEKTUESE

ç. Sinjale të domosdoshme për të paralajmëruar kushte të veçanta në rrugë :

1.MJETE PUNE NË LËVIZJE (figura II 388)

2.RRUGË E DEFORMUAR (figura II 389)

3.MATERIALE TË PAQËNDRUESHME MBI RRUGË (figura II 390)

4. SHENJA HORIZONTALE NË RIPUNIM (figura II 391)

(neni 30/3,4,5)

Ngjyrat

Në sinjalet e përkohshme mbizotëron ngjyra e verdhë e kombinuar me të kuqe, të bardhë dhe të zezë, sipas secilit sinjal.

Nëse shumë sinjale dhe simbole shfaqen në një panel të vetëm, sfondi i sinjalit kompleks (të përbëre) duhet të jetë i verdhë. Bëjnë përjashtim sinjalet komplekse të përdorura në parasinjalet e kantierëve të lëvizshëm, dhe në përgjithësi me drita të trupëzuara, për të vënë në dukje më mirë dritat e verdha.

Me qëllim realizimin e dukshmërisë së sinjaleve vertikale, sidomos në kushtet e dukshmërisë së dobët, rekomandohet përdorimi i ngjyrës së verdhë, me faktorin e ndriçimit më të lartë.

Sinjalizimi i përkohshëm horizontal është me ngjyrë të verdhë me koordinatat trengjyrëshe të fiksuara sipas *Rregullores në Zbatim të Kodit Rrugor*

Sinjalet e ndritshme vertikale, edhe me mesazh të ndryshueshëm, kanë të njëjtin konfigurim të sinjaleve korrespondente vertikale të pandritshme.

Sinjalet me mesazh të ndryshueshëm të tipit alfanumerik kanë shkrim me ngjyrë të verdhë në sfond të zi.

Fenerët (sytë) semaforikë të përdorur në kantiere janë të njëjtë me ato të sinjalizimit të përhershëm.

Udhëzuesit e ndritshëm për të përmirësuar dukshmërinë e mjeteve të sinjalizimit reflektues dhe për të përmirësuar dukshmërinë e natës janë përgjithësisht të përbëra nga fenerë të përdorur veç e veç ose me kombinimet e duhura, me dritë të kuqe fikse, me dritë të verdhë fikse, me dritë të verdhë e cila ka ndriçim me ndërprerje.

Pajisjet e integruara të sinjalizimit horizontal dhe kordonët e mundshëm të vendosur në kufizim të korsive ose të anës së karrexhatës janë me ngjyrë të verdhë.

Sinjalet plotësuese (barrierat, paletat kufizuese, konet dhe përvijuesit e përkulshëm*) janë me ngjyrë të bardhë dhe të kuqe me vendosjen e përshkruar në nenin 20 dhe 21 të Kodit Rrugor si edhe Rregullores në Zbatim të Kodit Rrugor e dhënë nga V.K.M 153 DATË 07.04.2000.*

Rrethimet që përdoren në kantiere janë me ngjyre të kuqe ose portokalli. Të njëjtat rrethime janë shënuar me drita të kuqe fikse dhe me pajisje reflektuese të kuqe.

Përmasat

Përmasat e sinjaleve vertikale, të ndritshme dhe plotësuese janë të njëjta me ato që i korrespondojnë sinjalizimit të përhershëm, me të njëjtën mënyrë përdorimi.
Në këtë manual janë të prezantuara.vetëm përmasat e sinjaleve vertikale të sinjalizimit të përkohshëm.

Sinjalizimi i përkohshëm horizontal ka të njëjtat përmasa me sinjalizimin e përhershëm horizontal, të parashikuara këto për tipin e rrugës, ose pjesën e rrugës që rezulton nga prania e kantierit, gjatë së cilës është vendosur.

Dukshmëria

Të gjitha sinjalet e përdorura në sinjalizimin e përkohshëm duhet të jenë të perceptueshme dhe të lexueshme si ditën ashtu dhe natën, në veçanti sinjalet që kanë anën e përdorimit të realizuar me adeziv (film) mbrapapasqyrues.

Sinjalet e përkohshme natën kanë të njëjtat kushte si ato të sinjaleve vertikale. (neni 79) dhe për barrierat (neni 77/8)

Karakteristikat fotometrike dhe kolorometrike të sinjaleve horizontale të përkohshme dhe sistemeve plotësuese përcaktohen në dispozitë të veçantë.(neni 35/5)

Për të ndihmuar dukshmërinë e mjeteve ndriçuese të sinjaleve gjatë orëve të natës dhe në rastet me dukshmëri të dobët, barrierat e fillimit të zonës së punimeve, duhet të ndriçohen me paisje të posaçme ndriçimi, me ngjyrë të kuqe dhe me ndriçim të fiksuar.

Rrëshqitjet e pjerrta që parashikohen në zonën e punimeve, duhet të plotësohen me sisteme me ngjyrë të verdhë vezulluese, në sinkron apo në progresion (dritat lëvizëse)

Në asnjë rast nuk lejohen të përdoren fenerë apo barriera të tjera drite me flakë. (neni 35/6,7,8)

Përsa i takon sinjalizimit të përkohshëm horizontal duhet t'i referohemi *V.K.M 153 DATË 07.04.2000 neni 34 pika nr.5 dhe nr.6* **me detyrën e garantimit të klasës R5** për rrugët e tipit A, B dhe D dhe **klasën R3 ose R5 për tipe të tjera të rrugësh.**

Mbështetëset dhe mbajtëset

Mbështetëset dhe mbajtëset ose panelet, duhet të fiksohen në mënyrë fikse me një mbështetje dhe të jenë të qëndrueshme.

Mbështetëset e sinjaleve rrugore të përdorura në sinjalizimin e përkohshëm duhet të jenë të njëjta me elementet e përshkruar në nenin 29/3 të Rregullores në Zbatim të Kodit Rrugor.

Përdorimi i materialeve jo metalike duhet të aprovohet gjithmonë nga institucioni përgjegjës. Mund të përdoren mbështetëse ose baza të lëvizshme të tipit të transportueshëm dhe me palosje, mjafton që të kenë aftësinë e qëndrueshmërisë në kushtet e përdorimit.

Mbushjet e mundshme me zhavorr të mbështetjeve duhet të realizohen në rastet kur nuk përbëjnë rrezik ose pengesë për rrjedhjen e trafikut. (neni 31 i Rregullores në Zbatim të Kodit Rrugor).

PENGESA (BARRIERA) NORMALE DHE DREJTIMTREGUESE

Shërbejnë për përcaktimin e kufijve të zonës së rrugës ku do kryhen punime etj. (neni 31/1)

Pengesat janë dy tipesh (neni 31/3):

a. PENGESË NORMALE në formë drejtkëndëshi e ngjyrosur me shirita të alternuar të kuq me të bardhë, me përmasa ku shiriti i kuq është sa 1.2 e shiritit të bardhë, në lartësi nga toka jo më tepër se 80cm. Shiritat janë të pjerrët nga e majta në të djathtë (figura II 392) (neni 31/4)



Figura II.392, neni 31

b. PENGESË DREJTIMTREGUESE në formë drejtkëndëshi me përmasa jo më të vogla se 60x240 cm dhe jo më të mëdha se 90x360 cm, (figura II 393/a)



Figura II.393/a, neni 31

Pengesat drejtimtreguese mund të krijohen nga elementë të veçantë me përmasa 60x60cm deri 90x90cm, prej katër pjesësh që vendosen horizontalisht me bordin e poshtëm në një lartësi jo më pak se 80cm, (figura II 395) të paraprirë dhe ndjekur nga sinjali "KALIM I DETYRUESHËM" (figura II.393/b)



Figura II.395, nenet 31,32

Ngjyrosja është me shirita të alternuar kuq e bardhë në formë shigjete të drejtuar në drejtimin që kërkohet devijimi i trafikut. Gjerësia e shiritave do jetë si në pengesa normale si më sipër. (figura II 393/a, neni 31)

SHMANGËSIT SPECIAL (neni 32)

Përdoren për të treguar kufijtë gjatësor të hyrjes në zonën ku punohet dhe vendosen në rrugë në distancë jo më të vogël se 15 m, nga njëri – tjetri.

PALETA(PIKETA) KUFIZUESE

Ky sinjal ka formën e një paneli katërkëndor me përmasa jo më të vogla se 20x80cm, të vendosura vertikalisht mbi mbajtëse solide, në lartësi nga toka jo më shumë se 30cm.

Ngjyra e panelit është me shirita të alternuar kuq e bardhë duke filluar nga sipër.Gjerësia e shiritit të kuq të jetë 1.2 herë më e madhë se ajo e të bardhit.

Sinjali vendoset në seri, në distancë jo më të vogël se 15m, nga njëri – tjetri, në zonë të përcaktuar. (figura II 394) (neni 32/1a)



Figura II.394, neni 32

Ky sinjal, vendoset në rastet e devijimit të rrugës me kthesë të përkohshme ne kthesa me rreze më të vogël ose të barabartë me 200m. Shih paragrafin "b" "PENGESA DREJTIMTREGUES" (figura II 395)

Intervali i vendosjes së sinjalit njëri pas tjetrit është në funksion të kthesës (neni 32/1b) si më poshtë:

RREZJA E KTHESËS (m)	HAPËSIRA GJATËSORE (m)
deri në 30	5
30 deri 50	10
50 deri 100	5
100 deri 200	20

KONET KUFIZUES

Janë sinjale që përdoren për të kufizuar dhe vënë në dukje zonën ku kryhen punime në rrugë, apo zona ku mund të ndodhin aksidente etj, me kohë zgjatje të shkurtër (neni 33/1).

Materiali i përdorur për prodhimin e tyre mund të jetë material fleksibël gome ose plastike.

Ngjyra me shirita rrethor të alternuar të kuq me të bardhë, duke filluar nga sipër. Koni duhet të ketë një bazë të përshtatshme mbështetëse.

Hapësira e vendosjes së koneve të njëpasnjëshëm merret 12m, kur vendosen në vijë të drejtë dhe 5m, kur vendosen në kthesë.

Përmasa dhe forma jepet në (figurën II 396) (neni 33/1)



Figura II.396, neni 33

SHMANGËS FLEKSIBËL (VIJËZUES TË PËRKULSHËM)

Këto sinjale kanë formë cilindrike vertikale ose prizëm katërkëndor në bazë, me pjesën e sipërme të rrumbullakosur. (figura II 397) (neni 33/2).

Përdoren në kufizimin e drejtimit të lëvizjes në korsi të ngjitura (në një karrexhatë), qofshin ato me një drejtim lëvizje ose në drejtime të kundërta, si edhe për të rrethuar zonën ku kryhen punime me kohë të gjatë veprimi.

Materiali është gome fleksibël ose plastmasi .

Ngjyra është me shirita të alternuar të kuqe me të bardhë, rrathë ose kuadrat të bardhë në faqe në drejtim të trafikut prapareflektues.

Përmasa dhe forma jepet në (figurën II 397)



Figura II.397, neni 33

Intervali i vendosjes së "SHMANGËS FLËKSIBËL" është i njëjtë me atë të sinjalit KON, për çdo 12m, në vijë të drejtë dhe çdo 5m, në kthesa.
Bazamenti i sinjalit duhet të jetë solid që të sigurojë stabilitetin e sinjalit aty ku vendoset.

AUTOMJETE OPERATIVE

Mjetet, makineritë dhe paisjet që përdoren për mirëmbajtjen e rrugës, qofshin ato të lëvizshme apo të palëvizshme duhet të mbajnë në anën e pasme një panel me shirita të badhë dhe të kuqe së bashku me një sinjal "KALIM I DETYRUESHËM "me një shigjetë të drejtuar në anën ku mund të anashkalohet. (figura II 398)



Figura II.398, neni 37

Paneli dhe sinjali është i realizuar me celuloidin prapapasqyrues të tipit të dytë të përshkruar në (nenin 77/10)

Ky sinjal duhet të përdoret edhe në automjetet të cilët në vartësi nga lloji i ngarkesës dhe masa e saj, duhet të lëvizin me shpejtësi të kufizuar (neni 37/1)

Këto mjete gjithnjë duhet të parasinjalizohen në afate të përshtatshme kohore:

a. Në rrugë urbane me paralajmërimin "PUNIME" (figura II 383), me sinjalin "KALIM I DETYRUESHËM" i parapritë ky, nëse është e nevojshme nga sinjalet:

1. "NDALIM PARAKALIMI' (figura II 48)
2. "NGUSHTIM RRUGE" (figura 384,385,386)
3. "NJË KALIMSH I ALTERNUAR" (figura II 41,45)
4. "KUFI MAKSIMAL I SHPEJTËSISË" (figura II 50) nëse kufiri i shpejtësisë është më i vogël se 50km/orë

b. Në rrugë interurbane me sinjalet:

1. "KUFIRI MAKSIMAL I SHPEJTËSISË" në rrugë në zbritje
2. "KALIM I DETYRUESHËM" në numrin e mjaftueshëm për të shmangur dyndjen e trafikut, veçanërisht në rrugë malore (neni 37/2)

KANTIER I LËVIZSHËM
(neni 38)

Kantieri quhet i lëvizshëm, nëse lëviz me një shpejtësi mesatare të zhvillimit të punimeve, i cili mund të variojë nga disa qindra metra në ditë, deri në disa km/orë.

Gjithashtu kantieri i lëvizshëm parasinjalizohet në të dy anët e rrugës nëse është e nevojshme, me sinjalin "PUNIME" dhe "KORSI E LEJUAR", si dhe me një panel të integruar që tregon largësinë e kantierit (figura II 399/ a,b) dhe me shirita të verdhë vezullues.



Figura II.399/a, neni 38



Figura II.399/b, neni 38

Në rastet kur parasinjalizimi është i vendosur në një mjet, mund të përmbajë edhe sinjalin "SINJALIZIM I LËVIZSHËM PARALAJMËRIMI" (neni 38/2a) (figura II 400).



Figura II.400, neni 38

Po ashtu kantierët shoqërohen me sinjalin e lokalizimit, "SINJALIZIM I LËVIZSHËM MBROJTJE", i cili vendoset mbi tokë, dhe zhvendoset në përputhje me ecurinë e punimeve. Sinjali ka formën e një paneli me shirita të bardhë dhe të kuq etj, si në (figurën II 401)



Figura II.401, neni 38

Në kohën kur në kantier nuk punohet, dritat e panelit duhet të ç'aktivizohen dhe vetësinjalizimi (paneli), vendoset në pozicion të palosur (neni 38/2)

PENGESA RRETHUESE PËR PUSETA

Në çdo rast të punimeve në rrugë, kantiere ose grumbullime në to, është e domosdoshem të vendosen sinjale për mbrojtjen dhe paprekshmërinë e këmbësorëve që lëvizin pranë zonave të mësipërme. (neni 39/1)



Figura II.402, neni 39

Ku ka ndërhyrje në puseta ose punime të tjera në rrugë, qoftë edhe për një kohë të shkurtër ato detyrimisht duhet të rrethohen. (neni 39/5) (figura II 402)

Rrethimet duhet të shënohen me drita të forta të palëvizshme si dhe sisteme të vijëzuara me sipërfaqe minimale 50 cm^2, mundësisht me interval në të gjithë perimetrin e rrethuar. (neni 39/2,3)

NGUSHTIMET E RRUGËVE DHE NJËKALIMET E ALTERNUARA
(neni 41)

Në punimet në rrugë, kur ato sjellin nevojën e një ngushtimi të saj, nevojitet vendosja e sinjalit të rrezikut të përkohshëm "NGUSHTIM" i cili mund të jetë në tre versione (figura II 384,385, 386) shih Kapitullin Sinjalet e Rrezikut.

Kur sinjali vendoset pranë zonës së punimeve, gjithmonë pas parasinjalizimeve të tjera, vendoset një panel plotësues ku jepen të dhënat e ngushtimit.

Kur ngushimi i rrugës është më i vogël se 5.6 m, duhet përcaktuar një nga kalimet e alternuar:

a. Kalim i është alternuar me anë të shikimit që mund të jetë:

   1. sinjali i rrezikut "JEP PËRPARËSI NË NJËKALIM TË ALTERNUAR" (figura II 41)

   2. sinjali i rrezikut " E DREJTË PËRPARËSIE NË NJËKALIM TË ALTERNUAR" (figura II 45)

b. Kalim i alternuar i rregulluar nga polic trafiku, bëhet nga dy policë trafiku, të pajisur me tabelat e duhura të vendosur në të dy ekstremet e zonës së ngushtimit .

   Kur njëri nga policët nxjerr anën jeshile të sinjalit (tabelës) për lejimin e trafikut në atë drejtim, tjetri tregon sinjalin e kuq të bllokimit të trafikut nga ana e kundërt. Tabela e policit është ajo e figurës II 403, neni 41/3b



Figura II.403, neni 41

Në mungesë të tabelave të mësipërme, policët e trafikut mund të përdorin edhe flamurë me ngjyrë portokalli fluoreshente, me përmasa jo më të vogla se 80x60cm. Në këtë rast policët e trafikut detyrojnë drejtuesit e mjeteve të lëvizin me shpejtësi të reduktuar dhe të tregojnë vetëkontroll gjatë lëvizjes.

Lëvizja e flamurëve nga të dy drejtimet mund të bëhet edhe me sistem mekanik.

c. Kur nuk është i mundur, përdorimi i dy mënyrave të mësipërme, kalimi i alternuar duhet të realizohet nëpërmjet dy semaforëve, të komanduar me komandim manual ose automatik.

Cikli i ngjyrës së kuqe nuk duhet t'i kalojë dy minuta, me përjashtim të rasteve të veçanta kur ngushtimi ka gjatësi të madhe.
Në zona interurbane impjanti semaforik duhet të paraprihet nga sinjalizimi i rrezikut të përkohshëm "SEMAFOR" figura II 404 (neni 41/3c)

Figura II.404, neni 41

Ngjyra e verdhë vezulluese, vendoset në diskun e vetë të simbolit. Lidhja semafor-central-semafor mund të realizohet me anë të kabllove ose me radiovalë.

Vendosja e semaforit bëhet në krahun e djathtë të ngushtimit, në rast të një trafiku të shtuar, vendoset edhe në krahun e majtë të ngushtimit.

SHMANGËSI I ITINERARIT
(neni 42)

Përdoren në rastet kur i gjithë trafiku ose një pjesë e tij kalon në një vendkalim tjetër nga itinerari ekzistues.

Shmangësit autorizohen nga enti pronar dhe janë:

- të detyrueshëm
- fakultativ

PARALAJMËRIM DEVIJIMI

Sinjali tregon detyrimin për të devijuar plotësisht rrugën. (neni 42/2a) (figura II 405)

Figura II.405, neni 42

Sinjali në kushte normale vendoset në një distancë prej 100m, në rrugë interurbane kryesore dhe autostrada respektivisht 150m dhe 300m (figura II 406)

Figura II.406, neni 42

SINJAL DREJTIMI

Vendoset pas sinjalit të mësipërm për të treguar drejtimin që duhet të ndjekë trafiku (figura II 407)

Figura II.407, neni 42

PARALAJMËRIM SHMANGIE (DEVIJIMI)

Vendoset në kryqëzimet që paraprijnë kantierin, në të cilin vendoset gjatësia e shmangies (neni 42/2c)(figura II 408)

Figura II.408, neni 42

DREJTIM I DETYRUESHËM

Përfaqëson sinjalin për devijim të detyrueshëm, vetëm për një lloj ose për lloje të veçanta mjetesh. Sipas rastit simboli paraqet kategorinë e mjeteve. (figura II 409/a,b)

Figura II.409/a, neni 42

Figura II.409/b, neni 42

DREJTIM I KËSHILLUAR

Përfaqëson sinjalin e një devijimi fakultativ, vetëm për një ose disa kategori të veçanta mjetesh. Sipas rastit sinjali ka simbolin e mjetit që duhet të kryejë devijimin. (figura II 410/a,b)

Figura II.410/a, neni 42

Figura II.410/a, neni 42

KORSI E MBYLLUR OSE TË MBYLLURA

Sinjalet tregojnë mbylljen e një korsie në një rrugë me më shumë se dy korsi me të njëjtin drejtim lëvizjeje.

Mbyllja mund të jetë nga e majta ose nga e djathta sipas rastit. (figura II 411/a,b,c,d)



Figura II.411/a, nenet 30, 42



Figura II.411/a, nenet 30, 42



Figura II.411/b, nenet 30, 42



Figura II.411/b, nenet 30, 42



Figura II.411/c, nenet 30, 42



Figura II.411/d, nenet 30, 42

Sinjali mund të paraprihet nga një paralajmërim i përbërë nga i njëjti sinjal i pajisur me një panel plotësues ku tregohet largësia nga pika ku është vendosur mbyllja e korsisë.

RRUGË AUTOMOBILISTIKE E MBYLLUR

Sinjali vendoset në rastet kur njëra prej rrugëve me karrexhata të ndara mbyllet për trafikun.(figura II 412/a, II 413/a,b)



Figura II.412/a, nenet 30, 42





Figura II.413/a, nenet 30, 42

Figura II.413/b, nenet 30, 42

RIHYRJE NË RRUGË

Sinjali përdoret për të treguar rivendosjen e kushteve të vlefshme normale. (figurat II.412/b, II 413/c)

Sinjali vendoset në pozicionin kur rruga hyn në rrjedhën e saj normale.





Figura II.412/b, nenet 30, 42

Figura II.413/c, nenet 30, 42

PËRDORIMI I KORSIVE

Sinjali mund të përdoret për të treguar korsinë që duhet të marrin mjetet në funksion të kategorisë së mjetit. (figura II 414)



Figura II.414, nenet 30, 42

SINJALET HORIZONTALE TË PËRKOHSHËM DHE SISTEMET PRAPAREFLEKTUESE

Këto sinjale me karakter të përkohshëm, zbatohen në rastet e ngritjes së kantiereve, punimeve apo shmangieve me kohëzgjatje maksimale shtatë ditë.

Sinjalet horizontale me karakter të përkohshëm, janë me ngjyrë të verdhë dhe nuk duhet të jenë në lartësi më të madhe se 5mm, nga sipërfaqja e rrugës. Këto sinjale duhet të jenë lehtësisht të zhvendosshme me mbarimin e punimeve pa lënë gjurmë mbi rrugë.

Këto sinjale, janë shirita gjatësorë të vazhdueshëm dhe të ndërprerë për të treguar ndarjen, pikat e ndarjes etj. (neni 34/1,2,3,4)

Në rastet kur kushtet atmosferike apo të terrenit pengojnë vendosjen e tyre, përdoren sisteme prapareflektuese plotësues me kohëzgjatje nga dy deri në gjashtë ditë.

Këto sisteme përdoren për të përforcuar sinjalin horizontal të përkohshëm në situata të veçanta rreziku.

Ato duhet të reflektojnë një dritë të verdhë e cila nuk duhet te jetë më e lartë se 2.5 cm, mbi tokë.

Këto duhet të jenë solide, lehtësisht të montueshme dhe të zmontueshme

Intervali i vendosjes së sistemeve të tilla është çdo 12m në vijë të drejtë dhe 3 m në kthesë. (neni 34/6)

Sinjalizimi horizontal i përkohshëm është një sistem drejtimi i besueshëm, i vlefshëm dhe efikas, për përdoruesit e rrugës.

Ne ato raste kur rrjedhjet e trafikut janë të ndryshme nga ato të treguara nga sinjalizimi horizontal i përhershëm, është e nevojshme ti paralajmërosh me sinjalizim të përkohshëm horizontal.

Në veçanti:

- Për ndarjen e rrjedhjes së trafikut në të njëjtin drejtim, me korsitë që kanë gjerësi të zvogëluar;
- Për ndarjen e rrjedhjes së trafikut në drejtimin të kundërt me integrimin e sistemeve të sinjalizimit të përhershëm vertikal, ose me përdorimin e karrexhatës në mënyrë të ndryshme nga ato në kushte të përhershme;
- Për të drejtuar përdoruesit e rrugës në një shmangie të përkohshme të lëvizjes, ose në ndërrimet e karrexhatës nga ana e tyre.
- Për të kufizuar rrugët, dhe kalimet e këmbësorëve në pozicione të ndryshme nga ato të përhershmet.

Mënyrat e përdorimit janë të njëjta me ato të sinjalizimit të përhershëm horizontal.

Kujdes i veçante duhet të ndërmerret gjatë vendosjes së saj në terren, meqë një operacion i tillë, në përgjithësi, shoqërohet së bashku me rrjedhjen e trafikut të automjeteve.

I gjithë sinjalizimi i përkohshem, automatikisht duhet të hiqet në të njëjtën mënyre si dhe vendosja e tij, me mbylljen e kantierit. Kjo mund të kushtëzojë zgjedhjen e produkteve për t'u përdorur nga ana e kantierit.

PARIMET E SINJALIZIMIT TË PËRKOHSHËM

Sinjalizimi i përkohshëm ka për detyrë:

- të informojë përdoruesit e rrugës.
- ti drejtojë (ti udhëheqë) përdoruesit e rrugës.
- ti ndërgjegjësojë përdoruesit e rrugës, për një sjellje të përshtatshme me një situatë jo të zakonshme.

Vënia në jetë ose zbatimet për një sinjalizim të përkohshëm duhet të respektojë parimet pasuese:

- përshtatje me rastin specifik të pengesës së përkohshme;
- koherencën e sinjalizimit të përkohshëm me sinjalizimin ekzistues
- besueshmërinë;
- dukshmërinë dhe lexueshmërinë.

PARIMI I PËRSHTATJES

Sinjalizimi i përkohshëm duhet të përshtatet me rrethanat specifike që diktohen nga lloji i punimit në lidhje me infrastrukturën dhe trafikun:

- **Tipin e rrugës dhe karakteristikat e saj gjeometrike** (numri i korsive për drejtim lëvizjeje, prania ose jo e korsive të emergjencës ose bankinave, prania ose jo e trafikndarësve).
- **Natyrën dhe zgjatjen e rrethanave** (pengesa ose rreziqe të papritura, kantiere fikse, kantiere të lëvizshme, devijime të trafikut).
- **Rendësinë e kantierëve** (në funksion të efekteve në qarkullim dhe të zënies vend në rrugë).
- **Dukshmëria e lidhur me elementët gjeometrik të rrugës** (ecuria e planit altimetrik, bimësia, vepra arti, pengesa sigurie etj).
- **Dukshmëria e lidhur me kushte të veçanta ambientale** (kohë me shi, borë, mjegull. etj)
- **Përcaktimi i vendit** (shtrirje urbane ose interurbane, rrugë e sheshtë ose në vepra arti, pika të veçanta si për shembull kryqëzime ose dalje).
- **Shpejtësinë dhe tipin e trafikut** (ndryshueshmëria e tyre gjate veprimtarisë së kantierit mund të jetë burim i përplasjeve në seri).

PARIMI I KOHERENCËS

Në sistemet e sinjalizimit të përkohshëm, çdo sinjal duhet të jetë koherent me situatën për të cilën është caktuar incidenti;

Të njëjtës situate duhet ti përgjigjen të njëjtat sinjale dhe të njëjtat kritere të vendosjes.

Nuk mund të qëndrojnë në veprim sinjalizimi i përkohshëm përkrah sinjalizimit të përhershëm, në kontraditë midis tyre.

Për të shmangur kontraditat e këtyre dy lloj grup-simbolikash duhen errësuar përkohësisht ose hequr sinjalet e sinjalizimit të përhershëm

PARIMI I BESUESHMËRISË

Që të jetë i vlefshëm sinjalizimi duhet të jetë mbi të gjitha i besueshëm nga të gjithë përdoruesit e rrugës. Ai duhet ti informojë ata sa më saktësisht për incidentin, llojin, afërsinë, mënyrën, sasinë, kohën, etj.

Pra duhet që situata e pengesës së përkohshme të jetë vërtetë ajo që ai pret, pasi ka lexuar sinjalet.

Është e nevojshme të sigurohemi, në veçanti, që:

- paralajmërimet e vendosura të jenë efektivisht të justifikuara.
- sinjalizimi ndjek në kohë dhe në hapësirë, lëvizjen (zhvillimin) e kantierit.
- sinjalizimi i përkohshëm për trafikun në kohë, duhet që të zëvendësohet menjëherë me sinjalizimin e përhershëm pasi mbarojnë punimet.

PARIMI I DUKSHMËRISË DHE I LEJUESHMËRISË

Për të qenë të dukshme dhe të lexueshme, sinjalet duhet:

- të kenë formë, përmasa, ngjyrë, simbole dhe përmbajtje ;
- te jenë në numër të kufizuar (nuk duhet të jenë të vendosur në të njëjtën mbështetje ose të vihen pranë më shumë se dy sinjale);
- të jenë të pozicionuar korrektësisht (hapësira e duhur e pamshmërisë, orientimi dhe kujdesi i vertikalitetit);
- të jenë në gjendje të mirë (nuk duhet të përdoren sinjale të dëmtuara).

Në disa kushte për të garantuar dukshmërinë e sinjaleve është e kështillueshme, të përsëriten në të majtë.

Rregullorja

Vendosja e sinjaleve të paralajmërimit duhet të jetë objekt i një ose disa veprimeve të ndërmarra nga autoriteti ose institucionet e ngarkuara për të përballuar situatat e emergjencës.

Zgjedhja e llojit të masave ose veprimeve për kohëzgjatje më shumë se 48 orë, duhet të ratifikohen nga institucioni i varësisë, nëse periudha kohore përkon me dy ditë festive të njëpasnjëshme, ky term shkon në 72 orë.

Në rastin e intervaleve të paprogramueshme, domethënë në të gjitha ato raste që nuk hyjnë në aktivitetin e përditshëm të mirëmbajtjes, si dhe në rastet e aksidenteve rrugore, ose fatkeqësive natyrale, organi menaxhues i rrugës ose subjektet e caktuara nga ai, duhet të parapërgatitin skemat dhe udhëzuesit e sinjalizimit të përkohshëm.

Kryerja e punimeve

Në rastin e kantiereve që vendosen (pozicionohen) në autostradë, rrugë interurbane kryesore, ose rrugë urbane me trafik, punimet duhet të zhvillohen, me shumë ndërresa (turne) gjatë gjithë ditës. Punimet e gjata që nuk janë urgjente, duhet të realizohen në periudhën vjetore me ngarkesë minimale trafiku.

Koordinimi midis institucioneve

Kur kryerja e punëve kërkon devijimin e fluksit të trafikut në rrugë të cilat i përkasin enteve të tjera pronare (ose koncensionare) duhet të kërkohet detyrimisht një marrëveshje paraprake me këto të fundit.

KUFIZIMI I SHPEJTËSISË

(neni 40)

Shkallëzimi i kufizimit të shpejtësisë së fluksit të trafikut.

Shpejtësia tepër e zvogëluar.

Në afërsi të zonës së punimeve ose kantierëve rrugor duhet të sinjalizohen me sinjalin "KUFIRI I SHPEJTËSISË"

Në raste të jashtzakonshme ai duhet të vendoset në vazhdim të sinjalit "PUNIME" qoftë dhe i vendosur në të njëjtën mbajtëse.

Vlera e kufizimit të shpejtësisë nuk duhet të jetë më e vogël se 10 km/orë, me përjashtim të rasteve të jashtzakonshme (neni 40/1)

Në sinjalizimin e përkohshëm kufizimi i shpejtësisë nuk është gjithmonë i nevojshëm meqenëse sinjalet "PUNË" ose "RREZIQE TË TJERA" nga natyra e tyre i diktojnë përdoruesve të rrugës respektimin e një rregulli elementar, atë të kujdesit në parashikimin e mundësisë së përshtatjes së shpejtësisë së lëvizjes së tyre.

Megjithatë për të shmangur sjellje të ndryshme midis përdoruesve, për shkak të një vlerësimi të ndryshëm të rrezikut, është e nevojshme të zgjidhen kritere të njëjta në kufijtë e shpejtësive. Kufizimi i shpejtësisë duhet të zbatohet zakonisht, me zvogëlimin për grupe (nivele) me një shkallëzim 20 Km/h.

Numri i sinjaleve të ndryshme për t'u përdorur do të jetë përgjithësisht në maksimum deri në tre (3).

Kështu, nëse duhet zvogëluar shpejtësia prej 70 km/h (p.sh. nga 130 në 60 km/h në afrim të një ndërrimi të karrexhatës në autostradë) niveli i tretë i zvogëlimit duhet të jetë në 30 km/h (110, 90, 60).

Kriteri i besueshmërisë së shenjave e shmang përdorimin e sinjaleve të kufizimit të shpejtësisë tepër të zvogëluar (5, 10 ose 20 km/h), të cilat nuk janë faktikisht të justifikuara për kushtet e sipërfaqes rrugore, ose të lëvizjes veçanërisht të penalizuara.

Në fund të zonës së punimeve vendoset sinjali "RRUGË E LIRË" ose "MBARIM I KUFIRIT TË SHPEJTËSISË", po ashtu mund të vendoset sinjali i kufirit të shpejtësisë së mëparshme (neni 40/2)

Sinjalizimi

Kufizimi i shpejtësisë i caktohet përdoruesve të rrugës nëpërmjet sinjalit të "KUFIRIT MAKSIMAL TË SHPEJTËSISË".

Përdoruesi i rrugës gjithmonë duhet të dijë përse i kufizohet shpejtësia. Prandaj sinjali i kufirit maksimal të shpejtësisë, nuk duhet të jetë kurrë sinjali i parë i ndeshur nga përdoruesi dhe për këtë duhet të vendoset pas një sinjali rreziku.

Në zonën e kantierit, sinjali i "KUFIRIT TË SHPEJTËSISË" duhet të përsëritet çdo herë që pjesa e rrugës përkatëse (interesuar) është më e gjatë se 10 km. Sinjalizimi i fundit të paralajmërimit është i detyrueshëm dhe zbatohet me një sinjal "MBARIM KUFIZIMI SHPEJTËSIE" ose "RRUGË E LIRË".

Gjithësesi n.q.se paralajmërimi i përhershëm është ai i lidhur me kantierin, atëherë në këtë rast i përket vetëm kufizimi i shpejtësisë, përdorimi i sinjalit "MBARIM KUFIZIMI" nuk është i detyruar. Kufizimi i shpejtësisë i përhershëm do të rivendoset me sinjalin e kufirit maksimal të shpejtësisë së përshtatshme.

VENDOSJA E SINJALEVE DALLUESE

Distanca midis paneleve

Që të nguliten në kujtesë nga përdoruesit, sinjalet duhet të vendosen në një distancë koherente, në varësi të shpejtësisë të caktuar në afrim dhe gjatë kantierit. Mbi të gjitha, sinjalet duhet të jenë të dukshme, prandaj distanca mund të ndryshohet me praninë e skërmiturave (mbulesave me ekran), ose të pengesave si: këmbë ure, kthesa, bimësi, etj. Megjithatë duhet kujdes për vendosjen në varg të sinjaleve, në mënyrë që të shmanget mbimbulimi i tyre.

Sinjalet e afrimit, e pozicionit, e fundit te paralajmërimit

Një projekt i plotë i sinjalizimit të përkohshëm përfshin këto informacione:

- Një sinjalizim të afrimit, i vendosur në krye të zonës së rrezikshme për paralajmërim
- Një sinjalizim të pozicionit, i vendosur menjëherë mbas sinjalit të paralajmërimit dhe gjatë zonës së interesuar;
- Një sinjalizim i mbarimit të paralajmërimit, i vendosur poshtë zonës së interesuar.

Për kantieret e rëndësishme, ose në vende me dukshmëri të dobët dhe të vështirë, sinjalizimi i afrimit mund të paraprihet nga një fener me dritë të verdhë pulsuese (në rrugë me dy drejtime lëvizjeje) ose dy (në rrugë me karrexhata të ndara).

Feneri duhet të ketë diametrin e madh (minimumi 30 cm) duke parashikuar mundësinë e formimit të rradhës (rreshtit).

Vendosja e fenerëve realizohet duke moduluar distancën nga sinjali i parë, në funksion të madhësisë së parashikuar të rreshtit.

